



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 1209/112 prot.

Tiranë, më 15.02.2026

RAPORT

“PËR KRYERJEN E INSPEKTIMIT TEMATIK ME OBJEKT: “MBI KOHËZGJATJEN E GJYKIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE CIVILE, ME PALË KUNDËRSHTARE, TË PËRFUNDUARA NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM SARANDË, PËR PERIUDHËN 01.04.2024-30.06.2024”

Në zbatim të vendimit nr. 19, datë 15.04.2025 “PËR KRYERJEN E INSPEKTIMIT TEMATIK ME OBJEKT: “MBI KOHËZGJATJEN E GJYKIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE CIVILE, ME PALË KUNDËRSHTARE, TË PËRFUNDUARA NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM SARANDË, PËR PERIUDHËN 01.04.2024-30.06.2024”, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Tiranë, Shkurt 2026

INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME MBI RAPORTIN

Titulli:


Raporti i inspektimit tematik me objekt: "Mbi kohëzgjatjen e gjyimit të çështjeve gjyqësore civile me palë kundërshtare të përfunduara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, për periudhën 01.04.2024-30.06.2024".

Data e përgatitjes:

18.02.2026

Përgatitur nga:

Znj. Daniela Sulaj 

Znj. Joana Sorraj 

Për shqyrtim nga:

Inspektori i Lartë i Drejtësisë

Z. Artur Metani

Miratoi Ndryshoi Ktheu

Data 15.02.2026



1. Hyrje

- 1.1. Arsyet e inicimit të inspektimit
- 1.2. Qëllimi i inspektimit
- 1.3. Burimet relevante të së drejtës
- 1.4. Periudha e mbulimit të inspektimit
- 1.5. Objekti i inspektimit
- 1.6. Metodologjia e inspektimit
- 1.7. Periudha e kryerjes së inspektimit
- 1.8. Fazat e zhvillimit të inspektimit
- 1.9. Problematikat e hasura gjatë kryerjes së inspektimit

2. Objekti i kontrollit dhe përshkrimi i të dhënave të administruara

- 2.1. Objekti i kontrollit
- 2.2. Drejtimit e inspektimit
- 2.3. Komunikimi administrativ në kuadër të marrjes së të dhënave të nevojshme për kryerjen e inspektimit

3. Fakte të konstatuara në lidhje me veprimtarinë e gjykatës në raport me parashikimet ligjore/nënligjore për sa i përket rregullave standarde për eficiencën

4. Faktet e konstatuara dhe analiza e të dhënave në lidhje me veprimtarinë administrative

- 4.1. Organizimi i brendshëm dhe funksionimi i gjykatës subjekt inspektimi
- 4.2. Sistemi për menaxhimin e çështjeve
- 4.3. Fakte të konstatuar në lidhje me saktësinë e të dhënave të hedhur në regjistrin fizik si dhe në sistemin elektronik
 - 4.3.1. Kuadri rregullator në lidhje me të dhënat statistikore
 - 4.3.1. Regjistrat civil
 - 4.3.2. Saktësia e të dhënave

5. Analiza e të dhënave dhe gjetjet e inspektimit në lidhje me veprimtarinë gjyqësore të gjykatës objekt inspektimi

- 5.1. Numri i vendimeve të shpallura gjatë periudhës 01.04.2024-30.06.2024
- 5.2. Fakte të konstatuara në lidhje me kohëzgjatjen e çështjeve / kohëzgjatjen mesatare si dhe me mënyrën e përfundimit për çështjet civile me palë kundërshtare të përfunduara gjatë periudhës 01.04.2024-30.06.2024
- 5.3. Fakte të konstatuara në lidhje me objektin e padisë dhe kohëzgjatjen mesatare në varësi të llojit të objektit të padisë
- 5.4. Fakte të konstatuara në lidhje me shkaqet e zgjatjes së proceseve duke ju referuar llojit të objektit të padisë

- 5.5. Fakte të konstatuara në lidhje me çështjet me objekt padie “Kundërshtimi i veprimeve përmbarimore”
- 6. Gjetjet e inspektimit në lidhje me proceset gjyqësore që janë zgjatur përtej afatit dyvjeçar si dhe kërkesat për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit**
- 7. Konkluzione**
- 8. Rekomandime**



1.Pjesa hyrëse

1.1.Arsyet e inicimit të inspektimit

Në mbështetje të nenit 194, pika 4 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen inspektime institucionale e tematike mbi çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyra të prokurorive dhe administratës së prokurorisë, bazuar në kërkesën e motivuar me shkrim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të Ministrit të Drejtësisë, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe në planin vjetor të inspektimeve.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në përmbushje të detyrave të tij të përcaktuara në nenin 147/d, të Kushtetutës, në zbatim të nenit 194, pika 4 dhe nenit 204, pika 1, shkronja "dh", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ka miratuar me vendimin nr. 5, datë 31.01.2025 "Planin e inspektimeve për vitin 2025".

Në këtë kuadër në ushtrim të kompetencave të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për sa i përket kontrollit të veprimtarisë së gjykatave bazuar në vendimin e sipërcituar, është planifikuar zhvillimi i inspektimit tematik me objekt: "Mbi kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve gjyqësore civile, me palë kundërshtare të përfunduara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, për periudhën 01.04.2024-30.06.2024".

Ky inspektim është iniciuar duke pasur parasysh disa rrethana:

- **Së pari**, numrin e lartë të ankesave të paraqitura nga qytetarët me objekt "Tej zgjatjen në kohë të çështjeve civile ku ata kanë cilësinë e palës ndërgjyqëse" dhe në mënyrë të veçantë ankesën e Dhomës Vendore të Avokatisë Sarandë drejtuar Kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë për dëjneni disa institucioneve, një ndër të cilat është edhe Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
- **Së dyti**, nevojën për njohjen dhe vlerësimin e gjendjes faktike të veprimtarisë administrative dhe gjyqësore në disa gjykata të juridiksionit të përgjithshëm në drejtim të planifikimit dhe zhvillimit të seancave.
- **Së treti**, praktikën e konsoliduar në vijimësi të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila ka konstatuar shkelje për mosrespektimin e afatit të arsyeshëm të gjykimit, ndër të cilat përmendim çështjen Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë, Vrioni dhe të tjerë kundër Shqipërisë, Bara & Kola kundër Shqipërisë si dhe ARB sh.p.k kundër Shqipërisë.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në çështjen Bara & Kola kundër Shqipërisë (2021), ka konstatuar shkelje të nenit 6 të Konventës në lidhje me kohëzgjatjen e tepërt të procedurave duke arsyetuar në mënyrë të përsëritur (shih § 70 dhe § 94 të vendimit) se: "Duke e marrë në konsideratë vonesën e kuptueshme të shkaktuar nga reformat e thella në sistemin e drejtësisë dhe nga procesi i vetting-ut,

Gjykata vëren se shtetet kanë detyrim të përgjithshëm që t'i organizojnë sistemet e tyre ligjore për të garantuar respektim të kushteve të parashikuara në nenin 6, duke përfshirë edhe një seancë të drejtë dëgjimore brenda një afati të arsyeshëm (shih Krastanov kundër Bullgarisë 30 shtator 2004”.

Gjithashtu në vendimin ARB sh.p.k., kundër Shqipërisë (2025), Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut thekson se arsyetimi i kohëzgjatjes së procedurave përcaktohet mbështetur në rrethanat e çështjes dhe referuar kritereve të përcaktuara në praktikën gjyqësore të gjykatës, veçanërisht kompleksitetit të çështjes, sjelljes së kërkuarit dhe të autoriteteve përkatëse, dhe se çfarë ishte në rrezik për kërkuarin në fjalë.

1.2. Qëllimi i inspektimit:

Inspektori i Lartë i Drejtësisë nëpërmjet këtij inspektimi synon të tërheq vëmendjen e gjyqtarëve që ushtrojnë funksionin pranë gjykatës objekt inspektimi por edhe pranë të gjitha gjykatave të tjera, se gjykimi brenda një afati të arsyeshëm është një e drejtë kushtetuese e individëve dhe në këtë kontekst gjyqtarët duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme në drejtim të organizimit të proceseve gjyqësore në mënyrë që gjykimet të përfundojnë brenda një afati të arsyeshëm.

1.3. Burimet relevante të së drejtës

Burimet e të drejtës së brendshme, në të cilën është mbështetur puna e inspektorëve, lidhur me objektin e inspektimit janë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë¹.
- Ligji nr. 115/2016, datë 03.11.2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”², me ndryshimet përkatëse.
- Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”³, me ndryshimet përkatëse.
- Kodi i Procedurës Civile të RSH⁴, me ndryshimet përkatëse.
- Kodi Civil i R.SH, me ndryshimet përkatëse.

¹ Neni 42, pika 2 “Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”.

² Neni 2 “Sistemi i drejtësisë në Republikën e Shqipërisë qeveriset bazuar në parimet e pavarësisë, llogaridhënies, transparencës dhe eficiencës”.

³ Neni 74 pika 2 “Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës matet duke u bazuar në treguesit për respektimin e afateve ligjore, plotësimin e standardeve minimale kohore, kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, në rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore dhe kohën mesatare për marrjen e vendimit përfundimtar gjyqësor ose të prokurorisë për një çështje.

⁴ Neni 4 “Gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor. Për këtë qëllim, në bazë të kompetencave që i jepen nga ky Kod, vendos për afatet dhe urdhëron marrjen e masave të nevojshme”.

Neni 145 pika 1 “Afatet për kryerjen e veprimeve procedurale caktohen nga ligji dhe kur ky e lejon edhe nga gjykata”.

Neni 399/1-399/12 “Gjykimi i kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit”.

- Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në R.SH⁵, me ndryshimet përkatëse.
- Ligji nr. 9969, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, me ndryshimet përkatëse.
- Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 47, datë 11.02.2021 “Për miratimin e “Udhëzuesit” për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe eficiencës së gjykatave”.
- Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 148, datë 29.03.2023 “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e parë, më zyrë shërbimi”.
- Raportet vjetore të Këshillit të Lartë Gjyqësor mbi gjendjen e sistemit gjyqësor.
- Analiza vjetore për vitin 2024 e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.
- Rregullore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë miratuar me Urdhrin nr. 6, datë 24.01.2017 të Kryetarit të Gjykatës.

Burimet e të drejtës ndërkombëtare:

- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe praktika e Gjykatës për sa i përket “Shkeljes së afatit të arsyeshëm” në kuptim të nenit 6 të kësaj konvente.
- Opinionet e Këshillit Konsultativ për Gjyqtarët Evropianë.
- Opinionet dhe Raportet e Komisionit Evropian për Eficiencën në Drejtësi (CEPEJ).

1.4. Periudha e mbulimit të inspektimit

Inspektimi tematik përfshiu veprimtarinë e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë për periudhën 01.04.2024-30.06.2024.

1.5. Objekti i Inspektimit

Çështjet gjyqësore objekt i këtij inspektimi do të jenë ato çështje gjyqësore të cilat përkufizohen si “**çështje gjyqësore civile me palë kundërshtare**” në referim të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 47, datë 11.02.2021 “Për miratimin e “Udhëzuesit” për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe eficiencës së gjykatave”.

⁵ Neni 5, pika 4 “Gjykatat funksionojnë në mënyrë transparente, të shpejtë dhe efikase”.

1.6 Metodologjia e inspektimit

Duke iu referuar volumit të të dhënave të administruara, kemi përzgjedhur një metodologji të përshtatshme inspektimi me qëllim analizimin e të gjithë elementeve të rëndësishëm që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e gjykimeve civile me palë kundërshtare, analizuar kjo kohëzgjatje në raport me afatin ligjor dhe afatin e arsyeshem të gjykimit, me kompleksitetin e çështjes në varësi të llojit të objektit të padisë, por dhe në raport me gjendjen e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, për sa i përket organikës dhe ngarkesës gjatë kohës së gjykimit.

Në kuadër të identifikimit të faktorëve që ndikojnë në efektivitetin e procesit por edhe në kohëzgjatjen e tij në varësi të llojit të objektit të padisë janë përzgjedhur si “çështje kampion” 2 (dy) çështje gjyqësore përkatësisht një çështje për të cilën procesi ka zgjatur më pak dhe një çështje për të cilën procesi ka zgjatur më shumë në raport me çështjet e tjera të të njëjtit lloj.

Çështjet për të cilat gjykimi ka përfunduar brenda një afati të shkurtër janë analizuar me qëllim nxjerrjen në dukje të praktikave më të mira në drejtim të gjykimit efikas si dhe identifikimin dhe promovimin e metodologjive që kontribuojnë në rritjen e eficiencës së procesit gjyqësor.

Kjo lloj metodologjie vjen në harmoni dhe me “Metodologjinë e inspektimit” të miratuar me Urdhrin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nr. 121, datë 30.12.2022 për sa i përket qëllimit në tërësi të inspektimeve tematike dhe vlerave që duhet të përcjellin këto inspektime.

1.7. Periudha e zhvillimit të inspektimit

Ky inspektim është kryer gjatë periudhës kohore 15.04.2025 – 15.02.2026⁶, dhe realizimi tij është zhvilluar në disa faza.

1.8. Fazat e zhvillimit të inspektimit

1) Faza e parë “Përgatitja e planit të punës, hartimi i kërkesave për informacion dhe akte, si dhe zhvillimi i verifikimeve apo vizitave pranë gjykatës”. Kjo fazë ka përfshirë hapat si më poshtë:

- i) Përgatitja e planit të punës.
- ii) Përgatitja e shkresave drejtuar institucionit objekt inspektimi.
- iii) Administrimi i dokumentacionit të ardhur në përgjigje të kërkesave të ILD-së.

2) Faza e dytë “Përpunimi i të dhënave dhe informacionit të mbledhur”. Kjo fazë ka përfshirë hapat si më poshtë:

⁶ Afati është shtyrë deri në datë 15.02.2026 për shkak se është kërkuar dokumentacion shtesë pranë gjykatës subjekt inspektimi



- i) Përpunimi i dokumentacionit administrativ dhe studimi i materialit.
- ii) Kryerja e verifikimeve dhe vizitave në ambientin e gjykatës ku grupi i inspektorëve ka kryer intervista gjysmë të strukturuar me Kancelarin. Gjithashtu, gjatë kësaj vizite janë administruar të dhëna që kanë rezultuar të nevojshme nga studimi i materialit të vënë në dispozicion me shkresë nga gjykata.

3) Faza e tretë “*Hartimi i raportit të inspektimit*”

- i) Hedhja e të dhënave si dhe hartimi i pjesëve të veçanta të raportit.
- ii) Hartimi i raportit, i cili dërgohet për shqyrtim pranë Inspektorit të Lartë të drejtësisë.

Pas shqyrtimit dhe miratimit të Raportit nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do të kalohet në fazën e fundit:

4) Faza e katërt: “*Ndjekja e rekomandimeve*”

- i) Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të inspektimit.

Për kryerjen e inspektimit sipas vendimit nr.19, datë 15.04.2024 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë u angazhuan inspektorët znj. Daniela Sulaj dhe znj. Joana Sorraj. Gjithashtu me qëllim rritjen e eficiencës së grupit të inspektimit dhe miradministrimit të procesit, me të njëjtin vendim është caktuar si kryetar grupi inspektorë znj. Daniela Sulaj.

1.9. Problematikat e hasura gjatë mbledhjes së të dhënave dhe përpunimit të tyre në funksion të procesit të inspektimit

Gjykata ka vënë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar nga grupi i inspektimit. Në kuadër të mbarëvajtjes së punës, si dhe në kushtet kur konstatuam mospërputhje midis informacionit të përcjellë dhe numërorit të vendimeve civile me RIV-et përkatëse, kemi kërkuar nga gjykata informacion dhe dokumentacion në lidhje me sqarimin e këtyre mospërputhjeve. Në vijim gjykata na ka vendosur në dispozicion informacionin sqarues si dhe dokumentacionin shtesë.

2. Objekti i kontrollit dhe përshkrimi të dhënave të administruara

2.1. Objekti i kontrollit

Objekti i kontrollit është inspektimi i veprimtarisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë (*më poshtë referohet edhe shkurt: “gjykata”*), për sa i përket kohëzgjatjes së gjykimit të çështjeve gjyqësore civile, me palë kundërshtarë, të përfunduara gjatë periudhës kohore 01.04.2024-30.06.2024.

Kategorizimi i “çështjeve gjyqësore” për qëllim të udhëzimit të sipërcituar i referohet kategorive universale të çështjeve CIVILE / PENALE / ADMINISTRATIVE. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë është kompetente për gjykimin e çështjeve civile, të cilat për qëllime organizative dhe statistikore klasifikohen në dy

kategori kryesore: “Çështje civile me palë kundërshtare” dhe “Çështje civile pa palë kundërshtare”.

Duke qenë se objekti i inspektimit janë “**çështjet civile me palë kundërshtare**”, më poshtë po pasqyrojmë mënyrën se si janë nën kategorizuar këto çështje për efekt të të dhënave statistikore referuar vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.47, datë 11.02.2021 “Për miratimin e “Udhëzuesit” për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe eficiencës së gjykatave”.

Kategoria “A” e “çështjeve gjyqësore me palë kundërshtare” ndahet në disa nënkategori si më poshtë:

A. Çështje civile me palë kundërshtare

A.1. “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare” përfshin çështje të cilat iniciohen me kërkesë padi duke përjashtuar çështjet që përfshihen në kategoritë e mëposhtme:

A.2. “Familjare me palë kundërshtare” përfshin por pa u kufizuar në to çështjet si më poshtë:

-Padi për pavlefshmërinë e martesës (neni 43 i K. Familjes); Padi për zgjidhjen e martesës (neni 129 e vijues); Padi për njohjen dhe kundërshtimin e amësisë ose atësisë (nenet 177,178,179,181,183-188 të Kodit të Familjes); Padi për kërkimin e detyrimit për ushqim (neni 199); Padi për përcaktimin ose ndryshimin e detyrimit për ushqim ndaj fëmijës; Padi për heqjen ose kthimin e përgjegjësisë prindërore, përcaktimin e përgjegjësisë prindërore të fëmijës së lindur jashtë martese (neni 227, 228 i K. Familjes); Padi për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes dhe/ose urdhrit të mbrojtjes; çështje të tjera.

A.2.1. Ndërsa të dhënat për paditë me objekt “Zgjidhje martese” raportohen më vete, ku futen çështjet e parashikuara nga Kodi i Familjes por pa u kufizuar si më poshtë:

Zgjidhja e martesës në bazë të neneve 129-131 të Kodit të Familjes; Zgjidhja e martesës me kërkesën e njëjës prej palëve, nenet 132-140 të Kodit të Familjes; Çështje të tjera.

A.3. “Tregtare me palë kundërshtare” përfshin por pa u kufizuar në to sa më poshtë:

-Kërkesë padi të referuara në ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”; në ligjin “Për falimentimin” 110/2016; Zhvlerësimi i çeqeve/letra me vlerë etj., sipas neneve 337-346 të K.Pr.Civile.

A.4. “Marrëdhënie pune” përfshin të dhënat për konflikte gjyqësore që burojnë nga marrëdhëniet e punës të tilla si:

-Paditë për shpërblimin e dëmit që vijnë nga zgjidhja e marrëdhënieve të punës; Për pavlefshmërinë e zgjidhjes së marrëdhënies së punës; Padi për shpërblimin e dëmit të shkaktuar gjatë marrëdhënies së punës; Çështje të tjera.

2.2. Drejtimet e inspektimit

Fokusi i inspektimit tematik u përqendrua kryesisht në gjashtë drejtime kryesore:

- a) Numrin e përgjithshëm të vendimeve të shpallura në lidhje me gjykimet me palë kundërshtare gjatë periudhës 01.04.2024-30.06.2024.
- b) Numrin e përgjithshëm të gjykimeve me palë kundërshtare të cilat janë gjykuar përtej afatit të arsyeshëm.
- c) Numrin e përgjithshëm të çështjeve për të cilat është konstatuar shkelje e afatit të arsyeshëm.
- d) Identifikimin e shkaqeve të zgjatjes së gjykimeve.
- e) Analiza e ecurisë dhe dinamikës së kohëzgjatjes së çështjeve në varësi të llojit të objektit të gjykimit për periudhën e përcaktuar në inspektim.
- f) Analiza e ecurisë dhe e kohëzgjatjes së çështjeve për çështjet që kanë zgjatur më tepër se dy vjet.

Inspektimi tematik filloi me fazën e parë, hartimin dhe dërgimin e kërkesave për marrjen e informacionit dhe dokumentacionit të nevojshëm pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

2.3. Komunikimi administrativ me gjykatën subjekt inspektimi në kuadër të marrjes së të dhënave të nevojshme për kryerjen e inspektimit.

Në kuadër të kryerjes së inspektimit është kërkuar⁷ nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, informacioni dhe dokumentacioni si më poshtë:

- a. Kopje të njësuara të numërorit të vendimeve në lidhje me çështjet civile me palë kundërshtare, të shpallura në harkun kohor 01.04.2024 – 30.06.2024.
- b. Kopje të njësuara të RIV (Regjistrit të Veprimeve) për secilën nga çështjet civile me palë kundërshtare të shpallura në harkun kohor 01.04.2024 – 30.06.2024.
- c. Informacion statistikor në lidhje me gjykimet me palë kundërshtare të përfunduara gjatë periudhës kohore 01.04.2024 – 30.06.2024, duke përcaktuar për secilën çështje në formë tabelore datën e paraqitjes së kërkesëpadisë, datën e regjistrimit të çështjes, objektin e padisë, datën e shortit dhe gjyqtarin e caktuar me short, datën e rishortimit (nëse çështja është rishortuar) dhe gjyqtarin e caktuar, numrin e seancave totale të gjykimit, koha e pezullimit nëse çështja është pezulluar, datën e shpalljes së vendimit, mënyrën e përfundimit (nëse padia është pranuar, rrëzuar, pushuar), kohëzgjatjen e gjykimit (e llogaritur në ditë).
- d. Informacion statistikor i dhënë për të gjitha çështjet me palë kundërshtare të përfunduara në këtë gjykatë gjatë periudhës 01.04.2024-30.06.2024, sipas informacionit statistikor të përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 4, të këtij

⁷ Shkresa e ILD-së nr.1209/3 prot., datë 17.04.2025

- vendimi për trendin e përfundimit të gjyqimit jashtë afatit të arsyeshëm 2 - vjeçar në referim të nenit 399/2 të Kodit të Procedurës Civile.
- e. Informacion statistikor i dhënë për të gjitha çështjet me palë kundërshtare të përfunduara në këtë gjykatë gjatë periudhës 01.04.2024-30.06.2024, për trendin e përfundimit të këtyre gjykimeve me palë kundërshtare, në varësi të llojit të çështjes objekt gjykimi.
 - f. Informacion statistikor i dhënë për secilin gjyqtar për të gjithë çështjet me palë kundërshtare të përfunduara gjatë periudhës 01.04.2024-30.06.2024, për trendin e përfundimit të gjyqimit jashtë afatit të arsyeshëm 2 - vjeçar në referim të nenit 399/2 të Kodit të Procedurës Civile.
 - g. Të dhëna në lidhje me kërkesat me objekt "Konstatim shkelje dhe përshpejtim procedurash" në lidhje me gjykimet me palë kundërshtare të përfunduara gjatë periudhës kohore 01.04.2024 – 30.06.2024 (në referim të nenit 399/6, pika 1, të Kodit të Procedurës Civile) dhe vendimet e Gjykatës së Apelit në lidhje me këto kërkesa.
 - h. Të dhëna në lidhje me kërkesat me objekt "Shpërblim dëmi" të paraqitura pranë kësaj gjykate në lidhje me gjykimet me palë kundërshtare të përfunduara gjatë periudhës kohore 01.04.2024 – 30.06.2024 (në referim të nenit 399/6 pika 2 të Kodit të Procedurës Civile) dhe vendimet e Gjykatës në lidhje me këto kërkesa.
 - i. Kopje të akteve nënligjore që rregullojnë mënyrën e organizimit dhe administrimit të gjykatës.
 - j. Çdo informacion/dokumentacion tjetër, i cili do të dalë i nevojshëm gjatë kryerjes së inspektimit.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë⁸ dokumentacionin e kërkuar. Në lidhje me pikën g) dhe h) gjykata na ka informuar se në gjykatë nuk ka pasur kërkesa me objekt "Konstatim shkelje dhe përshpejtim procedurash" si dhe kërkesa me objekt "Shpërblim dëmi".

Gjithashtu në ambientin e gjykatës u morën dhe u bënë pjesë e materialeve të inspektimit: pasqyra e numrit të punonjësve, sipas strukturës organizative dhe organike në fakt, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë për muajt Prill, Maj, Qershor, Rregulloren e Brendshme "Për administrimin e Brendshëm Gjyqësor" miratuar me urdhrin nr. 6, datë 24.01.2017, raportet tremujore bazuar në vendimin e KLGJ-së nr. 25, datë 07.02.2019, informacion tabelor lidhur me natyrën e vendimmarrjes, numrin e çështjeve të përfunduara brenda afatit 2 vjeçar dhe jashtë (shpërndarë kjo e dhënë sipas gjyqtarëve) dhe Raport analiza vjetore e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë për vitin 2024, ngarkesa e gjyqtarëve për periudhën objekt inspektimi.

Në kuadër të mbarëvajtjes së punës, si dhe në kushtet kur konstatoam mospërputhje midis informacionit të përcjellë dhe numërorit të vendimeve civile me RIV-et përkatëse, kemi kërkuar nga gjykata informacion në lidhje me sqarimin e këtyre mospërputhjeve.

⁸ Shkresa me nr. 405/1 datë 07.05.2025

Në vijim Gjykata⁹ ka përcjellë pranë ILD-së informacion dhe dokumentacion shtesë në lidhje me organigramën e gjykatës si dhe informacion statistikor në format elektronik. Gjithashtu gjykata ka sqaruar ndër të tjera se: *“mospërputhja e të dhënave midis numërorit të vendimeve civile dhe tabelës statistikore për çështjet civile me palë kundërshtare është për arsye se në numëror pasqyrohen të gjithë vendimet që regjistrohen në regjistrin themeltar të çështjeve civile (nuk numërtohen kërkesa të veçanta si kërkesa për ndreqje gabimi, përjashtim gjyqtari, kërkesë për lëshim urdhëri ekzekutimi). Një pjesë e çështjeve të numërtuara janë çështje pa palë kundërshtare por me kërkuar dhe person të tretë si (vërtetimet e faktit). Po ashtu në numërorin e vendimeve civile nuk pasqyrohen vendimet me objekt “Lëshim urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes” dhe “Vërtetimi i urdhrit të mbrojtjes”.*

Gjykata ka dërguar në format Excel të dhënat në lidhje me “Kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve gjyqësore me palë kundërshtare të përfunduara gjatë periudhës kohore 01.04.2024-30.06.2024”. Në tabelën Excel janë të pasqyruara gjithsej si të regjistruara 170 vendime civile me palë kundërshtare.

Në mënyrë që analizimi i të dhënave të ishte sa më gjithëpërfshirës, objektiv dhe shterues, përveç të dhënave të sjella nga gjykata si dhe të dhënave të marra pranë kësaj gjykate, nga grupi i inspektimit u morën dhe të dhëna të përgjithshme të sistemit të drejtësisë në vend dhe konkretisht raporti vjetor i Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2024.

3. Fakte të konstatuara në lidhje me veprimtarinë e gjykatës në raport me parashikimet ligjore/nënligjore për sa i përket rregullave standarde për eficiencën

Kodi i Procedurës Civile në R.SH përcakton rregulla të detyrueshme për gjykimin e mosmarrëveshjeve civile. Gjykata ushtron të gjitha të drejtat e parashikuara në këtë Kod që janë të nevojshme për zhvillimin sa më të mirë të procesit gjyqësor dhe ka për detyrë të zhvillojë një proces të rregullt ligjor. Për këtë qëllim, në bazë të kompetencave që i jepen nga ky Kod, gjykata vendos për afatet dhe urdhëron marrjen e masave të nevojshme¹⁰. Afatet për kryerjen e veprimeve procedurale caktohen nga ligji, dhe kur ky e lejon edhe nga gjykata¹¹. Gjykimi i një çështjeje në gjykatë fillon me paraqitjen e kërkesëpadisë me shkrim¹².

Ndonëse Kodi i Procedurës Civile i miratuar me ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 ka pësuar ndryshime ndër vite, vlerësojmë të ndalemi tek ndryshimet që ka pësuar ky Kod në vitin 2017, duke pasur parasysh se këto ndryshime u iniciuan si rezultat i gjetjeve në Dokumentin e Analizës për Sistemin e Drejtësisë në R.SH që kishin të bënin në mënyrë të posaçme me zvarritjen e proceseve gjyqësore civile. Disa nga këto gjetje të pasqyruara

⁹ Shkresa nr.405/2 datë 05.11.2025

¹⁰ Neni 4 i K.Pr.Civile

¹¹ Neni 171/a i K.Pr.C: “Gjykata cakton seancat dhe afatet brenda të cilave palët dhe personat e tjerë të thirrur prej saj duhet të kryejnë aktet procedurale dhe veprime të tjera të kërkuara prej saj”.

¹² Neni 153 i K.Pr.Civile.

në këtë dokument ishin: mosrespektimi i duhur i rregullave për njoftimin e palëve i cili është evidentuar si një nga shkaqet kryesore të dëmtimit të eficiencës; adresat jo të sakta; mungesa e aksesit të gjykatave në të dhënat e adresave në nivel qendror dhe vendor; mungesa e një sistemi të efektshëm për ndjekjen e historikut të një çështje ka pasjellë procese gjyqësore civile paralele bazuar në të njëjtin subjekt; evidentim i mangësive të dispozitave ligjore procedurale civile në lidhje me njoftimin e vlefshëm të akteve; tendenca e gjyqtarëve për të shtyrë seancat veçanërisht për shkak të mungesës së një pale dhe mungesa e legjislacionit për të rregulluar këtë problem; mungesa e parashikimit ligjor për gjykimin e padive me vlerë të vogël; evidentimi i diskrecionit të gjyqtarit për shtyrjen e seancave gjyqësore si dhe mungesa e përcaktimit të qartë në kod e gjykimin në mungesë. Për sa më sipër referuar, ndryshimet dhe shtesat që pësoi Kodi i Procedurës Civile me hyrjen në fuqi të ligjit nr.38/2017, kishin për qëllim të evitonin problematikat e konstatuara dhe të nxisnin eficientë dhe efektshmërinë e sistemit të drejtësisë¹³. Në këtë kontekst, u parashikuan në Kodin e Procedurës Civile rregullime të detajuara që kanë të bëjnë me: Zgjidhjen e çështjes jo vetëm me pajtim por edhe me ndërmjetësim (neni 25 dhe neni 158/ç i K.Pr.C); me abuzimin me të drejtat në proces (neni 34 i K.Pr.C); bashkimi i çështjeve/padive (neni 57); u parashikuan rregulla më të detajuara në lidhje me “thirrjen në gjykatë” dhe njoftimin shkresor të akteve (neni 129,130,131); u shtuan rregulla në lidhje me mënyrën e njoftimit me shpallje publike (neni 133/a); rregulla në lidhje me përcaktimin e personit të autorizuar për marrjen e njoftimeve (neni 133). Gjithashtu u parashikuan në mënyrë kronologjike veprimet e nevojshme për tu kryer nga gjyqtari për sa i përket vlerësimit të kushteve të kërkesëpadisë dhe në vijim veprimet e nevojshme paraprake para caktimit të seancës përgatitore ndër të cilat përmenden këto veprime: gjyqtari përjashton paditësin nga tarifa gjyqësore sipas rastit; cakton provat që do të merren në shqyrtim në seancë gjyqësore; cakton ekspertin të cilin ua njofton palëve; vendos për marrjen e provave dhe informacioneve tek të tretët sipas rastit; vendos marrjen e masave për sigurimin e padisë, sigurimin e provës, pezullimin e gjykimin, vendos për pushimin e gjykimin, bashkimin e padive në një gjykim të vetëm, vendos në lidhje me thirrjen e personit të tretë në gjykim, gjithmonë sipas rastit, në përputhje me parashikimet e Kodit.

Gjithashtu Kodi i Procedurës Civile pësoi ndryshime edhe për sa i përket dispozitave në lidhje me seancën përgatitore dhe seancën gjyqësore.

Konkretisht për sa i përket seancës përgatitore në Kod janë parashikuar rregulla më të detajuara që përcaktojnë detyrimin (neni 158/b, pika 1 K.Pr.Civile) por edhe diskrecionin e gjyqtarit sipas rastit për të caktuar seancë përgatitore (neni 158/b, pika 2 K.Pr.Civile).

Ndërsa për sa i përket “Urdhrit për caktimin e seancës gjyqësore” janë përcaktuar elementët që duhet të përmbajë urdhri si dhe fakti se njoftimi drejtuar dëshmitarëve, përkthyesit, ekspertit, duhet të përmbajë edhe paralajmërimin për sanksione, sipas ligjit, për mosparaqitje në seancë pa shkak të ligjshëm. Gjithashtu nxjerrja e “urdhrit për

¹³ Shiko raportin për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8116 datë 29.03.2016 “Kodi i procedurës civile i R.SH”, i ndryshuar.

caktimin e seancës gjyqësore” është parashikuar si rregull, si një afat limit për kryerjen e një serë veprimesh procedurale sikurse mund të përmendim veprimet e parashikuara nga neni 57 të K.Pr.C¹⁴, neni 61 të K.Pr.C¹⁵; neni 160 të K.Pr.C¹⁶; neni 186 i K.Pr.C (pretendime për prova/fakte, të reja) si dhe nenet 190,191,192,193 të K.Pr.C¹⁷ në lidhje me pjesëmarrjen e personave të tretë në gjykim thirrja e të cilëve mund të kryhet derisa nuk është nxjerrë urdhri për caktimin e seancës gjyqësore.

Përveç parashikimeve ligjore të përmendura në pjesën hyrëse të këtij raporti (shih burimet relevante të së drejtës) si dhe normave procedurale civile, ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në nenin 89, shkronja b), në lidhje me funksionet e Këshillit të Lartë Gjyqësor për sa i përket administrimit të gjykatave, përcakton ndër të tjera se: “*Këshilli i Lartë Gjyqësor kujdeset për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve që lidhen me administrimin gjyqësor duke ushtruar kompetencat e mëposhtme:...****b) monitoron dhe menaxhon ngarkesën e gjyqtarëve dhe të gjykatave, kohëzgjatjen e çështjeve dhe aspekte të tjera të administrimit gjyqësor, bazuar në të dhënat e mbledhura përmes sistemit të menaxhimit të çështjeve, me qëllim përmirësimin e produktivitetit të gjykatave dhe uljen e ngarkesës së gjyqtarëve dhe nëpunësve civilë gjyqësorë***”.

Gjithashtu Këshilli i Lartë Gjyqësor gëzon autoritetin në bazë të ligjit¹⁸ për të miratuar rregulla standarde për funksionimin e brendshëm të gjykatave. Rregullat standarde të gjykatave përmbajnë norma në lidhje me **strukturën e gjykatave, eficiencën dhe cilësinë e drejtësisë.**

Rregullat standarde për eficiencën në sistemin e drejtësisë, në referim të nenit 94, pika 4, të ligjit nr.115/2016, përfshijnë ndër të tjera parashikimet për:

“a) afatet standarde kohore për gjykimin e llojeve të ndryshme të çështjeve gjyqësore, përfshirë, kur është e mundur, edhe afatet për fazat kryesore të procedurës, për ekzekutimin e vendimeve, duke mbajtur parasysh organizimin gjyqësor dhe normat procedurale;

b) rregullat standarde që do të përdoren nga gjykatat për përcaktimin e afateve kohore, duke mbajtur parasysh kompleksitetin e çështjeve, me qëllimin për të përmirësuar në vijimësi sistemin e menaxhimit të çështjeve”;

c) veprimet standarde që duhet të ndërmerren në rastet kur shqyrtimi i çështjes tejkalon afatet;

¹⁴ Bashkimi i çështjeve mund të bëhet derisa nuk është nxjerrë urdhri për caktimin e seancës gjyqësore.

¹⁵ Në rastet e tjera, mungesa e kompetencës tokësore mund të merret parasysh vetëm me kërkesë të palëve, derisa nuk është nxjerrë urdhri për caktimin e seancës gjyqësore.

¹⁶ Kundërpadia mund të paraqitet derisa nuk është nxjerrë urdhri për caktimin e seancës gjyqësore, sipas nenit 158/c të këtij Kodi.

¹⁷ Gjykata, kur çmon se procesi gjyqësor duhet të zhvillohet në prani të një personi të tretë, i cili rezulton se ka interes në çështje, e thërret atë derisa nuk është nxjerrë urdhri për caktimin e seancës gjyqësore, sipas nenit 158/c të këtij Kodi.

¹⁸ Ligji nr.115/2016“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, neni 89 dhe neni 94 pika 2

- c) rregullat standarde për monitorimin e kohëzgjatjes së pezullimeve që vijnë si rezultat i mosveprimit nga palët ose gjykatat;
- d) rregulla standarde për monitorimin dhe shpërndarjen e të dhënave për personelin e gjykatave dhe të gjithë përdoruesit e gjykatave;
- dh) udhëzues për mbajtjen e statistikave gjyqësore;
- e) udhëzues për një rol aktiv të gjyqtarëve në menaxhimin e çështjeve;
- ë) udhëzues për monitorimin e shtyrjeve të seancave gjyqësore;
- f) modele për vendimet gjyqësore;
- g) udhëzues për mënyrën e përdorimit të teknologjisë audiovizive në procesin gjyqësor;
- gj) udhëzues për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe marrjen e provave në gjykatë;
- h) krijimi i mekanizmave për zgjidhjen e problemeve funksionale dhe shpërndarjen e ekuilibruar të ngarkesës midis gjyqtarëve dhe gjykatave”.

Për sa i përket rregullave standarde kohore në referim të pikës 1 të nenit të sipërcituar, Këshilli i Lartë Gjyqësor edhe gjatë vitit 2024, për vlerësimin etiko-profesional të gjyqtarëve është bazuar në “Standardet minimale kohore dhe sasiore për gjykimin e çështjeve” të parashikuara në vendimin nr.261/2, datë 14.04.2010, e ish- Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Këshilli i Lartë Gjyqësor në muajin korrik të vitit 2025 (që është jashtë periudhës objekt inspektimi) ka miratuar **vendimin nr.433, datë 22.07.2025** “Për përcaktimin e afateve standarde minimale kohore dhe standardeve minimale sasiore për gjykimin e çështjeve.

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar edhe në nenin 89 të ligjit 115/2016 ka miratuar vendimin nr.25, datë 07.02.2019 i ndryshuar me vendimin nr. 115, datë 09.07.2019 “Mbi informacionin periodik të Kryetarëve të Gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore”. Referuar nenit 1, pika a) dhe e) të këtij vendimi kryetari i gjykatës duhet të informoj periodikisht Këshillin e Lartë Gjyqësor në lidhje me: a) “Ngarkesën e çështjeve gjyqësore për gjykatën dhe çdo gjyqtar të saj, evidentimin e numrit të çështjeve të mbartura nga vitet paraardhëse si dhe numrin e çështjeve të zvarritura tej afateve të arsyeshme të përcaktuara në nenin 399/2 të K.Pr.Civile”.. e) Gjendjen e përdorimit dhe funksionimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve, së bashku me nevojat e konstatuara për përditësimin e këtij sistemi”.

Në lidhje me sa më sipër, është konstatuar se për vitin 2024, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë i ka dërguar raportimet përkatëse tre mujore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gjithashtu Këshilli i Lartë Gjyqësor¹⁹ me **vendimin nr.47, datë 11.02.2021** ka vendosur miratimin e **udhëzuesit “Për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe efencës së**

¹⁹ Ne kuadër të përmbushjes së detyrimit të parashikuar në nenin 94, pika 4, shkronja dh) e ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar.

gjykatave” Ky udhëzim ofron një tërësi rregullash për mbajtjen, plotësimin dhe raportimin e të dhënave statistikore nëpërmjet tabelave standarde të unifikuara për të gjitha gjykatat.

4. Faktet e konstatuara dhe analiza e të dhënave në lidhje me veprimtarinë administrative

4.1. Organizimi i brendshëm dhe funksionimi

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, e ushtron veprimtarinë në adresën fizike: Rruga “Onhezmi”, Godina 69, Sarandë; Adresa elektronike: Email: sarande@gjykata.gov.al

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë është gjykatë e kategorisë së tretë (e ulët) e përcaktuar si e tillë me vendimin e KLGJ-së me nr. 147 datë 29.03.2023 dhe nr.149 datë 29.03.2023.

Periodha objekt inspektimi 01.04.2024-30.06.2024 përkon me kohën pas implementimit të hartës së re gjyqësore. Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 140, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë”²⁰ ka vendosur ndër të tjera që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë të emërtohet Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë. Kjo Gjykatë ka filluar funksionimin (me këtë emërtim) në datë 01.05.2023.

“Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.149, datë 29.03.2023 “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e dytë dhe e tretë pa zyrë shërbimi”, në nenin 15 parashikon ndër të tjera se “Këshilli i gjykatës pritëse, brenda 2 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, miraton strukturën, organikën, si dhe përshkrimet e hollësishme të punës, duke i përshtatur me nevojat e gjykatës dhe kriteret e vendit të punës”

Në referim të vendimit të sipërcituar, Këshilli i Gjykatës ka miratuar vendimin nr. 5, datë 03.04.2023 “Për miratimin e organigramës, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë”.

Referuar analizës vjetore të gjykatës subjekt inspektimi konstatohet se gjatë vitit 2024 në gjykatë kanë ushtruar detyrën 6 sekretarë gjyqësorë (aq sa është numri i gjyqtarëve efektivë) dhe 1 kryesekretare. Në këtë analizë parashtrohet ndër të tjera se: “Mungesa e sekretarëve gjyqësorë gjatë vitit 2024 ka sjellë vështirësi në veprimtarinë e përditshme të gjykatës, pranë sekretarisë të gjitha detyrat i përmbush krye sekretarja duke përfshirë edhe detyrat e sekretarit regjistruar, shërbimin ndaj publikut... . Jo vetëm që trupës

²⁰ Ky vendim, i cili hyn në fuqi me botimin në fletoren zyrtare, është publikuar në fletoren zyrtare në datë 29.03.2023.

gjqësore nuk i është bërë i mundur ardhja në ndihmë me sekretare gjyqësore me qëllim uljen e dosjeve në pritje por ka qenë i vështirë organizimi i këtij sektori në raste jo të zakonshme si sëmundje apo ndonjë problem tjetër që sekretaret gjyqësore mund të kenë duke u bërë shkak edhe për dështimin e seancave gjyqësore. Krahasuar numri i nëpunësve civile gjyqësorë të kësaj gjykate me gjykatat e tjera të të njëjtit nivel (madje po të shikohen statistikat kjo gjykatë ka shumë më tepër ngarkesë) rezulton se Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë ka nëpunës civil gjyqësor sa gjysma e nëpunësve civil gjyqësor që kanë gjykatat e tjera të së njëjtës kategori”.

Për sa më sipër gjykata ka kërkuar në mënyrë të përsëritur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor shtesë të strukturës organike në pozicione të cilat janë imediate dhe ndikojnë drejtpërdrejtë në veprimtarinë e kësaj gjykate. Këshilli i Lartë Gjyqësor për vitin 2025 (kohë e cila është jashtë periudhës së inspektimit) ka miratuar shtesën e organikës me 6 (gjashtë) punonjës të rinj përkatësisht 1 (një) shef sektori te burimet njerëzore; 1 (një) specialist buxheti; 1 (një) specialist prokurimesh; 1 (një) specialist protokollit; 1 (një) sekretare gjyqësore.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve nuk është ndarë në seksione. Duke ju referuar numrit të gjyqtarëve efektiv që është 6 gjyqtarë, në gjykatë janë krijuar 2 trupa gjykues ndërsa është krijuar dhe vazhdon funksionimin vetëm seksioni për gjykimin e çështjeve të drejtësisë për të mitur.

Gjatë vitit 2023-2024 dhe gjatë periudhës objekt inspektimi 01.04.2024-30.06.2024 ka pasur lëvizje në trupën gjyqësore.

Gjyqtari Shkëlzen Liçaj dhe gjyqtarja Suela Xhani me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor janë caktuar në skemë delegimi të gjykojnë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një vit duke filluar nga data 13.03.2023 për z.Liçaj dhe nga data 16.10.2023 për znj.Xhani. Gjyqtarit Shkëlzen Liçaj i është shtyrë edhe për 1 vit afati si gjyqtar i përfshirë në skemën e delegimit.

Gjithashtu në datë 20.06.2024 gjyqtarja Dejvi Çelçima ka përfutur raport paralindje ndërsa gjyqtari Alban Veçani me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor datë 31.07.2024 është transferuar për 1 (një) vit për të gjykuar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Kjo lëvizje ka sjellë si pasojë rindarjen e çështjeve duke sjellë një ngarkesë të shtuar për trupën gjyqësore Sarandë.

Gjyqtarët të cilat kanë ushtruar detyrën gjatë periudhës objekt inspektimi 01.04.2024-30.06.2024 paraqiten në tabelën si më poshtë:



Nr.	Gjyqtari	Shënime
1	Zv. Kryetar Alban Veçani	Larguar/Transferuar përkohësisht në dt.31.07.2024
2	Deivi Çelçima	Larguar/Përfitur raport para lindje në dt.20.06.2024
3	Fatmir Ndreu	
4	Edona Vajushi	Caktuar/Emëruar në dt 12.10.2023
5	Mikel Hysometaj	Caktuar/Emëruar në dt.12.10.2023
6	Entiljano Spahiu	Caktuar/Emëruar në dt.12.10.2023

Për sa më sipër, për periudhën objekt inspektimi 01.04.2024-30.06.2024 organika e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë ka qenë 7 gjyqtarë, ndërkohe që për muajt prill dhe maj kjo gjykatë ka funksionuar me 6 gjyqtarë efektivë ndërsa për muajin qershor ka funksionuar me 5 - 6 gjyqtarë. Mbajmë në konsideratë faktin se 3 gjyqtarë janë gjyqtarë të rinj, me një eksperiencë pune rreth 5-6 muaj kur është iniciuar periudha objekt inspektimi.

Gjykata shqyrton të gjitha llojet e çështjeve civile, familjare, tregtare që parashikohen përkatësisht në Kodin Civil, Kodin e Familjes, Kodin e Punës, në ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", "Ligjin për falimentin", "Ligjin për regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse" dhe ligje të tjera të veçanta ku përfshihen shprehimisht çështje që hyjnë në juridiksionin dhe kompetencën e kësaj gjykate²¹.

4.2. Sistemi për menaxhimin e çështjeve gjyqësore

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë aplikon sistemin për menaxhimin e çështjeve gjyqësore ICMIS.

Referuar analizës vjetore të vitit 2024 të kësaj gjykate rezultoi gjatë vitit 2024 kanë qenë të disponueshme 4 salla dhe që prej muajit tetor 3 salla gjykimi, përdorimi i të cilave bëhej sipas grafikut të përcaktuar me urdhër të zëvendës/kryetarit të Gjykatës. Në këtë analizë theksohet se sallat me nr. 3 dhe nr. 4 janë të papërshtatshme për zhvillimin e proceseve gjyqësore në veçanti për proceset penale, pasi këto ambiente nuk ofrojnë kushtet të gjykimit dhe të sigurisë dhe se e vetmja sallë e përshtatshme që ofron kushtet minimale të solemnitetit është salla nr.1. Për këto shkaqe, infrastruktura e gjykatës përbën

²¹ Neni 36 i K.Proc.Civile "Juridiksioni" – Në juridiksionin e gjykatave hyjnë të gjitha mosmarrëveshjet civile dhe mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kod dhe në ligje të veçanta. Juridiksioni gjyqësor civil ushtrohet sipas dispozitave të këtij Kodi dhe ligjeve të tjera.

Neni 41 i K.Proc.Civile "Kompetenca në lëndë"- Në kompetencë të gjykatës së shkallës së parë janë të gjitha mosmarrëveshjet civile e mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të tjera.

shkak për zhvillimin jo në orar të proceseve gjyqësore, për shkak të përplasjes së orareve ndërmjet gjyqtarëve.

Referuar raportimit për tremujorin e dytë të vitit 2024 (periudha objekt inspektimi) për përdorimin e sistemit të regjistrimit audio, rreth 97.9 % e seancave janë regjistruar audio.

Gjetje: Në lidhje me sallat gjyqësore duhet mbajtur në konsideratë se numri i sallave të gjykimit pranë kësaj gjykate është vetëm tre dhe nga këto vetëm një sallë plotëson kushtet minimale të solemnitetit të gjykimit.

4.3. Fakte të konstatuara në lidhje me saktësinë e të dhënave të hedhura në “regjistrat fizikë” dhe në “sistemin e menaxhimit të çështjeve të gjykatës”

Duke qenë se inspektimi do të mbështetet kryesisht tek të dhënat e sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, si dhe të dhënat statistikore të vëna në dispozicion nga gjykata për sa i përket kohëzgjatjes të seancave gjyqësore nga secili gjyqtar për periudhën 01.04.2024-30.06.2024 është vlerësuar fillimisht të verifikohet saktësia e të dhënave të vendosura në dispozicion nga gjykata.

Saktësia e të dhënave statistikore është shumë e rëndësishme, jo vetëm në drejtim të matjes së performancës dhe efikasitetit të gjykatës por edhe në drejtim të transparencës, llogaridhënies, evidentimit të problematikave si dhe identifikimit të nevojave për përmirësime të vazhdueshme të veprimtarisë gjyqësore. Statistikat jo të plota apo me gabime, shtrembërojnë panoramën reale të gjendjes së gjyqësorit dhe sjellin si pasojë vlerësime jo të sakta dhe strategji jo efektive të cilat nuk përmbushin qëllimin për rritjen e cilësisë, efektivitetit edhe eficiencës së gjykatës.

4.3.1. Kuadri rregullator në lidhje me të dhënat statistikore

Në lidhje me “Sistemin elektronik të teknologjisë së informacionit” në referim të nenit 92 pika 1 të ligjit nr. 115/2016 “Për qeverisjen e sistemit të drejtësisë” parashikohet ndër të tjera se: “Këshilli i Ministrave miraton rregulla për politikat e përgjithshme shtetërore për sistemin e teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë, që ndër të tjera parashikojnë:... b) sigurimin e aksesit të plotë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në të dhënat që përmbajnë të gjithë sistemet e teknologjisë së informacionit në lidhje me **Këshillin e Lartë Gjyqësor, Gjykatat, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe zyrat e prokurorisë**”.

Në pikën 2 të nenit 92 të ligjit të sipërcituar parashikohet se: “Në përputhje me politikat e përgjithshme në fushën e teknologjisë dhe sigurisë së informacionit, **Këshilli i Lartë Gjyqësor, në bashkëpunim me Qendrën e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë është përgjegjës për: a) zhvillimin ose pjesëmarrjen në zhvillimin e sistemit elektronik të teknologjisë së informacionit për përdorim në gjykata;.. e) përmirësimin periodik të sistemit, për të siguruar zbatimin e kërkesave funksionale të gjykatave, të vet Këshillit dhe të organeve të tjera brenda sistemit të drejtësisë, si dhe për të reflektuar**

ndryshimet në ligjet procedurale; ë) sigurimin e saktësisë dhe sigurisë së të dhënave...; f) garantimin që sistemi elektronik i teknologjisë së informacionit të të dhënave gjeneron informacione statistikore, të cilat janë të nevojshme për punën e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të organeve të tjera dhe që përputhen me standardet evropiane për treguesit e punës së gjyqësorit, të tilla si norma e evadimit të çështjeve, numri i çështjeve për gjyqtar, kohëzgjatja mesatare e çështjeve dhe kohëzgjatja e çështjeve në proces në raport me kohëzgjatjen mesatare etj., g) përcaktimin e rregullave për përdorimin e detyrueshëm të sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve, njësimin e futjes së të dhënave dhe për saktësinë e të dhënave”.

Këshilli i Ministrave në mbështetje edhe të dispozitës së sipërcituar, ka nxjerrë vendimin nr. 971, datë 02.12.2020 “Për miratimin e rregullave për politikën e përgjithshme shtetërore, për sistemin e teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë” si dhe vendimin nr. 972, datë 02.12.2020 “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”. Në referim të pikës 10 të vendimit nr.972/2020, përcaktohet se Bordi drejtues i QTI-së ushtron ndër të tjera kompetencat: “..e) përcakton rregulla dhe procedura përmes të cilave Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i garantohet aksesimi i plotë, pa të drejtë modifikimi/ndërrhyrjeje në sistemet e të dhënave dhe të teknologjisë së informacionit, siç parashikohet në ligj;.. gj) miraton masa që sistemet elektronike të teknologjisë së informacionit të gjenerojnë informacionin statistikor që nevojitet për punën e të gjitha institucioneve në sistemin e drejtësisë, në konsultim të ngushtë me institucionet përkatëse;..”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në referim të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, dhe konkretisht të nenit 89 shkronja “b”²² dhe nenit 94 pika 4, shkronja “dh”²³, me vendimin nr.47, datë 11.02.2021 ka miratuar “Udhëzuesin për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe eficiencës së gjykatave”. Ky udhëzues ofron një tërësi rregullash për mbajtjen, plotësimin dhe raportimin e të dhënave statistikore nëpërmjet tabelave standarde të unifikuara për të gjitha gjykatat.

Në seksionin 1 të këtij udhëzimi janë miratuar tabelat standarde për Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm të cilat përmbajnë të dhëna statistikore në lidhje me: Ngarkesën e punës në secilën gjykatë; gjendjen e backlog-ut; prurjet e çështjeve të reja; ngarkesën mesatare të gjyqtarëve; normën e eficiencës; raportin e qarkullimit të çështjeve; kohën e nevojshme për përfundimin e çështjes; normën e zgjidhjes së çështjes; vjetërsinë e çështjes etj.

²² Këshilli i Lartë Gjyqësor kujdeset për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve që lidhen me administrimin gjyqësor duke ushtruar kompetencat e mëposhtme:.. b) monitoron dhe menaxhon ngarkesën e gjyqtarëve dhe të gjykatave, kohëzgjatjen e çështjeve dhe aspekte të tjera të administrimit gjyqësor, bazuar në të dhënat e mbledhura përmes sistemit të menaxhimit të çështjeve, me qëllim përmirësimin e produktivitetit të gjykatave ose uljen e ngarkesës së gjyqtarëve dhe të nëpunësve civilë gjyqësorë;

²³ Rregullat standarde për eficiencën e drejtësisë përfshijnë parashikime për: dh) udhëzues për mbajtjen e statistikave gjyqësore;

Në seksionin “udhëzime të përgjithshme” parashikohet si më poshtë:

“Sekretaritetë gjyqësore në çdo gjykatë ndihmojnë me mirëmbajtjen e regjistrave dhe regjistrimeve të sakta në regjistra si dhe në krijimin e statistikave të gjykatës, sipas kritereve të përcaktuara në këtë Udhëzim, përfshirë saktësinë e të dhënave (neni 44 i Ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSH) ”.

Kancelari, pas konsultimit me Kryetarin e Gjykatës, mban përgjegjësi, mes të tjerave, edhe për funksionimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve (CMS) në gjykatë. Kancelari mbikëqyr mbledhjen dhe përpunimin e saktë të të dhënave si dhe orienton dhe mbikëqyr punën e nëpunësve civilë gjyqësorë të gjykatës që përfshihen në regjistrimin e të dhënave dhe në përpilimin e statistikave. Kancelari dërgon raporte periodike në Këshillin e Lartë Gjyqësor për përdorimin dhe funksionimin e CMS, si dhe raporton pa vonesë mbi nevojat dhe përditësimet e nevojshme të funksionimit të CMS (neni 39 i ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në R.SH”).

Deri në prodhimin në mënyrë elektronike të të gjitha statistikave të nevojshme... rekomandohet që të dhënat për çdo çështje të regjistruar të përmbajnë të paktën këto informacione: i) numrin e çështjes; ii) datën e regjistrimit; iii) objektin; iv) numrin e vendimit; v) datën e vendimit; vi) datën e zbardhjes së vendimit të arsyetuar; vii) mënyrën e disponimit të gjykatës”.

Në respektim të këtij udhëzimi, duke u kufizuar tek të dhënat që kanë lidhje me “Kohëzgjatjen e çështjes gjyqësore”, referuar tabelës 1 “statistikat për çështjet civile sipas llojit të çështjes” të dhënat për sa i përket çështjeve civile me palë kundërshtare si dhe çështjet civile në përgjithësi duhet të përmbajnë ndër të tjera tregues në lidhje me administrimin e çështjeve dhe tregues në lidhje me kohëzgjatjen e çështjeve të gjykuara si dhe me eficiencën.

Gjithashtu ky udhëzim ka përcaktuar se: *“Për qëllime të statistikave për performancën dhe eficiencën e gjykatës, kohëzgjatja e çështjeve të gjykuara llogaritet që nga data e regjistrimit të çështjes në gjykatë, deri në datën e shpalljes së vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse për lloje specifike çështjesh. ligji parashikon apo jo një afat ligjor për mbylljen e procedimit”.*

Për sa i përket treguesve statistikorë në lidhje me kohëzgjatjen e çështjeve të gjykuara, në këto tregues përfshihen ndër të tjera: Numri dhe përqindja e çështjeve të mbyllura sipas kohëzgjatjes; Kohëzgjatja mesatare e çështjes.

Për sa i përket treguesve statistikore në lidhje me eficiencën, në këtë tregues përfshihen ndër të tjera: Norma e likuidimit të çështjeve; numri dhe përqindja e çështjeve në pritje të gjykimit mbi dy vjet.

Për sa i përket treguesve statistikorë në lidhje me seancat gjyqësore, në këtë tregues përfshihen numri i seancave gjyqësore të mbajtura në prani të palëve, duke përfshirë seancat përgatitore dhe të dhënat për çështjet e shqyrtuara në dhomë këshillimi, kur ligji

e parashikon shqyrtimin e çështjes në këtë mënyrë si dhe numrin mesatar të seancave të mbajtura për çështje sipas kategorisë së çështjes.

4.3.2. “Regjistri “numërori i vendimeve”

Si burim informacioni për të konkluduar në lidhje me numrin e përgjithshëm të vendimeve të shpallura në lidhje me gjykimet me palë kundërshtare gjatë periudhës 01.04.2024-30.06.2024 kanë shërbyer të dhënat që përmban regjistri fizik i shënuar “Numërori i vendimeve civile” i cili është administruar me shkresën e regjistruar në ILD me nr. 1209/4 prot., datë 02.06.2025.

Nga këqyrja e të dhënave që përmban regjistri vihet re se në rubrikën “vendime” është regjistruar numri i vendimit dhe data e shpalljes. Vendimet janë renditur në mënyrë kronologjike sipas datës së shpalljes duke filluar nga vendimi me nr. 23-2024-607/243 datë 26.03.2024 deri në vendimin nr.20-2024-1275/582 dt.28.06.2024. Konstatohet se në këtë regjistër janë regjistruar edhe kërkesat për lëshim autorizimi/ caktim përfaqësimi si dhe vërtetime fakti. Në këtë numëror nuk pasqyrohen vendimet me objekt lëshim urdhër i menjëhershëm mbrojtje dhe vërtetimi i urdhrit të mbrojtjes.

Në këtë regjistër përveç numrit dhe datës së shpalljes së vendimit pasqyrohen edhe rubrika të tjera me qëllim për t’u plotësuar sikurse janë data e paraqitjes së kërkesëpadsisë në gjykatë, numri i protokollimit dhe data e regjistrimit të kërkesëpadsisë, palët ndërgjyqëse, objekti i padsisë, dispozitivi, trupi gjykues, anëtarët, numri i seancave, afati i dorëzimit të vendimit, vendimi i Apelit dhe vendimi i Gjykatës së Lartë.

Nga këqyrja e të dhënave vihet re se jo të gjitha rubrikat e regjistrimit janë të plotësuara. Konkretisht rubrika “anëtarët” e trupit gjykues, “Apeli”, “Afati i dorëzimit” dhe “Gjykata e Lartë” nuk rezultojnë të jenë të plotësuara.

Nga analiza e të dhënave të regjistrimit, referuar rubrikës “Data e paraqitjes” konstatohet se data më e hershme e paraqitjes të kërkesëpadsisë është data 12.09.2014 (përfunduar me vendimin nr. 23-1246/564 datë 24.06.2024) ndërsa data më e vonshme është data 12.06.2024 (me objekt përfunduar me vendimin nr. 23-2024-1274/581 datë 28.06.2024).

Për sa i përket të dhënave të hedhura në rubrikën “Regjistri” vihet re se data e regjistrimit të kërkesëpadsisë në pjesën më të madhe përputhet me datën e paraqitjes së kërkesëpadsisë. Por gjithashtu konstatohen edhe raste në të cilat midis datës së paraqitjes së kërkesëpadsisë dhe datës së regjistrimit ka diferencë kohore e cila varion nga 1 ditë deri në 21 ditë. Në tabelën më poshtë po paraqesim rastet e konstatuara me një diferencë kohore më shumë se 1 ditë:

Nr.	Data e paraqitjes	Regjistri		Diferenca
		Nr.	Data	
1	15.12.2023	01117/1668	18/12/2023	3 ditë
2	11.02.2022	00197/249	15/02/2022	4 ditë
3	14.08.2023	00762/632	04/09/2023	21 ditë
4	04.11.2022	01084/365	08/11/2022	4 ditë
5	23.12.2021	00016/305	06/01/2022	14 ditë
6	28.12.2023	00009/875	12/02/2024	15 ditë
7	04.09.2023	00778/641	06/09/2023	2 ditë
8	12.01.2024	00043/909	15/01/2024	3 ditë
9	05.01.2024	00026/892	15/01/2024	10 ditë
10	14.08.2023	00763/1370	04/09/2023	21 ditë
11	10.01.2024	00038/904	15/01/2024	5 ditë
12	28.08.2023	00767/1375	04/09/2023	7 ditë
13	07.07.2023	00684/598	10/07/2023	3 ditë
14	05.02.2021	00130/145	09/02/2021	4 ditë
15	09.04.2024	00316/1119	11/04/2024	2 ditë
16	22.09.2023	00860/687	25/09/2023	3 ditë
17	04.01.2024	00022/888	15/01/2024	11 ditë
18	03.05.2024	00403/1187	07/05/2024	4 ditë
19		00443/1220	15/05/2024	Nuk është shënuar data e paraqitjes
20	08.01.2024	00029/895	15/01/2024	7 ditë
21	30.07.2022	00646/258	15/03/2022	Hedhje gabim e datës
22	10.05.2024	00431/1210	13/05/2024	3 ditë
23	22.12.2023	00006/872	12/01/2024	21 ditë
24	13.02.2024	00174/1003		Nuk është shënuar data e regjistrimit
25	14.08.2023	00763/1370	04/09/2023	21 ditë
26	26.11.2014	01686	02/12/2014	6 ditë
27	11.01.2024	00040/906	15/01/2024	4 ditë

Nga këqyrja e të dhënave të pasqyruara në tabelën e sipërcituar konstatohet se diferenca më e madhe kohore në regjistrimin e çështjeve përkon me çështjet të cilat janë paraqitur gjatë muajit gusht (periudha e lejes vjetore) dhe në periudhën kohore 15 dhjetor-15 janar (periudha e mbartjes së dosjeve).

4.3.3. Të dhënat e hedhura në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore

Referuar Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.554, datë 29.12.2022 “Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore” pika III ndër të tjera parashikon se: *Çështjet gjyqësore me paraqitjen në gjykatë regjistrohet menjëherë në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve nga sekretaria gjyqësore, sipas kategorive të sistemit, nën mbikëqyrjen e kryesekretarit dhe kancelarit. .. Në rast pamundësie të realizimit të shortit brenda ditës së punës, çështjet e regjistruara shortohen jo më vonë se dita e nesërme e punës”.*

Referuar të dhënave statistikore mbi vendimet e shpallura gjatë periudhës 01.03.2024-30.06.2024 për çështjet civile me palë kundërshtare, të përcjella nga gjykata në formë fizike dhe elektronike, rezulton se janë shpallur gjithsej 170 vendime.

Referuar këtyre të dhënave rezulton se data e paraqitjes së kërkesëpadiisë përputhet me datën e regjistrimit në gjykatë. Nga këqyrja e të dhënave për sa i përket datës së paraqitjes/datës së regjistrimit/ datës së shortimit rezulton se të 170 kërkesë paditë janë paraqitur, janë regjistruar si dhe janë shortuar brenda ditës.

4.3.4. Saktësia e të dhënave


Duke qenë se inspektimi do të mbështetet kryesisht tek të dhënat për sa i përket kohëzgjatjes së çështjeve gjyqësore civile me palë kundërshtare të cilat janë përfunduar për periudhën 01.04.2024-30.06.2024, është vlerësuar fillimisht të verifikohet saktësia e të dhënave të hedhura në “Numërorin e vendimeve civile” dhe i të dhënave statistikore të ardhura në mënyrë elektronike dhe shkresërisht nga gjykata.

Nga regjistri fizik “numërori i vendimeve civile” u përzgjedhën për verifikim 5 çështje për të cilat kishte mospërputhje kohore midis datës së paraqitjes së kërkesëpadiisë dhe datës së regjistrimit.

Nga verifikimi i të dhënave në numërorin fizik u konstatua se kishte mospërputhje të “datës së paraqitjes” së kërkesëpadiisë të pasqyruar në “numërorin civil” dhe “datës së dorëzimit” të pasqyruar në të dhënat statistikore të përcjella nga gjykata.

Gjithashtu konstatohet se “data e regjistrimit” e pasqyruar në “numëror” përputhet me datën e shënuar në rubrikën “ data e dorëzimit” në të dhënat statistikore të përcjella nga gjykata.

Mospërputhjet janë pasqyruar në tabelën më poshtë:



Mospërputhje në lidhje me “datën e paraqitjes të kërkesë padive” midis regjistrit manual dhe të dhënave statistikore		
Nr. Çështje	“Data e paraqitjes” sipas “numërorit të vendimeve”	“Data e dorëzimit” sipas të dhënave statistikore
21001-00762-23-2023	14.08.2023	04.09.2023
21001-00763-23-2023	14.08.2023	04.09.2023
21256-00130-23-2021	5.02.2021	09.02.2021
21001-00767-23-2023	28.08.2023	04.09.2023
11232-01686-23-2014	26.11.2014	01.12.2014

Gjetje: Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga gjykata këto 5 çështje janë paraqitur/regjistruar dhe shortuar brenda ditës, ndërkohë referuar numërorit rezulton diferenca kohore midis datës së paraqitjes dhe datës së regjistrimit.

- **Verifikimi i të dhënave të marra nga sistemi elektronik si dhe të dhënave të pasqyruara në regjistrin “numërori i vendimeve civile” në raport me të dhënat e fashikujve gjyqësor fizikë.**

Saktësia e të dhënave statistikore është shumë e rëndësishme jo vetëm në drejtim të matjes së performancës dhe efikasitetit të gjykatës por edhe në drejtim të transparencës, llogaridhënies, evidentimit të problematikave si dhe identifikimit të nevojave për përmirësim të vazhdueshme të veprimtarisë gjyqësore. Statistikat jo të plota apo me gabime shtrembërojnë panoramën reale të gjendjes së gjyqësorit dhe sjellin si pasojë vlerësime jo të sakta dhe strategji jo efektive të cilat nuk përmbushin qëllimin për rritjen e cilësisë, efektivitetit edhe eficiencës së gjykatës.

Në kuadër të verifikimit nëse janë të hedhura saktë të dhënat në sistemin elektronik dhe në regjistrin fizik “Numërori i vendimeve civile”, nga ana jonë janë përzgjedhur 2 çështje, të cilat i administruam me procesverbalin e mbajtur në datën 31.10.2025 në ambientet e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, si më poshtë:

1. Çështja nr. 21246-00465-23-2024 regj, datë dorëzimi 23.05.2024, me objekt “Njohje pronar”

Konstatime: Në numërorin e vendimeve civile pasqyrohet data e paraqitjes së kërkesëpadisë, numri i regjistrimit, data e regjistrimit, e cila është e njëjtë me datën e depozitimit të padisë, emri i paditësit, pala e paditur, etj, pala e interesuar ASHK, objekti i kërkesëpadisë, dispozitivi, gjyqtari dhe numri i seancave.

Në tabelën në Excel dhe sistemin elektronik pasqyrohet data e shortit e njëjtë me datën referuar numërorit fizik si dhe emri i njëjtë i gjyqtarit të çështjes. Regjistri “Numërori i vendimeve civile” pasqyron 1 (një) seancë të zhvilluar për këtë çështje dhe gjithashtu tabela në Excel pasqyron 1 (një) seancë për këtë çështje.

Referuar të dhënave nga sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore, rezulton se gjykimi i çështjes është mbyllur me një seancë atë të datës 28.06.2024, ku me vendimin nr. 1275, datë 28.06.2024 u vendos shpallja e moskompetencës tokësore.

Nga këqyrja e të dhënave të pasqyruara në numërorin e vendimeve civile, tabelën excel si dhe të dhënat e përftuara nga sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë rezulton se nuk ka mospërputhje në numrin e seancave të pasqyruara midis tyre për këtë gjykim.

2. Çështja nr. 11217-00608-23-2020., datë dorëzimi 23.07.2020, me objekt "Përmbushje e detyrimit kontraktor"

Konstatime: Në numërorin e vendimeve civile pasqyrohet data e paraqitjes së kërkesëpadisë 22.07.2020, numri i regjistrimit 00608/122, data e regjistrimit 23.07.2020, emri i paditësit, pala e paditur, objekti i kërkesëpadisë, dispozitivi, gjyqtari dhe numri i seancave. Në tabelën në Excel rezulton data e shortit 23.07.2020 e njëjtë me datën e depozitimit të kërkesëpadisë, përputhen emrat e gjyqtarëve, ka mospërputhje me numrin e seancave pasi referuar tabelës në "Excel" numri i seancave është 31, ndërkohë sipas numërorit është 33 seanca.

4.4. Transparenca

Neni 91, pika 1, shkronja "f" i ligjit nr. 115 i vitit 2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë"²⁴, me ndryshimet përkatëse, parashikon ndër të tjera se: "*Këshilli i Lartë Gjyqësor kryen detyrat e mëposhtme: "bën të mundur që secila gjykatë të ketë hapësirën e saj të veçantë në portalin në internet dhe të lejohet të publikojë në të, të dhëna për gjykatën dhe çështjet gjyqësore; merr masa që publiku të informohet mbi veprimtarinë e gjykatave si dhe për çështje të veçanta gjyqësore.*

Në Vendimin nr. 47 datë 11.02.2021 për miratimin e Udhëzuesit "Për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe eficiencës së gjykatave" parashikohet ndër të tjera në rubrikën "udhëzime të përgjithshme" se "*për gjykatat e çdo niveli dhe juridiksioni, tabelat standarde duhet të plotësohen çdo vit dhe të publikohen në faqen zyrtare të gjykatës brenda dy javësh pas përfundimit të çdo periudhe raportuese ...*".

Nga vëzhgimi dhe monitorimi i faqes zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, rezulton se tabelat standarde sipas vendimit nr. 47 datë 11.02.2021 të KLGJ-së nuk janë të publikuara. Në mungesë të publikimit, është e pamundur të verifikohet në mënyrë publike efikasiteti dhe performanca e gjykatës për periudha të caktuara.

²⁴ Neni 2 "*Sistemi i drejtësisë në Republikën e Shqipërisë qeveriset bazuar në parimet e pavarësisë, llogaridhënies, transparencës dhe eficiencës*".



5. Analiza e të dhënave dhe gjetjet e inspektimit në lidhje me veprimtarinë gjyqësore të gjykatës

5.1. Numri i vendimeve të shpallura gjatë periudhës 01.04.2024-30.06.2024

Të dhënat në lidhje me “Vendimet civile me palë kundërshtare të shpallura për periudhën 01.04.2024-30.06.2024” të dërguar nga gjykata në formë elektronike²⁵ në tabelë “Excel”, fillojnë me vendimin nr. 23-2024-651, të shpallur në datë 02.04.2024, për çështjen me nr. regjistri 11217-00608-23-2020, datë 23.07.2020 dhe përfundojnë me vendimin nr. 23-2024-1275, të shpallur në datë 28.06.2024, për çështjen me nr. regjistri 21246-00465-23-2024, datë 23.05.2024.

Nga studimi dhe përpunimi i të dhënave të ardhura nga gjykata si më sipër, konstatohet se:

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë për periudhën 01.04.2024-30.06.2024 në lidhje me çështjet civile me palë kundërshtare janë shpallur 170 vendime nga 6 gjyqtarë.

Numri i vendimeve të shpallura për secilin gjyqtar si dhe numri i çështjeve për gjykimin e të cilave gjyqtari është caktuar si rrjedhojë e rishortimit është pasqyruar sipas tabelës në vijim:

NUMRI I VENDIMEVE TË SHPALLURA PËR PERIUdhËN TRE MUJORE 01.04.2024 - 30.06.2024 SI DHE ÇËSHTJET E RISHORTUARA

Nr.	Gjyqtarët	Vendimet totale për periudhën 01.04.2024-30.06.2024
1	Alban Veçani	36
2	Dejvi Çelçima	9
3	Edona Vajushi	37
4	Entiljano Spahiu	25
5	Fatmir Ndreu	30
6	Mikel Hysometaj	33
Totali		170

²⁵ Protokolluar në ILD me nr. 1209/4 prot., datë 02.06.2025 dhe shkresa nr. 1209/7 prot., datë 10.11.2025


5.2. Fakte të konstatuara në lidhje me kohëzgjatjen e çështjeve / kohëzgjatjen mesatare si dhe me mënyrën e përfundimit për çështjet civile me palë kundërshtare të përfunduara gjatë periudhës 01.04.2024 – 30.06.2024.

5.2.1. Kohëzgjatja e çështjeve

Referuar analizës së të dhënave në lidhje me periudhën kohore brenda së cilës çështjet kanë përfunduar, konstatohet se nga 170 çështje civile me palë kundërshtare të përfunduara, 23 çështje janë përfunduar brenda 30 ditëve, ndërsa 132 çështje janë përfunduar brenda një periudhe dyvjeçare. Gjithashtu konstatohet se 38 çështje kanë zgjatur me tepër se dy vjet.

- ✚ Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm, paraqiten të dhëna më të detajuara në lidhje me numrin dhe përqindjen e çështjeve civile me palë kundërshtare të përfunduara, në fasha të caktuara kohore, në raport me numrin total të çështjeve të përfunduara në periudhën tre mujore objekt inspektimi

Afati i Gjykimit	Numri i Çështjeve
deri në 1 muaj	19
1 muaj - 6 muaj	54
6 muaj - 1 vit e 6 muaj	50
1 vit e 6 muaj - 2 vite	9
mbi 2 vjet	38
Totali	170



5.2.2. Kohëzgjatja mesatare

Referuar raportit vjetor të Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2024, koha mesatare për likuidimin e një çështje civile gjatë vitit 2024 për gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm është 256 ditë, ndërsa koha mesatare për gjykimin e një çështje civile gjatë vitit 2024 për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë **është 214 ditë.**

Ndërsa koha mesatare e kohëzgjatjes se gjykimit për 170 çështjet civile me palë kundërshtare të përfunduara për periudhën 01.04.2024-30.06.2024 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Sarandë, është 423 ditë.

✚ Në tabelën më poshtë pasqyrohet koha mesatare e kohëzgjatjes së gjykimeve të përfunduara për periudhën tre mujore 01.04.2024-30.06.2024 për secilin gjyqtar.

Koha mesatare e gjykimit për secilin gjyqtar për periudhën 01.04.2024-30.06.2024			Çështjet e rindara Totali 47
Nr	Gjyqtari	Koha mesatare në ditë	
1	Alban Veçani	530	5 çështje (2 shorte)
2	Dejvi Çelçima	399	1 çështje (2 shorte)
3	Edona Vajushi	331	7 çështje (2 shorte) 2 çështje (3 shorte) 1 çështje (4 shorte)
4	Entiljano Spahiu	338	8 çështje (2 shorte) 1 çështje (3 shorte)
5	Fatmir Ndreu	513	10 (2 shorte)
6	Mikel Hysometaj	397	10 (2 shorte) 2 (3 shorte)

Kemi parasysh këtu faktin se koha mesatare i referohet kohëzgjatjes së çështjes që nga momenti i regjistrimit të kërkesëpadisë deri në shpalljen e vendimit që do të thotë se për çështjet e rindara në përcaktimin e kohës mesatare është e përfshirë edhe koha që është mbajtur në gjykim nga gjyqtarët e caktuar më parë.

5.2.3. Mënyra e përfundimit të çështjeve

Mënyra e përfundimit të 170 çështjeve civile me palë kundërshtare përgjatë periudhës 01.04.2024-30.06.2024 është pasqyruar si më poshtë:

Mënyra e përfundimit të çështjeve	Numri i çështjeve
Pranim padie	62
Pranim i pjesshëm	13
Rrëzim padie	20
Kthim aktesh	3
Pushim	62
Rrëzim padie pranim kundërpadie	2
Moskompetencë tokësore	4

Mungesë kompetence/ moskompetencë	vendim	2
Vendim tjetër		2
Totali		170

5.3. Fakte të konstatuara në lidhje me objektin e padisë dhe kohëzgjatjen mesatare në varësi të llojit të objektit të padisë

Nga analiza e të dhënave në lidhje me objektin e shqyrtimit të mosmarrëveshjes rezulton se numrin më të madh të vendimeve të shpallura e zënë çështjet që kanë për objekt “Zgjidhjen e martesës” dhe në vijim çështjet me objekt “njohje bashkëpronësie/ njohje e pronësisë” dhe “Lëshim urdhër mbrojtje”.

5.3.1. Lloji i objektit të padisë

Objekti i Padisë	Numri i çështjeve
Shpërblim dëmi	4
Pushim cenimi	5
Pavlefshmëri akti	7
Pagim shume	3
Padi servituti	6
Pjesëtim sendi	14
Padi përmbushje detyrimi që rrjedh nga kontrata	12
Padi lirim/dorëzim sendi	6
Kthim shume	3
Njohje e pronësisë	16
Goditje për falsitet	2
Lëshim urdhër mbrojtje/lëshim i urdhrit të menjëhershëm mbrojtje	14
Kundërshtim veprime përbarimore	2
Padi për zgjidhje martese	70
Vërtetim atësie	2
Sigurim padie	1
Të tjera	3
Totali	170

5.3.2. Kohëzgjatja mesatare e çështjeve gjyqësore të gjykuara në varësi të objektit të padisë

Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore civile me palë kundërshtare të përfunduara gjatë periudhës kohore 01.04.2024-30.06.2024, në varësi të llojit të objektit të padisë paraqitet si më poshtë:

- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt “shpërblim dëmi” është 574 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt “kundërshtim veprime përmbarimore” është 88 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt “lëshim urdhër mbrojtje/ urdhër i menjëhershëm i mbrojtjes” është 16 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt “pavlefshmëri dokumenti/ akti / titulli ekzekutiv” është 918 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt “pushim cenimi,” është 1164 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt “përmbushje detyrimi që rrjedh nga kontrata” është 642 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt “kthim shume” është 1389 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt “lirim dorëzim sendi” është 628 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt “njohje pronar” është 602 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt “deklarim falsifikimi” është 457 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt “zgjidhje martesë” është 192 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt “pjesëtim sendi” është 796 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt “vërtetim atësie” është 668 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt “sigurim padie” është 4 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt “të tjera” është 633 ditë.

5.4. Fakte të konstatuara në lidhje me shkaqet e zgjatjes së proceseve në varësi të llojit të objektit të padisë.

Në kuadër të identifikimit të faktorëve që ndikojnë në efektivitetin e procesit gjyqësor por edhe kohëzgjatjen e tij në varësi të llojit të çështjes, janë përzgjedhur si raste studimore 2 çështje gjyqësore për secilin objekt padie, përkatësisht një çështje për të cilën procesi ka zgjatur më pak dhe një çështje për të cilën procesi ka zgjatur më shumë në raport me çështjet e tjera të të njëjtit lloj. Në vijim janë pasqyruar faktet e konstatuara referuar RIV (regjistrin të veprimeve) dhe procesverbaleve të seancave gjyqësore të gjeneruara nga sistemi i menaxhimit të çështjeve të gjykatës.

Rastet Studimore:

- **Dy çështje me objekt “shpërblim dëmi”**

I. Çështja nr. 10907-00658-23-2022

Kërkesëpadia është depozituar në gjykatë në datën 24.06.2022 dhe është regjistruar në të njëjtën ditë.

Kjo çështje është shortuar në datë 24.06.2022.

Seanca e parë për kërkesën e masës së sigurimit të padis është caktuar në ditën e hedhjes së shortit.

Seanca e parë për gjykimin në themel është caktuar pas 4 muaj e 23 ditësh pas hedhjes së shortit.

Gjykata ka kryer veprimet procedurale si vijojnë:

1. **Seanca e datës 24.06.2022.** Në këtë seancë gjykata ka marrë në shqyrtim kërkesën për sigurim padie. Brenda të njëjtës seancë gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës për sigurim padie.(4 muaj e 23 ditë)
2. **Seanca e datës 16.11.2022.** Në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve u ka lënë detyrë palëve paraqitjen e provave. Në vijim ka shtyrë seancën për në datë 26.01.2023. (2 muaj e 10 ditë)
3. **Seanca e datës 26.01.2023.** Në këtë seancë gjykata ka verifikuar prezencën e palës, i ka lënë detyra ekspertit dhe ka shtyrë seancën për kryerjen e aktit të ekspertimit. Seanca e radhës është planifikuar në datë 15.03.2023.(1 muaj e 17 ditë)
4. **Seanca e datës 15.03.2023.** Kjo seancë nuk është zhvilluar pasi ka munguar gjyqtari për arsye familjare. (1 muaj e 17 ditë)
5. **Seanca e datës 02.05.2023.** Në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ndërgjyqëse ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse, nuk është paraqitur pala e paditur, dhe i pranishëm ka qenë dhe eksperti. Është dorëzuar akti i ekspertimit. Për shkak të mungesës së dakordësisë lidhur me aktin e ekspertimit, gjykata i ka lënë kohë ekspertit të plotësojë aktin e ekspertimit. Seanca është shtyrë për në datën 21.06.2023.(1 muaj e 19 ditë)
6. **Seanca e datës 21.06.2023.** Kjo seancë është zhvilluar në prani të palës paditëse dhe palës së paditur. Gjykata ka revokuar vendimin e mungesës për të paditurin. Për ti lënë kohë ekspertit të plotësojë aktin e ekspertimit, gjykata ka shtyrë seancën për në datën 03.10.2023.(3 muaj e 12 ditë)
7. **Seanca e datës 03.10.2023.** Kjo seancë është zhvilluar në prani të palës paditëse, palës së paditur dhe ekspertit. Për ti lënë kohë palëve të njihen me aktin e ekspertimit, gjykata ka shtyrë seancën për t’u zhvilluar për në datën 30.11.2023.(1 muaj e 27 ditë)
8. **Seanca e datës 30.11.2023.** Kjo seancë është zhvilluar në prani të palës paditëse, palës së paditur dhe ekspertit. Gjykata ka urdhëruar vjeljen e tarifës së ekspertit nëpërmjet shërbimit përmbarimor. Seanca e radhës është caktuar për t’u zhvilluar në datën 06.02.2024.(2 muaj e 7 ditë)

9. **Seanca e datës 06.02.2024.** Kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së palëve ndërgjyqëse. Seanca e radhës është caktuar për t'u zhvilluar në datën 03.04.2024.(1 muaj e 26 ditë)
10. **Seanca e datës 03.04.2024.** Kjo seancë është zhvilluar në prezencë të palës paditëse dhe palës së paditur. Seanca është shtyrë për t'u zhvilluar në datën 23.05.2024 për shkak të mungesës së të paditurit për shkaqe familjare.(1 muaj e 20 ditë)
11. **Seanca e datës 23.05.2024.** Kjo seancë është zhvilluar në prezencë të palës paditëse, palës së paditur dhe ekspertit. Janë administruar aktet dhe është kaluar në konkluzione përfundimtare. Seanca është shtyrë për shpallje vendimi në datën 12.06.2024.(20 ditë)
12. **Seanca gjyqësore e datës 12.06.2024.** Shpallja e vendimit.

Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë 24.06.2022 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës 12.06.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 1 vit, 11 muaj e 19 ditë.

Lidhur me shkaqet e shtyrjes së seancave ndër të tjera konstatohen disa seanca të shtyra për shkaqe që lidhen me ekspertin dhe aktin e ekspertimit; 1 seancë e shtyrë për shkak të gjykatës; 1 seancë e shtyrë për shkak të mungesës së palëve ndërgjyqëse; 1 seancë e shtyrë për shpallje vendimi.

Për sa i përket distancës kohore ndërmjet seancave konstatohet se:: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 20 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 4 muaj e 23 ditë.

II. Çështja nr. 21234-00113-23-2021

Kërkesë padia është depozituar në gjykatë në datë 02.02.2021, është regjistruar dhe është shortuar brenda datës 02.02.2021.

Kjo çështje është shortuar dy herë përkatësisht: shorti i parë në datën 02.02.2021; shorti i dytë në datën 20.03.2023.

Seanca e parë është caktuar pas 3 muajsh e 15 ditësh nga data e hedhjes së shortit.

Seanca e parë pas shortit të dytë është caktuar 6 muaj pas hedhjes së shortit të dytë.

Gjykata ka kryer veprimet procedurale si vijojnë:

1. **Seanca e datës 17.05.2021,** në të cilën gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur paditësi dhe palët e paditura. Gjykata gjithashtu ka konstatuar se prokura për përfaqësim e paraqitur nga pala paditëse nuk është e vlefshme për objektin e kërkesëpadisë. Për t'i dhënë kohë palës paditëse të rregullojë prokurën, ka shtyrë seancën për në datën 10.06.2021. (24 ditë)
2. **Seanca e datës 10.06.2021,** në të cilën gjykata pasi çel seancën dhe verifikon prezencën e palëve të cilët rezultojnë të jenë të pranishëm, shpall trupin gjykues dhe sekretaren gjyqësore dhe ka ftuar palët të parashetrojnë qëndrimet e tyre. Në kushtet kur lind e nevojshme caktimi i një eksperti të fushës, seanca është shtyrë për në datën 09.07.2021. (29 ditë)
3. **Seanca e datës 09.07.2021,** në të cilën gjykata pasi çel seancën, dhe verifikon prezencën e palëve ka konstatuar se janë paraqitur palët e paditura dhe eksperti,

- ndërsa pala paditëse ka depozituar kërkesë për shtyrje. Me qëllim njoftimin e palës paditëse, gjykata ka shtyrë seancën e radhës për në datë 13.10.2021. (3 muaj e 6 ditë)
4. **Seanca e datës 13.10.2021**, në të cilën gjykata pasi ka çelur seancën dhe ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse, nuk është paraqitur njëri nga të paditurit, si dhe nuk është paraqitur ekspertja (pa shkak mungesa e ekspertës). Përfaqësuesi i palës ka kërkuar nga gjykata zëvendësimin e ekspertës. Gjykata me qëllim njoftimin e të njëjtit ekspert, ka shtyrë seancë për në datën 02.12.2021. (1 muaj e 20 ditë)
 5. **Seanca e datës 02.12.2021**, në të cilën gjykata pasi ka çelur seancën dhe ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se nuk është paraqitur pala paditëse (ka kërkesë për shtyrje), nuk është paraqitur njëri nga të paditurit, si dhe është paraqitur ekspertja. Gjykata pranon kërkesën për shtyrje të paraqitur nga paditësi dhe ka shtyrë seancën për në datën 18.02.2022. (2 muaj e 17 ditë)
 6. **Seanca e datës 18.02.2022**, në të cilën gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse, nuk janë paraqitur të paditurit, si dhe nuk është paraqitur ekspertja. Paditësi pretendon se ekspertja ka konflikt interesi dhe duhet të përjashtohet. Me qëllim njoftimin e ekspertës, është shtyrë seanca për në datën 21.03.2022. (1 muaj e 2 ditë)
 7. **Seanca e datës 21.03.2022**, nuk është zhvilluar për shkak se kjo datë është festë zyrtare. Seanca e radhës është caktuar në datën 14.04.2022. (24 ditë)
 8. **Seanca e datës 14.04.2022**, në të cilën gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se mungojnë palët e paditura, prezent është paditësi dhe ekspertja. Paditësi parashtron përsëri kërkesën për përjashtim eksperti pasi janë në kushtet e konfliktit të interesit. Gjykata pranon kërkesën dhe thërret një ekspert të ri. Eksperti i ri është paraqitur në të njëjtën seancë, i cili pasi bën betimin, ka marrë detyrat. Me qëllim përgatitjen e aktit të ekspertimit (akti do dorëzohet në datën 16.05.2022), është shtyrë seanca për në datën 27.06.2022. (2 muaj e 15 ditë)
 9. **Seanca e datës 27.06.2022**, në të cilën gjykata pasi verifikon prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur paditësi, nuk është paraqitur një nga palët e paditura. Gjykata ka relatuar se eksperti ka njoftuar se nuk e ka përgatitur aktin pasi nuk rezulton të mos jetë paguar tarifa për aktin e ekspertimit. Për ti lënë kohë ekspertit të përfundojë aktin, seanca është shtyrë për në datën 03.10.2022. (3 muaj e 6 ditë)
 10. **Seanca e datës 03.10.2022**, në të cilën gjykata pasi verifikon prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur paditësi, nuk janë paraqitur palët e paditura. Gjykata ka marrë vendim për zhvillimin e seancës në mungesë të palës së paditur. Gjykata ka relatuar se eksperti e ka përgatitur aktin dhe e ka depozituar. Për ti komunikuar aktin e ekspertimit palëve në mungesë, seanca është shtyrë për në datën 22.11.2022. (1 muaj e 21 ditë)
 11. **Seanca e datës 22.11.2022**. Kjo seancë nuk është zhvilluar për arsye se gjyqtari mungon për shkak delegimi në një gjykatë tjetër. Seanca e radhës është caktuar në datë 18.01.2023. (1 muaj e 28 ditë)
 12. **Seanca e datës 18.01.2023**, në të cilën gjykata pasi verifikon prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur vetëm paditësi, nuk janë paraqitur palët e paditura. Gjykata ka vijuar seancën në mungesë të palës së paditur. Paditësi paraqet një

kërkesë për shtim të objektit të kërkesëpadisë dhe me qëllim të komunikimit të shtesës së objektit, seanca është shtyrë për në datën 13.03.2023.

- Në datë 20.03.2023 është rishortuar çështja.

13. **Seanca e datës 20.09.2023.** Kjo seancë nuk është zhvilluar sepse gjyqtari ka munguar për arsye familjare. (1 muaj e 13 ditë)
14. **Seanca e datës 08.11.2023,** në të cilën gjykata pasi verifikon prezencën e palëve ka konstatuar se nuk është paraqitur paditësi (ka kërkesë për shtyrje nga paditësi), është paraqitur njëra nga palët e paditura. Seanca është shtyrë për në datën 22.01.2024. (2 muaj e 14 ditë)
15. **Seanca e datës 22.01.2024,** në të cilën, gjykata pasi verifikon prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur paditësi, nuk është paraqitur njëra nga palët e paditura, vijohet seanca në mungesë të kësaj të fundit. Gjykata ka vlerësuar të nevojshme të thërrasë ekspertin në lidhje me shtesën e objektit. Në vijim është shtyrë seanca për në datën 26.03.2024. (2 muaj e 4 ditë)
16. **Seanca e datës 26.03.2024,** në të cilën gjykata pasi bën verifikimin e prezencës të palëve, ka marrë vendim mungese për palët që kanë marrë dijeni dhe nuk janë paraqitur dhe ka vijuar duke pyetur ekspertin nëse mund të vijojë me shtesë akti. Gjykata ka marrë vendim për kalim në seancë gjyqësore e cila është caktuar në datën 15.05.2024. (1 muaj e 19 ditë)
17. **Seanca gjyqësore e datës 15.05.2024,** në të cilën gjykata pasi çel seancën gjyqësore bën verifikimin e prezencës së palëve, ka konstatuar se është paraqitur përfaqësuesja e palës së thërritur rishtazi, është paraqitur paditësi dhe një nga palët e paditur si dhe është paraqitur përfaqësuesi i A.SH. Pasi shpall trupin gjykues, gjykata ka deklaruar të hapur debatin gjyqësor duke vijuar diskutimet rreth çështjes. Në seancë rezultoi të jenë thërritur dëshmitarë të cilët pas betimit kanë dhënë deklaratimet e tyre. Eksperti i thërritur ka sqaruar aktin e ekspertimit. Në përfundim gjykata çmon se i duhet dhënë fund hetimit gjyqësor, ka administruar provat dhe ka ftuar palët për të dhënë konkluzionet përfundimtare. Në kushtet kur palët kanë kërkuar kohë, gjykata ka shtyrë seancën në datë 27.05.2024. (12 ditë)
18. **Seanca gjyqësore e datës 27.05.2024,** në të cilën palët depozitojnë pretendimet e fundit. Seanca për shpallje të vendimit është shtyrë për në datë 13.06.2024. (17 ditë)
19. **Seanca gjyqësore e datës 13.06.2024.** Shpallja e vendimit.

Referuar datës 02.02.2021 të depozitimit të kërkesëpadisë dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës 13.06.2024, rezultoi se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 3 vite e 4 muaj e 11 ditë.

Shkaqet e shtyrjes së seancave ndër të tjera lidhen me shkaqe procedurale që vijnë nga sjellja e paditësit (4 seanca) si kërkesa për shtyrje seance, rregullim prokure, si dhe me mungesën e gjyqtarit, (3 seanca) për arsye delegimi; familjare; festë zyrtare). Gjithashtu konstatohen seanca të shtyra për shkaqe që janë të lidhura me ekspertin dhe aktin e ekspertimit.

Për sa i përket distancës kohore ndërmjet seancave konstatohet se:



Për gjyqtarin e parë: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 24 ditë. Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 3 muaj e 6 ditë. Për gjyqtarin e dytë: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 12 ditë. Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 2 muaj e 14 ditë.

- **Dy çështje me objekt “Konstatim pavlefshmërie”**

I. Çështja nr. 10935-00710-23-2023

Kërkesë padia është depozituar dhe regjistruar në gjykatë në datën 19.07.2023 si dhe është shortuar po në të njëjtën datë.

Seanca e parë është caktuar pas 2 muajsh nga data e hedhjes së shortit.

Nga ana e gjykatës janë kryer këto veprime procedurale si më poshtë:

1. **Seanca e datës 19.09.2023**, në të cilën gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se nuk është paraqitur pala e paditur pasi rezulton të mos ketë marrë dijeni në lidhje me datën e seancës, është paraqitur i padituri tjetër të cilit ju la detyrë të depozitohet ekstraktin e shoqërisë. Me qëllim njoftimin e palës së paditur nëpërmjet shpalljes publike, seanca e radhës u caktua në datën 01.11.2023.
2. **Seanca e datës 01.11.2023**, në të cilën gjykata pasi ka çelur seancën përgatitore ka verifikuar prezencën e palëve, ka shpallur trupin gjykues, ka deklaruar të hapur shqyrtimin gjyqësor të çështjes duke ftuar palët të japin shpjegime. Në referim të nenit 213 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata vendos të lejojë për shqyrtim provat e depozituara nga palët, si dhe vlerëson se zyra përmbarimore duhet të depozitohet praktikën përmbarimore. Gjithashtu gjykata vlerëson se do të lejojë provat me dëshmitarë në seancën e radhës e cila caktohet në datën 14.12.2023.
3. **Seanca e datës 14.12.2023**, në të cilën sekretarja gjyqësore relaton mungesën e gjyqtarit për shkaqe shëndetësore. Seanca e radhës do të jetë në datë 27.02.2024.
4. **Seanca e datës 27.02.2024**, në të cilën sekretarja gjyqësore relaton mungesën e gjyqtarit për shkak të pjesëmarrjes së gjyqtarit në një angazhim në Këshillin e Lartë të Gjyqësor. Seanca e radhës do të jetë në datë 28.02.2024, ora 11.00.
5. **Seanca e datës 28.02.2024**, në të cilën pasi është verifikuar prezenca e palëve ka rezultuar se nuk është paraqitur paditësi, është paraqitur përfaqësuesi i tij ligjor (avokati) si dhe janë paraqitur palët e tjera. Përfaqësuesi ligjor i paditësit ka deklaruar se ky i fundit ka ndërruar jetë dhe për këtë shkak kërkojnë kohë. Në këto kushte gjykata ka caktuar seancën e radhës në datën 09.04.2024.
6. **Seanca e datës 09.04.2024**, në të cilën është verifikuar prezenca e palëve ku rezulton se janë paraqitur palët ndërgjyqëse. Përfaqësuesi i palës paditëse depoziton dëshminë e trashëgimisë nëpërmjet së cilës do të kryhet kalimi procedural te trashëgimtarët ligjorë. Gjkata vlerëson se duhet të depozitohet edhe një prokurë tjetër. Seanca e radhës është caktuar në datën 29.04.2024.
7. **Seanca e datës 29.04.2024**, në të cilën pasi është verifikuar prezenca e palëve konstatohet se përfaqësuesi i palës paditëse kërkon përsëri kohë për të paraqitur prokurën. Me qëllim përmbushjen e kësaj detyre, seanca e radhës caktohet në datën 22.05.2024, ora 10.00.
8. **Seanca e datës 22.05.2024**, në të cilën pasi verifikohet prezenca e palëve, përfaqësuesi i palës paditëse deklaroi se kanë pasur 2 dëshmitarë por njëri prej tyre

ka ndërruar jetë. Prezent është dëshmitari tjetër i cili ka lexuar formulën e betimit dhe është betuar. Gjykata fton palët t'i bëjnë pyetje dëshmitarit, i cili më pas lihet i lirë. Gjykata revokon vendimin për thirrjen e dëshmitarit të dytë pasi ka ndërruar jetë. Në përfundim të debatit gjyqësor, në mbështetje të nenit 213 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata merr në administrim të gjitha provat, deklaron të mbyllur shqyrtimin gjyqësor dhe fton palët në diskutimet përfundimtare. Vendimi do të shpallet i arsyetuar në datën 06.06.2024, ora 13.45.

9. Seanca e datës 06.06.2024, në të cilën gjykata ka shpallur vendimin.

Referuar datës 19.07.2023 të depozitimit të kërkesëpadisë dhe datës 06.06.2024 të vendimmarrjes së gjykatës, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 10 muaj e 18 ditë.

Konstatohet se nuk kanë rezultuar shumë seanca të shtyra për shkak të mungesës së palëve ndërgjyqëse. Shkak për shtyrjen më të gjatë ka qenë seanca e cila u shty për shkak të ndërrimit të jetës të palës paditëse si dhe të kohës së nevojshme për çeljen e dëshmisë të trashëgimisë dhe depozitimin e saj. Rezultojnë 2 seanca të shtyra për shkak të mungesës së gjyqtarit.

Në procesverbalet e seancave mungon pasqyrimi i kalimit nga seanca përgatitore në seancën gjyqësore. Distanca më e gjatë kohore nga seanca në seancë është 14.12.2023-27.02.2024. Distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është 27.02.2024-28.02.2024.

II. Çështja nr. 21262-00235-23-2021

Kërkesë padia është depozituar dhe regjistruar në gjykatë në datën 18.03.2021. Çështja është shortuar në datën 18.03.2021.

Kjo çështje është shortuar 1 herë.

Seanca e parë është caktuar 3 muaj e 17 ditë pas shortit.

Nga gjykata janë kryer këto veprime procedurale:

- 1. Seanca e datës 05.07.2021.** Gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar mungesën e të paditurve për shkak të mos marrjes dijeni për seancën. Me qëllim marrjen dijeni gjykata ka vlerësuar njoftimin e të paditurve me shpallje publike. Seanca e radhës është planifikuar në datë 21.09.2021. (2 muaj e 16 ditë)
- 2. Seanca e datës 21.09.2021,** kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të delegimit të gjyqtarit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Përmet. Seanca e radhës është planifikuar në datë 19.10.2021. (28 ditë)
- 3. Seanca e datës 19.10.2021,** gjykata ka deklaruar mungesën e palëve të paditura të cilat janë njoftuar nëpërmjet shpalljes publike duke vlerësuar gjithashtu caktimin e një seance tjetër në funksion të paraqitjes së përfaqësuesve të palëve të paditura. Seanca e radhës është planifikuar në datë 07.12.2021. (2 muaj 17 ditë)
- 4. Seanca e datës 07.12.2021.** Kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të delegimit të gjyqtarit në Gjykatë në Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Përmet. Seanca e radhës është planifikuar në datë 25.01.2022. (1 muaj e 19 ditë)

5. **Seanca e datës 25.01.2022**, gjykata ka pranuar kërkesën për shtyrje të një pale të paditur për shkak të gjendjes shëndetësore e justifikuar me raport mjekësor. Seanca e radhës është planifikuar në datë 15.03.2022.(1 muaj e 19 ditë)
6. **Seanca e datës 15.03.2022**. Në këtë seancë gjykata ka verifikuar prezencën e palëve ka vlerësuar të shtyjë seancën me kërkesë të palës së paditur. Seanca e radhës është planifikuar në datë 04.05.2022. (1 muaj e 20 ditë)
7. **Seanca e datës 04.05.2022**. Gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se për një nga palët e paditura nuk është realizuar njoftimi. Në funksion të njoftimit me shpallje publike seanca e radhës është planifikuar në datë 23.06.2022. (1 muaj e 20 ditë)
8. **Seanca e datës 23.06.2022**. Në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka shtyrë seancën me qëllim për t'u shprehur në lidhje me kërkesën e palës së paditur për gjykimin e çështjes me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. Seanca e radhës është planifikuar në datë 11.10.2022. (3 muaj e 20 ditë)
9. **Seanca e datës 11.10.2022**. Në këtë seancë gjykata ka pranuar kërkesën e palës së paditur për t'u njohur me dosjen. Seanca e radhës është planifikuar në datë 07.12.2022. (1 muaj e 27 ditë)
10. **Seanca e datës 07.12.2022**. Gjatë kësaj seance pala e paditur nuk i ka paraqitur provat sikurse ka kërkuar në seancën paraardhëse, dhe në vijim gjykata ka shtyrë në mënyrë të përsëritur seancën për të njëjtin shkak. Referuar këtij procesverbali konstatohet se nuk ka shënime lidhur me datën e seancës se ardhshme. (4 muaj e 28 ditë)
11. **Seanca e datës 04.05.2023**. Kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak se gjyqtari ka munguar për arsye shëndetësore. Seanca e radhës është planifikuar për t'u zhvilluar në datë 22.06.2023. (1 muaj e 19 ditë)
12. **Seanca e datës 22.06.2023**, gjykata ka relatuar mosformimin e trupit gjykues pasi një nga anëtarët mungon (nuk specifikohet shkaku i mungesës) ndërsa anëtari tjetër është në një gjykim paralel. (planifikuar 2 çështje njëkohësisht). Seanca e radhës është planifikuar për t'u zhvilluar në datë 10.10.2023. (3 muaj e 20 ditë)
13. **Seanca e datës 10.10.2023**, gjykata verifikon prezencën e palëve dhe ka vlerësuar të vijojë në mungesë të palëve të paditura që kanë dijeni dhe të njoftojë me shpallje publike të paditurit për të cilët nuk konfirmohet marrja dijeni. Seanca e radhës është planifikuar për t'u zhvilluar në datë 13.12.2023. (2 muaj e 3 ditë)
14. **Seanca e datës 13.12.2023**, kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye shëndetësore. Seanca e radhës është planifikuar për t'u zhvilluar në datë 05.03.2024 (2 muaj e 23 ditë)
15. **Seanca e datës 05.03.2024**, në këtë seancë gjykata ka deklaruar mungesën për palët të cilët kanë dijeni dhe për të tjerët ka vijuar me procedurën me shpallje, ka shpallur trupin gjykues dhe ka lejuar marrjen në shqyrtim të provave. Palët kanë paraqitur prapësimet, dhe në vijim gjykata ka administruar provat dhe ka deklaruar të mbyllur shqyrtimin gjyqësor. Me qëllim paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare nga palët, seanca e radhës është planifikuar për t'u zhvilluar në datë 11.03.2024. (6 ditë)
16. **Seanca e datës 11.03.2024**. Gjatë kësaj seance palët kanë paraqitur konkluzionet dhe gjykata i ka administruar. Gjykata ka vlerësuar të riçel hetimin gjyqësor në funksion të administrimit të një "Vendimi gjyqësor të formës së prerë" nga pala e

- paditur. Në vijim gjykata ka shtyrë seancën me qëllim për t'i lënë kohë paditësit të njihet me këtë provë. Seanca e radhës është planifikuar në datë 04.04.2024. (25 ditë)
17. **Seanca e datës 04.04.2024.** Gjatë kësaj seanca A.SH ka paraqitur kërkesën për njohjen me provat e reja dhe në vijim gjykata ka pranuar këtë kërkesë duke shtyrë seancën për në datë 07.05.2024. (1 muaj e 3 ditë)
 18. **Seanca e datës 07.05.2024.** Në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se njëri nga përfaqësuesit e palës së paditur ka depozituar kërkesë për shtyrje. Seanca është shtyrë për në datën 28.05.2024 (21 ditë).
 19. **Seanca e datës 28.05.2024.** Në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ndërgjyqëse, ka marrë në administrim provat shkresore dhe ka deklaruar të mbyllur shqyrtimin gjyqësor, ka ftuar palët të paraqesin konkluzionet përfundimtare dhe ka shtyrë seancën për shpalljen e vendimit për në datën 11.06.2024 (14 ditë).
 20. **Seanca e datës 11.06.2024.** Shpallja e vendimit.

Referuar datës 18.03.2021 të depozitimit të kërkesëpadiisë dhe datës 11.06.2024 të vendimmarrjes së gjykatës, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 3 vjet 2 muaj 24 ditë.

Referuar shkaqeve të shtyrjes së seancave ndër të tjera rezultojnë 2 seanca të shtyra për shkak të mungesës së gjyqtarit për shkak delegimi si dhe shkaqe të tjera, 3 seanca të shtyra për shkak të mosmarrjes dijeni të palëve ndërgjyqëse për seancën si dhe për shkak të njohjes së tyre me provat e reja.

Distanca më e shkurtër kohore nga njëra çështje në tjetrën është 6 ditë. Distanca më e gjatë kohore nga njëra çështje në tjetrën është 4 muaj e 27 ditë.

- Çështjet me objekt “Pushim cenimi”

I. Çështja nr. 21256-00456-23-2022

Kërkesëpadiia është depozituar në gjykatë në datë 05.05.2022, është regjistruar në këtë të fundit dhe është shortuar në datën 05.05.2022. Kjo çështje është shortuar një herë. Seanca e parë është caktuar pas 2 muaj e 23 ditë nga data e hedhjes së shortit.

Nga ana e gjykatës janë kryer veprimet procedurale si më poshtë:

1. **Seanca e datës 28.07.2022**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur paditësi dhe përfaqësuesi i tij gjithashtu është paraqitur i padituri. Për të caktuar ekspertin, gjykata ka shtyrë seancën për në datën 06.10.2022. (2 muaj e 8 ditë)
2. **Seanca e datës 06.10.2022**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se nuk është paraqitur paditësi, por është paraqitur asistentja e përfaqësuesit të tij. Është paraqitur i padituri së bashku me 2 përfaqësues ligjorë. Në vijim gjykata ka pranuar kërkesën për shtyrje seance për shkak të mos paraqitjes së përfaqësuesit të paditësit. Seanca e radhës është caktuar në datën 17.11.2022 (1 muaj e 11 ditë).



3. **Seanca e datës 17.11.2022**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se nuk është paraqitur paditësi, por është paraqitur përfaqësuesi i tij. Është paraqitur i padituri dhe përfaqësuesi i tij. Është paraqitur eksperti i cili ka kërkuar kohë për hartimin e aktit të ekspertimit. Në vijim gjykata ka caktuar datën 12.01.2023 për dorëzim të aktit të ekspertimit si dhe i ka lënë 5 ditë kohë palëve për paraqitjen e kundërshtimeve. (5 muaj e 8 ditë)
4. **Seanca e datës 25.04.2023**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se nuk është paraqitur paditësi, por është paraqitur përfaqësuesi i tij. Është paraqitur i padituri dhe përfaqësuesi i tij. Nuk është paraqitur eksperti i cili ka bërë kërkesë për shtyrje të seancës. Për të njoftuar ekspertin, është caktuar seanca në datën 07.06.2023 (1 muaj e 13 ditë).
5. **Seanca e datës 07.06.2023**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se nuk janë paraqitur palët ndërgjyqëse, të cilët kanë paraqitur kërkesën për shtyrje. Për të njoftuar palët, është shtyrë seanca për në datën 05.10.2023. (3 muaj e 28 ditë)
6. **Seanca e datës 05.10.2023**, kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye trajnimi. Seanca e radhës është caktuar në datën 07.12.2023 (2 muaj e 2 ditë).
7. **Seanca e datës 07.12.2023**, në këtë seancë gjykata ka konstatuar se nuk janë paraqitur paditësi dhe përfaqësuesi i tij të cilët kanë depozituar kërkesë për shtyrje. Për të paditurin është paraqitur përfaqësuesi i tij. Nuk është paraqitur eksperti. Me qëllim shoqërimin e tij, gjykata ka shtyrë seancën në datën 22.02.2024 (4 muaj e 15 ditë).
8. **Seanca e datës 21.02.2024** në këtë seancë gjykata ka konstatuar se është paraqitur përfaqësuesi i paditësit dhe përfaqësuesi i të paditurit. Nuk është paraqitur eksperti. Me qëllim shoqërimin e ekspertit, seanca e radhës është caktuar në datën 11.03.2024 (18 ditë).
9. **Seanca e datës 11.03.2024**, në këtë seancë gjykata ka konstatuar se janë paraqitur përfaqësuesit e palëve si dhe eksperti i cili ka dorëzuar aktin e ekspertimit. Është urdhëruar kalimi në seancë gjyqësore. Seanca e radhës është caktuar në datën 23.04.2024 (1 muaj e 12 ditë).
10. **Seanca e datës 23.04.2024**, në këtë seancë gjykata ka konstatuar se janë paraqitur përfaqësuesi i palës paditëse, i padituri me përfaqësuesin e tij. Është paraqitur eksperti. Për të marrë forcërisht pagesën e tarifës së ekspertit gjykata ka shtyrë seancën për në datën 23.05.2024 (1 muaj).
11. **Seanca e datës 23.05.2024**, në këtë seancë u paraqit përfaqësuesi i palës paditëse, i padituri së bashku me përfaqësuesin e tij. Përfaqësuesi i palës paditëse ka kërkuar përjashtimin e trupit gjykues dhe ka paraqitur me shkrim kërkesën. Pasi është relatuar akti i ekspertimit, gjykata ka shtyrë seancën për tu shprehur një gjyqtar tjetër i kësaj gjykate. Seanca e radhës është 05.06.2024 (13 ditë).
12. **Seanca e datës 05.06.2024**, kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të bojkotit të avokatëve. Seanca e radhës është caktuar në datën 13.06.2024 (8 ditë).
13. **Seanca e datës 13.06.2024**, në këtë seancë gjykata ka vendosur pushimin e gjykimit për shkak të kërkesës së bërë nga përfaqësuesi i paditësit për heqje dorë nga gjykimi.



Referuar datës 05.05.2022 së depozitimit të kërkesëpadisë dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës 13.06.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 2 vite, 1 muaj e 8 ditë.

Në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave pjesë e konsiderueshme e shkaqeve të shtyrjes lidhen me ekspertin dhe aktin e ekspertimit. Gjithashtu 3 seanca janë shtyrë për shkak të palës paditëse. Për shkak të gjykatës është shtyrë 1 seancë (trajnim gjyqtari) ndërsa 1 seancë është shtyrë për shkak të bojkotit të avokatëve. Konstatohet gjithashtu se 1 seancë është shtyrë për shkak të shqyrtimit të kërkesës për përjashtim gjyqtari.

Distanca kohore nga seanca në seancë: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 8 ditë. Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 5 muaj e 8 ditë.

II. Çështja nr. 21256-00209-23-2020

Kërkesëpadia është depozituar dhe regjistruar në gjykatë në datën 06.02.2020.

Kjo çështje është shortuar dy herë përkatësisht: Shorti i parë në datën 06.02.2020; shorti i dytë në datën 26.10.2023.

Seanca e parë e sigurimit të padisë është caktuar brenda 5 ditëve nga data e shortit, ndërsa seanca e parë për themelin e çështjes është caktuar 5 muajsh e 16 ditë pas shortit të parë.

Seanca e parë pas shortit të dytë është zhvilluar pas 3 muajsh e 7 ditë.

Nga gjykata janë kryer këto veprime procedurale:

1. **Seanca e datës 11.02.2020** Në këtë seancë gjykata pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën për sigurim padie brenda 5 ditëve, ka shpallur vendimin lidhur me këtë kërkesë në dhomë këshillimi. (5 muaj e 11 ditë)
2. **Seanca e datës 22.07.2020** është shtyrë për shkak të njoftimit të ekspertit dhe njoftimit të pakësimit të ndërgjyqësisë. Seanca e radhës është planifikuar në datë 30.09.2020. (2 muaj e 8 ditë)
3. **Seanca e datës 30.09.2020** Në këtë seancë nuk është paraqitur eksperti dhe për këtë arsye si dhe për depozitimin e pyetjeve për ekspertin është shtyrë seanca për ditën e nesërme, në datë 01.10.2020. (1 ditë)
4. **Seanca e datës 01.10.2020**, është shtyrë për shkak të marrjes së provave tek të tretët. Seanca e radhës është caktuar për në datën 23.11.2020. (1 muaj e 23 ditë)
5. **Seanca e datës 23.11.2020**. Në procesverbalin e kësaj date nuk ka shënime dhe si rrjedhim nuk kuptohet se çfarë veprimesh janë kryer si dhe nuk kuptohet shkakun e shtyrjes. Data e seancës së radhës është caktuar në 03.02.2021. (2 muaj e 10 ditë)
6. **Seanca e datës 03.02.2021**, është shtyrë për shkak të njohjes me aktin e ekspertimit si dhe sigurimin e provave tek të tretët. Seanca e radhës është caktuar në datën 07.04.2021. (2 muajsh e 4 ditësh)
7. **Seanca e datës 07.04.2021**, është shtyrë me qëllim marrjen e provës nga të tretët. Gjykata drejtohet me kërkesë të përsëritur për marrje prove tek të tretët. Seanca e radhës është caktuar në datën 26.05.2021. (1 muajsh e 19 ditësh)

8. **Seanca e datës 26.05.2021**, është shtyrë për shkak të procedurave që kanë të bëjnë me akt ekspertimin. Seanca e radhës është caktuar në datën 12.07.2021 (1 muaj e 16 ditë)
9. **Seanca e datës 12.07.2021**. Në këtë seancë gjykata ka marrë vendimin për kalim në seancë gjyqësore. Seanca është shtyrë për shkak të procedurave që kanë të bëjnë me aktin e ekspertimit. Seanca e radhës është caktuar në datën 13.10.2021. (3 muaj e 1 ditë)
10. **Seanca gjyqësore e datës 13.10.2021**, në seancë ka qenë prezent paditësi dhe përfaqësuesi i tij. Përfaqësuesi i të paditurit ka njoftuar gjykatën se i padituri nuk ka qenë prezent pasi ka ndërruar jetë. Gjykata ka relatuar se do ti drejtohet gjendjes civile për vënien në dispozicion të certifikatës së vdekjes dhe më pas të bëhet kalimi procedural. Gjykata në referim të nenit 299 të K.P.C në vijim ka vendosur pezullimin e gjykimit. (3 muaj e 27 ditë)
11. **Seanca gjyqësore e datës 09.02.2022**, nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye shëndetësore. Seanca e radhës është planifikuar në datë 28.03.2022. (1 muaj e 17 ditë)
12. **Seanca gjyqësore e datës 28.03.2022**, nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye shëndetësore. Seanca e radhës është planifikuar në datë 12.05.2022. (1 muaj e 14 ditë)
13. **Seanca gjyqësore e datës 12.05.2022**, nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye të pjesëmarrjes në trajnim. Seanca e radhës është planifikuar në datë 15.06.2022. (1 muaj e 3 ditë).
14. **Seanca gjyqësore e datës 15.06.2022**, nuk është zhvilluar për shkak të bojkotit të avokatëve. Seanca e radhës është planifikuar në 21.09.2022.(3 muaj e 6 ditë)
15. **Seanca gjyqësore e datës 21.09.2022**. Në këtë seancë gjykata ka relatuar se nuk është paraqitur dëshmia e trashëgimisë ligjore dhe në vijim ka vendosur pezullimin e gjykimit derisa të depozitohet ky dokument.

- **Çështja është rishortuar në datën 26.10.2023**

16. **Seanca gjyqësore e datës 02.02.2024**, është seanca e parë për gjyqtarin e ri pasi kjo çështje është rishortuar në datë 26.10.2023. Gjykata pasi ka relatuar ndryshimin e trupit gjykues, ka vlerësuar të nevojshëm njoftimin personalisht të palës paditëse. Për këtë shkak gjykata ka shtyrë seancën për në datën 13.02.2024. (11 ditë)
17. **Seanca gjyqësore e datës 13.02.2024**, është shtyrë për shkak të mungesës së paditësit. Gjykata ka vlerësuar të përsërisë njoftimin me letërthirrje për palën paditëse. Seanca e radhës është planifikuar në datë 01.03.2024. (18 ditë)
18. **Seanca gjyqësore e datës 01.03.2024**. Në këtë seancë gjykata pasi ka konstatuar pamundësinë e njoftimit të paditësit me letërthirrje ka vlerësuar të njoftojë paditësin me shpallje publike. Për këtë shkak seanca e radhës është planifikuar në datë 12.04.2024. (1 muaj e 11 ditë)
19. **Seanca gjyqësore e datës 12.04.2024**. Në këtë seancë paditësi nuk është paraqitur. Gjykata është relatuar se e konsideron të kryer njoftimin dhe në këto kushte gjykata ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes.

Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë 06.02.2020 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës 12.04.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 4 vite 2 muaj e 6 ditë.

Kërkesa për sigurim padie është shqyrtuar dhe është marrë vendim brenda afatit ligjor. Konstatohet ndër të tjera se 5 seanca janë të shtyra për shkaqe që kanë të bëjnë me procedurat që lidhen me aktin e ekspertimit dhe ekspertin; 3 seanca të shtyra për shkak të mungesës së gjyqtarit (2 seanca për shkaqe shëndetësore dhe 1 seancë për shkak të pjesëmarrjes në trajnim); 3 seanca të shtyra për shkak të palës paditëse; 1 seancë e shtyrë për shkak të bojkotit të avokatëve.

Distanca kohore ndërmjet seancave:

Për gjyqtarin e parë: Distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është 1 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga seanca në seancë është 5 muaj e 11 ditë.

Për gjyqtarin e dytë: Distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është 11 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga seanca në seancë është 1 muaj e 11 ditë.

Çështja është pezulluar dy herë përkatësisht nga data: 13.10.2021-09.02.2022 dhe 21.09.2022 – 02.02.2024.

- Çështjet me objekt “Përmbushjen e detyrimit kontraktor”

1. Çështja nr. 21235-00604-23-2023

Kërkesëpadia është depozituar në datën 13.06.2023, është regjistruar në datën 13.06.2023 si dhe është shortuar në datë 13.06.2023.

Kjo çështje është shortuar 1 herë.

Seanca e parë është caktuar 4 muaj e 27 ditë pas hedhjes së shortit.

Gjykata ka kryer veprimet procedurale si vijojnë:

1. **Seanca e datës 09.11.2023.** Në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ndërgjyqëse ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse, nuk është paraqitur pala e paditur për të cilin ka vendosur gjykimin në mungesë. Është caktuar eksperti i cili ka marrë detyrat përkatëse. Për ti lënë kohë ekspertit të hartojë aktin e ekspertimit kjo seancë është shtyrë për t’u zhvilluar në datën 23.01.2024.(2 muaj e 14 ditë)
2. **Seanca e datës 23.01.2024.** Kjo seancë është zhvilluar në prani të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur. Është dorëzuar akti i ekspertimit. Me qëllim njoftimin e aktit të ekspertimit palës së paditur është shtyrë seanca në datën 29.02.2024.(1 muaj e 6 ditë)
3. **Seanca e datës 29.02.2024.** Kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye shëndetësore. Seanca e radhës është caktuar për t’u zhvilluar në datën 09.04.2024.(1 muaj e 10 ditë)
4. **Seanca e datës 09.04.2024.** Kjo seancë është zhvilluar në prani të palës paditëse dhe palës së paditur. Gjykata ka marrë vendim për kalim të çështjes për gjykim dhe është shtyrë seanca për t’u zhvilluar në datën 13.05.2024.(1 muaj e 4 ditë)
5. **Seanca gjyqësore e datës 13.05.2024.** Kjo seancë është zhvilluar në prezencë të palëve dhe pasi janë administruar aktet, është kaluar në konkluzione përfundimtare. Seanca është shtyrë për shpallje vendimi për në datën 30.05.2024.(17 ditë)
6. **Seanca gjyqësore e datës 30.05.2024.** Shpallja e vendimit.

Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë 13.06.2023 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës 30.05.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 11 muaj e 17 ditë.

Shkaqet e shtyrjes së seancave: 1 seancë e shtyrë për shkaqe që lidhen me ekspertin dhe aktin e ekspertimit; 1 seancë e shtyrë për shkak të palës së paditur; 1 seancë e shtyrë për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye shëndetësore; 1 seancë e shtyrë për shkak të kalimit në seancë gjyqësore; 1 seancë e shtyrë për shpallje vendimi.

Distancat kohore ndërmjet seancave: Distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është 17 ditë. Distanca më e gjatë kohore nga seanca në seancë është 2 muaj e 14 ditë.

II. Çështja nr. 11217-00608-23-2020

Kërkesëpadia është depozituar në gjykatë në datë 23.07.2020, është regjistruar dhe shortuar brenda datës 23.07.2020.

Kjo çështje është shortuar 2 herë përkatësisht: shorti i parë në datën 23.07.2020; shorti i dytë në datën 12.11.2020.

Seanca e parë është caktuar pas 3 muaj e 6 ditë nga data e hedhjes së shortit të parë.

Seanca e parë pas shortit të dytë është caktuar pas 1 muaj e 30 ditë nga data e rishortimit.

Nga ana e gjyqtarit të çështjes janë kryer këto veprime procedurale si më poshtë:

1. **Seanca e datës 29.10.2020**, në të cilën gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve i ka dhënë fjalën palëve ndërgjyqëse në proces. Në vijim gjykata ka caktuar ekspertin. Për ti lënë kohë palës paditëse të sjellë prova, seanca është shtyrë në datën 20.11.2020. (2 muaj e 13 ditë)

- Çështja është rishortuar në datë 12.11.2020

2. **Seanca e datës 11.01.2021**. Kjo seancë ka nisur me verifikimin e prezencës së palëve, por për shkak të mungesës së aktit të përfaqësimit (prokura fotokopje) përfaqësuesi i palës paditëse ka kërkuar kohë që të paraqitet vetë administratori i shoqërisë. Kjo seancë është shtyrë për t'u zhvilluar në datën 03.02.2021, me qëllim paraqitjen e aktit të përfaqësimit. (23 ditë).
3. **Seanca e datës 03.02.2021**. Në këtë seancë pasi është verifikuar prezenca e palëve ka rezultuar se është paraqitur pala paditëse e cila ka kërkuar shtyrjen e seancës për shkakun se gabimisht avokatit të palës paditëse i është nisur nga shoqëria paditëse prokura e gabuar. Me qëllim plotësimin e kësaj të mete (paraqitjen e prokurës së rregullt), është shtyrë seanca për në datën 18.02.2021. (15 ditë)
4. **Seanca e datës 18.02.2021**. Në këtë seancë kanë qenë prezent palët ndërgjyqëse në proces të përfaqësuar nga avokatët përkatës. Është kërkuar nga përfaqësuesi i palës paditëse caktimi i ekspertit topograf dhe kontabël të cilëve do t'u vihet në dispozicion kontrata e bashkëpunimit. Gjykata pranon kërkesën dhe ka marrë vendim duke caktuar 2 ekspertët e fushës. Prezent eksperti kontabël, mungon eksperti topograf.

Me qëllim thërritjen e ekspertit topograf kjo seancë është shtyrë për t'u zhvilluar në datën 11.03.2021. 21 (ditë)

5. **Seanca e datës 11.03.2021.** Në këtë seancë është nuk është paraqitur përfaqësuesi i palës paditëse i cili kishte kërkuar shtyrjen e seancës për shkak të pjesëmarrjes së tij në një seancë tjetër, ndërkohë është paraqitur avokati i palës së paditur. Njëkohësisht është paraqitur eksperti i cili ka bërë betimin dhe ka marrë detyrat. Gjykata ka pranuar kërkesën e palës paditëse për shtyrjen e seancës për në datën 18.03.2021. 7 (ditë)
6. **Seanca e datës 18.03.2021.** Kjo seancë është zhvilluar me paraqitjen e ekspertit të caktuar nga gjykata, detyrat ndaj të cilit duhet të depozitohen me shkrim. Me qëllim depozitimin e aktit të ekspertimit nga eksperti, kjo seancë është shtyrë për t'u zhvilluar në datën 15.04.2021. (21 ditë)
7. **Seanca e datës 15.04.2021.** Në këtë seancë, në prani të palëve ndërgjyqëse, është dorëzuar akti i ekspertimit nga eksperti. Me qëllim lënien kohë palëve për tu njohur me aktin e ekspertimit si dhe për tu depozituar marrëveshja gjykata ka vendosur të shtyjë seancën për në datën 19.05.2021. (1 muaj e 4 ditë)
8. **Seanca e datës 19.05.2021,** nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye shëndetësore. Kjo seancë është shtyrë për në datën 21.06.2021. (1 muaj e 2 ditë)
9. **Seanca e datës 21.06.2021.** Në këtë seancë konstatohet se në vijim të zhvillimit të saj në prani të palëve ndërgjyqëse, avokati i palës paditëse i ka kërkuar kohë gjykatës për paraqitjen e marrëveshjes dhe kryerjen e pagesës së ekspertit. Kjo kërkesë është pranuar nga gjykata e cila ka shtyrë seancën për në datën 26.07.2021. (1 muaj e 5 ditë)
10. **Seanca e datës 26.07.2021.** Në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se avokati i palës paditëse ka paraqitur kërkesë për shtyrje e cila është pranuar nga gjykata. Seanca është shtyrë për në datë 27.09.2021. (2 muaj e 2 ditë)
11. **Seanca e datës 27.09.2021.** Në këtë seancë janë të pranishëm të 2 përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse, por për shkak të pamundësisë të përmbushjes së 2 detyrave të lëna nga gjykata për shkak të sëmundjes së administratorit të shoqërisë paditëse, avokati i palës paditëse kërkoi shtyrjen e seancës. Gjykata pranon kërkesën dhe ka shtyrë seancën për në datën 04.11.2021, ora 10.00. (1 muaj 8 ditë)
12. **Seanca e datës 04.11.2021.** Në këtë seancë, pas konstatimit të përmbushjes së detyrave të lëna dhe administrimit të provave gjykata ka vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore. Seanca e radhës është caktuar në datën 20.12.2021. (1 muaj e 16 ditë)
13. **Seanca gjyqësore e datës 20.12.2021.** Në këtë seancë palët janë prezent. Gjykata shpall trupin gjykues, pyeten palët nëse janë dakord dhe nëse kanë kërkesa. Avokati i palës paditëse sqaron se ka kërkuar të konsultohet me palën pasi mund ta zgjidhin çështjen me pajtim duke sqaruar se do ta paguajnë faturën e ekspertit. Për këtë arsye ka kërkuar shtyrjen e seancës, kërkesë e cila pranohet nga gjykata e cila ka caktuar seancën në datën 31.01.2022. (1 muaj 11 ditë)
14. **Seanca gjyqësore e datës 31.01.2022.** Në këtë seancë janë prezent të dyja palët. Përfaqësuesi i palës paditëse ka relatuar se nuk ka kontakt me palën që përfaqëson

dhe sqaron se nuk është bërë ende pagesa, duke propozuar shtyrjen e seancës me një muaj kohë për të bërë pagesën e ekspertit dhe arritjen e marrëveshjes së pajtimit. Në këto kushte gjykata pranon kërkesën dhe ka shtyrë seancën gjyqësore në datën 07.03.2022. (1 muaj 4 ditë)

15. **Seanca gjyqësore e datës 07.03.2022**, nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye familjare. Kjo seancë është shtyrë për në datën 20.04.2022. (1 muaj e 13 ditë)
16. **Seanca gjyqësore e datës 20.04.2022**, rezulton të jetë shtyrë përsëri për shkak të mos kryerjes së pagesës së tarifës për aktin e ekspertimit nga pala paditëse. Me qëllim administrimin e pagesës të aktit kjo seancë është shtyrë për t'u zhvilluar në datën 26.05.2022. (1 muaj e 6 ditë)
17. **Seanca gjyqësore e datës 26.05.2022**. Në këtë seancë pasi verifikohet prezenca e palëve konstatohet që është paraqitur avokati i palës paditëse, nuk është paraqitur avokati i palës së paditur. Përfaqësuesi i palës paditëse ka deklaruar se eksperti nuk është paguar. Gjykata riçel seancën duke i lënë edhe njëherë kohë për likuidimin e ekspertit, në të kundërt do të procedohet me Zyrën e Përmbarrimit. Në funksion të përmbushjes së këtij detyrimi, seanca është shtyrë për në datën 07.07.2022. (1 muaj e 11 ditë)
18. **Seanca gjyqësore e datës 07.07.2022**, nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së palëve dhe përfaqësuesve. Seanca e radhës është caktuar në datën 03.10.2022. (2 muaj 26 ditë)
19. **Seanca e datës 03.10.2022**, nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye familjare. Kjo seancë është shtyrë për në datën 03.11.2022. (1 muaj)
20. **Seanca gjyqësore e datës 03.11.2022**. Pasi verifikohet prezenca e palëve ndërgjyqëse, avokati i palës paditëse sqaron se pagesa e ekspertit vijon të mos jetë kryer. Për këtë shkak, gjykata urdhëron vjeljen e shpenzimeve të ekspertit përmes shërbimit përmbarrimor.
Seanca është shtyrë për në datën 15.12.2022. (1 muaj e 12 ditë)
21. **Seanca gjyqësore e datës 15.12.2022**, nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye trajnimi. Kjo seancë është shtyrë për në datën 30.01.2023. (1 muaj 15 ditë)
22. **Seanca gjyqësore e datës 30.01.2023**. Në këtë seancë, pas diskutimeve përkatëse mes palëve, në vijim të konstatimit të mospërmbushjes së detyrimeve në lidhje me akt ekspertimin, me qëllim thirrjen e ekspertit për relativimin e aktit të ekspertimit, gjykata ka shtyrë seancën për në datën 16.03.2023. (1 muaj 14 ditë)
23. **Seanca gjyqësore e datës 16.03.2023**, nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye trajnimi. Kjo seancë është shtyrë për në datën 04.05.2023. (1 muaj e 18 ditë)
24. **Seanca gjyqësore e datës 04.05.2023**. Në këtë seancë pasi është verifikuar prezenca e palëve, gjykata ka relatuar se nuk është përmbushur detyrimi për pagesën e ekspertit dhe se nuk disponojnë informacion nga shërbimi përmbarrimor për këtë çështje. Në këto kushte, për tu informuar lidhur me veprimtarinë e Zyrës Përmbarrimore, është shtyrë seanca gjyqësore për në datë 12.06.2023. (1 muaj e 8 ditë)

- 25. Seanca gjyqësore e datës 12.06.2023.** Pas verifikimit të prezencës së palëve ndërgjyqëse është riçelur seanca për verifikim të kryerjes së pagesës së ekspertit, i cili rezultoi sërish i palikuiduar. Në këto kushte gjykata urdhëron shtyrjen e seancës në pritje të ekzekutimit të vendimit nga shërbimi përbarimor. Seanca e radhës është caktuar për në datë 04.07.2023. (22 ditë)
- 26. Seanca gjyqësore e datës 04.07.2023.** Në këtë seancë, pasi është verifikuar prezenca e palëve, është relatuar nga gjykata se ka një përgjigje nga Zyra Përbarimore, por gjykata ka vlerësuar se me qëllim që të bëhet ekzekutimi i detyrueshëm i aktit, të shtyhet seanca për në datën 04.10.2023. (3 muaj)
- 27. Seanca gjyqësore e datës 04.10.2023.** Të pranishëm në këtë seancë janë të 2 përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse. Gjykata ka relatuar se edhe pse seanca është shtyrë disa herë dhe edhe pse është urdhëruar ekzekutimi i detyrueshëm i aktit, ende nuk është përmbushur ekzekutimi. Eksperti citon aktin dhe konfirmon se pagesa nuk është kryer. Seanca është shtyrë për në datën 30.11.2023. (1 muaj e 26 ditë)
- 28. Seanca gjyqësore e datës 30.11.2023.** Pas verifikimit të prezencës së palëve ndërgjyqëse u relatua se pagesa ende nuk është përmbushur. Për të lënë kohë Zyrës së Përbarimit për vjeljen e shpenzimeve të ekspertit seanca është shtyrë për në datën 01.02.2024 (2 muaj e 2 ditë).
- 29. Seanca gjyqësore e datës 01.02.2024.** Seanca nuk është zhvilluar pasi avokati i palës paditëse nuk është paraqitur për shkak të një urgjence mjekësore. Seanca u shty në datën 12.03.2024, ora 12.00. (2 muaj e 2 ditë)
- 30. Seanca gjyqësore e datës 12.03.2024.** Në këtë seancë, pas verifikimit të prezencës së palëve në gjykim gjykata ka relatuar dhe pyetur nëse palët janë dakord të japin fund shqyrtimit gjyqësor. Gjykata administron aktet, i jep fund shqyrtimit gjyqësor dhe ka ftuar palët në konkluzionet përfundimtare. Seanca për shpallje të vendimit është caktuar në datën 02.04.2024. (21 ditë)
- 31. Seanca gjyqësore e datës 02.04.2024,** shpallja e vendimit

Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë 23.07.2020 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës, 02.04.2024, rezultoi se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 3 vitesh e 8 muajsh e 10 ditë.

Lidhur me shkaqet e shtyrjes së seancave konstatohet se 15 seanca janë shtyrë përkatësisht për shkaqe që lidhen me palën paditëse; 5 seanca të shtyra për shkak të mungesës së gjyqtarit; 2 seanca për shkaqe shëndetësore, 2 seanca për pjesëmarrje në trajnim dhe 1 seancë për shkaqe të tjera. Rezultojnë 2 seanca të shtyra për shkaqe që lidhen me mosnjohimin e gjykatës mbi fazën përbarimore në të cilën ndodhej vjelja e tarifës së aktit të ekspertimit.

Distanca kohore ndërmjet seancave:

Për gjyqtarin e parë: Në lidhje me këtë çështje rezultoi të jetë zhvilluar vetëm 1 seancë.

Për gjyqtarin e dytë: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 7 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 3 muaj.

- Çështje me objekt “ kthim shume”

I. Çështja nr. 21240-00064-23-2023 me objekt “kthim shume”

Kërkesëpadia është depozituar në gjykatë në datë 16.01.2023 dhe është regjistruar në sekretari po në datë 16.01.2023.

Kjo çështje është shortuar 1 herë përkatësisht në datën 16.01.2023.

Seanca e parë është caktuar pas 3 muajsh e 6 ditësh nga data e hedhjes së shortit të parë.

Gjykata ka kryer veprimet procedurale si vijojnë:

1. **Seanca e datës 24.05.2023.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, te rubrika “Shënim për seancën” rezulton që për këtë seancë nga ana e gjykatës për njërën prej palëve të paditura të jetë vendosur gjykimi në mungesë, për shkak të kthimit të përgjigjes postare me shënimin në fletëthirrje “refuzuar”, ndërsa për palën tjetër të paditur të vijojë njoftimi nëpërmjet shpalljes publike si dhe nëpërmjet kontaktit të telefonit për shkak të kthimit të përgjigjes postare me shënimin “larguar”. Seanca e radhës është caktuar të jetë serish përgatitore dhe është shtyrë për t’u zhvilluar në datën 06.07.2023. (1 muaj e 12 ditë)
2. **Seanca e datës 06.07.2023,** rezulton të jetë zhvilluar në mungesë të palëve të paditura (njoftuar). Kjo seancë është shtyrë për në datën 13.09.2023, duke i lënë kohë palës paditëse të dorëzojë provat e kërkuara nga gjykata për vijimin e gjykimit.(2 muaj e 7 ditë)
3. **Seanca e datës 13.09.2023,** është zhvilluar në mungesë të palëve të paditura sipas vendimit të marrë nga gjykata në seancat e kaluara. Rezulton të jenë administruar provat e kërkuara, dhe në vijim seanca është shtyrë nga gjykata për shkak të nevojës së marrjes së një informacioni drejtuar QKB dhe shoqërisë ADCA. Pas pranimit të kërkesës, nga ana e gjykatës është caktuar eksperti dhe janë caktuar detyrat e tij në lidhje me çështjen. Kjo seancë është shtyrë për t’u zhvilluar në datë 17.10.2023.(1 muaj e 4 ditë)
4. **Seanca e datës 17.10.2023,** rezulton të jetë zhvilluar serish në mungesë të palëve të paditura. Pas administrimit të provave të kërkuara në seancën e kaluar dhe pyetjes së palës së paditur, gjykata ka urdhëruar kalimin në seancë gjyqësore. Seanca e radhës rezulton të jetë caktuar nga ana e gjykatës për t’u zhvilluar në datë 14.12.2023 si dhe është bërë komunikimi i palëve të paditura.(1 muaj e 27 ditë)
5. **Seanca gjyqësore e datës 14.12.2023,** rezulton të mos jetë zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit të çështjes për arsye shëndetësore. Në Rubrikën “Shënim për seancën” rezulton që për seancën e radhës palët do të njoftohen nga gjykata.(2 muaj e 28 ditë)
6. **Seanca gjyqësore e datës 13.03.2024,** rezulton të jetë zhvilluar në mungesë të palëve të paditura, njoftimi i të cilëve është bërë nëpërmjet shpalljes publike. Në këtë seancë pasi janë administruar provat në tërësi është mbyllur shqyrtimi gjyqësor dhe janë ftuar palët për konkluzionet përfundimtare. Kjo seancë është shtyrë për t’u zhvilluar në datë 02.04.2024.(20 ditë)
7. **Seanca gjyqësore e datës 02.04.2024,** është mbyllur me shpalljen e vendimit për këtë çështje dhe pranimin e kërkesë-padisë nga ana e gjykatës.

Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë 16.01.2023 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës 02.04.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 1 vit 2 muaj e 17 ditë.

Nga përmbajtja e seancave rezulton se këto të fundit janë shtyrë për shkaqe procedurale të ndryshme sikundër janë kalimi për shqyrtim në seancë gjyqësore, dhënien kohë palëve ndërgjyqëse për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare etj. Ndërsa për sa i përket seancës gjyqësore të datës 14.12.2023, kjo e fundit rezulton të jetë shtyrë për shkak të mungesës së gjyqtarit të çështjes për arsye shëndetësore. Për sa i përket distancës kohore ndërmjet seancave, evidentohet fakti se distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është prej 20 (njëzet) ditë ndërsa distanca më e largët është ajo prej 2 muaj e 28 ditë.

II. Çështja nr. 21240-01201-23-2014, me objekt “Shpërblim dëmi”

Kërkesë padia është depozituar në gjykatë në datë 12.09.2014, është regjistruar në datë 12.09.2014 si dhe është shortuar brenda kësaj date.

Kjo çështje është shortuar katër herë përkatësisht: **shorti i parë** – 12.09.2014²⁶, **shorti i dytë** 25.04.2019²⁷, **shorti i tretë** 19.12.2019²⁸, dhe **shorti i katërt** 26.10.2023²⁹.

Seanca e parë është caktuar pas 24 ditësh nga data e hedhjes së shortit të parë.

Seanca e parë pas hedhjes së shortit të dytë (25.04.2019) është caktuar në datë 10.07.2019, pas 2 muajsh e 15 ditësh nga data e këtij shorti.

Seanca e parë pas shortit të tretë (19.12.2019), është caktuar në datë 12.02.2020, pas 1 muaj e 24 ditë nga data e hedhjes së këtij shorti.

Seanca e parë pas shortit të katërt (26.10.2023), është caktuar (09.05.2024) pas 6 muaj e 13 ditë.

Gjykata ka kryer veprimet procedurale si vijojnë:

- 1. Seanca e datës 06.10.2014.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, në rubrikën “Shënim për seancën” konstatohet se kjo seancë pas shpalljes së trupit gjykues dhe verifikimit të palëve ndërgjyqëse ka vijuar me dëgjimin e kërkesave të tyre. Në vijim, gjykata ka vendosur të shtyjë seancën për t’u zhvilluar në datë 29.10.2014, pas kërkesës së palës paditëse për plotësimin e të metave të padisë (23 ditë).
- 2. Seanca e datës 29.10.2014.** Palët kanë qenë prezent. Pala paditëse ka parashtruar vlerën e objektit të padisë dhe ka paraqitur kërkesë lidhur me kompetencën territoriale. Gjykata ka rrëzuar kërkesën dhe ka vendosur ta kalojë çështjen në seancë

²⁶ Kryesuese gjyqtare Enkeleda Doda

²⁷ Pas miratimit të kërkesës për dorëheqje të gjyqtarës E.D, çështja i është shortuar gjyqtarës Ketra Bajrami

²⁸ Sipas vendimit të KLGJ gjyqtarës Ketra Bajrami i ka përfunduar statusi i magjistratit për arsye të dorëheqjes së saj, çështja i është shortuar gjyqtarës Nevrie Duka e cila ka hequr dorë. Brenda datës 19.12.2019 çështja i është shortuar gjyqtarës Suela Xhani.

²⁹ Me vendimin nr. 527, datë 11.10.2023 gjyqtarja Suela Xhani është transferuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe çështja është rishortuar tek gjyqtarja Edona Vajushi.

gjqësore. Në vijim, gjykata ka marrë vendim duke caktuar seancën e radhës për t'u zhvilluar në datë 19.11.2014 (21 ditë).

3. **Seanca gjyqësore e datës 19.11.2014**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, tek rubrika "Shënim për seancën" konstatohet se zhvillimi i kësaj seance nuk është realizuar për shkak të mosplotësimit të trupës gjyqësore, për shkak të mungesës së gjyqtarit A.Ç i cili ndodhej në një seminar trajnues. Gjukata ka planifikuar seancën e radhës në datë 09.12.2024 (2 ditë).
4. **Seanca gjyqësore e datës 09.12.2024**, rezulton të jetë shtyrë për t'u zhvilluar në datë 13.01.2025, pas pranimit nga gjykata të kërkesës së palës paditëse për ndryshimin e përfaqësuesit të saj. (1 muaj e 4 ditë)
5. **Seanca gjyqësore e datës 13.01.2015**. Pala e paditur ka kërkuar pezullimin për shkak të një procesi tjetër. Seanca rezulton të jetë shtyrë për t'u zhvilluar në datë 27.01.2015, pas lënies së detyrës për të paraqitur pala e paditur kopje të kërkesës së padisë për çështjen që po gjykohej në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (14 ditë).
6. **Seanca gjyqësore e datës 27.01.2015**, rezulton të jetë shtyrë për shkak të mosplotësimit të trupës gjyqësore për shkak të mungesës së gjyqtarit A.Ç i cili ndodhej në seminar. Gjithashtu, në këtë seancë rezulton të mos jenë paraqitur palët e paditura të cilat kanë pasur dijeni në seancën e kaluar (14 ditë).
7. **Seanca gjyqësore e datës 10.02.2015**, gjykata ka vendosur mospranimin e kërkesës për pezullim, ka deklaruar të hapur shqyrtimin gjyqësor. Gjukata ka vendosur ta shtyjë seancën për t'u zhvilluar në datë 27.02.2015 me qëllim lënien kohë për dorëzimin e provave të palës paditëse dhe paraqitjes së prapësimeve nga ana e palës së paditur (17 ditë).
8. **Seanca gjyqësore e datës 27.02.2015**, rezulton të jetë shtyrë për shkak të mosplotësimit të trupës gjyqësore për shkak të mungesës së gjyqtarit A.Ç (nuk bëhen me dije shkaqet e mungesës). Seanca e radhës është caktuar për t'u zhvilluar në datën 17.03.2015 (duke sqaruar se ky afat është i gjatë për shkak se gjyqtarët janë në seminar) (18 ditë)
9. **Seanca gjyqësore e datës 17.03.2015**, rezulton të jetë shtyrë për shkak të mungesës së përfaqësuesit të palës së paditur me kërkesë të palës së paditur. Seanca e radhës është caktuar për t'u zhvilluar në datën 10.04.2015 (25 ditë).
10. **Seanca gjyqësore e datës 10.04.2015**, rezulton të jetë shtyrë për shkak të mosplotësimit të trupës gjyqësore për shkak të mungesës së gjyqtarit A.Ç (nuk bëhen me dije shkaqet e mungesës) si dhe mungesës së gjyqtarës K.B e cila ndodhej në një gjyq tjetër. Gjithashtu, konstatohet shënimi se palët janë njoftuar për shtyrjen dhe nuk janë paraqitur në këtë seancë. Seanca e radhës është caktuar për t'u zhvilluar në datën 24.04.2015. (14 ditë)
11. **Seanca gjyqësore e datës 24.04.2015**, rezulton të jetë shtyrë për shkak të kërkesës së paraqitur nga pala e paditur për shtyrje seance për shkak të mungesës së përfaqësuesit për arsye shëndetësore (raport mjekësor). Seanca e radhës është caktuar për t'u zhvilluar në datën 21.05.2015. (27 ditë)
12. **Seanca gjyqësore e datës 21.05.2015**, gjatë zhvillimit të kësaj seance rezulton të jenë relatuar pretendimet e palëve dhe janë depozituar provat duke vijuar me prapësimet. Me kërkesë të palës paditëse për t'u përgjigjur me shkrim pyetjeve të palës së paditur,



gjkata ka vendosur ta pranojë kërkesën dhe të caktojë seancën e radhës për t'u zhvilluar në datë 11.06.2015. (21 ditë)

- 13. Seanca gjyqësore e datës 11.06.2015**, gjykata ka vendosur të shtyjë seancën për në datën 06.07.2015, pas diskutimeve të zhvilluara ndërmjet palëve në proces, me qëllim lënien kohë palës paditëse për plotësimin e përgjigjeve si dhe palës së paditur për të paraqitur prova. (25 ditë)
- 14. Seanca gjyqësore e datës 13.10.2015**. Në këtë seancë rezultoi që nga ana e palës së paditur të jetë paraqitur kërkesë për pezullimin e gjykimit pasi ndodhet në cilësinë e të paditurit në këtë proces dhe njëkohësisht në një proces tjetër që ka të bëjë me këtë çështje në cilësinë e të pandehurit. Mbi këtë kërkesë dhe pas verifikimit të dokumentacionit të përcjellë në seancë, Gjykata ka vendosur pezullimin e gjykimit të kësaj çështjeje civile. koha e pezullimit : 3 vjet, 8 muaj e 27 ditë)

- Çështja u shortua në datën 25.04.2019 (shorti i 2-të)

- 15. Seanca gjyqësore e datës 10.07.2019**. Në këtë seancë³⁰ gjykata raportoi mungesën e palës paditëse dhe të paditurit, pasi ndonëse janë njoftuar në rrugë postare nuk ka ardhur konfirmimi për njoftimin e tyre. Gjykata ka vendosur të shtyjë seancën për në datë 11.09.2019 (afat i gjatë për shkak të lejes vjetore dhe ngarkesës së punës së gjyqtarëve). (2 muaj e 1 ditë)
- 16. Seanca gjyqësore e datës 11.09.2019**, gjykata ka vendosur të shtyjë seancën për në datën 25.09.2019, për shkak të depozitimit në datën 10.09.2019 të kërkesës për shtyrje nga pala e paditur në adresën e kancelarit të gjykatës. (Shkak pasi ndodhej në një proces penal) (14 ditë).
- 17. Seanca gjyqësore e datës 25.09.2019**, është zhvilluar në mungesë të palëve të paditura pasi gjykata nuk ka pranuar kërkesën për shtyrje të paraqitur elektronikisht dhe me postë nga pala e paditur. Gjykata ka shpallur trupën gjyqësore sipas vendimit të KLGJ-së dhe ka raportuar shkaqet e rënies së pezullimit, pas përfundimit të çështjes penale. Për nevojën të gjykimit kjo seancë është shtyrë për t'u zhvilluar në datë 09.10.2019, me qëllim marrjen e informacionit dhe dokumentacionit kryesisht nga gjykata drejtuar shoqërisë tregtare "Raiffaisen Bank", si dhe thirrjen e ekspertit (13 ditë).
- 18. Seanca gjyqësore e datës 09.10.2019**, kjo seancë është zhvilluar në mungesë të palës së paditur, kërkesa për shtyrje e së cilës është refuzuar nga gjykata si e përsëritur dhe e pajustificuar. Në vijim, gjykata ka vendosur të pranojë kërkesën e palës paditëse për përjashtimin e ekspertit (shkak njëanshmëria), Gjykata ka marrë vendim për caktimin e grupit të ekspertimit dhe për të marrë detyrën këta të fundit si dhe në mungesë të dërgimit të informacionit të kërkuar në seancën e kaluar nga Raiffaisen Bank, ka vendosur të shtyjë seancën për në datën 23.10.2019. (14 ditë)
- 19. Seanca gjyqësore e datës 23.10.2019**. Në këtë seancë gjykata ka pranuar kërkesën e palës paditëse për përjashtimin e njërit prej ekspertëve dhe ka caktuar ekspertin e ri. Në kushtet kur ekspertët nuk janë paraqitur si dhe me qëllim paraqitjen dhe betimin e

³⁰Kryesuesja Ketra Bajrami ka raportuar vendimin e KLGJ-së mbi caktimin e 2 anëtarëve të trupit gjyqësor Mirela Ilipopudho dhe Pëllumb Vehbi për gjykimin e kësaj çështjeje.

tyre si dhe caktimin e detyrave përkatëse, gjykata ka vendosur të shtyjë seancën për në datën 06.11.2019. (14 ditë)

- 20. Seanca gjyqësore e datës 06.11.2019.** Në këtë seancë gjykata ka vendosur të refuzojë kërkesat e palëve të paditura për shtyrje të seancës (për shkak se ka qenë e përsëritur dhe e pajustificuar). Gjithashtu, në këtë seancë rezulton të mos jenë paraqitur 2 ekspertë për shkak të gjendjes shëndetësore. Gjukata vendosi të revokoj vendimin e ndërmjetëm për caktimin e këtyre dy ekspertëve dhe të caktoj dy ekspertë të tjerë. Me qëllim thirrjen e ekspertëve, gjykata ka vendosur të shtyjë gjykimin për në datën 20.11.2019. (14 ditë)
- 21. Seanca gjyqësore e datës 20.11.2019.** Në këtë seancë gjykata ka rrëzuar kërkesën e palës së paditur për shtyrjen e seancës (e pajustificuar dhe e papërligjur) dhe ka vijuar gjykimin në mungesë. Më tej, rezulton të mos jenë paraqitur dy prej ekspertëve për shkak së një prej tyre ishte me leje lindje ndërsa për ekspertin tjetër gjykata ka relatuar: *“eksperti ka deklaruar se është i zënë me punë të tjera dhe nuk mund të paraqitet”*. Gjukata ka revokuar përsëri vendimin e ndërmjetëm për ekspertin me leje lindje dhe ka caktuar një ekspert të ri si dhe ka vendosur shoqërimin e detyrueshëm për ekspertin i cili ka deklaruar më herët ngarkesën e punës. Në vijim gjykata ka shtyrë seancën në datën 04.12.2019. (14 ditë)
- 22. Seanca gjyqësore e datës 04.12.2019,** nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarës K.B për arsye shëndetësore. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, në rubrikën “Shënim për seancën” konstatohet se kjo seancë është shtyrë për t’u zhvilluar në datë 18.12.2019

- **Çështja është rishortuar në datë 19.12.2019 (shorti i 3-të)**

- 23. Seanca gjyqësore e datës 12.02.2020.** Në këtë seancë konstatohet të jetë ndryshuar trupi gjykues dhe të ketë vijuar gjykimin në fazën e mbetur. Në këtë seancë janë administruar provat shkresore dhe është vendosur thirrja e ekspertëve për dhënien e një mendimi shkencor. Seanca e radhës është shtyrë në datë 11.03.2020 (ky planifikim është anuluar) (5 muaj e 10 ditë)
- 24. Seanca gjyqësore e datës 22.07.2020.** Kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarës M.I., Kjo seancë është shtyrë për t’u zhvilluar në datë 16.09.2020. (1 muaj e 25 ditë)
- 25. Seanca gjyqësore e datës 16.09.2020.** Në këtë seancë konstatohet se gjatë kësaj seance janë parashtruar disa kërkesa nga pala e paditur për pushimin e gjykimin, kërkesë për ripërsëritjen e hetimit të cilat nuk janë pranuar nga gjykata. Në vijim pala e paditur ka paraqitur kërkesën për përjashtim të trupit gjykues për të cilën gjykata ka relatuar: *“në referim të nenit 75 të K.P.C gjykimin nuk mund të pezullohet”*. Në vijim pasi është bërë betimi i ekspertëve të caktuar nga gjykata, është proceduar me pyetje nga palët, të cilat kanë kërkuar kohë në paraqitjen e tyre me shkrim. Bazuar në kërkesën e palëve dhe në faktin se akti i ekspertimit ka shtesë, kjo seancë është shtyrë për t’u zhvilluar në datë 14.10.2020. (28 ditë)
- 26. Seanca gjyqësore e datës 14.10.2020,** nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit P.B i cili ka qenë prezent në Gjukatën e Rrethit Gjyqësor Përmet. Palët janë

njoftuar në lidhje me mungesën e tij dhe nuk janë paraqitur. Seanca është shtyrë për t'u zhvilluar në datë 04.11.2020 (21 ditë).

27. **Seanca gjyqësore e datës 04.11.2020.** Në këtë seancë gjykata ka relatuar se kërkesa e bërë për ndryshimin e trupit gjykues nuk është pranuar dhe më pas ka vijuar gjykimi duke proceduar me pyetjet drejtuar ekspertëve. Në vijim gjykata është tërhequr në dhomë këshillimi për të caktuar se cilat pyetje do ti paraqiten ekspertëve. Seanca është shtyrë për në datë 02.12.2020 si dhe është urdhëruar shoqërimi i detyrueshëm i ekspertit K.R i cili ka marrë dijeni dhe nuk është paraqitur në seancë.(28 ditë)
28. **Seanca gjyqësore e datës 02.12.2020.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, në rubrikën "Shënim për seancën" konstatohet shënimi: "Gjyqtarja M.I nuk do të paraqitet për arsye objektive". Kjo seancë është shtyrë për t'u zhvilluar në datë 13.01.2021. (1 muaj 11 ditë).
29. **Seanca gjyqësore e datës 13.01.2021.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, në rubrikën "Shënim për seancën" konstatohet shënimi: "Eksperti kontabël K.R ka depozituar një kërkesë për të mos qenë pjesë pasi ka njohje personale me z. V.N. Për këtë arsye gjykata e pranon kërkesën e ekspertit dhe do të caktoj një ekspert tjetër.". Kjo seancë është shtyrë për t'u zhvilluar në datë 10.02.2021. (28 ditë)
30. **Seanca gjyqësore e datës 10.02.2021.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, në rubrikën "Shënim për seancën" konstatohet se një eksperte ka kërkuar kohë për të përfunduar aktin. Pasi është betimi i ekspertit të ri seanca ka vijuar me pyetjet e palëve. Seanca është shtyrë për në datë 17.03.2021 për t'i dhënë kohë palëve për tu njohur me provat e paraqitura dhe sqarimet e dhëna nga eksperti. (1 muaj e 5 ditë)
31. **Seanca gjyqësore e datës 17.03.2021.** Në këtë seancë rezulton të mos jenë paraqitur anëtarët e trupit gjykues për shkak të gjykimeve të ngutshme. Gjithashtu, konstatohet se e njëjta eksperte ka kërkuar përsëri kohë për të përgatitur aktin. (1 muaj e 18 ditë)
32. **Seanca gjyqësore e datës 05.05.2021,** rezulton të mos jetë zhvilluar për shkak të përfundimit të statusit të magjistratit për anëtarin P.V. Seanca është shtyrë deri në caktimin e një date të re pas krijimit të trupit gjykues. (28 ditë)
33. **Seanca gjyqësore e datës 02.06.2021.** Gjykata ka vijuar me shpalljen e trupit gjykues dhe ka relatuar zëvendësimin e një prej anëtarëve të seancës së kaluar me gjyqtarin S.L. Ekspertja ka kërkuar kohë shtesë për tu paraqitur aktin. Kjo seancë është shtyrë për t'u zhvilluar në datë 07.07.2021 për ti lënë kohë ekspertëve për paraqitjen e akt-ekspertimit, pas kërkesës së tyre. (1 muaj e 5 ditë)
34. **Seanca gjyqësore e datës 07.07.2021,** konstatohet të mos jetë zhvilluar për shkak të mungesës së një prej anëtareve të trupit gjykues, gjyqtare M.I për arsye shëndetësore. Gjithashtu konstatohet mungesa e ekspertës për arsye shëndetësore. Palët nuk janë paraqitur është shënuar njoftimi i tyre nëpërmjet fletëthirrjes për seancën e ardhshme në datë 06.10.2021 (3 muaj).
35. **Seanca gjyqësore e datës 06.10.2021,** rezulton të mos jetë zhvilluar për shkak të përfundimit të statusit të magjistratit për anëtarin e trupit gjykues M.I e cila është zëvendësuar me gjyqtarin F.N i cili për këtë seancë ka paraqitur raport mjekësor. Gjithashtu ka paraqitur kërkesë për shtyrje ekspertja. Në lidhje me këtë fakt, rezulton të jetë njoftuar dhe anëtarja tjetër e trupës M.I. Seanca është shtyrë për t'u zhvilluar në datë 01.12.2021. (1 muaj e 25 ditë)

36. **Seanca gjyqësore e datës 01.12.2021**, rezulton të mos jetë zhvilluar për shkak të mungesës së kryetares së trupit gjykues S.XH për arsye shëndetësore. (2 muaj e 2 ditë)
37. **Seanca gjyqësore e datës 02.02.2022**. Në këtë seancë rezulton të jetë dorëzuar akti i ekspertimit të ekspertëve si dhe një kundërpadi nga pala e paditur. Gjykata ka vendosur afat 1 javor për plotësimin e të metave të kundërpadisë së depozituar nga pala e paditur. Në vijim, gjykata ka vendosur të shtyjë seancën në datë 31.03.2022 dhe për njoftimin e ekspertit. (1 muaj e 27 ditë)
38. **Seanca gjyqësore e datës 31.03.2022**, rezulton të mos jetë zhvilluar për shkak të mungesës së anëtarit të trupit gjykues F.N për arsye shëndetësore, dhe mungesës së gjyqtarit SH.L pasi ndodhej në trajnim. Seanca është shtyrë për t'u zhvilluar në datë 30.05.2022. (2 muaj)
39. **Seanca gjyqësore e datës 30.05.2022**, rezulton të mos jetë zhvilluar për shkak të mungesës së anëtarit të trupit gjykues SH.L për arsye shëndetësore. Seanca është shtyrë për t'u zhvilluar në datë 06.07.2022. (37 ditë)
40. **Seanca gjyqësore e datës 06.07.2022**, rezulton të mos jetë zhvilluar për shkak të mosparaqitjes së ekspertëve të cilët kanë marrë dijeni. Gjithashtu rezulton të jenë paraqitur kërkesa për shtyrje nga përfaqësuesit e palëve. Seanca është shtyrë për t'u zhvilluar në datë 04.10.2022 (3 muaj).
41. **Seanca gjyqësore e datës 04.10.2022**. Në këtë seancë rezulton të jetë dorëzuar akti i ekspertimit. Nga pala e paditur rezulton të jetë paraqitur kërkesë për pezullimin e gjykimit për shkak se ka paraqitur një kallëzim penal ndaj trupës gjyqësore dhe ekspertëve, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet dhe kërkesë për fillimin e gjykimit nga fillimi pasi ka ndryshuar dy anëtarë të trupës gjyqësore. Të dyja këto kërkesa janë rrëzuar nga gjykata. Gjithashtu ka rrëzuar dhe kërkesën për kundërpadinë. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, rezulton se seanca është shtyrë për t'u zhvilluar në datë 05.12.2022 për shkak të mungesës së ekspertit për arsye familjare. (2 muaj e 1 ditë)
42. **Seanca gjyqësore e datës 05.12.2022**, rezulton të mos jetë zhvilluar për shkak të mungesës së anëtarit të trupit gjykues SH.L pasi ndodhej në trajnim. Seanca është shtyrë për t'u zhvilluar në datë 06.02.2023. (2 muaj e 1 ditë)
43. **Seanca gjyqësore e datës 06.02.2023**, rezulton të mos jetë zhvilluar për shkak të mungesës së kryetares së trupit gjykues S.XH për arsye shëndetësore. Seanca është shtyrë për t'u zhvilluar në datë 27.04.2023 (2 muaj e 1 ditë).
44. **Seanca gjyqësore e datës 27.04.2023**, referuar procesverbalit të kësaj seance, rezulton se të jetë ndryshuar trupi gjykues pasi gjyqtari SH.L është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe sipas shortit është caktuar gjyqtari A.V. Gjykata ka vijuar me gjykimin në prezencë të palëve dhe pas diskutimeve të zhvilluar ka vendosur ta shtyjë seancën në datë 13.06.2023 për t'i dhënë kohë ekspertëve për pyetjet dhe provat e paraqitura nga pala e paditur. (47 ditë)
45. **Seanca gjyqësore e datës 13.06.2023**, rezulton të mos jetë zhvilluar për shkak të mungesës së palës së paditur dhe përfaqësuesja ligjore të cilët kanë depozituar kërkesë për shtyrje të seancës. Seanca është shtyrë për t'u zhvilluar në datë 28.09.2023. (3 muaj e 15 ditë)



46. Seanca gjyqësore e datës 28.09.2023, rezulton të mos jetë zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit A.V për arsye shëndetësore.

- Çështja u rishortua në datën 26.10.2023 (shorti i 4-rt)

47. Seanca gjyqësore e datës 09.05.2024, rezulton të mos jetë zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarës E.V për arsye shëndetësore. Seanca është shtyrë për t'u zhvilluar në datë 24.06.2024. (1 muaj e 15 ditë)

48. Seanca gjyqësore e datës 24.06.2024. Referuar procesverbalit të kësaj seance, rezulton se gjykata pas verifikimit të palëve prezentë ka relatuar mbi kërkesën e depozituar me shkrim për heqje dorë nga e drejta kryesisht e padisë dhe rrëzimin e padisë e firmosur nga palët. Gjykata në përfundim ka shpallur vendimin përfundimtar.

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 48 seanca. Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë, dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 9 vjet, 9 muaj e 12 ditë.

Në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave konstatohet ndër të tjera se: Rezultojnë 20 seanca të shtyra për shkak të mungesës së gjyqtarit, 1 seancë e shtyrë për shkak të mungesës së palës paditëse, 4 seanca të shtyra për shkak të mungesës të palës së paditur, 2 seanca të shtyra për shkak të mungesës e palëve ndërgjyqëse, 14 seanca të shtyra për shkak të ekspertit dhe veprimeve procedurale që lidhen me aktin e ekspertimit, 1 seancë e shtyrë për shkak të rregullimit të metave të padisë, 3 seanca të shtyra për shkak të marrjes dhe paraqitjes së provave, 1 seancë e shtyrë për shkak të kalimit nga një fazë procedurale në tjetrën, 1 seancë e shtyrë për administrim prove që lidhet me shkakun ligjor të pezullimit, 1 seancë e shtyrë për shkaqe të tjera.

Në lidhje me distancën kohore ndërmjet seancave konstatohet se:

Për gjyqtarin e parë: Distanca me e gjatë nga seanca në seancë është 1 muaj e 4 ditë

Distanca me e shkurtër nga seanca në seancë është 2 ditë

Për gjyqtarin e dytë: Distanca me e gjatë nga seanca në seancë është 2 muaj e 8 ditë;

Distanca me e shkurtër nga seanca në seancë është 13 ditë

Për gjyqtarin e tretë: Distanca me e gjatë nga seanca në seancë është 5 muaj e 10 ditë;

Distanca me e shkurtër nga seanca në seancë është 21 ditë

Për gjyqtarin e katërt: Ka caktuar dy seanca me distancë kohore 1 muaj e 15 ditë.

- Çështje me objekt "Lirim dhe dorëzim sendi"

I. Çështja nr. 21627-00620-23-2023

Kërkesëpadia është depozituar në gjykatë në datë 14.06.2023, është regjistruar në sekretari dhe është shortuar në të njëjtën ditë.

Kjo çështje është rishortuar në datë 26.10.2023³¹.

Seanca e parë është caktuar pas 3 muaj 25 ditësh nga data e hedhjes së shortit të parë.

³¹ "Me vendimin e KLGJ-së nr. 527, datë 11.10.2023 gjyqtarja Suela Xhani është transferuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

Seanca e parë pas rishortimit është caktuar pas 3 muajsh nga data e hedhjes së rishortimit.

Gjykata ka kryer veprimet procedurale si më poshtë:

1. **Seanca e datës 09.10.2023**, nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarës S. Xh., e cila është paraqitur në mbledhjen e zhvilluar në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Kjo seancë është shtyrë për t'u zhvilluar në datë 07.11.2023.

- Rishortimi datë 26.10.2023

2. **Seanca e datës 26.01.2024**. Në këtë seancë është bërë shpallja e trupit të ri gjykues, ku referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "Shënim për seancën" konstatohet se është relatuar se gjyqtari ka ndryshuar për shkak se gjyqtarja S. Xh., është transferuar në një gjykatë tjetër. Gjykimi i kësaj çështjeje ka vazhduar në fazën e mbetur. Me qëllim njoftimin e të paditurit nëpërmjet shpalljes publike për shkak të pamundësisë së njoftimit të parë, gjykata ka vendosur të shtyjë seancën në datë 01.03.2024.(1 muaj e 4 ditë)
3. **Seanca e datës 01.03.2024**, është shtyrë për t'u zhvilluar në datë 11.03.2024, me qëllim thirrjen e ekspertëve të caktuar nga gjykata për çështjen dhe kryerjen e ekspertimit nga ana e tyre.(10 ditë)
4. **Seanca e datës 11.03.2024**, rezulton të jetë shtyrë për t'u zhvilluar në datë 29.03.2024, pas lënies së detyrave ndaj ekspertit dhe dorëzimit të akt ekspertimit prej tij në datën e caktuar nga gjykata 21.03.2024.(10 ditë)
5. **Seanca e datës 29.03.2024**, rezulton të jetë shtyrë për t'u zhvilluar në datë 22.02.2024, për shkak të mungesës së gjyqtarit M. H., për arsye familjare.(24 ditë)
6. **Seanca gjyqësore e datës 22.04.2024**. Në këtë seancë gjykata ka relatuar seancën e kaluar dhe ka administruar aktet e ekspertimit (kontabël dhe gjeodezik). Në vijim, pasi është bërë vlerësimi i provave dhe palët janë njohur me aktet, është bërë kalimi në seancë gjyqësore. Seanca është shtyrë për t'u zhvilluar në datë 24.05.2024 për shkak të njoftimit të paditësit me anë të fletëthirrjes dhe me anë të shpalljes publike.(1 muaj e 2 ditë)
7. **Seanca gjyqësore e datës 24.05.2024**. Pasi janë zhvilluar diskutimet përkatëse dhe janë administruar provat në këtë seancë gjykata i ka dhënë fund shqyrtimit gjyqësor duke kaluar në fazën e paraqitjes së konkluzioneve. Në vijim, pasi janë paraqitur konkluzionet përfundimtare prej palëve, gjykata ka vendosur të shtyjë seancën për t'u zhvilluar në datë 07.06.2024 me qëllim shpalljen e vendimit të arsyetuar.(14 ditë)
8. **Seanca gjyqësore e datës 07.06.2024**, është mbyllur me shpalljen e vendimit për këtë çështje dhe pranimin pjesërisht të kërkesë-padisë nga ana e gjykatës.

Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë 14.06.2023 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës 07.06.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 11 muaj e 24 ditësh.

Nga përmbajtja e seancave rezulton se pjesa më e madhe e tyre janë shtyrë për shkaqe procedurale të ndryshme si njoftimi me shpallje publike i palës ndërgjyqëse, caktimi i ekspertëve, dorëzimi i akt ekspertimeve, etj. Referuar përmbajtjes së

procesverbaleve të administruara në sistemin e çështjeve gjyqësore ka rezultuar të jenë gjithsej 2 seanca të shtyra për shkak të gjykatës.

Për sa i përket distancës kohore ndërmjet seancave, evidentohet fakti se distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është prej 10 (dhjetë) ditë ndërsa distanca më e largët është prej 1 muaj e 4 ditë.

II. Çështja nr. 11115-00305-23-2021

Kërkesë padia është depozituar në gjykatë në datë 15.04.2021 dhe është regjistruar po në datë 15.04.2021, rezulton të jetë shortuar vetëm 1 herë, në datën 15.04.2021.

Seanca e parë është caktuar 2 muaj 15 ditë pas hedhjes së shortit.

Gjykata ka kryer këto veprime procedurale si më poshtë:

1. **Seanca e datës 30.06.2021**, në këtë seancë pas verifikimit të palëve dhe shpalljes së trupi gjykues ka vijuar gjykimi në mungesë të palës së paditur (njoftuar). Në vijim të kërkesës për pezullim të çështjes, nga kjo e fundit, gjykata ka çmuar të zhvillojë edhe një seancë përgatitore duke e shtyrë këtë seancë për t'u zhvilluar në datë 14.07.2021 (14 ditë).
2. **Seanca e datës 14.07.2021**, rezulton të jetë zhvilluar në mungesë të palës paditëse (njoftuar) dhe në prezencë të përfaqësuesit të saj. Gjatë kësaj seance nga përfaqësuesi i palës së paditur konstatohet të jetë kërkuar pezullimi i gjyqimit të çështjes pas pretendimit se nga ana e gjykatës është refuzuar kërkesa për bashkim të çështjes. Në përfundim të seancës, referuar përmbajtjes së procesverbalit përkatës rezulton se gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës për pezullimin e çështjes dhe bashkimin e saj me çështjen nr. 01051 regj., e cila ka qenë në gjykim nga gjyqtar tjetër. Kjo seancë është mbyllur me shënimin se palët do njoftohen në vijimësi mbi ecurinë e çështjes (7 muaj e 8 ditë).
3. **Seanca e datës 22.12.2021**, rezulton të jetë shtyrë për t'u zhvilluar në datë 03.03.2021, për shkak të pranimit nga ana e gjykatës të kërkesës për shtyrje të palës së paditur, e cila së bashku me përfaqësuesin e saj nuk kanë qenë prezent përgjatë seancës (2 muaj e 10 ditë).
4. **Seanca e datës 03.03.2022**, rezulton të jetë zhvilluar vetëm në prani të përfaqësuesëve të palëve. Në këtë seancë përfaqësuesi i palës së paditur rezulton të ketë kërkuar përsëri pezullim të çështjes, kërkesë e cila është cilësuar si e pabazuar dhe është refuzuar nga gjykata. Pasi janë parashtruar padia dhe provat nga përfaqësuesi i palës paditëse si dhe është kërkuar kohë për paraqitjen e provave nga përfaqësuesi i palës së paditur, gjykata ka vlerësuar se ka nevojë për njohuri të posaçme në caktimin e mbivendosjes dhe ka vijuar me caktimin e ekspertit. Seanca e radhës rezulton të jetë caktuar nga ana e gjykatës për t'u zhvilluar në datë 20.04.2022 (1 muaj 17 ditë).
5. **Seanca e datës 20.04.2022**, rezulton të jetë zhvilluar vetëm në prezencë të përfaqësuesit të palës paditëse. Seanca e radhës rezulton të jetë caktuar nga ana e gjykatës për t'u zhvilluar në datë 02.06.2022 pas pranimit të kërkesës për shtyrje nga pala e paditur. (1 muaj e 3 ditë)

6. **Seanca e datës 02.06.2022**, është shtyrë për t'u zhvilluar në datë 05.07.2022 për shkak të mungesës së ekspertit dhe përsëritjes së njoftimit të tij (1 muaj e 3 ditë).
7. **Seanca e datës 05.07.2022**, rezulton të jetë zhvilluar në mungesë të palëve dhe përfaqësuesëve të tyre për shkak të bojkotit të avokatëve. Seanca u caktuar në datë 06.10.2022 (3 muaj e 1 ditë).
8. **Seanca e datës 06.10.2022**, rezulton të jetë zhvilluar në prezencë të palëve ndërgjyqëse, përfaqësuesit të palës paditëse dhe ekspertit. Në këtë seancë, pasi është bërë betimi i ekspertit dhe caktimi i detyrave të tij nga ana e gjykatës, me kërkesë të ekspertit është kërkuar lënia kohë për kryerjen e veprimeve, përkatësisht tre javë. Gjykata ka vijuar me pranimin e kërkesës së ekspertit dhe caktimin e një afati 10 ditor kundrejt palëve për paraqitjen e kundërshtimeve. Në këtë seancë është përcaktuar data 11.11.2022 si datë për dorëzim të aktit të ekspertimit (nuk është përcaktuar data e seancës së radhës (6 muaj e 6 ditë).
9. **Seanca e datës 12.04.2023**, është shtyrë për t'u zhvilluar në datë 17.05.2023 për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye shëndetësore. (1 muaj e 5 ditë)
10. **Seanca e datës 17.05.2023**. Në këtë seancë rezulton të jetë paraqitur kërkesë për shtyrje gjykimi (për shkak të mungesës) dhe kundërpadi nga përfaqësuesja e palës së paditur. Kjo seancë është shtyrë për t'u zhvilluar në datë 12.07.2023 me qëllim njoftimin e kundërpadisë edhe palës së tretë. (25 ditë)
11. **Seanca e datës 12.07.2023**. Në këtë seancë, gjykata ka vendosur të pranojë kundërpadinë e palës së paditur dhe me qëllim marrjen e informacionit për sa i përket vendimit të shpallur në lidhje me procesin tjetër gjyqësor të zhvilluar nga gjyqtari tjetër (i cili mund të ndikojë në këtë proces) ka vendosur të shtyjë seancën për t'u zhvilluar në datë 26.10.2023 (3 muaj e 14 ditë).
12. **Seanca e datës 26.10.2023**, rezulton të jetë është shtyrë për t'u zhvilluar në datë 14.12.2024 me qëllim caktimin e detyrave ekspertit lidhur me faktet e paraqitura gjatë zhvillimit të seancës (1 muaj e 18 ditë)
13. **Seanca e datës 14.12.2023**, rezulton të jetë është shtyrë për t'u zhvilluar në datë 28.02.2024 për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye shëndetësore (2 muaj e 14 ditë).
14. **Seanca e datës 28.02.2024**, në këtë seancë rezulton të jetë bërë kalimi në seancë gjyqësore dhe kjo seancë është shtyrë për t'u zhvilluar në datë 16.04.2024 (1 muaj e 18 ditë).
15. **Seanca e datës 16.04.2024**, në këtë seancë i është dhënë fund shqyrtimit gjyqësor dhe është kaluar në konkluzione përfundimtare. Seanca është shtyrë për t'u zhvilluar në datë 07.05.2024 për shkak të shpalljes së vendimit nga ana e gjykatës (21 ditë).
16. **Seanca e datës 07.05.2024**, shpallja e vendimit.

Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë, dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës 06.06.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 3 vjet, 1 muaj e 22 ditë.

Në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave konstatohet ndër të tjera se për mungesë të gjykatës (për arsye shëndetësore) janë shtyrë 2 seanca; rezultojnë 4 seanca të shtyra për shkak të mungesës së palës së paditur; 4 seanca të shtyra për shkaqe që lidhen me ekspertin dhe aktin e ekspertimit dhe një seancë e shtyrë për shkak të bojkotit të avokatëve.

Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 7 muaj e 18 ditë; Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 2 muaj e 3 ditë.

- Çështje me objekt “Njohje pronar”

I. Çështja nr.21246-00822-23-2022

Kërkesëpadia është depozituar në gjykatë në datë 06.09.2022, është regjistruar në sekretari dhe shortuar po në këtë datë.

Seanca e parë është caktuar pas 3 muajsh e 1 ditë nga data e hedhjes së shortit.

Gjykata ka kryer veprimet procedurale si vijon:

1. **Seanca e datës 07.12.2022.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, te rubrika “Shënim për seancën” rezulton që nga ana e gjykatës të jetë bërë verifikimi i paraqitjes së palëve dhe pasi është vlerësuar se për çështjen nevojiten njohuri të posaçme, me qëllim caktimin e ekspertit ka vendosur të shtyjë seancën për në datë 09.02.2023. (2 muaj e 2 ditë)
2. **Seanca e datës 09.02.2023.** Referuar procesverbalit të kësaj seance rezulton që gjykata ti ketë caktuar ekspertit detyrat përkatëse. Në vijim, konstatohet shënimi i gjykatës “i jep kohë ekspertit të paraqitet akti i ekspertimit në datë 24.03.2023, palët të vinë të marrin aktin dhe kanë 10 ditë kohë të paraqesin kundërshtimet. Seanca ndërpritet. Palët do të njoftohen . (9 muaj e 12 ditë)
3. **Seanca e datës 21.11.2023** nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit A.V., i cili ndodhej në trajnim në shkollën e Magjistraturës. Seanca e radhës është caktuar për t’u zhvilluar në datë 14.02.2024. (2 muaj e 24 ditë)
4. **Seanca e datës 14.02.2024.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, te rubrika “Shënim për seancën” rezulton që për këtë seancë, pas verifikimit të palëve dhe diskutimeve të zhvilluara, gjykata ka vendosur ta shtyjë seancën për në datën 04.04.2024, për ti lënë kohë ekspertit për të përfunduar aktin e ekspertimit pas konsultimeve me palët. (1 muaj e 21 ditë)
5. **Seanca e datës 04.04.2024.** Gjykata ka urdhëruar kalimin në seancë gjyqësore dhe ka caktuar seancën e radhës në datën 30.04.2024. (26 ditë)
6. **Seanca gjyqësore e datës 30.04.2024.** Në këtë seancë, pas verifikimit të palëve dhe shpalljes së trupit gjykues, është relatuar akti i ekspertimit në prani të ekspertit dhe është vijuar me paraqitjen e pretendimeve prej palëve. Gjykata pasi ka administruar provat shkresore ka deklaruar të mbyllur shqyrtimin gjyqësor dhe ka vendosur kalimin në diskutimet përfundimtare. Seanca e radhës është caktuar për t’u zhvilluar në datën 09.05.2024, pas kërkesës së përfaqësueses së Avokaturës së Shtetit, për ti paraqitur ato me shkrim. (9 ditë)
7. **Seanca e datës 09.05.2024,** është mbyllur me shpalljen e vendimit për këtë çështje dhe rrëzimin e kërkesë-padisë nga ana e gjykatës.

Për këtë çështje janë caktuar gjithsej 7 (shtatë) seanca. Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadiisë 06.09.2022 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës 09.05.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 1 vit 8 muaj e 3 ditë.

Në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave ndër të tjera konstatohet se ato lidhen me caktimin e ekspertit, për ti lënë kohë ekspertit për të përfunduar aktin e ekspertimit pas konsultimeve me palët, apo qoftë dhe për shkaqe procedurale të ndryshme sikundër janë kalimi për shqyrtim në seancë gjyqësore, paraqitjen e pretendimeve

përfundimtare, etj. Ndërsa për sa i përket seancave të shtyra për shkak të gjykatës, konstatohet se vetëm seanca e datës 21.11.2023 nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit i cili ndodhej në një trajnim në shkollën e Magjistraturës.

Për sa i përket distancës kohore ndërmjet seancave, evidentohet fakti se distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është prej 9 (nëntë) ditësh (e cila përkon me mbylljen e procesit dhe shpalljen e vendimit) ndërsa distanca më e largët është ajo prej 9 muaj e 12 ditë.

II. Çështja 11232-01388-23-2019

Kërkesë padia është depozituar në gjykatë në datë 15.10.2019 është rregjistruar dhe shortuar po në këtë datë. Rezulton se në vijim kjo çështje është shortuar 2 herë: Shorti i parë në datën 15.10.2019, Shorti i dytë në datën 30.09.2020.

Seanca e parë është caktuar 3 muaj 28 ditë pas hedhjes së shortit të parë datë 15.10.2019. Seanca e parë pas shortit të dytë, është caktuar 3 muaj e 9 ditësh pas hedhjes së rishortimit 30.09.2020.

Nga ana e gjykatës janë kryer veprimet proceduriale si vijojnë:

1. Seanca e datës 12.02.2020, konstatohet se kjo seancë është shtyrë për shkak të njoftimit me shpallje në QKB dhe faqen zyrtare të internetit në gjykatë pasi pala e paditur nuk ka pasur dijeni mbi seancën e kësaj date (njoftimi është kthyer me shënimin larguar). (4 muaj e 7 ditë)

2. Seanca e datës 19.06.2020, në këtë seancë pasi është verifikuar prezenca e palëve dhe shpallur trupi gjykues, janë caktuar ekspertit kontabël dhe ekspertit inxhinier ndërtimi. Gjykata ka caktuar seancën e radhës në datë 10.07.2020 me qëllim njoftimin e ekspertit kontabël. (21 ditë)

3. Seanca e datës 10.07.2020, konstatohet se gjatë kësaj seance ndër të tjera gjykata ka vijuar me caktimin e detyrave ekspertëve. Gjykata caktoi seancën e radhës në datë 11.09.2020 me qëllim lënien kohë ekspertëve për hartimin e aktit të ekspertimit. (2 muaj e 1 ditë)

4. Seanca e datës 11.09.2020, rezulton të jetë shtyrë për t'u zhvilluar në datë 16.10.2020, me qëllim lënien përsëri kohë ekspertëve për të kryer aktin e ekspertimit.

- Çështja është rishortuar në datën 30.09.2020

5. Seanca e datës 08.01.2021, rezulton të jetë shtyrë për t'u zhvilluar në datë 05.02.2021, për shkak të njoftimit të palës së paditur shoqëria "Mega Construcion" sh.p.k, në selinë e saj dhe në QKB, mbi ndryshimin e trupit gjykues. (28 ditë)

6. Seanca e datës 05.02.2021, në këtë seancë është relatuar kundër padia, gjykata ka vijuar me gjykimin e çështjes në fazën e mbetur. Kjo seancë është shtyrë për t'u zhvilluar në datë 01.03.2021 pas kërkesës së ekspertëve për lënien kohë mbi përgatitjen e akt-ekspertimit. (24 ditë)

7. Seanca e datës 01.03.2021, në këtë seancë rezulton të jenë paraqitur aktet e ekspertimit, por me qëllim lënien kohë palëve për njohjen me to, kjo seancë është shtyrë për t'u zhvilluar në datë 25.03.2021. (24 ditë)

- 8. Seanca e datës 25.03.2021**, rezulton të jetë shtyrë për shkak të mosmarrjes së informacionit shtesë drejtuar institucionit, i cili nevojitet për nevoja të aktit të ekspertimit. Seanca e radhës është caktuar për t'u zhvilluar në datën 22.04.2021. (28 ditë)
- 9. Seanca e datës 22.04.2021**, pas relatimit të përgjigjes së ardhur nga institucioni, gjykata ka vendosur të shtyjë seancën në datë 26.05.2021, për ti lënë kohë ekspertit inxh.ndërtimi për të plotësuar aktin e ekspertimit. (1 muaj e 4 ditë)
- 10. Seanca e datës 26.05.2021**, rezulton të jetë shtyrë për shkak të kërkesës së paraqitur me shkrim nga pala kundërpaditëse, e cila është pranuar nga gjykata. Seanca e radhës është caktuar në datën 28.06.2021. (1 muaj 2 ditë)
- 11. Seanca e datës 28.06.2021**, rezulton të jetë shtyrë për shkak të mungesës së ekspertit inxh.ndërtimi i cili ndodhet jashtë shtetit dhe nuk ka paraqitur aktin shtesë të ekspertimit. Seanca e radhës është caktuar në datën 22.07.2021. (24 ditë)
- 12. Seanca e datës 22.07.2021**, rezulton të jetë shtyrë për në datë 11.10.2021, me qëllim njohjen e palëve me aktin shtesë të ekspertimit. (2 muaj e 19 ditë)
- 13. Seanca e datës 11.10.2021**, gjykata ka vendosur të shtyjë seancën për në datën 25.11.2021, me qëllim njohjen e palëve në mungesë, mbi pranimin e kërkesës për saktësimin e kundërpadisë dhe shtimin e objektit.(1 muaj e 14 ditë)
- 14. Seanca e datës 25.11.2021**. Pas relatimit të seancës së kaluar dhe zhvillimit të diskutimeve mbi procesin, gjykata pasi ka çmuar se janë kryer të gjitha veprimet përgatitore, ka urdhëruar kalimin në seancë gjyqësore dhe ka caktuar seancën e radhës në datë 31.01.2022. (2 muaj e 6 ditë)
- 15. Seanca gjyqësore e datës 31.01.2022**, në këtë seancë, pas paraqitjes së prapësimeve nga pala paditëse, gjykata ka vijuar me përlllogaritjen e vlerave të padisë dhe kundër padisë nga ku ka rezultuar e nevojshme thirrja e trupit gjykues me tre gjyqtarë. Kjo seancë është mbyllur për t'u vendosur seanca e radhës, njoftimi i së cilës është caktuar për tu kryer me fletëthirrje. (1 muaj e 28 ditë)
- 16. Seanca e datës 31.03.2022**, nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye familjare. Seanca e radhës është caktuar në datën 18.05.2022 (1 muaj e 18 ditë)
- 17. Seanca e datës 18.05.2022**, në këtë seancë është bërë shpallja e trupit gjykues dhe është vijuar me pyetjet dhe kërkesat e palëve në proces. Gjatë zhvillimit të diskutimeve është identifikuar se ka paqartësi nga palët në lidhje me aktin e ekspertimit, për të cilën gjykata ka vendosur përgatitjen e kërkesave dhe pyetjeve me shkrim si dhe thirrjen e ekspertëve për të relatuar aktin e ekspertimit. Seanca e radhës është caktuar në datë 30.06.2022. (1 muaj e 12 ditë)
- 18. Seanca e datës 30.06.2022**, është shtyrë për t'u zhvilluar në datë 13.10.2022, për shkak të mungesës të avokatëve për shkak të bojkotit. Seanca e radhës është caktuar për t'u zhvilluar në datë 13.10.2022. (3 muaj e 13 ditë)
- 19. Seanca e datës 13.10.2022**, nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye shëndetësore. Seanca e radhës është caktuar për t'u zhvilluar në datë 23.11.2022. (1 muaj e 10 ditë)
- 20. Seanca e datës 23.11.2022**, nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye shëndetësore. Njoftimi i seancës së radhës është caktuar për t'u komunikuar me fletëthirrje. (2 muaj e 9 ditë)

- 21. Seanca e datës 01.02.2023**, nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye familjare. Seanca e radhës është caktuar për t'u zhvilluar në datë 21.03.2023. (1 muaj 20 ditë)
- 22. Seanca e datës 21.03.2023**, nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit pasi ndodhej në trajnim. Njoftimi i seancës së radhës është caktuar për t'u komunikuar me fletëthirrje. (3 muaj e 1 ditë)
- 23. Seanca e datës 22.06.2023**, nuk është zhvilluar për shkak të mosformimit të trupit gjykues. Njoftimi i seancës së radhës është caktuar për t'u komunikuar me fletëthirrje. (7 muaj e 30 ditë)
- 24. Seanca e datës 21.02.2024**, konstatohet të jetë ndryshuar trupi gjykues dhe të ketë vijuar gjykimi në fazën e mbetur. Kjo seancë është shtyrë për t'u zhvilluar në datë 16.04.2024 për shkak të kërkesës së gjyqtarit, për tu njohur me aktet e dosjes e cila është paraqitur si voluminoze për nga përmbajtja e saj. (1 muaj e 26 ditë)
- 25. Seanca e datës 16.04.2024**, konstatohet se gjykata pasi ka administruar të gjitha provat shkresore dhe aktet e ekspertimit, i ka dhënë fund seancës duke kaluar te konkluzionet përfundimtare. Kjo seancë është shtyrë për t'u zhvilluar në datë 23.05.2024 pas kërkesës së palëve për përgatitjen me shkrim të tyre. (1 muaj 7 ditë)
- 26. Seanca e datës 23.04.2024**, nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye shëndetësore. Kjo seancë është caktuar për t'u zhvilluar në datë 29.04.2024 (6 ditë)
- 27. Seanca e datës 29.04.2024**, në këtë seancë, gjykata pasi ka administruar konkluzionet e palëve ka vendosur për shtyrjen e seancës për t'u zhvilluar në datë 16.05.2024, me qëllim shpalljen e vendimit të arsyetuar. (17 ditë)
- 28. Seanca e datës 16.05.2024**, në këtë seancë gjykata ka relatuar se vendimi është i plotë por nuk mund të shpallet për shkak të mosformimit të trupës gjykuese. Shpallja e vendimit është caktuar për t'u komunikuar në datën 21.05.2024. (5 ditë)
- 29. Seanca gjyqësore e datës 21.05.2024** shpallja e vendimit

Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë 15.10.2019, dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës 21.05.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 4 vjet, 7 muaj e 6 ditë.

Në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave konstatohet ndër të tjera se: rezultojnë 9 seanca të shtyra për shkaqe që lidhen me mungesën e gjyqtarit (për shkaqe shëndetësore, trajnimi, formimi të trupit gjykues me 3 gjyqtarë); Rezultojnë 3 seanca të shtyra për shkak të mungesës së palës së paditur; 9 seanca të shtyra për shkaqe që lidhen me ekspertin dhe aktin e ekspertimit; 1 seancë e shtyrë për shkak të bojkotit të avokatëve.

Distanca kohore ndërmjet seancave:

Për gjyqtarin e parë: Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 4 muaj e 7 ditë; Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 21 ditë.

Për gjyqtarin e dytë: Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 7 muaj e 30 ditë; Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 5 ditë.

- Çështje me objekt “ Deklarim falsiteti”

I. Çështja nr. 21321-00286-23-2024

Kërkesëpadia është paraqitur në gjykatë në datë 28.03.2024 dhe është regjistruar në sekretari po në datë 28.03.2024. Çështja është shortuar në datën 28.03.2024
Seanca e parë është caktuar 3 muaj e 28 ditë pas hedhjes së shortit.

Përkatësisht nga përmbajtja e procesverbaleve të seancave të disponuara rezulton:

1. **Seanca e datës 25.06.2024.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, te rubrika “Shënim për seancën” rezulton që pala paditëse të mos jetë paraqitur dhe të ketë dorëzuar kërkesë për heqje dorë nga padia, e cila është pranuar nga gjykata dhe më pas është vendosur pushimi i gjykimit dhe njoftimi i palëve.

Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadiës 28.03.2024, dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës 25.06.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 2 muaj e 28 ditë.

Për këtë çështje konstatohet se regjistrimi i saj në sekretarinë e gjykatës si dhe shortimi i saj të jenë bërë brenda ditës së dorëzimit të kërkesëpadiës në gjykatë. konstatohet që për këtë çështje të jetë caktuar vetëm 1 (një) seancë, e cila është mbyllur me shpalljen e vendimit.

Evidentohet fakti se në lidhje me çështjet e tjera me të njëjtin objekt padie, kjo çështje të jetë mbyllur në periudhën më të shkurtër kohore, për shkak të heqjes dorë nga padia e palës paditëse.

II. Çështja nr. 21321-00016-23-2022

Kërkesë padia është depozituar në gjykatë në datë 06.01.2022, është regjistruar po në datë 06.01.2022 dhe është shortuar në të njëjtën ditë, në datën 06.01.2022.

Çështja është rishortuar në datën 20.03.2023

Seanca e parë është caktuar 8 muaj e 13 ditë pas hedhjes së shortit të parë datë 06.01.2022.

Seanca e parë pas rishortimit të parë, është caktuar 6 muaj e 13 ditë pas hedhjes së rishortimit 20.03.2023.

Nga ana e gjykatës janë kryer këto veprime procedurale si më poshtë:

1. **Seanca e datës 19.09.2022.** Kjo seancë pas shpalljes së trupit gjykues dhe verifikimit të palëve ndërgjyqëse ka vijuar në mungesë të palëve të paditura të cilat janë njoftuar. Në vijim, gjykata ka vendosur të shtyjë seancën për në datën 23.11.2022, për shkak të njoftimit të palëve të paditura, për të cilat konstatohet shënimi “larguar”, nëpërmjet shpalljes publike dhe saktësisht të adresës për një prej tyre (2 muaj e 3 ditë).

2. **Seanca e datës 23.11.2022**, rezulton të mos jetë zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit Sh.L., i cili ndodhej në seminar trajnimi. Seanca e radhës është caktuar për në datën 15.02.2023 (2 muaj e 23 ditë).
3. **Seanca e datës 15.02.2023**, rezulton të jetë shtyrë për në datën 17.05.2023, për shkak të njoftimit të palëve të paditura të cilat nuk kanë dijeni, nëpërmjet fletëthirrjes dhe shpalljes publike.

- Çështja është rishortuar në datën 20.03.2023

4. **Seanca e datës 03.10.2023**, rezulton të jetë shtyrë për t'u zhvilluar në datë 27.11.2023, për shkak të njoftimit të palëve të paditura të cilat nuk kanë dijeni (për seancën e datës 27.11.2023 nuk rezulton të jetë mbajtur procesverbal).(4 muaj e 16 ditë)
5. **Seanca e datës 19.02.2024**, rezulton të jetë shtyrë për t'u zhvilluar në datë 11.04.2024, për shkak të njoftimit nëpërmjet shpalljes publike të palëve të paditura të cilat nuk kanë dijeni (1 muaj e 23 ditë).
6. **Seanca e datës 11.04.2024**, fillimisht rezulton të jetë shtyrë për t'u zhvilluar në datë 29.05.2024, për shkak të rinjoftimit nëpërmjet shpalljes publike të palëve të paditura për të cilat është bërë njoftimi por nuk kanë marrë dijeni. Më pas nga ana e palës paditëse rezulton të jetë kërkuar pushimi i çështjes. Në vijim, gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës dhe ka shpallur vendimin përfundimtar për pushimin e gjykimit të çështjes.

Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë 06.01.2022 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës 11.04.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 2 vjet, 3 muaj e 5 ditë.

Në lidhje me shkakun e shtyrjes së seancave konstatohet ndër të tjera 1 seancë e shtyrë për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye trajnimi; 4 seanca të shtyra për shkak të mungesës së palës së paditur.

Distanca kohore ndërmjet seancave:

Për gjyqtarin e parë: Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 7 muaj e 18 ditë; Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 2 muaj e 3 ditë.

Për gjyqtarin e dytë: Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 4 muaj e 16 ditë; Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 1 muaj e 23 ditë.

- **Çështje me objekt “zgjidhje martesë”**

I. Çështja nr. 21001-00240-23-2024

Kërkesë padia është depozituar në gjykatë në datë 06.03.2024 dhe është regjistruar në sekretari si dhe shortuar po në datë 06.03.2024.

Seanca e parë është caktuar 27 ditë pas hedhjes së shortit.

Përkatësisht nga përmbajtja e procesverbaleve të seancave të disponuara rezulton:

1. **Seanca e pajtimit e datës 02.04.2024**, në të cilën gjykata ka vlerësuar se çështja nuk mund të zgjidhet me pajtim dhe ka nxjerrë urdhrin për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore.

Gjykata ka vijuar seancën gjyqësore po në këtë datë, pas shqyrtimit gjyqësor të së cilës ka vendosur të mbyllë shqyrtimin gjyqësor duke ftuar palët për pretendimet përfundimtare dhe pasi është tërhequr për vendim, ka shpallur vendimin përfundimtar për pranimin e kërkesëpadisë duke e deklaruar të mbyllur seancën e datës 02.04.2024.

Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës 02.04.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 27 ditë.

Nga përmbajtja e procesverbalit të seancës rezulton se për gjykimin e kësaj çështjeje, është zhvilluar një seancë e cila fillimisht ka nisur me mundësimin e pajtimit dhe në kushtet kur nuk është mundësuar pajtimi, ka kaluar në seancë gjyqësore. Për këtë çështje konstatohet se është zhvilluar 1 seancë.

Për sa i përket kohëzgjatjes së trajtimit të kësaj çështjeje, rezulton që të jetë zhvilluar dhe përfunduar brenda një seance, e cila përkon me afatin më të shkurtër kohor të trajtimit të çështjeve me objekt "Zgjidhje martese".

II. Çështja nr. 21001-00447-23-2024

Kërkesë padia është depozituar në gjykatë në datë 16.05.2024 dhe është regjistruar në sekretari brenda ditës.

Kjo çështje rezulton të jetë shortuar po në datë 16.05.2024.

Seanca e parë është caktuar 27 ditësh pas hedhjes së shortit.

Përkatësisht nga përmbajtja e procesverbaleve të seancave të disponuara rezulton:

1. **Seanca e pajtimit e datës 12.06.2024**, në të cilën gjykata ka vlerësuar se çështja nuk mund të zgjidhet me pajtim dhe ka nxjerrë urdhrin për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore.

Gjykata ka vijuar seancën gjyqësore po në këtë datë, pas shqyrtimit gjyqësor të së cilës ka vendosur të mbyllë shqyrtimin gjyqësor duke ftuar palët për pretendimet përfundimtare dhe pasi është tërhequr për vendim, ka shpallur vendimin përfundimtar për pranimin e kërkesëpadisë duke e deklaruar të mbyllur seancën e datës 12.06.2024.

Referuar datës 16.05.2024 së depozitimit të kërkesëpadisë dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës 12.06.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 27 ditë.

Nga përmbajtja e procesverbalit të seancës rezulton se për gjykimin e kësaj çështjeje, është zhvilluar një seancë e cila fillimisht ka nisur me mundësimin e pajtimit dhe në

kushtet kur nuk është mundësuar pajtimi, ka kaluar në seancë gjyqësore. Për sa i përket kohëzgjatjes së trajtimit të kësaj çështjeje, rezulton që të jetë zhvilluar dhe përfunduar brenda një seance, e cila përkon me afatin më të shkurtër kohor të trajtimit të çështjeve me objekt “Zgjidhje martesë”.

III. Çështja nr. 3 (21001-00137-23-2022)

Kërkesë padia është depozituar në gjykatë në datë 01.02.2022, është regjistruar në datë 01.02.2022 si dhe është shortuar brenda kësaj date.

Kjo çështje është shortuar tre herë përkatësisht: shorti i parë në datë 03.02.2022; shorti i dytë në datë 20.03.2023; shorti i tretë në datë 26.10.2023.

Seanca e parë është caktuar pas 1 muaj e 6 ditë nga data e hedhjes së shortit të parë.

Seanca e parë pas shortit të dytë është caktuar pas 2 muaj e 5 ditë nga data e hedhjes së shortit të dytë.

Seanca e parë pas shortit të tretë është caktuar pas 1 muaj e 18 ditë nga data e hedhjes së shortit të tretë.

Përkatësisht nga përmbajtja e procesverbaleve të seancave të disponuara rezulton:

1. **Seanca e datës 07.03.2022**, gjykata ka verifikuar prezencën e palëve. Gjykata për të njoftuar palën e paditur me shpallje publike ka shtyrë seancën për më datë 26.04.2022. (1 muaj e 19 ditë)
2. **Seanca e datës 26.04.2022** ka vijuar në mungesë të palës së paditur. Gjykata ka relatuar : “Për të përsëritur njoftimin për palën e paditur për seancë pajtimi shtyjmë seancën për më datë 07.06.2022. (1 muaj e 12 ditë)
3. **Seanca e datës 07.06.2022**, Gjykata ka relatuar se paditësi ka dërguar email për shtyrje. Për të njoftuar palen paditëse dhe palën e paditur me shpallje publike është shtyrë seanca për në datë 12.07.2022 (1 muaj e 5 ditë)
4. **Seanca e datës 12.07.2022**. Gjykata ka relatuar se pala paditëse ka paraqitur kërkesë për shtyrje seance. Gjykata pranon kërkesën dhe ka shtyrë seancën për më datë 18.10.2022.(3 muaj e 6 ditë)
5. **Seanca e datës 18.10.2022**, nuk është zhvilluar për shkak se gjyqtari është deleguar për të zhvilluar gjykime në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet. Seanca e radhës është planifikuar në datë 20.12.2022. (2 muaj e 2 ditë)
6. **Seanca e datës 20.12.2022**, nuk është zhvilluar pasi ka gjyqtari për arsye familjare nuk është paraqitur. Kjo seancë është shtyrë për në datë 08.02.2023.(1 muaj e 19 ditë)
7. **Seanca e datës 08.02.2023**. Edhe kjo seancë është shtyrë për në datë 09.05.2023, pasi ka rezultuar të mos jetë paraqitur asnjë prej palëve si dhe pala paditëse ka paraqitur kërkesë për shtyrje seance.

- **Çështja është shortuar për herë të dytë në datë 20.03.2023**

8. **Seanca e datës 25.05.2023**. Përfaqësues i palës paditëse ka bërë me dije gjykatën se fëmija e palëve ndërgjyqëse është në gjendje kome dhe ka kërkuar shtyrjen në një afat te gjatë. Gjykata ka shtyrë seancën për në datë 12.09.2023. (3 muaj e 18 ditë)

9. **Seanca e datës 12.09.2023**, nuk është zhvilluar. Kjo seancë është shtyrë për në datë 17.10.2023 për shkak se gjyqtari nuk është paraqitur për arsye shëndetësore. (1 muaj e 5 ditë)

- **Çështja është shortuar për herë të tretë në datën 26.10.2023**

10. **Seanca e datës 14.12.2023**, Në këtë seancë konstatohet të jetë ndryshuar trupi gjykues si dhe është relatuar se është thirrur e paditura nëpërmjet letërnjoftimit por ka firmosur kunati i saj. Për të përsëritur njoftimin me ane të shpalljes publike për të paditurën seanca është shtyrë në datën 31.01.2024.(1 muaj e 17 ditë)

11. **Seanca e datës 31.01.2024**, nuk është zhvilluar. për shkak se gjyqtari E. S., ndodhej për trajnim pranë Shkollës së Magjistraturës. Kjo seancë është shtyrë për në datën 05.03.2024.(1 muaj e 4 ditë)

12. **Seanca e datës 05.03.2024**, gjykata ka relatuar se nuk është prezent pala e paditur, është proceduar me njoftim nëpërmjet shpalljes publike konfirmuar nga shkresa e Bashkisë Sarandë për konfirmimin e shpalljes publike në datë 05.02.2024. Për të përsëritur njoftimin për të paditurin nëpërmjet shpalljes publike shtyn seancën për në datë 04.04.2024.(29 ditë)

13. **Seanca e datës 04.04.2024**, gjykata ka relatuar në këtë seancë nuk është paraqitur e paditura, është proceduar nëpërmjet shpalljes publike por nuk është paraqitur, ka vijuar kryerja e veprimeve përgatitore në mungesë të palës së paditur. Në vijim, gjykata ka vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore duke e caktuar këtë të fundit më datë 14.05.2024 si dhe njoftimin e palës së paditur nëpërmjet shpalljes publike.(1 muaj e 10 ditë)

14. **Seanca gjyqësore e datës 14.05.2024**, në të cilën gjykata ka deklaruar të hapur shqyrtimin gjyqësor në vijim ka administruar provat shkresore ka vendosur ti japi fund shqyrtimit gjyqësor duke ftuar palët për konkluzionet përfundimtare. Gjykata brenda ditës është tërhequr në dhomë këshillimi dhe më pas ka shpallur vendimin.

Referuar datës 01.02.2022 së depozitimit të kërkesëpadsisë dhe datës 14.05.2024 të vendimmarrjes së gjykatës, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 2 vite e 3 muaj e 11 ditë.

Nga përmbajtja e seancave konsatohen shtyrje të seancave për shkaqe procedurale të passjella nga mosmarrja dijeni e palëve ndërgjyqëse (specifikisht palës së paditur); 4 seanca të pazhvilluara, për shkak të mungesës së gjyqtarit (për arsye të trajnimit, për shkak të gjendjes shëndetësore; për shkak të delegimit në një gjykatë tjetër 1 seancë, për arsye familjare 1 seancë. Gjithashtu 4 seanca rezultojnë të jenë shtyrë për shkak të kërkesës për shtyrje të paraqitur nga paditësi.

Distancat kohore ndërmjet seancave:

Për gjyqtarin e parë: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 1 muaj e 5 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 3 muaj e 6 ditë.

Për gjyqtarin e dytë: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 1 muaj e 5 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 3 muaj e 18 ditë.

Për gjyqtarin e tretë: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 29 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 1 muaj e 17 ditë.

- Çështje me objekt “Pjesëtim sendi”

I. Çështja nr. 1 (10901-00424-23-2023)

Kërkesë padia është depozituar në gjykatë në datë 07.04.2023 dhe në vijim është regjistruar dhe shortuar brenda ditës.

Seanca e parë është caktuar pas 1 muaj e 30 ditë pas hedhjes së shortit.

Nga ana e gjykatës janë kryer këto veprime procedurale si më poshtë:

1. **Seanca e datës 06.06.2023**, në këtë seancë, gjykata pasi ka çelur seancën, dhe ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur paditësi i përfaqësuar nga përfaqësues ligjor, është paraqitur një nga të paditurit, ndërsa i padituri tjetër nuk është paraqitur për shkak të mos marrjes dijeni. Ndodhur në këto kushte, gjykata shtyn seancën në datën 20.09.2023.(3 muaj e 14 ditë)
2. **Seanca e datës 20.09.2023**, në të cilën gjykata pasi çel seancën, verifikon prezencën e palëve, legjitimon përfaqësuesit e tyre ligjorë dhe shpall trupin gjykues, fton palët të parashtrojnë qëndrimet e tyre rreth kërkesëpadisë. Gjykata vlerëson të domosdoshme administrimin e provës (vendim gjyqësor) nga pala paditëse. Pasi administron vendimin shtyn seancën për në datën 14.11.2023.(1 muaj e 25 ditë)
3. **Seanca e datës 14.11.2023**, në të cilën gjykata pasi çel seancën dhe verifikon prezencën e palëve konstaton se janë paraqitur palët ndërgjyqëse. Gjykata verifikon përmbushjen e detyrimit të caktuar nga gjykata për depozitim të provës së kërkuar. Rezulton se ka dakordësi mes palëve për sa i përket fazës së parë të pjesëtimit, por për të vijuar do të pritet dhe pala tjetër e paditur që ishte në mungesë. Seanca e radhës caktohet në datën 05.12.2023.(21 ditë)
4. **Seanca e datës 05.12.2023**, në të cilën pasi verifikohet prezenca e palëve dhe konstatohet që palët ndërgjyqëse janë paraqitur, gjykata pasi administron të gjitha provat dhe deklaron të mbyllur shqyrtimin gjyqësor, kalon në diskutime përfundimtare. Pasi kthehet vendos pranimin e pjesshëm të padisë për fazën e parë të pjesëtimit. Seanca ndërpritet për t'u nënshkruar procesverbali nga të gjitha palët. Pas riçeljes së seancës, kalohet në fazën e dytë të pjesëtimit. Seanca e radhës në të cilën do të thërritet eksperti caktohet në datën 31.01.2024.(1 muaj e 26 dite)
5. **Seanca e datës 31.01.2024**, në të cilën gjykata pasi verifikon prezencën e palëve konstaton se është paraqitur pala paditëse, një nga të paditurit me përfaqësuesit e tyre si dhe nuk është paraqitur i padituri tjetër. Rezulton të jetë paraqitur eksperti i cili pasi lexon formulën e betimit, dhe i caktohen detyrat, i lihet koha e nevojshme

për përgatitjen e aktit të ekspertimit. Seanca e radhës caktohet në datën 04.04.2024.(dy muaj e 4 ditë)

6. **Seanca e datës 04.04.2024**, në të cilën pasi verifikohet prezenca e palëve dhe konstatohet se janë paraqitur palët ndërgjyqëse, rezulton se eksperti ka depozituar një e-mail ku parashtron se nuk është kryer pagesa e tarifës për aktin e ekspertimit. Në funksion të likuidimit të tarifës në fjalë, seanca shtyhet për në datën 30.04.2024. (26 ditë)
7. **Seanca e datës 30.04.2024**, në të cilën verifikohet prezenca e palëve dhe konstatohet se është paraqitur pala paditëse si dhe të paditurit. Rezulton se eksperti ka depozituar aktin, por nuk është paraqitur. Me qëllim thirrjen e ekspertit për relativimin e aktit, seanca shtyhet për në datën 30.05.2024.(1 muaj)
8. **Seanca e datës 30.05.2024**, në të cilën gjykata pasi verifikon prezencën e palëve të cilat rezultojnë prezent, fton palët të diskutojnë rreth aktit të ekspertit i cili rezulton prezent. Në përfundim, gjykata pasi merr në administrim të gjitha provat e deklaron të mbyllur shqyrtimin gjyqësor, fton palët për pretendimet e fundit dhe tërhiqet për vendim të cilin e shpall po në këtë seancë.

Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë 07.04.2023 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës 30.05.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur rreth 1 vit e 1 muaj e 23 ditë.

Referuar procesverbaleve të seancave të zhvilluara konstatohet se nuk ka urdhër për kalim të çështjes në seancë gjyqësore. Shtyrjet janë për shkak të veprimeve procedurale që kanë të bëjnë me aktin e ekspertimit dhe ekspertin. Nuk rezultojnë shtyrje për shkak të mungesës së gjyqtarit.

Distanca kohore ndërmjet seancave: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 21 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 3 muaj e 14 ditë.

II. Çështja nr. 11112-01027-23-2021

Kërkesë padia është depozituar në gjykatë në datë 26.10.2021, dhe më pas është regjistruar dhe shortuar brenda ditës.

Kjo çështje është rishortuar në datën 20.03.2023.

Seanca e parë është caktuar pas 2 muaj e 26 ditësh nga data e hedhjes së shortit të parë.

Seanca e parë pas rishortimit është caktuar pas 11 muajsh nga data e hedhjes së shortit.

Nga ana e gjykatës janë kryer këto veprime procedurale si më poshtë:

1. **Seanca e datës 21.01.2022** në të cilën gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse, për njërën nga palët e paditura nuk konfirmohet dijenia. Me qëllim njoftimin e palëve jo prezent, si dhe rregullimin e aktit të përfaqësimit të palës paditëse, gjykata shtyn seancën për në datën 10.03.2022. (1 muaj e 17 ditë)
2. **Seanca e datës 10.03.2022**, në të cilën gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur përfaqësuesi ligjor i njëres prej palëve paditëse, janë paraqitur palët e paditura si dhe janë legjitimuar përfaqësuesit e tyre

ligjorë (avokatët). Pasi ka shpallur trupin gjykues dhe sekretaren gjyqësore, gjykata ka deklaruar të hapur debatin gjyqësor lidhur me fazën e parë të pjesëtimit. Në përfundim gjykata urdhëron kalimin e çështjes në seancë gjyqësore për sa i përket fazës së parë të pjesëtimit, në përfundim të shqyrtimit të së cilës dhe kalimit në diskutime përfundimtare, vendos pranimin e padisë për këtë fazë. Lidhur me fazën e dytë të pjesëtimit do të thërritet një ekspert që disponon njohuri të posaçme Ekspertes i ngarkohen detyra dhe i lihet kohë për përgatitjen e aktit. Seanca e radhës caktohet në datën 04.05.2022.(1 muaj e 24 ditë)

3. **Seanca gjyqësore e datës 04.05.2022**, në të cilën gjykata pas verifikimit të prezencës së palëve konstaton se është paraqitur përfaqësuesi i palës paditëse, përfaqësuesi i njëjës prej palëve të paditura, nuk është paraqitur i padituri tjetër. Rezulton të jetë paraqitur edhe ekspertja e cila relaton aktin e ekspertimit, i cili vlerësohet të plotësohet përsëri. Për ti lënë kohë ekspertes të plotësojë aktin e ekspertimit, shtyhet seanca për në datën 14.07.2022.(2 muaj e 10 ditë)
4. **Seanca gjyqësore e datës 14.07.2022**, në të cilën gjykata çel seancën gjyqësore, verifikon prezencën e palëve dhe konstaton se përfaqësuesit ligjorë mungojnë për shkak të bojkotit të organizuar nga DHKA. Për këtë shkak seanca shtyhet për në datën 31.10.2022. (3 muaj e 17 ditë)
5. **Seanca gjyqësore e datës 31.10.2022**, në të cilën pas verifikimit të prezencës së palëve rezulton se është paraqitur pala paditëse, nuk është paraqitur pala e paditur e cila rezulton të ketë paraqitur kërkesë për shtyrje. Rezulton që ekspertja nuk e ka plotësuar aktin e ekspertimit. Me qëllim plotësimin e aktit të ekspertimit, seanca shtyhet për në datë 21.12.2022.(1 muaj e 21 ditë)
6. **Seanca gjyqësore e datës 21.12.2022**, në këtë seancë sekretarja relaton mungesën e gjyqtarit për shkak të pjesëmarrjes në trajnim. Seanca e radhës caktohet në datën 28.02.2024.(2 muaj e 7 ditë)
7. **Seanca gjyqësore e datës 28.02.2023**, në të cilën gjykata pasi verifikon prezencën e palëve dhe konstaton vetëm prezencën e përfaqësuesit të paditësit dhe të ekspertes, administron përgjigjen e saj dhe shtyn seancën për në datën 11.04.2023 për t'ju komunikuar palëve përgjigjen e ekspertes.

- **Çështja është shortuar në datën 20.03.2023³²**

8. **Seanca gjyqësore e datës 20.02.2024**. Në këtë seancë gjykata pasi verifikon prezencën e palëve, konstaton se është paraqitur përfaqësuesi ligjor i palës paditëse, nuk është paraqitur njëra nga të paditurat. Gjkata pyet palët nëse janë dakord të vijnë aty ku ka mbetur gjykimi dhe pasi merr dakordësinë vazhdon me diskutimin lidhur me plotësimin e aktit të ekspertimit. Me qëllim plotësimin e aktit, shtyhet seanca për në datën 06.03.2023.(15 ditë)
9. **Seanca gjyqësore e datës 06.03.2024**, në të cilën gjykata pasi çel seancën, dhe verifikon prezencën e palëve konstaton prezencën e përfaqësuesit ligjor të paditësit, mungesën e palës së paditur për të cilin merr vendim mungese. Pasi pyet

³² Për shkak të transferimit të gjyqtarit Shkëlzen Liçaj, çështja i është shortuar gjyqtarit Fatmir Ndreu i cili në datë 17.11.2023 ka planifikuar të caktoj seancë në datë 20.02.2024.



eksperten lidhur me plotësimin e akt ekspertimit, i lë kohë kësaj të fundit dhe cakton seancën në datën 30.04.2024.(1 muaj e 24 ditë)

10. Seanca gjyqësore e datës 30.04.2024, në të cilën gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se pala paditëse është e pranishme, duke revokuar vendimin e mungesës për njërën nga palët e paditura. Gjykata ka konstatuar se nuk është paraqitur ekspertja e cila duhet të depozitonte aktin e plotësuar. Me qëllim urdhërimit të ekspertës për të plotësuar aktin i cili duhet tu komunikohet palëve, gjykata shtyn seancën për në datën 04.06.2024.(1 muaj e 5 ditë)

11. Seanca gjyqësore e datës 04.06.2024, në të cilën gjykata pasi verifikon prezencën e palëve dhe ekspertës, fton palët në diskutimet rreth aktit të ekspertimit. Në përfundim të debatit gjyqësor dhe pasi pyeten palët për vazhdimin e gjykimit, gjykata administron provat, i jep fund shqyrtimit gjyqësor dhe fton palët të japin konkluzionet përfundimtare. Seanca për shpallje të vendimit caktohet në datën 24.06.2024.(20 ditë)

12. Seanca e datës 24.06.2024, në të cilën gjykata shpall vendimin.

Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë 26.10.2021 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës 24.06.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatuar 2 vjet 7 muaj 29 ditë.

Shtyrjet janë për shkak të veprimeve procedurale që kanë të bëjnë me aktin e ekspertimit, mosparaqitja e përsëritur e ekspertës si dhe për mosparaqitje të palëve të paditura. Evidentohet 1 shtyrje për shkak të mungesës së gjyqtarit.

Distanca ndërmjet seancave:

Për gjyqtarin e parë: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra çështje në tjetrën është 1 muaj e 17 ditë. Distanca më e gjatë kohore nga njëra çështje në tjetrën është 3 muaj e 17 ditë.

Për gjyqtarin e dytë: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra çështje në tjetrën është 15 ditë. Distanca më e gjatë kohore nga njëra çështje në tjetrën është 1 muaj e 24 ditë.

- Çështje me objekt "Padi servituti"

I. Çështja nr. 10903-00453-23-2023

Kërkesë padia është paraqitur në gjykatë në datë 20.04.2023, dhe më pas është regjistruar dhe shortuar brenda ditës.

Kjo çështje është rishortuar në datën 26.10.2023.

Seanca e parë është caktuar pas 5 ditësh nga data e hedhjes së shortit të parë.

Seanca e parë pas rishortimit është caktuar pas 5 muaj e 7 ditësh nga data e hedhjes së këtij shorti

Nga ana e gjykatës janë kryer këto veprime procedurale:

- 1. Seanca e datës 25.04.2023**, në të cilën gjykata pasi mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën për sigurim padie vendosi rrëzimin e kërkesës.
- 2. Seanca e datës 14.07.2023**. Gjykata ka çelur seancën dhe ka verifikuar prezencën e palëve në gjykim. Nga përfaqësuesi i palës paditëse është ngritur pretendimi se

vendimi për sigurimin e padisë nuk është shpallur ende. Në lidhje me këtë pretendim, gjykata relatohet se do arsyetohet bashkë me vendimin përfundimtar. Gjykata çmon se duhet caktuar ekspert topograf. Me qëllim thirrjen e ekspertit, seanca është shtyrë për në datën 03.10.2023.

3. **Seanca e datës 03.10.2023**, në të cilën është bërë verifikimi i prezencës së palëve ku palët e paditura rezultojnë në mungesë. Është paraqitur eksperti i cili ka bërë betimin dhe ka marrë detyrat. Seanca shtyhet për në datën 20.11.2023.

- **Çështja është rishortuar në datë 26.10.2023**

4. **Seanca e datës 02.04.2024**, në të cilën pasi verifikohet prezenca e palëve, relatohet akti i ekspertit dhe listohen provat. Gjykata merr vendim për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore e cila caktohet në datën 07.05.2024.
5. **Seanca gjyqësore e datës 07.05.2024**, në të cilën pasi gjykata ka bërë verifikim e prezencës së palëve ka konstatuar se palët e paditura nuk janë paraqitur edhe pse kanë dijeni. Pasi shpallet trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, deklarohet i hapur shqyrtimi gjyqësor. Gjykata vlerëson se duhet thërritur avokatura e shtetit. Për këtë qëllim seanca shtyhet për në datën 20.05.2024.
6. **Seanca e datës 20.05.2024**, në të cilën është verifikuar prezenca e palëve dhe rezultoni se është paraqitur përfaqësuesi ligjor i paditësit, nuk është paraqitur eksperti dhe palët e paditura. Nga ana e ekspertit është paraqitur një kërkesë për shtyrje. Lidhur me këtë kërkesë pyetet përfaqësuesja e paditësit e cila e lë në çmim të gjykatës. Gjykata vlerëson ta shtyjë edhe njëherë seancën për në datën 31.05.2024.
7. **Seanca e datës 31.05.2024**, në të cilën gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka relatuar seancën e fundit dhe i ka dhënë fjalën ekspertit i cili relatoni aktin. Në kushtet kur janë ezauruar veprimet procedurale gjykata i jep fund hetimit gjyqësor dhe kalon në diskutime përfundimtare. Pasi tërhiqet shpall vendimin duke rrëzuar padinë.

Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë 20.04.2023 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës, 31.05.2024, rezultoni se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 1 vit e 1 muaj e 11 ditë.

Konstatohet se edhe pse çështja i është nënshtruar rishortimit, gjyqtari i fundit vijoi me veprimet procedurale duke mos e përsëritur hetimin gjyqësor. Shkaqet e shtyrjes lidhen me njoftimin e palëve, për veprime procedurale që kanë të bëjnë me aktin e ekspertimit dhe për mosparaqitje të palëve të paditura. Nuk evidentohen shtyrje për shkak të mungesës së gjyqtarit.

Distancat kohore ndërmjet seancave:

Distanca më e shkurtër kohore nga njëra çështje në tjetrën është 07.05.2024-20.05.2024. Distanca më e gjatë kohore nga njëra çështje në tjetrën është 20.11.2023-07.05.2024.

II. Çështja nr. 11114-00856-23-2022

Kërkesë padia është depozituar në gjykatë në datë 08.09.2022, është regjistruar në këtë të fundit dhe po në datën 08.09.2022 është shortuar.

Kjo çështje është rishortuar në datën 20.03.2023.

Seanca e parë është caktuar 5 ditë pas hedhjes së shortit të parë.

Seanca e parë pas shortit të dytë është caktuar 1 muaj e 5 ditë pas këtij shorti

Nga ana e gjyqtarit të çështjes janë kryer këto veprime procedurale si më poshtë:

- 1. Seanca e datës 13.09.2022**, në të cilën gjykata çel seancën, verifikon prezencën e palëve dhe konstaton se vetëm për njërin nga palët e paditura nuk konfirmohet dijenia. Për palët të cilët kanë marrë dijeni rregullisht dhe nuk janë paraqitur, merret vendimi i gjykimit në mungesë, ndërsa për palën dijenia e të cilës nuk konfirmohet, do të përsëritet njoftimi. Në funksion të njoftimit të palës jo prezent, caktohet seanca e datës 14.09.2022.(1 ditë)
- 2. Seanca e datës 14.09.2022**, pasi është verifikuar prezenca e palëve ndërgjyqëse në proces, gjykata konstaton se është depozituar një kërkesë për zëvendësim të sekretares gjyqësore. Lidhur me këtë kërkesë shprehet sekretarja gjyqësore e cila ka dhënë mendimin për tu zëvendësuar. Në vijim gjykata shpall sekretaren e re gjyqësore për zgjedhjen e të cilës palët bien dakord. Gjykata deklaron të hapur shqyrtimin lidhur me kërkesën për marrjen e masës të sigurimit të padisë dhe fton palët të japin qëndrimin e tyre lidhur me këtë kërkesë. Në kushtet kur gjykata e çmon të domosdoshme këqyrjen në vend të pronave për të parë pozicionimin, kërkon nga pala e paditur të jetë e pajisur me hartë ose projekt urbanistike. Seanca e radhës caktohet në datën 15.09.2022.(1 ditë)
- 3. Seanca e datës 15.09.2022**, në të cilën gjykata pasi verifikon prezencën e palëve, relaton se po vazhdon procesi i këqyrjes (*nuk përcaktohet në procesverbal data e seancës së radhës*). (1 ditë)
- 4. Seanca e datës 16.09.2022**, në këtë seancë gjykata pasi verifikon prezencën e palëve konstaton se ka një kërkesë për shtyrje nga përfaqësuesi i palës paditëse i cili ka depozituar raport mjekësor. Në këto kushte gjykata vendos shtyrjen seancës për në datën 19.09.2022.(3 ditë)
- 5. Seanca e datës 19.09.2022**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ndërgjyqëse ka konstatuar se është paraqitur vetëm përfaqësuesi i palës paditëse, nuk janë paraqitur palët e paditura. Gjykata pasi relaton një kërkesë për shtyrje nga njëri prej përfaqësuesve ligjorë (avokat), pyet nëse ekziston mundësia për zgjidhjen me pajtim të çështjes. Avokati i palës paditëse relaton se një marrëveshje e tillë nuk është arritur. Në kushtet kur është depozituar një kërkesë për marrje të masës së sigurimit të padisë, gjykata administron provat dhe në referim të nenit 302 të Kodit të Procedurës Civile deklaron të mbyllur shqyrtimin gjyqësor, kalon në diskutime përfundimtare dhe tërhiqet për vendim në dhomë këshillimi. Pasi kthehet nga dhoma e këshillimit, shpall vendimin për rrëzim të kërkesës për sigurim padie.(1 muaj e 28 ditë)

6. **Seanca e datës 16.11.2022**, gjykata pasi verifikon prezencën e palëve, relaton ndryshimin e sekretares gjyqësore si dhe vendos të marrë vendimin për vazhdimin e gjykimit për palët të cilët kanë dijeni për seancën dhe nuk janë paraqitur. Përfaqësuesi i palës së paditur kërkon caktimin e një eksperti, kërkesë e cila pranohet nga gjykata e cila me qëllim njoftimin e ekspertit shtyn seancën për në datën 30.11.2022.(14 ditë)
7. **Seanca e datës 30.11.2022**, në të cilën sekretarja gjyqësore relaton mungesën e gjyqtarit për shkaqe trajnimi pranë Shkollës së Magjistraturës. Seanca e radhës caktohet në datën 13.12.2022.(13 ditë)
8. **Seanca e datës 13.12.2022**, në të cilën gjykata ka verifikuar prezencën e palëve duke deklaruar prezencën e ekspertit topograf. Gjykata gjithashtu relaton një kërkesë për shpallje të moskompetencës, kërkesë për të cilën gjykata urdhëron të depozitohet e plotësuar më dokumente të tjera. Gjithashtu gjykata shprehet për kërkesën për pushim të gjykimit për njërin nga palët e paditura. Më pas vijohet me betimin e ekspertit, dhe caktimin e detyrave të tij. Seanca e radhës caktohet në datën 27.02.2023.(2 muaj e 14 ditë)
9. **Seanca e datës 27.02.2023**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ndërgjyqëse dhe njihet me kërkesën e përfaqësuesit të palëve të paditura për pezullim të gjykimit, vendos për rrëzimin e saj. Në vijim të diskutimit lidhur me akt ekspertimin, avokati i palëve të paditura kërkon zëvendësimin e ekspertit, për shkaqe të cilat i ka parashtruar. Gjykata pasi shqyrton këtë kërkesë vendos rrëzimin e saj si të pabazuar në ligj e në prova dhe vendos ti lërë kohë ekspertit për të përfunduar aktin e ekspertimit. Seanca e radhës caktohet në datën 03.04.2023.

- **Rishortimi datë 20.03.2023**

10. **Seanca e datës 25.04.2023** në të cilën gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve, ka relatuar kërkesën për shtyrje të depozituar nga eksperti. Pasi pyet palët prezent lidhur me qëndrimin për kërkesën për shtyrje të ekspertit, shtyn seancën për në datën 01.06.2023.(1 muaj e 7 ditë)
11. **Seanca e datës 01.06.2023**, në të cilën gjykata pasi verifikon prezencën e palëve, konstaton se nuk janë paraqitur palët e paditura, është paraqitur pala paditëse. Nga administratori i shoqërisë palë të paditur në proces është parashtruar kërkesa për mungesën e kompetencës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë. Në lidhje me këtë kërkesë pasi pyeten palët lidhur me qëndrimin, gjykata vendos rrëzimin e saj si të pabazuar në prova e në ligj. Eksperti i caktuar nga gjykata dorëzon aktin për të cilën do kryhet pagesa e tarifës. Me qëllim komunikimin e aktit palëve në mungesë si dhe për të thërritur ZVASH-në Gjirokastër, seanca shtyhet për në datën 18.07.2023.(1 muaj e 17 dite)
12. **Seanca e datës 18.07.2023**, në të cilën gjykata pasi verifikoi prezencën e palëve ndërgjyqëse, fton palët të parashtrojnë qëndrimin e tyre lidhur me aktin e ekspertimit. Përfaqësuesi i palës së paditur vijon me kërkesën për përjashtim eksperti, kërkesë e cila nuk pranohet nga gjykata. Konstatohet ndërprerje e energjisë elektrike, ndërprerje e cila bëhet shkak për zhvillimin manualisht të



- seancës e cila u shty për në datën 18.10.2023. Gjykata ka marr vendim për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore.(3 muaj)
13. **Seanca gjyqësore e datës 18.10.2023**, në të cilën sekretarja gjyqësore relatton se gjyqtari mungon për shkaqe familjare. Seanca shtyhet për në datë 06.12.2023.(1 muaj e 18 dite)
 14. **Seanca gjyqësore e datës 06.12.2023**, gjykata pasi verifikon prezencën e palëve, konstaton se përfaqësuesi i palës së paditur ka depozituar kërkesë për shtyrje. Lidhur me vazhdimin e gjykimit, palët prezent e kanë lënë në çmim të gjykatës e cila pranon kërkesën dhe shtyn seancën për në datën 07.02.2024.(2 muaj e 1 ditë)
 15. **Seanca gjyqësore e datës 07.02.2024**, në këtë seancë gjykata pasi verifikoi prezencën e palëve konstatoi mungesën e disa palëve ndërgjyqëse për të cilat është marrë vendim mungese. Shpallet trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, dhe më pas gjykata fton palët për debatin gjyqësor si dhe vijojnë diskutimet për aktin e ekspertimit. Pala e paditur vijon përsëri me kërkesë për shpallje moskompetence, kërkesë e cila vlerësohet e përsëritur, për të cilën gjykata është shprehur njëherë dhe e ka rrëzuar. I padituri parashtron se do paraqesë kërkesë për përjashtim gjyqtari. Pala e paditur kërkon të njihet me një provë shkresore e cila ndodhet në dosje por i padituri nuk është në dijeni të saj. Në këto kushte, për ti lënë kohë të paditurit të njihet me provën shkresore, gjykata shtyn seancën për në datë 27.03.2024. (1 muaj e 20 ditë)
 16. **Seanca gjyqësore e datës 27.03.2024**, në këtë seancë, gjykata ka verifikuar prezencën e palëve dhe ka relatuar se është marrë vendim për rrëzim kërkesë për përjashtim gjyqtari nga ky gjykim. Për t'i dhënë edhe një mundësi palës së paditur, gjykata shtyn seancën për në datën 22.04.2024.(26 ditë)
 17. **Seanca gjyqësore e datës 22.04.2024**, në këtë seancë pasi verifikohet prezenca e palëve ndërgjyqëse, gjykata pyet palët nëse janë dakord ti japin fund shqyrtimit gjyqësor dhe fton palët të japin konkluzionet përfundimtare. Me qëllim për t'i dhënë kohë palëve ti paraqesin me shkrim, gjykata shtyn seancën për në datën 24.04.2024.(dy ditë)
 18. **Seanca gjyqësore e datës 24.04.2024**, në këtë seancë sekretarja gjyqësore relatton se gjyqtari mungon për arsye shëndetësore. Seanca e radhës caktohet në datën 29.04.2024.(5 ditë)
 19. **Seanca e datës 29.04.2024**, në këtë seancë gjykata çel seancën gjyqësore, verifikon prezencën e palëve, administron konkluzionet përfundimtare dhe shtyn seancën për shpallje të arsytuar të vendimit për në datën 16.05.2024.(17 ditë)
 20. **Seanca e datës 16.05.2024**, shpallje e vendimit.

Referuar datës 08.09.2022 së depozitimit të kërkesëpadsisë dhe datës 16.05.2024 të vendimmarrjes së gjykatës, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur më shumë 1 vit, 8 muaj e 8 ditë.

Shkaqet për shtyrje të seancave konsistojnë në kërkesa për shtyrje me kërkesë të palëve për shkaqe të ndryshme, mungesa e gjyqtarit për shkaqe trajnimi, familjare, shëndetësore, veprime procedurale që kanë të bëjnë me aktin e ekspertimit.

Distanca kohore ndërmjet seancave:

Për gjyqtarin e parë: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra çështje në tjetrën është 1 ditë. Distanca më e gjatë kohore nga njëra çështje në tjetrën është 2 muaj e 14 ditë.

Për gjyqtarin e dytë: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra çështje në tjetrën është 2 ditë. Distanca më e gjatë kohore nga njëra çështje në tjetrën është 3 muaj

- **Dy çështje me objekt “ detyrim për pagim shume”**

I. Çështja me nr.1. (21258-00404-23-2023)

Kërkesë padia është depozituar në gjykatë në datë 03.04.2023, është regjistruar në këtë të fundit dhe po në datën 03.04.2023 është shortuar.

Seanca e parë është caktuar 3 muaj e 3 ditë pas së shortit.

Nga ana e gjyqtarit janë kryer veprimet procedurale si më poshtë:

1. **Seanca e datës 06.07.2023** në të cilën gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve, ka konstatuar se është paraqitur njëri nga paditësit, ndërsa për paditësin tjetër është paraqitur përfaqësuesi i tij ligjor. Nuk është paraqitur pala e paditur. Pasi çel seancën, shpall trupin gjykues dhe sekretaren gjyqësore, gjykata merr vendim për të deklaruar mungesën e palës së paditur. Deklarohet i hapur shqyrtimi gjyqësor dhe paditësi vijon të japë shpjegime rreth padisë. Drejtuesi i seancës relatton një kërkesë procedurale të depozituar nga Avokatura e Shtetit, kërkesë e cila është vlerësuar të rrëzohet nga gjykata. Përfaqësuesi i palës paditëse paraqet kërkesë për thërritjen e ekspertës e cila ka bërë bërë aktin. Me qëllim thërritjen e saj, seanca shtyhet për në datën 19.10.2023.(3 muaj e 13 ditë)
2. **Seanca e datës 19.10.2023**, në të cilën gjykata pasi bëri verifikimin e prezencës së palëve ndërgjyqëse konstaton se janë të pranishëm të gjitha palët nëpërmjet përfaqësuesve të tyre. Rezulton një kërkesë për shtyrje nga eksperti i cili nuk është paraqitur për shkaqe shëndetësore. Pasi pranohet kërkesa, shtyhet seanca për në datën 07.12.2023.(1 muaj e 18 ditë)
3. **Seanca e datës 07.12.2023**, në të cilën pasi verifikohet prezenca e palëve, konstatohet se janë të pranishëm palët paditëse të përfaqësuar nga avokati i tyre, nuk është paraqitur pala e paditur, për të cilën deklarohet mungesa. Pasi paraqitet eksperti i cili lexon formulën e betimit, gjykata urdhëron caktimin e detyrave për përmbushjen e të cilave, caktohet seanca në datën 14.02.2024.(2 muaj e 7 ditë)
4. **Seanca e datës 14.02.2024**, në të cilën pasi verifikohet prezenca e palëve gjykata pyet palët nëse janë njohur me aktin e ekspertimit. Merret vendimi për kalimin në seancë gjyqësore në të cilën do të merren në shqyrtim të gjitha provat dhe akti i ekspertimit. Seanca e radhës do të jetë në datën 11.04.2024. (1 muaj 28 ditë)
5. **Seanca gjyqësore e datës 11.04.2024**, në të cilën sekretarja gjyqësore ka relatuar se mungon gjyqtari për arsye familjare. Seanca e radhës do të jetë në datën 21.05.2024.(1 muaj e 10 ditë)
6. **Seanca gjyqësore e datës 21.05.2024**, në të cilën pasi verifikohet prezenca e palëve, rezultojnë të pranishëm palët paditëse, mungon një nga palët e paditura.

Çelet seanca gjyqësore dhe gjykata fiton palët të zhvillojnë debatin gjyqësor. Në përfundim, pasi deklaroi të mbyllur hetimin gjyqësor, gjykata merr vendim për administrimin e provave, dhe u lë kohë palëve të depozitojnë konkluzionet e fundit me shkrim. Seanca e radhës caktohet në datën 28.05.2024. (7 ditë)

7. **Seanca e datës 28.05.2024**, në të cilën gjykata shpall vendimin.

Referuar datës 03.04.2023 së depozitimit të kërkesëpadisë, dhe datës 28.05.2024 të vendimmarrjes së gjykatës, rezultoi se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 1 vit e 25 ditë.

Shtyrjet ndër të tjera janë për shkak të veprimeve procedurale që kanë të bëjnë me aktin e ekspertimit dhe ekspertin dhe për shkak të njoftimit të palës së paditur. Rezultoi një seancë e shtyrë për shkak të mungesës së gjyqtarit.

Distancat kohore ndërmjet seancave: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 7 ditë. Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 3 muaj e 13 ditë.

II. Çështja nr. 21258-00102-23-2023

Kërkesë padia është depozituar në gjykatë në datë 25.01.2023, është regjistruar në këtë të fundit dhe po në datën 25.01.2023 është shortuar.

Kjo çështje është rishortuar në datën 26.10.2023

Seanca e parë është caktuar 2 muaj e 11 ditë pas hedhjes së shortit të parë.

Seanca e parë pas shortit të dytë është caktuar 5 muaj e 7 ditë pas hedhjes së shortit.

Nga ana e gjyqtarit të çështjes janë kryer këto veprime procedurale si më poshtë:

1. **Seanca e datës 05.04.2023**, në këtë seancë gjykata pasi verifikoi prezencën e palëve konstatoi se është paraqitur pala paditëse përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor (avokat), për të paditurën rezultoi të ketë nënshkruar një person i panjohur. Në funksion të njoftimit të palës së paditur, gjykata shtyn seancën për në datën 23.05.2023.(1 muaj e 18 ditë)
2. **Seanca e datës 23.05.2023**, në këtë seancë sekretarja gjyqësore raportoi mungesën e gjyqtarës së çështjes e cila ndodhet në trajnim në Shkollën e Magjistraturës. Seanca e radhës është në datën 05.07.2023.(1 muaj e 12 ditë)
3. **Seanca e datës 05.07.2023**, në të cilën gjykata pasi verifikoi prezencën e palëve dhe konstatoi se paditësja ishte prezent, dhe e paditura edhe pse kishte marrë njoftim nuk ishte paraqitur, mori vendim mungese. Gjykata raportoi provën shkresore të vënë në dispozicion nga institucioni shtetëror. Në kushtet kur vlerësohet e domosdoshme caktimi i një eksperti kontabël, gjykata thërritet ekspertin i cili pasi bën betimin, njihet me detyrat e caktuara. Në funksion të përgatitjes së aktit, seanca shtyhet për në datën 26.09.2023.(2 muaj e 21 ditë)
4. **Seanca e datës 26.09.2023**, në të cilën gjykata pasi verifikoi prezencën e palëve, konstatoi se është paraqitur pala paditëse, rezultoi në mungesë pala e paditur. Është paraqitur eksperti i cili ka depozituar aktin. Më qëllim komunikimit e aktit palës së paditur, shtyhet seanca në datën 21.11.2023.

- **Rishortuar në datë 26.10.2023**

5. **Seanca e datës 02.04.2024.** Në këtë seancë gjyqtari i çështjes pasi çel seancën verifikon prezencën e palëve. Rezulton të jetë paraqitur pala paditëse, në mungesë pala e paditur. Gjyqtari pas rishortimit vijon gjykimin në fazën në të cilën është lënë nga gjyqtarja paraardhëse. Pasi administrohet fatura e lëshuar nga eksperti, seanca shtyhet për në datën 16.05.2024. (1 muaj e 14 ditë)
6. **Seanca e datës 16.05.2024,** në të cilën pasi verifikohet prezenca e palëve, nga ku rezulton prezent paditësja dhe në mungesë e paditura, gjykata urdhëron kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, administron dhe citon provat shkresore dhe shtyn seancën për në datën 18.06.2024.(1 muaj e 2 ditë)
7. **Seanca gjyqësore e datës 18.06.2024,** në të cilën gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka shpallur trupin gjykues duke deklaruar të hapur shqyrtimin gjyqësor. Fjalën e ka marrë përfaqësuesi i palës paditëse i cili ka dhënë shpjegime rreth çështjes. Në përfundim, gjykata ka deklaruar të mbyllur shqyrtimin gjyqësor dhe fton palët të japin konkluzionet e fundit. Po në këtë datë gjykata shpall vendimin.

Referuar datës 25.01.2023 të depozitimit të kërkesëpadisë dhe datës 18.06.2024 të vendimmarrjes së gjykatës, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 1 vit e 4 muaj e 24 ditë.

Shtyrjet janë për shkak të veprimeve procedurale që kanë të bëjnë me aktin e ekspertimit dhe ekspertin dhe për shkak të njoftimit të palës së paditur. Rezulton një seancë e shtyrë për shkak të mungesës së gjyqtares.

Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 1 muaj e 2 ditë. Distanca më e gjatë kohore nga njëra çështje në tjetrën është 1 muaj e 26 ditë.

5.5. Faktet e konstatuara në lidhje me çështjet me objekt “kundërshtim të veprimeve përmbareme”.

Referuar nenit 610 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se “Ankimi kundër veprimeve ose refuzimit të përmbaremit gjyqësor shqyrtohet brenda 20 ditëve nga gjykata e vendit të ekzekutimit e cila kur e sheh të nevojshme mund të thërrasë palët dhe përmbaremitin gjyqësor”.

Referuar të dhënave statistikore të ardhura nga gjykata rezulton se gjatë periudhës tremujore objekt ekspertimi janë përfunduar 2 çështje civile me objekt “kundërshtimi i veprimeve përmbareme”

- **Dy çështje me objekt “Kundërshtim veprimesh përmbareme”**

I. Çështja nr. 21274-00535-23-2024

Kërkesë padia është depozituar në gjykatë në datën 12.06.2024, është regjistruar po në datën 12.06.2024 dhe po në të njëjtën datë është shortuar.

Seanca e parë është caktuar 16 ditë pas hedhjes së shortit.

1. **Seanca e datës 28.06.2024**, është caktuar 16 ditë pas shortimit. Gjatë kësaj seance e cila është seanca e parë dhe e fundit e zhvilluar, gjyqtari i çështjes ka evidentuar mungesën e kompetencës lëndore për shqyrtimin e kësaj çështjeje. Në këto kushte, po në datën 28.06.2024, gjykata ka marrë vendim duke shpallur mungesën e kompetencës lëndore për gjykimin e çështjes (në procesverbalin e seancës nuk evidentohet nëse palët ndërgjyqëse janë prezent).

Referuar datës 12.06.2024 të depozitimit të kërkesëpadiisë dhe datës 28.06.2024 të vendimmarrjes së gjykatës, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 16 ditë.

II. Çështja nr. 21274-01050-23-2023

Kërkesë padia është dorëzuar në datën 20.11.2023, është regjistruar në datën 20.11.2023 dhe është shortuar në datë 20.11.2023.

Seanca e parë është caktuar pas 1 muaji e 28 ditë pas hedhjes së shortit.

Nga ana e gjykatës janë kryer këto veprime:

1. **Seanca e datës 17.01.2024**, në të cilën gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ndërgjyqëse në gjykim, ka shpallur trupin gjykues, për të vijuar më pas me pranimin e kërkesës së përfaqësuesit ligjor për thërritje të personit të tretë në gjykim. Me qëllim njoftimin e personit të tretë, gjykata ka shtyrë seancën për më datë 09.02.2024
2. **Seanca e datës 09.02.2024**, në të cilën gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve, ka dëgjuar parashtrimin e përfaqësuesit ligjor të palës ndërgjyqëse dhe ka vlerësuar tërheqjen e provës shkresore (*urdhër ekzekutimi*), për depozitimin e të cilës ka shtyrë seancën për më datën 05.03.2024.
3. **Seanca e datës 05.03.2024**, në të cilën gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve dhe ka listuar provat e depozituara, ka vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, e cila u caktua më datë 05.04.2024.
4. **Seanca gjyqësore e datës 05.04.2024**, në të cilën gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve, ka shpallur trupin gjykues, ka administruar provat shkresore dhe i ka dhënë fund shqyrtimit gjyqësor, ka ftuar palët të japin konkluzionet përfundimtare me shkrim. Për t'u dhënë kohë palëve të depozitojnë pretendimet e fundit me shkrim, shtyn seancën për më datë 22.04.2024.
5. **Seanca gjyqësore e datës 22.04.2024**, në të cilën gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve të cilat kanë depozituar konkluzionet e fundit me shkrim, ka shtyrë seancën me qëllim shpalljen e vendimit për në datë 29.04.2024.
6. **Seanca gjyqësore e datës 29.04.2024**, në të cilën gjykata shpall vendimin.

Për këtë çështje konstatohet se janë zhvilluar gjithsej 6 seanca. Gjykimi ka zgjatur gjithsej 5 muaj e 9 ditë.

Nga përmbajtja e seancave rezultojnë se kryesisht seancat e para janë shtyrë për shkak procedurale të ndryshme sikundër raportuar më sipër. Nuk rezultojnë shtyrje për shkak të mungesës së gjyqtarit të çështjes.

Për sa i përket distancës kohore ndërmjet seancave evidentohet fakti se distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është prej 7 ditë ndërsa distanca më e largët është 1 muaj.

6. Gjetjet e inspektimit në lidhje me proceset gjyqësore që janë zgjatur përtej afatit dy vjeçar si dhe kërkesat për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit.

6.1. Faktet e konstatuara në lidhje me numrin e përgjithshëm të proceseve gjyqësore civile me palë kundërshtare të cilat janë zgjatur përtej afatit 2 vjeçar.

Një vëmendje e veçantë gjatë inspektimit i është kushtuar çështjeve, kohëzgjatja e të cilave mund të çojnë në konstatimin e shkeljes së të drejtës së individit për një proces gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme.

Sikurse kemi konstatuar edhe më lart, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, për periudhën 01.04.2024-30.06.2024 ka shpallur 170 vendime.

Nga këto 170 çështje të përfunduara, numri i çështjeve të cilat kanë zgjatur më shumë se dy vjet është 38 çështje.

Koha mesatare e gjykimit të 38 çështjeve të cilat kanë zgjatur më shumë se dy vjet është 1157 ditë.

Të dhëna më të detajuara në lidhje me numrin e çështjeve të përfunduara, kohën mesatare të gjykimit për secilin gjyqtar për çështjet mbi dy vjet, janë pasqyruar në tabelën në vijim:

Vendimet për periudhën 01.04.2024-30.06.2024				
Nr.	Gjyqtari	Numri total i vendimeve për gjyqtar dhe për gjykatën	Numri i vendimeve për çështjet mbi dy vite	Koha mesatare në ditë për çështjet mbi dy vite për gjyqtar/për gjykatën
1	Alban Veçani	36	13	975
2	Dejvi Çelçima	9	1	917
3	Edona Vajushi	37	5	1590

4	Entiljano Spahiu	25	5	900
5	Fatmir Ndreu	30	9	1106
6	Mikel Hysometaj	33	5	1510
TOTALI	Gjykata	170	38	1157

Referuar të dhënave statistikore, në lidhje me 38 çështjet e përfunduara janë zhvilluar gjithsej 642 seanca.

Në kuadër të identifikimit të faktorëve që ndikojnë në kohëzgjatjen e proceseve përtej afatit 2 vjeçar, në vijim janë pasqyruar faktet e konstatuara referuar RIV (regjistrit të veprimeve) dhe procesverbaleve të seancave gjyqësore të gjeneruara nga sistemi i menaxhimit të çështjeve të gjykatës.

✚ Raste studimore:

1. Çështja nr. 11217-00608-23-2020 me objekt "Përmbushje detyrimi kontraktor"

Kjo çështje është relatuar me detaje tek pika 5.4 e këtij raporti (shkaqet e zgjatjes së proceseve duke ju referuar llojit të objektit të padisë) .

Në mënyrë të përmbledhur konstatohet se kjo çështje është shortuar dy herë përkatësisht: shorti i parë – 23.07.2020; shorti i dytë – 12.11.2020. Për këtë çështje konstatohet se janë zhvilluar 31 seanca. Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë 23.07.2020 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës, 02.04.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 3 vite e 8 muaj e 10 ditë.

Në lidhje me shkaqet e shtyrjes të seancave ndër të tjera konstatohet se 15 seanca janë shtyrë për shkaqe të lidhura me palën paditëse; 5 seanca të shtyra për shkak të mungesës së gjyqtarit përkatësisht 2 seanca për shkaqe shëndetësore, 2 seanca për pjesëmarrje në trajnim dhe 1 seancë për shkaqe të tjera. Rezultojnë 2 seanca të shtyra për shkaqe që lidhen me mosnjohimin e gjykatës mbi fazën përmbartimore në të cilën ndodhej vjelja e tarifës së aktit të ekspertimit.

Distanca kohore ndërmjet seancave:

Për gjyqtarin e parë: Në lidhje me këtë çështje rezulton të jetë zhvilluar vetëm 1 seancë.

Për gjyqtarin e dytë: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 7 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 3 muaj.

2. Çështja nr. 21271-00551-23-2020 me objekt "Pavlefshmëri vendimi"

Kërkesë padia është paraqitur në gjykatë në datë 07.07.2020, është regjistruar në këtë të fundit dhe po në datën 07.07.2020 është shortuar.

Kjo çështje është shortuar 2 herë përkatësisht: shorti i parë – 07.07.2020; shorti i dytë – 20.03.2023.

Seanca e parë është caktuar pas 2 muaj e 23 ditë nga data e hedhjes së shortit.

Seanca e parë pas rishortimit është caktuar pas 6 muaj e 22 ditë nga data e hedhjes së shortit të dytë

Nga ana e gjykatës janë kryer veprimet procedurale si më poshtë:

1. **Seanca e datës 30.09.2020**, në të cilën gjykata pasi verifikon prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse, nuk janë paraqitur palët e paditura edhe pse kanë dijeni rregullisht, gjykata vazhdon gjykimin në mungesë. Gjykata pasi ka konstatuar një kërkesë për ndërhyrje si person të tretë, ka shtyrë seancën për në datën 12.10.2020. (12 ditë)
2. **Seanca e datës 12.10.2020**, në të cilën gjykata pasi çel seancën dhe verifikon prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse dhe nuk janë paraqitur përsëri të paditurit për të cilët është deklaruar mungesa. Me qëllim që ndërhyrësi kryesor të njihet me CD e seancës, gjykata merr vendim për ti lënë kohë ndërhyrësit kryesor të njihet me provën. Në vijim seanca e radhës planifikohet për në datën 05.11.2020. (24 ditë)
3. **Seanca e datës 05.11.2020**, në të cilën gjykata verifikon prezencën e palëve dhe ka konstatuar se pala paditëse ka paraqitur kërkesë për shtyrje. Gjykata ka vijuar seancën në mungesë të palëve të paditura. Gjykata është relatuar se është paraqitur edhe një kërkesë për ndërhyrje kryesore. Në vijim, gjykata ka shtyrë seancën për në datën 02.12.2020. (27 ditë).
4. **Seanca e datës 02.12.2020**, nuk është zhvilluar pasi gjyqtari mungon për arsye shëndetësore. Njoftimi i palëve për seancën e radhës do të kryhet me fletëthirrje. (2 muaj e 16 ditë).
5. **Seanca e datës 18.02.2021**, në të cilën gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse, nuk janë paraqitur palët e paditura për të cilat është marrë vendimi i gjykimit në mungesë. Gjykata në vijim ka konstatuar se prokura e ndërhyrësit kryesor rezulton me të metë. Për ti lënë kohë ndërhyrësit kryesor të plotësojë të metat e përfaqësimit ka shtyrë seancën për në datën 12.04.2021. (1 muaj e 25 ditë).
6. **Seanca e datës 12.04.2021**, në të cilën gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse, ka vijuar gjykimin në mungesë për të paditurit. Gjykata ka konstatuar se nuk është korrigjuar prokura dhe palët duhet të jenë prezent. Përfaqësuesi i ndërhyrësit kryesor ka kërkuar kohë për rregullimin e aktit të përfaqësimit. Në vijim gjykata për t'i dhënë kohë përfaqësuesit për të rregulluar prokurën ka shtyrë seancën në datën 07.06.2021. (1 muaj e 26 ditë)
7. **Seanca e datës 07.06.2021**, në të cilën gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve dhe ka ndërprerë seancën për ti mundësuar avokatit të ndërhyrësit kryesor marrjen e prokurës, e ka rifilluar atë duke relatuar se një kopje të akteve për ndërhyrësin kryesor duhet t'ju komunikohet palëve në mungesë. Në vijim për këtë

shkak si dhe për të sjellë pala paditëse një provë, gjykata ka shtyrë seancën për në datën 23.09.2021. (3 muaj e 16 ditë)

8. **Seanca e datës 23.09.2021**, nuk është zhvilluar pasi mungon gjyqtari për arsye shëndetësore. Seanca e radhës është caktuar 01.12.2021. (2 muaj e 8 ditë)
9. **Seanca e datës 01.12.2021**, në këtë seancë gjykata verifikon përmbushjen e detyrave të lëna nga seanca e mëparshme dhe ka konstatuar se i duhet lënë përsëri kohë palës paditëse për të sjellë provën e kërkuar sipas vlerësimit të gjykatës. Në vijim seanca e radhës është caktuar për në datën 16.02.2022. (2 muaj e 15 ditë)
10. **Seanca e datës 16.02.2022**. Në këtë seancë gjykata pasi verifikon prezencën e palëve është relatuar seancën e kaluar dhe në vijim konkludon për tju drejtuar me shkresë të tretëve për marrje të provës. Për këtë shkak dhe për ti lënë kohë palës paditëse të sigurojë provën e kërkuar gjykata ka shtyrë seancën për në datën 20.04.2022. (2 muaj e 4 ditë)
11. **Seanca e datës 20.04.2022**. Kjo seancë nuk është zhvilluar për arsye se gjyqtari mungon për shkaqe shëndetësore. Seanca e radhës është caktuar në datë 23.06.2022 (2 muajsh e 3 ditësh).
12. **Seanca e datës 23.06.2022**, në të cilën gjykata pasi verifikon prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur vetëm paditësi, nuk është paraqitur përfaqësuesi i ndërhyrësit kryesor për shkak të bojkotit të organizuar nga avokatët. Në vijim gjykata ka shtyrë seancën për në datën 12.10.2022. (3 muaj 19 ditë)
13. **Seanca e datës 12.10.2022**. kjo seancë nuk është zhvilluar pasi gjyqtari mungon për shkaqe shëndetësore. Seanca është shtyrë për në datën 19.12.2022. (2 muajsh e 7 ditësh)
14. **Seanca e datës 19.12.2022**. kjo seancë nuk është zhvilluar sepse gjyqtari ndodhet në seminar trajnimi. Seanca është shtyrë për në datën 07.03.2023. (2 muajsh e 16 ditësh)
15. **Seanca e datës 07.03.2023**, në të cilën gjykata pasi verifikon prezencën e palëve dhe është relatuar seancën e kaluar ka vlerësuar marrjen e provës tek të tretët. Për ti lënë kohë palës paditëse për të sjellë këtë provë ka shtyrë seancën për në datën 10.05.2023. (7 muaj 5 ditë)

- **Çështja rishortohet në datën 20.03.2023**

16. **Seanca e datës 12.10.2023**. Në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve, është relatuar se referuar kompleksitetit të çështjes vlerësohet se është e paqartë ndërgjyqësia në procesin që është mbajtur në Gjykatën e Apelit Gjirokastër dhe çmon të studiojë aktet e dosjes në lidhje me palët që duhet të thirren. Në vijim seanca është caktuar për në datën 01.02.2024. (3 muaj e 20 ditë)
17. **Seanca e datës 01.02.2024**, në të cilën gjykata pasi bën verifikimin e prezencës së palëve, relatton ndryshimin e trupit gjykues, dhe është relatuar gjithashtu se në referim të nenit 181 të K.Pr.C. çështja do të fillojë nga e para. Gjykata ka deklaruar të hapur seancën përgatitore. Me qëllim njoftimin e palës është shtyrë seanca për në datën 02.04.2024. (2 muaj 1 ditë)
18. **Seanca e datës 02.04.2024**, në të cilën gjykata pasi ka konstatuar mungesën e legjitimitetit aktiv ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes civile.

Për këtë çështje konstatohet se janë zhvilluar 18 seanca. Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë 07.07.2021 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës, 02.04.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 2 vite e 8 muaj e 26 ditë. Në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave ndër të tjera konstatohet se 1 seancë është shtyrë për shkaqe që lidhen me paditësin; 5 seanca të shtyra për shkak të mungesës së gjyqtarit; 4 seanca për shkaqe shëndetësore dhe 1 seancë për pjesëmarrje në trajnim.

Për gjyqtarin e parë: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 12 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 7 muaj e 15 ditë. Për gjyqtarin e dytë: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 2 muaj e 1 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 3 muaj e 20 ditë.

3. Çështja nr. 21246-01255-23-2021 me objekt "Pavlefshmëri vendimi"

Kërkesë padia është paraqitur në gjykatë në datë 14.12.2021, regjistruar në këtë të fundit dhe po në datën 14.12.2021 është shortuar. Kjo çështje është shortuar dy herë përkatësisht: shorti i parë – 14.12.2021; shorti i dytë – 20.03.2023.

Seanca e parë është caktuar pas 6 ditë nga data e hedhjes së shortit.

Seanca e parë pas rishortimit është caktuar pas 10 muaj e 11 ditë nga data e hedhjes së shortit.

Nga ana e gjyqtarit të çështjes janë kryer këto veprime procedurale si më poshtë:

1. **Seanca e datës 20.12.2021**, në të cilën gjykata ka marrë në shqyrtim kërkesën për marrje mase sigurimi në dhomë këshillimi pa praninë e palëve. Po në këtë datë gjykata shpall vendimin për këtë kërkesë. (6 muaj e 2 ditë).
 2. **Seanca e datës 22.06.2022**, në këtë seancë gjykata pasi bën verifikimin e prezencës së palëve konstaton se nuk janë paraqitur palët. Gjykata ka relatuar se avokatët mungojnë për shkak të bojkotit të seancave. Në vijim seanca është shtyrë për në datën 12.10.2022. (3 muaj e 20 ditë).
 3. **Seanca e datës 12.10.2022**, nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye shëndetësore. Seanca e radhës është caktuar për t'u zhvilluar në datë 14.12.2022 (2 muaj e 2 ditë).
 4. **Seanca e datës 14.12.2022**, nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit i cili ndodhej në seminar trajnimi. Seanca e radhës është planifikuar për t'u zhvilluar në datë 30.01.2023 (1 muaj e 16 ditë).
 5. **Seanca e datës 30.01.2023**, nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye shëndetësore. Seanca e radhës është planifikuar për t'u zhvilluar në datë 09.02.2023 (10 ditë).
 6. **Seanca e datës 09.02.2023**. Në këtë seancë pas verifikimit të palëve, gjykata ka konstatuar se përfaqësuesi i palës paditëse nuk është paraqitur për shkak të prezencës së tij në një tjetër gjykim. Seanca e radhës është caktuar për t'u zhvilluar në datë 27.04.2023
- **Çështja është rishortuar në datë 20.03.2023**

7. **Seanca e datës 31.01.2024.** Në këtë seancë gjykata ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse ndërsa palët e paditura nuk janë paraqitur pjesërisht për shkak të padijenisë dhe një pjesë nuk janë paraqitur edhe pse kanë pasur dijeni për seancën. Gjykata ka vijuar gjykimin në mungesë për palët e paditura që kanë marrë dijeni dhe urdhëron të sillen dëshmia e trashëgimisë për të paditurin që ka ndërruar jetë. Ndërsa për të paditurit për të cilët nuk është konfirmuar dijenia, të përsëriten njoftimet. Në vijim, në funksion të çeljes së dëshmisë së trashëgimisë, gjykata ka shtyrë seancën për në datën 03.04.2024. (2 muaj e 3 ditë)
8. **Seanca e datës 03.04.2024.** Në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se pala paditëse ka depozituar kërkesë për shtyrje me pretendimin se ndodhen jashtë shtetit, ndërsa palët e tjera nuk janë paraqitur. Gjykata ka relatuar se nuk janë plotësuar të metat duke vendosur kështu me pushimin e çështjes.

Për këtë çështje konstatohet se janë zhvilluar 8 seanca. Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë, 14.12.2021 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës, 03.04.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 2 vite, 3 muaj e 20 ditë. Në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave ndër të tjera konstatohet se 1 seancë e shtyrë për shkak të bojkotit të avokatëve; 1 seancë e shtyrë për shkak të paditësit; 3 seanca të shtyra për shkak të mungesës së gjyqtarit; 2 për shkaqe shëndetësore dhe 1 seancë për pjesëmarrje në trajnim.

Distanca kohore ndërmjet seancave:

Për gjyqtarin e parë; Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 10 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 6 muaj e 2 ditë Për gjyqtarin e dytë; Ka caktuar vetëm dy seanca me një diferencë kohore prej 2 muaj e 3 ditë.

4. Çështja nr. 21262-00197-23-2022 me objekt "Pavlefshmëri kontrate"

Kërkesë padia është paraqitur në gjykatë në datë 15.02.2022, është regjistruar në këtë të fundit dhe po në datën 15.02.2022 është shortuar.

Kjo çështje është shortuar dy herë përkatësisht: shorti i parë – 15.02.2022; shorti i dytë – 20.03.2023.

Seanca e parë është caktuar pas 7 muaj 21 ditë nga data e hedhjes së shortit.

Seanca e parë pas rishortimit është caktuar pas 6 muaj e 21 ditë nga data e hedhjes së shortit.

Nga ana e gjykatës janë kryer këto veprime procedurale si më poshtë:

1. **Seanca e datës 06.10.2022,** në të cilën gjykata pas verifikimit të prezencës së palëve, ka konstatuar se është paraqitur përfaqësuesi i palës paditëse dhe se janë paraqitur disa nga palët e paditura. Gjykata i lë kohë palës paditëse të paraqesë prokurën për përfaqësuesin. Për të njoftuar palët për të cilët nuk është konfirmuar marrja dijeni gjykata ka shtyrë seancën për në datën 14.12.2022. (2 muaj e 8 ditë)

2. **Seanca e datës 14.12.2022.** kjo seancë nuk është zhvilluar pasi gjyqtari ndodhet në një seminar trajnimi. Në vijim seanca është shtyrë për në datën 20.02.2023. (2 muaj e 6 ditë)
3. **Seanca e datës 20.02.2023,** në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka legjitimuar përfaqësuesin e palës paditëse. Në vijim gjykata ka marrë vendim për zhvillimin e gjykimit në mungesë të palëve të paditura që kanë marrë dijeni dhe ka shtyrë seancën me qëllim përsëritjen e njoftimit për palët për të cilët nuk është konfirmuar dijenia. Seanca e radhës është caktuar për t'u zhvilluar në datë 23.05.2023.
- **Çështja u rishortua në datën 20.03.2023.**
4. **Seanca e datës 11.10.2023.** Në këtë seancë gjykata ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse përmes përfaqësuesit të tij. Janë paraqitur pjesërisht palët e paditura. Është relatuar ndryshimi i trupit gjykues dhe ka vijuar gjykimi në fazën e ngelur nga seanca e kaluar. Gjykimi i çështjes ka vijuar në mungesë të palëve që kanë marrë dijeni. Në vijim gjykata pasi administron aktet kalon çështjen në seancë gjyqësore. Seanca e radhës është planifikuar për t'u zhvilluar në datë 24.01.2024. (3 muaj e 13 ditë).
5. **Seanca gjyqësore e datës 24.01.2024.** Në këtë seancë është paraqitur paditësi, janë paraqitur pjesërisht palët e paditura. Në vijim gjykata ka konstatuar të pavlefshëm njoftimin për një nga të paditurit. Seanca e radhës është planifikuar për t'u zhvilluar në datë 06.03.2024 me qëllim përsëritjen e njoftimit. (1 muaj e 11 ditë).
6. **Seanca gjyqësore e datës 06.03.2024.** Në këtë seancë është paraqitur paditësi, janë paraqitur pjesërisht palët e paditura. Në këtë seancë për një nga palët e paditura gjykata ka vendosur të vijojë gjykimin në mungesë. Në vijim gjykata ka deklaruar të hapur shqyrtimin gjyqësor dhe ka ftuar palët të japin qëndrimin e tyre. Gjykata ka referuar kërkesën për marrje të provave të reja në gjykim me arsyetimin se çështja ka kaluar në seancë gjyqësore. Në vijim pasi ka marrë në administrim provat shkresore që janë lejuar ka deklaruar të mbyllur shqyrtimin gjyqësor. Në kushtet kur nga pala është paraqitur kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit seanca është shtyrë për në datë 27.03.2024 (21 ditë).
7. **Seanca gjyqësore e datës 27.03.2024.** Në këtë seancë është paraqitur paditësi, ndërsa përfaqësuesi i palës së paditur ka paraqitur një kërkesë për shtyrje. Gjykata ka relatuar pas konsultimit me sekretaren gjyqësore se nuk rezulton të jetë paraqitur kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit. Kërkesa për shtyrje e palës së paditur nuk është marrë në konsideratë. Në vijim gjykata ka marrë në administrim provat, ka deklaruar të mbyllur shqyrtimin gjyqësor dhe ka ftuar palët të japin konkluzionet përfundimtare. Seanca është shtyrë për në datën 04.04.2024. (8 ditë)
8. **Seanca gjyqësore e datës 04.04.2024,** shpallja e vendimit.

Për këtë çështje konstatohet se janë zhvilluar 8 seanca. Referuar datës së depozitimit të kërkespadiës, 15.02.2022 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës, 04.04.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 2 vite e 1 muaj e 20 ditë. Në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave ndër të tjera konstatohet 1 seancë e shtyrë për shkak të mungesës së paditësit; 1 seancë e shtyrë për shkak të mungesës së

gjqtarit për pjesëmarrje në trajnim; 2 seanca të shtyra për shkak të mungesës së palëve të paditura.

Për gjyqtarin e parë; Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 2 muaj e 6 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 7 muaj e 21 ditë.

Për gjyqtarin e dytë; Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 8 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 3 muaj e 13 ditë.

5. Çështja nr. 21246-00742-23-2021 me objekt “Njohje dhe kthim prone”

Kërkesë padia është paraqitur në gjykatë në datë 09.09.2021, është regjistruar në datën 09.09.2021 si dhe është shortuar po në këtë datë. Kjo çështje në vijim është shortuar tre herë përkatësisht: shorti i parë- 09.09.2021; shorti i dytë- 20.03.2023; shorti i tretë – 26.10.2023.

Seanca e parë është caktuar pas 5 muaj e 7 ditë nga data e hedhjes së shortit.

Seanca e parë pas rishortimit të parë është caktuar pas 6 muaj nga data e hedhjes së shortit.

Seanca e parë pas rishortimit të dytë është caktuar pas 5 muaj e 1 ditë nga data e hedhjes së shortit.

Nga ana e gjykatës janë kryer këto veprime procedurale si më poshtë:

- 1. Seanca e datës 16.02.2022.** Në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur përfaqësuesi i palës paditëse, rezulton të mos jenë paraqitur palët e paditura të cilat kanë dijeni dhe nuk janë paraqitur. Gjykata ka marrë vendim për të zhvilluar gjykimin në mungesë të palëve të paditura. Në vijim është caktuar ekspert për çështjen dhe seanca e radhës është planifikuar për në datën 20.04.2022. (2 muaj e 4 ditë)
- 2. Seanca e datës 20.04.2022.** kjo seancë nuk është zhvilluar pasi gjyqtari ka munguar për arsye shëndetësore. Seanca është shtyrë për në datën 26.05.2022. (1 muaj e 6 ditë)
- 3. Seanca e datës 26.05.2022,** Në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka relatuar kërkesën e ekspertit për shtyrje të seancës e cila është pranuar. Seanca e radhës është caktuar për t’u zhvilluar në datë 28.09.2022. (4 muaj e 2 ditë)
- 4. Seanca e datës 28.09.2022.** Në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka vijuar me gjykimin në mungesë të palëve të paditura (palët që kanë pasur dijeni për seancën). Është paraqitur eksperti të cilit i janë caktuar detyrat. Seanca e radhës është caktuar për t’u zhvilluar në datë 14.12.2022 me qëllim lënien kohë ekspertit për realizuar aktin e ekspertimit. (2 muaj e 16 ditë)
- 5. Seanca e datës 14.12.2022.** kjo seancë nuk është zhvilluar pasi gjyqtari ndodhet në një seminar trajnimi. Në vijim seanca është shtyrë për në datën 30.01.2023. (1 muaj e 16 ditë)
- 6. Seanca e datës 06.02.2023.** kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së ekspertit dhe mosdorëzimit të aktit nga ana e tij. Në vijim seanca është shtyrë për në datën 04.05.2023.

- Çështja u rishortua në datën 20.03.2023.
- 7. Seanca e datës 20.09.2023, kjo seancë nuk është zhvilluar pasi gjyqtari ka munguar për arsye shëndetësore. Seanca është shtyrë për në datën 26.05.2022. (2 muaj e 6 ditë)
- Çështja u rishortua në datën 26.10.2023.
- 8. Seanca gjyqësore e datës 27.03.2024, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve, ka konstatuar se nuk është paraqitur pala paditëse edhe pse kishte dijeni për seancën. Në vijim gjykata ka marrë vendimin për pushimin e gjykimit.

Për këtë çështje konstatohet se janë zhvilluar 8 seanca. Referuar datës së depozitimit të kërkespadsisë, 15.02.2022 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës, 04.04.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 2 vite, 1 muaj e 20 ditë.

Në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave ndër të tjera konstatohen 3 seanca të shtyrë për shkak të mungesës së gjyqtarit 1 për pjesëmarrje në trajnim dhe 2 për shkaqe shëndetësore; 2 seanca të shtyra për shkak të procedurave që kanë të bëjnë me aktin e ekspertimit.

Distanca kohore ndërmjet seancave:

Për gjyqtarin e I-rë; Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 2 muaj e 4 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 7 muaj e 14 ditë.

Për gjyqtarin e 2-të; Eshtë zhvilluar vetëm një seancë.

Për gjyqtarin e 3-të; Eshtë zhvilluar vetëm një seancë

6. Çështja nr. 11112-01209-23-2021 me objekt "Pjesëtim i sendit në bashkëpronësi"

Kërkesë padia është paraqitur në gjykatë në datë 02.12.2021, është regjistruar në datë 02.12.2021 si dhe është shortuar brenda kësaj date.

Kjo çështje është shortuar dy herë përkatësisht: shorti i parë – 02.12.2021; shorti i dytë – 26.10.2023.

Seanca e parë është caktuar pas 3 muaj e 5 ditë nga data e hedhjes së shortit.

Seanca e parë pas rishortimit është caktuar pas 3 muaj e 14 ditë nga data e hedhjes së rishortimit.

Nga ana e gjykatës janë kryer këto veprimet procedurale si më poshtë:

1. Seanca e datës 07.03.2022, në të cilën gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse, ndërsa pala e paditur dhe personi i tretë edhe pse kanë marrë dijeni nuk janë paraqitur. Gjykata ka vijuar seancën në mungesë të këtyre të fundit, si dhe ka marrë vendim për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore. Seanca e radhës është planifikuar në datë 20.04.2022 (1 muaj e 13 ditë)

2. **Seanca gjyqësore datë 20.04.2022.** Gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka lejuar për shqyrtim provat, në vijim i ka administruar ato si dhe ka deklaruar të mbyllur shqyrtimin gjyqësor. Gjykata është tërhequr në dhomë këshillimi dhe në vijim ka shpallur vendimin lidhur me fazën e parë të pjesëtimit.³³ Gjykata pyet palët nëse do ushtrojnë ankim. Palët janë përgjigjur “jo”. Gjykata ka vijuar me sqarim. (8 muaj)
 3. **Seanca gjyqësore e datës 20.12.2022,** në të cilën gjykata pas verifikimit të prezencës së palëve ka konstatuar se është paraqitur përfaqësuesi i palës paditëse, nuk është paraqitur pala e paditur edhe pse ka marrë dijeni. Ka vijuar gjykimi në mungesë të palës së paditur. Gjykata ka relatuar se vendimi i pjesëtimit ka marrë formë të prerë dhe vijuar me fazën e dytë të pjesëtimit, ka caktuar ekspert dhe ka shtyrë seancën në datë 01.02.2023. (1 muaj e 12 ditë)
 4. **Seanca gjyqësore e datës 01.02.2023,** gjatë kësaj seance është paraqitur eksperti, gjykata i ka lënë detyrat dhe ka shtyrë seancën në datë 21.03.2023. (1 muaj e 20 ditë)
 5. **Seanca gjyqësore e datës 21.03.2023** nuk është zhvilluar për shkak se gjyqtari ka qenë në trajnim në Shkollën e Magjistraturës. Seanca e radhës është planifikuar në datë 19.04.2023.(29 ditë)
 6. **Seanca gjyqësore e datës 19.04.2023,** gjykata ka relatuar se është depozituar akti i ekspertimit dhe është shtyrë seanca me qëllim që palët të njihen me aktin e ekspertimit. Seanca e radhës është planifikuar në datë 30.05.2023. (1 muaj e 11 ditë)
 7. **Seanca gjyqësore e datës 30.05.2023** është shtyrë me kërkesë të palës paditëse. Seanca e radhës është planifikuar në datë 12.09.2023.(3 muaj e 13 ditë)
 8. **Seanca gjyqësore e datës 12.09.2023.** Kjo seancë nuk është zhvilluar pasi mungon gjyqtarja për arsye shëndetësore. Seanca e radhës është planifikuar në datë 05.10.2023. (23 ditë)
 9. **Seanca gjyqësore e datës 05.10.2023** nuk është zhvilluar pasi gjyqtari është në një takim në KLGJ. Seanca e radhës është planifikuar në datë 01.11.2023.
- **Çështja është rishortuar në datë 26.10.2023**
10. **Seanca gjyqësore e datës 09.02.2024,** gjykata verifikon prezencën e palëve, ka deklaruar gjykimin në mungesë të palëve të paditura si dhe ka konstatuar se eksperti nuk është paraqitur. Gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës me qëllim paraqitjen e ekspertit për në datë 08.03.2024 (28 ditë)
 11. **Seanca gjyqësore e datës 08.03.2024,** kjo seancë nuk është zhvilluar sepse ka munguar gjyqtari për arsye shëndetësore. Seanca e radhës është planifikuar në datë 08.04.2024. (1 muaj)
 12. **Seanca gjyqësore e datës 08.04.2024,** gjyqtarja pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se nuk është paraqitur përfaqësuesi i palës paditëse edhe pse

³³ Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Gjzkatën e Apelit Gjirokastër brenda 5 ditëve, afat që fillon të llogaritet nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

ka pasur dijeni për seancën. Në vijim gjykata ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes.

Për këtë çështje konstatohet se janë zhvilluar 12 seanca. Referuar datës së depozitimit të kërkespadi së 02.12.2021, dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës 08.04.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 2 vite, 4 muaj e 6 ditë.

Në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave ndër të tjera konstatohen 3 seanca të shtyra për shkaqe që lidhen me ekspertin dhe aktin e ekspertimit; 4 seanca të shtyra për shkak të mungesës së gjyqtarit, 1 seancë për pjesëmarrje në trajnim, 2 seanca për shkaqe shëndetësore dhe 1 seancë për shkaqe të tjera; 1 seancë e shtyrë për shkak të paditësit.

Diferenca kohore ndërmjet seancave:

Për gjyqtarin e I-rë; Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 27 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 3 muajsh e 13 ditë.

Ndërsa distanca nga seanca e shpalljes së vendimit për fazën e parë të pjesëtimit deri në seancën e parë të fazës e dytë të gjykimit, është 8 muaj.

Për gjyqtarin e 2-të; Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 28 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 1 muaj.

7.Çështja nr. 21321-00016-23-2022 “Deklarim në pavërtetë dhe të fallsifikuar të akt testamentit, detyrim njohje trashëgimtarë ligjorë”

Kjo çështje është relatuar me detaje tek pika 5.4 e këtij raporti (shkaqet e zgjatjes së proceseve duke ju referuar llojit të objektit të padisë) .

Në mënyrë të përmbledhur konstatohet se për këtë çështje janë zhvilluar 6 seanca. Referuar datës së depozitimit të kërkespadi së 06.01.2022 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës 11.04.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 2 vjet, 3 muaj e 5 ditë.

Në lidhje me shkakun e shtyrjes së seancave konstatohet ndër të tjera 1 seancë e shtyrë për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye trajnimi; 4 seanca të shtyra për shkak të mungesës së palës së paditur.

Distanca kohore ndërmjet seancave:


Për gjyqtarin e parë: Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 7 muaj e 18 ditë; Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 2 muaj e 3 ditë.

Për gjyqtarin e dytë: Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 4 muaj e 16 ditë; Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 1 muaj e 23 ditë.

8.Çështja nr. 21256-00209-23-2020 “pushim cenimi në posedim”

Kjo çështje është relatuar me detaje tek pika 5.4 e këtij raporti (shkaqet e zgjatjes së proceseve duke ju referuar llojit të objektit të padisë) .

Në mënyrë të përmbledhur konstatohet se për këtë çështje gjykata ka zhvilluar gjithsej 19 seanca. Referuar datës së depozitimit të kërkespadi së 06.02.2020 dhe datës së



vendimmarrjes së gjykatës 12.04.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 4 vite 2 muaj e 6 ditë.

Kërkesa për sigurim padie është shqyrtuar dhe është marrë vendim brenda afatit ligjor. Konstatohet ndër të tjera se 5 seanca janë të shtyra për shkaqe që kanë të bëjnë me procedurat që lidhen me aktin e ekspertimit dhe ekspertin; 3 seanca të shtyra për shkak të mungesës së gjyqtarit (2 seanca për shkaqe shëndetësore dhe 1 seancë për shkak të pjesëmarrjes në trajnim); 3 seanca të shtyra për shkak të palës paditëse; 1 seancë e shtyrë për shkak të bojkotit të avokatëve.

Distanca kohore ndërmjet seancave:

Për gjyqtarin e parë: Distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është 1 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga seanca në seancë është 5 muaj e 11 ditë.

Për gjyqtarin e dytë: Distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është 11 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga seanca në seancë është 1 muaj e 11 ditë.

Çështja është pezulluar dy herë përkatësisht nga data: 13.10.2021-09.02.2022 dhe 21.09.2022 – 02.02.2024.

9.Çështja nr. 11115-00952-23-2021 me objekt “lirim dorëzim sendi”

Kërkesë padia është paraqitur në gjykatë në datë 12.10.2021, është regjistruar në këtë të fundit dhe në datën 12.10.2021.

Kjo çështje është shortuar dy herë përkatësisht: shorti i parë – 12.10.2021; shorti i dytë – 20.03.2023.

Seanca e parë është caktuar pas 4 muaj e 4 ditë nga data e hedhjes së shortit.

Seanca e parë pas rishortimit është caktuar pas 10 muaj e 3 ditë nga data e hedhjes së shortit.

Nga ana e gjyqtarit të çështjes janë kryer këto veprime procedurale si më poshtë:

- 1. Seanca e datës 16.02.2022**, në të cilën gjykata pas verifikimit të prezencës së palëve, ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse dhe pala e paditur për të cilët gjykata me vendim legjitimon përfaqësuesit e tyre. Në vijim gjykata shpall trupin gjykues dhe ka ftuar palët të japin prapësimet lidhur me çështjen. Për depozitimin e provave si nga pala paditëse ashtu edhe nga pala e paditur, gjykata ka shtyrë seancën për në datën 21.04.2022. (2 muaj e 5 ditë)
- 2. Seanca e datës 21.04.2022**, Në këtë seancë gjykata pasi verifikon prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse, nuk është paraqitur pala e paditur për të cilin gjykata ka marrë vendimin e gjykimit në mungesë. Në vijim gjykata ka vlerësuar të caktojë një ekspert i cili disponon njohuri të posaçme rreth objektit të padisë. Për të njoftuar ekspertin seanca është shtyrë për në datën 08.06.2022. (1 muaj e 18 ditë).
- 3. Seanca e datës 08.06.2023**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse, nuk është paraqitur pala e paditur e cila ka depozituar kërkesë për shtyrje. Në vijim gjykata ka pranuar kërkesën për shtyrje dhe ka shtyrë seancën për në datën 26.09.2022 (3 muaj e 18 ditë).

4. **Seanca e datës 26.09.2022**, në këtë seancë, gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar prezencën e palës paditëse, dhe palës së paditur. Është paraqitur eksperti i cili pasi ka lexuar formulën e betimit ka marrë detyrat. Gjykata ka marrë vendim për të kaluar çështjen në seancë gjyqësore si dhe provat që do të marrë në gjykim. Në vijim gjykata planifikon seancën e radhës për në datën 21.11.2022 (1 muaj e 26 ditë).
5. **Seanca gjyqësore e datës 21.11.2022**, në të cilën gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar prezencën e palëve të cilët kanë kërkuar kohë për të zgjidhur çështjen me pajtim. Për t'i dhënë kohë palëve për zgjidhjen e çështjes me pajtim, gjykata ka shtyrë seancën për në datën 27.02.2023. (2 muaj e 6 ditë)
6. **Seanca gjyqësore e datës 27.02.2023**, në të cilën gjykata pasi verifikon prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse dhe përfaqësuesi, nuk është paraqitur pala e paditur por është paraqitur përfaqësuesi i tij. Gjykata ka marrë vendim për të lejuar marrjen në shqyrtim të provave. Në vijim, për të njoftuar palën e paditur gjykata ka shtyrë seancën për në datën 05.04.2023.
- **Çështja u rishortua në datën 20.03.2023.**
7. **Seanca gjyqësore e datës 23.01.2024**, në këtë seancë gjykata ka relatuar ndryshimin e trupit gjykues, revokon vendimin e fillimit të çështjes nga e para dhe vazhdon në seancën gjyqësore. Pasi verifikon prezencën e palëve gjykata ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse si dhe legjitimon përfaqësuesin e saj si dhe ka konstatuar prezencën e palës së paditur. Për të njoftuar përfaqësuesin e të paditurit seanca është shtyrë për në datën 16.04.2024.(2 muaj e 24 ditë)
8. **Seanca gjyqësore e datës 16.04.2024**, Në këtë seancë, gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve, ka konstatuar se nuk janë paraqitur palët ndërgjyqëse. Gjykata ka relatuar se përfaqësuesi i palës paditëse ka paraqitur kërkesë për pushimin e gjykimin të çështjes. Në vijim gjykata ka vendosur pushimin e gjykimin të çështjes.

Për këtë çështje konstatohet se janë zhvilluar 8 seanca. Referuar datës së depozitimit të kërkespadsisë, 12.10.2021 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës, 16.04.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 2 vite, 6 muaj e 4 ditë.

Në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave ndër të tjera konstatohen 2 seanca te shtyra për shkaqe që lidhen me të paditurin; 1 seancë e shtyrë për shkaqe që lidhen me palën paditëse; 1 seancë e shtyrë për shkaqe që ka të bëjë me ekspertin dhe aktin e ekspertimit.

Distancat kohore ndërmjet seancave:

Për gjyqtarin e parë; Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 1 muaj e 18 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 7 muaj e 21 ditë.

Për gjyqtarin e dytë; Distanca nga njëra seancë në tjetrën është 2 muaj e 24 ditë.

10.Çështja nr. 21269-00102-23-2022 me objekt “detyrim njohje bashkëpronar”

Kërkesë padia është paraqitur në gjykatë në datë 25.01.2022, është regjistruar në këtë të fundit dhe në datën 25.01.2022. Kjo çështje është shortuar dy herë përkatësisht: shorti i parë – 25.01.2022; shorti i dytë – 20.03.2023.

Seanca e parë është caktuar pas 2 muaj e 13 ditë nga data e hedhjes së shortit.

Seanca e parë pas rishortimit është caktuar pas 9 muaj nga data e hedhjes së shortit.

Nga ana e gjyqtarit të çështjes janë kryer këto veprime procedurale si më poshtë:

1. **Seanca e datës 07.04.2022**, seanca nuk është zhvilluar pasi gjyqtari nuk është paraqitur për arsye shëndetësore. Seanca është shtyrë për në datën 04.05.2022. (27 ditë)
2. **Seanca e datës 04.05.2022**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse dhe palët e paditura. Gjykata ka marrë vendim për legjitimimin e përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse. Në vijim gjykata ka shtyrë seancën për në datën 06.06.2022 me qëllim njoftimin e njërës nga palët e paditura. (1 muaj e 2 ditë)
3. **Seanca e datës 06.06.2022**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur paditësi dhe përfaqësuesi i tij. Nuk janë paraqitur palët e paditura edhe pse kanë marrë dijeni. Gjykata ka marrë vendim për vazhdimin e gjykimit në mungesë për palët e paditura, ndërkohë paraqitet përfaqësuesi i njërës prej palëve të paditura e për këtë shkak gjykata revokon vendimin e gjykimit në mungesë për këtë palë. Gjykata vendos të shtyjë seancën për në datën 14.07.2022 me qëllim paraqitjen personalisht të palës së paditur (1 muaj e 8 ditë).
4. **Seanca e datës 14.07.2022**, kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të bojkotit të avokatëve. Seanca është shtyrë për në datën 26.10.2022. (3 muaj e 12 ditë)
5. **Seanca e datës 26.10.2022**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse dhe përfaqësuesi i saj. Nuk janë paraqitur palët e paditura. Relatohet se përfaqësuesi i një prej palëve të paditura ndodhet në një gjykim tjetër. Me kërkesë të palës paditëse vazhdon gjykimi në mungesë. Gjykata ka marrë vendim për kalim të çështjes në seancë gjyqësore, dhe ka caktuar seancën e radhës në datën 17.01.2023.(2 muaj e 22 ditë)
6. **Seanca gjyqësore e datës 17.01.2023**, në këtë seancë pasi është verifikuar prezenca e palëve, është konstatuar prezenca e palës paditëse dhe përfaqësuesit të saj. Për njërën prej palëve të paditura gjykata vendos përsëritjen e njoftimit edhe përmes telefonit, ndërsa për palën tjetër të paditur ka vazhduar gjykimin në mungesë. Për këto shkaqe gjykata ka shtyrë seancën në datën 03.04.2023.

- **Çështja u rishortua në datën 20.03.2023**

7. **Seanca gjyqësore e datën 20.12.2023**, Në këtë seancë rezulton se është kërkuar nga pala paditëse shtyrja e seancës për shkak të mungesës së përfaqësuesit të tij për

shkaqe shëndetësore. Në vijim gjykata ka pranuar kërkesën dhe ka shtyrë seancën për në datën 20.02.2024. (2 muaj)

8. **Seanca gjyqësore e datës 20.02.2024**, në këtë seancë pasi është bërë verifikimi i prezencës së palës, ka rezultuar se për një prej palëve të paditura është kthyer fletëthirrja me shënimin “larguar”. Me qëllim njoftimin e palës me shpallje publike, seanca është shtyrë për në datën 26.03.2024 (1 muaj e 6 ditë).
9. **Seanca gjyqësore e datës 26.03.2024**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse dhe përfaqësuesi i tij, nuk është paraqitur një prej palëve të paditura edhe pse ka pasur dijeni nga seanca e kaluar si edhe për palën e paditur që është proceduar me shpallje ka vijuar gjykimi në mungesë pasi nuk është paraqitur. Pasi është relatuar kërkesë padia dhe janë administruar provat është kërkuar kohë nga pala paditëse për paraqitjen e diskutimeve përfundimtare. Në vijim gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datën 02.04.2024. (7 ditë)
10. **Seanca e datës 02.04.2024**, kjo seancë është zhvilluar në prezencë të palës paditëse dhe përfaqësuesit të saj. Pasi janë paraqitur konkluzionet përfundimtare me shkrim dhe janë administruar nga gjykata, është caktuar seanca e radhës për në datën 23.04.2024.(21 ditë)
11. **Seanca e datës 23.04.2024**, shpallja e vendimit.

Për këtë çështje konstatohet se janë zhvilluar 11 seanca. Referuar datës së depozitimit të kërkespadiës, 25.01.2022 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës, 03.04.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 2 vite, 2 muaj e 9 ditë.

Në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave ndër të tjera konstatohen 1 seancë e shtyrë për shkak të mungesës e gjyqtarit për shkaqe shëndetësore; 1 seancë e shtyrë për shkak të bojkotit të avokatëve; 2 seanca të shtyra për shkak të mungesës së palës së paditur; 1 seancë e shtyrë për shkak të mungesës së palës paditëse

Distancat kohore ndërmjet seancave:

Për gjyqtarin e parë; Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 27 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 3 muaj e 12 ditë.

Për gjyqtarin e dytë; Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 7 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 2 muaj.

11.Çështja nr. 21282-00319-23-2022 me objekt “Pavlefshmëri titulli”

Kërkesë padia është paraqitur në gjykatë në datë 25.03.2022, është regjistruar në këtë të fundit dhe në datën 25.03.2022 është shortuar.

Kjo çështje është shortuar dy herë përkatësisht: shorti i parë – 25.03.2022; shorti i dytë – 26.10.2023.

Seanca e parë është caktuar pas 5 ditë nga data e hedhjes së shortit të parë.

Seanca e parë pas rishortimit është caktuar pas 5 muaj e 29 ditë nga data e hedhjes së shortit.

Nga ana e gjykatës janë kryer këto veprimet procedurale si më poshtë:

1. **Seanca e datës 30.03.2022**, në këtë seancë rezulton që gjyqtari i çështjes të mos ketë evidentuar asnjë shënim (13 ditë)

2. **Seanca e datës 12.04.2022**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse së bashku me përfaqësuesin, është paraqitur pala e paditur. Gjykata pasi ka vlerësuar se ka shkak për heqje dorë ka paraqitur kërkesë e cila nuk është miratuar. Në vijim gjykata pasi ka dëgjuar pretendimet e palëve rreth kërkesës për sigurim padie është tërhequr për vendim dhe pasi kthehet, shpall vendimin.

- **Çështja është rishortuar në datën 26.10.2023**

3. **Seanca e datës 24.04.2024**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se nuk është paraqitur pala paditëse, nuk është paraqitur një nga palët e paditura, është paraqitur i padituri tjetër. Në vijim për shkak të mosparaqitjes së palëve, gjykata ka vendosur pushimin e gjykimit.

Çështja është shortuar dy herë përkatësisht: shorti i parë – 25.03.2022; shorti i dytë – 26.10.2023. Për këtë çështje konstatohet se janë zhvilluar 3 seanca. Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë, 25.01.2022 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës, 24.04.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 2 vite, 2 muaj e 30 ditë

12.Çështja nr. 11112-00250-23-2022 me objekt “Pjesëtim sendi”

Kërkesë padia është paraqitur në gjykatë në datë 03.03.2022, është regjistruar në këtë të fundit dhe është shortuar në datën 03.03.2022. Kjo çështje është shortuar dy herë përkatësisht: shorti i parë – 03.03.2022; shorti i dytë – 26.10.2023.

Seanca e parë është caktuar pas 3 muaj e 24 ditë nga data e hedhjes së shortit të parë.

Pas rishortimit seanca e parë është caktuar pas 6 muaj e 6 ditë nga data e hedhjes së shortit.

Nga ana e gjyqtarit të çështjes janë kryer këto veprime procedurale si më poshtë:

1. **Seanca e datës 27.06.2022**, në këtë seancë, gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse, janë paraqitur pjesërisht palët e paditura. Për palët e paditura të cilët kanë pasur dijeni dhe nuk janë paraqitur, është deklaruar mungesa. Në vijim gjykata ka deklaruar se një nga palët e paditura ka ndërruar jetë. Gjithashtu, gjykata ka relatuar se është paraqitur kërkesë për përjashtim gjyqtari si dhe kërkesë për heqje dorë të cilat nuk janë pranuar. Për ti lënë kohë palës për të paraqitur certifikatën e vdekjes, është shtyrë seanca për në datën 28.09.2022. (3 muaj e një ditë)

2. **Seanca e datës 28.09.2022**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse dhe personi i tretë. Gjykata ka relatuar se një nga të paditurit ka bërë kërkesë për shtyrje si dhe është relatuar gjithashtu se një tjetër i paditur ka ndërruar jetë përpara depozitimit të kërkesëpadisë në gjykatë. Për ti lënë kohë paditësit të rregullojë të metën e kërkesëpadisë gjykata ka shtyrë seancën për në datën 30.11.2022 (2 muaj e 2 ditë)

3. **Seanca e datës 30.11.2022**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse, palët e paditura janë në mungesë. Në vijim, me qëllim komunikimin e seancës së radhës trashëgimtarëve të një prej palëve të paditura që ka ndërruar jetë, gjykata ka shtyrë seancën për në datën 31.01.2023. (2 muaj e 1 ditë)
4. **Seanca e datës 31.01.2023**, kjo seancë nuk është zhvilluar pasi gjyqtarja ka qenë në trajnim. Seanca e radhës është caktuar në datën 20.03.2023 (1 muaj e 17 ditë).
5. **Seanca e datës 20.03.2023**, kjo seancë nuk është zhvilluar pasi gjyqtarja ka qenë në trajnim. Seanca e radhës është caktuar në datën 12.04.2023 (23 ditë).
6. **Seanca e datës 12.04.2023**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse, janë njoftuar por nuk janë paraqitur palët e paditura për të cilat ka vijuar gjykimi në mungesë, ndërsa për një prej palëve të paditura trashëgimtarët e të cilës janë njoftuar por ka ardhur letërthirrja “adresë e panjohur”, është vendosur njoftimi nëpërmjet shpalljes publike. Seanca e radhës është caktuar në datën 25.05.2023 (1 muaj e 13 ditë).
7. **Seanca e datës 25.05.2023**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse, ka vijuar gjykimi në mungesë për një pjesë të palëve të paditura. Paditësi ka paraqitur kërkesë për saktësim padie e cila është pranuar nga gjykata. Për t’u njoftuar palëve saktësimin e objektit të kërkesëpadisë dhe për të njoftuar palët e paditura dijenia e të cilëve nuk është konfirmuar, gjykata ka shtyrë seancën për në datën 11.07.2023 (1 muaj 16 ditë)
8. **Seanca e datës 11.07.2023**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse dhe personi i tretë, ka vijuar gjykimi në mungesë të palëve të paditura. Është relatuar kërkesë padia dhe është vendosur kalimi i çështjes në seancë gjyqësore . Gjykata ka shtyrë seancën për në datën 28.09.2023 (2 muaj e 17 ditë).
9. **Seanca e datës 28.09.2023**, në këtë seancë gjykata pasi ka konstatuar se nuk është paraqitur asnjë prej palëve ndërgjyqëse dhe ka vendosur shtyrjen e seancës për në datën 22.11.2023. (7 muaj e 4 ditë)

- **Çështja është rishortuar në datën 26.10.2023**

10. **Seanca gjyqësore e datës 02.05.2024**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se nuk është paraqitur pala paditëse e cila ka depozituar kërkesë për pushimin e gjykimit. Në vijim gjykata ka pushuar gjykimin.

Për këtë çështje konstatohet se janë zhvilluar 10 seanca. Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë, 03.03.2022 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës, 02.05.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 2 vite, 1 muaj e 29 ditë

Në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave ndër tjera konstatohen 2 seanca të shtyra për shkak të pjesëmarrjes në trajnim të gjyqtarit; 6 seanca të shtyra për shkak të mungesës së palëve të paditura; 1 seancë e shtyrë për shkak të palës paditëse.

Distanca kohore ndërmjet seancave:

Për gjyqtarin e parë; Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 23 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 7 muaj e 4 ditë.

Për gjyqtarin e dytë; Gjyqtari i dytë ka zhvilluar vetëm 1 seancë

13.Çështja nr. 11115-00062-23-2022 me objekt “Detyrim lirim dorëzim sipërfaqe trualli”

Kërkesë padia është paraqitur në gjykatë në datë 13.01.2022, është regjistruar në këtë të fundit dhe është shortuar në datën 13.01.2022. Kjo çështje është shortuar 1 herë. Seanca e parë është caktuar pas 3 muaj e 22 ditë nga data e hedhjes së shortit.

Nga ana e gjykatës janë kryer veprimet procedurale si më poshtë:

1. **Seanca e datës 05.05.2022**, kjo seancë është zhvilluar në prezencë të palës paditëse dhe përfaqësuesit i cili është legjitimuar nga gjykata. Pala e paditur ka paraqitur kërkesë për shtyrje e cila është pranuar nga gjykata. Në vijim gjykata ka planifikuar seancën e radhës në datën 01.06.2022.(27 ditë)
2. **Seanca e datës 01.06.2022**, në këtë seancë, gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se nuk është paraqitur përfaqësuesi i palës paditëse i cili ka paraqitur kërkesë për shtyrje. Është paraqitur përfaqësuesi i palës së paditur i cili është legjitimuar nga gjykata. Në vijim, për shkak të ngarkesës së gjykatës është shtyrë seanca për në datën 21.09.2022 (3 muaj e 20 ditë).
3. **Seanca e datës 21.09.2022**, në këtë seancë, gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur përfaqësuesi i palës paditëse. Nuk është paraqitur përfaqësuesi i palës së paditur i cili ka kërkuar shtyrjen e seancës. Në vijim, gjykata ka pranuar kërkesën dhe ka shtyrë seancën për në datën 02.11.2022. (1 muaj e 11 ditë)
4. **Seanca e datës 02.11.2022**, në këtë seancë, gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur me vonesë përfaqësuesi i palës paditëse, pasi ishte në një gjykim tjetër. Nuk është paraqitur përfaqësuesi i palës së paditur. Gjykata ka vlerësuar se për zgjidhjen e çështjes nevojiten njohuri të posaçme dhe për të thërritur ekspertin planifikon seancën e rradhës për në datën 05.12.2022 (1 muaj e 3 ditë).
5. **Seanca e datës 05.12.2022**, në këtë seancë, gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur përfaqësuesi i palës paditëse. Nuk është paraqitur përfaqësuesi i palës së paditur i cili ka kërkuar shtyrjen e seancës. Kërkesa për shtyrje e paraqitur nga përfaqësuesi i të paditurit nuk pranohet nga gjykata pasi nuk i është bashkëlidhur ndonjë dokument provues. Është paraqitur eksperti të cilit i caktohen detyra. Për t'i dhënë kohë palës së paditur të paraqesë kundërshtimet e veta, gjykata ka shtyrë seancën për në datën 08.02.2023 (2 muaj e 3 ditë).
6. **Seanca e datës 08.02.2023**, në këtë seancë, gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se nuk është paraqitur përfaqësuesi i palës paditëse, por është paraqitur asistentja e tij e cila ka kërkuar shtyrjen e seancës pasi avokati mungon për shkaqe shëndetësore. Është paraqitur eksperti dhe përfaqësuesi i palës së paditur. Kërkesa për shtyrje e paraqitur në seancë nga asistentja e përfaqësuesit të paditësit është pranuar nga gjykata e cila ka shtyrë seancën për në datën 23.03.2023 (1 muaj e 15 ditë).

7. **Seanca e datës 23.03.2023**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se janë paraqitur palët ndërgjyqëse, por nuk është paraqitur eksperti (nuk identifikohet shkaku i mosparaqitjes së ekspertit). Për të njoftuar ekspertin gjykata ka shtyrë seancën për në datën 02.05.2023 (1 muaj e 9 ditë).
8. **Seanca e datës 02.05.2023**, kjo seancë nuk është zhvilluar pasi gjyqtari mungon për arsye shëndetësore. Seanca është shtyrë për në datën 13.06.2023. (1 muaj e 11 ditë)
9. **Seanca e datës 13.06.2023**, në këtë seancë, gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur përfaqësuesi i palës paditëse. Nuk është paraqitur përfaqësuesi i palës së paditur i cili ka paraqitur kërkesë për shtyrje. Nuk është paraqitur eksperti i cili gjithashtu ka paraqitur kërkesë për shtyrje. Pranohet kërkesa dhe me qëllim njoftimin e ekspertit dhe palës së paditur, është shtyrë seanca për në datën 27.09.2023 (3 muaj e 14 ditë).
10. **Seanca e datës 27.09.2023**, kjo seancë nuk është zhvilluar pasi gjyqtari mungon për arsye shëndetësore. Seanca është shtyrë për në datën 08.11.2023.(1 muaj e 12 ditë)
11. **Seanca e datës 08.11.2023**, në këtë seancë pasi u verifikua prezenca e palëve u konstatua se nuk është paraqitur përfaqësuesi i palës paditëse, përfaqësuesi i palës së paditur ka paraqitur kërkesë për shtyrje. Rezulton të mos jetë paraqitur eksperti (nuk citohet shkaku për mosparaqitje të ekspertit). Për të njoftuar personalisht paditësin, është shtyrë seanca për në datën 13.02.2024 (3 muaj e 5 ditë).
12. **Seanca e datës 13.02.2024**, në këtë seancë pasi u verifikua prezenca e palëve u konstatua se nuk është paraqitur përfaqësuesi i palës paditëse, por është paraqitur asistentja e tij e cila bën me dije se avokati ndodhet jashtë shtetit. Janë paraqitur përfaqësuesi i palës së paditur dhe eksperti. Seanca është shtyrë me qëllim njoftimin e paditësit për në datën 03.04.2024 (1 muaj e 24 ditë).
13. **Seanca e datës 03.04.2024**, seanca u zhvillua në prani të ekspertit dhe palëve ndërgjyqëse të cilat u pyetën për qëndrimin lidhur me aktin e ekspertimit. Gjykata urdhëron kalimin në seancë gjyqësore si dhe lejon marrjen në shqyrtim të provave. Seanca është shtyrë për në datën 30.04.2024 (27 ditë).
14. **Seanca gjyqësore e datës 30.04.2024**, kjo seancë është zhvilluar në prezencë të palëve ndërgjyqëse dhe të ekspertit i cili ka relatuar aktin e ekspertimit. Gjykata lejon shqyrtimin e provave shkresore të depozituara dhe i jep fjalën palëve ndërgjyqëse. Në vijim gjykata vendos të administrojë të gjitha provat shkresore dhe ka deklaruar të mbyllur shqyrtimin gjyqësor. Për t'i dhënë palëve kohë të japin konkluzionet përfundimtare, është shtyrë seanca për në datën 07.05.2024 (7 ditë).
15. **Seanca gjyqësore e datës 07.05.2024**, në këtë seancë pasi verifikohet prezenca e palëve konstatohet se nuk është paraqitur paditësi dhe as përfaqësuesi i tij. Përfaqësuesi i palës së paditur, ka kërkuar pushimin e gjykimit të çështjes. Në vijim gjykata vendos pushimin e gjykimit të çështjes.

Për këtë çështje konstatohet se janë zhvilluar 15 seanca. Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë, 13.01.2022 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës, 07.05.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 2 vjet, 3 muaj e 24 ditë



Në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave ndër të tjera konstatohen 3 seanca të shtyra për shkak të procedurave që kanë të bëjnë me ekspertin; 2 seanca të shtyra për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye shëndetësore; 3 seanca të shtyra për shkak të mungesës së palës së paditur; 5 seanca të shtyra për shkak të palës paditëse
Distanca kohore ndërmjet seancave:

Distanca më e shkurtër nga seanca në seancë është 7 ditë

Distanca më e gjatë nga seanca në seancë është 3 muaj e 20 ditë

14. Çështja me nr. 11115-00305-23-2021 me objekt "Lirim dorëzim sendi"

Kjo çështje është relatuar me detaje tek pika 5.4 e këtij raporti (shkaqet e zgjatjes së proceseve duke ju referuar llojit të objektit të padis) .

Në mënyrë të përmbledhur konstatohet se për këtë çështje gjykata ka zhvilluar 16 seanca. Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë, dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës 06.06.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 3 vjet, 1 muaj e 22 ditë.

Në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave konstatohet ndër të tjera se për mungesë të gjykatës (për arsye shëndetësore) janë shtyrë 2 seanca; rezultojnë 4 seanca të shtyra për shkak të mungesës së palës së paditur; 4 seanca të shtyra për shkaqe që lidhen me ekspertin dhe aktin e ekspertimit dhe një seancë e shtyrë për shkak të bojkotit të avokatëve.

Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 7 muaj e 18 ditë; Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 2 muaj e 3 ditë.

15. Çështja nr. 21283-00922-23-2020 me objekt "përmbushje detyrimi"

Kërkesë padia është paraqitur në gjykatë në datë 22.10.2020, është regjistruar në këtë të fundit dhe është shortuar në datën 22.10.2020.

Seanca e parë pas shortit është caktuar pas 3 muaj e 12 ditë nga hedhja e shortit.

Nga ana e gjykatës janë kryer këto veprime procedurale si më poshtë:

1. **Seanca e datës 03.02.2021**, kjo seancë ka vijuar në prezencë të përfaqësuesit të palës paditëse, në mungesë të një prej palëve të paditura. Një nga palët e paditura ka kërkuar pezullimin e gjykimit për shkak të shpalljes së një vendimi gjyqësor të Gjykatës së Apelit, vendim i cili ka lidhje me këtë proces për sa i përket veprimtarisë së ekspertit. Nga ana e gjykatës është kërkuar që kërkesa të paraqitet në formë shkresore. Gjykata ka vijuar me caktimin e ekspertit. Për të njoftuar ekspertin si dhe për vlerësimin në lidhje me proceset gjyqësore ku pala e paditur ka qenë prezent, seanca është shtyrë për në datën 03.03.2021 (1 muaj).
2. **Seanca e datës 03.03.2021**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur përfaqësuesi i palës paditëse, janë paraqitur pjesërisht palët e paditura ku për 2 prej të cilave ka vijuar gjykimi në mungesë. Pas verifikimit të bërë nga gjykata rezulton se është depozituar një padi tjetër për çështjen, e regjistruar në datën 15.09.2020. Pala e paditur ka kërkuar pezullimin e çështjes për shkak të ndarjes nga jeta të një prej të paditurve. Për ti lënë kohë palës

të depozitohet dëshminë e trashëgimisë, është shtyrë seanca për në datën 16.04.2021.(1 muaj e 13 ditë)

3. **Seanca e datës 16.04.2021**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse, palët e paditura janë në mungesë. Për ti lënë mundësi palës ti drejtohet zyrës noteriale për nxjerrjen e dëshmisë së trashëgimisë, seanca është shtyrë për në datën 19.05.2021 (1 muaj e 3 ditë).
4. **Seanca e datës 19.05.2021**, për ti njoftuar seancën e radhës trashëgimtarëve të palës së paditur për të cilën është paraqitur dëshmia e trashëgimisë, seanca është shtyrë për në datën 17.06.2021(29 ditë).
5. **Seanca e datës 17.06.2021**, kjo seancë është zhvilluar në prezencë të palës paditëse dhe përfaqësuesit të saj, si dhe në prezencë të palëve të paditura. Për trashëgimtarët ligjorë ka vijuar gjykimi në mungesë. Gjykata pasi ka konstatuar të meta në kërkesë padi, ka shtyrë seancën për në datën 14.07.2021 me qëllim rregullimin e të metës (27 ditë).
6. **Seanca e datës 14.07.2021**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse e cila ka paraqitur kërkesë për saktësim të objektit të kërkesëpadisë, kërkesë e cila është pranuar nga gjykata e me qëllim njoftimin e palëve në mungesë ka shtyrë seancën për në datën 06.10.2021 (2 muaj e 22 ditë).
7. **Seanca e datës 06.10.2021**, kjo seancë është shtyrë për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye shëndetësore. Seanca e radhës është caktuar në datën 05.11.2021 (30 ditë).
8. **Seanca e datës 05.11.2021**, në këtë seancë gjykata ka relatuar se pala e paditur ka paraqitur kërkesë për pezullim gjykimi, kërkesë e cila nuk është pranuar nga gjykata. Është caktuar ekspert dhe me qëllim njoftimin e tij është shtyrë seanca për në datën 15.12.2021 (1 muaj e 10 ditë).
9. **Seanca e datës 15.12.2021**, kjo seancë është shtyrë për shkak të mungesës së gjyqtarit për shkaqe shëndetësore. Seanca e radhës është caktuar në datën 03.02.2022 (1 muaj e 19 ditë).
10. **Seanca e datës 03.02.2022**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse dhe pjesërisht palët e paditura, ndër të cilat, për ato që kanë marrë njoftim, ka vijuar gjykimi në mungesë. Nuk është paraqitur ekspertja dhe me qëllim njoftimin e saj është shtyrë seanca për në datën 23.03.2022 (20 ditë).
11. **Seanca e datës 23.03.2022**, kjo seancë nuk është zhvilluar pasi mungonte gjyqtari për arsye familjare. Seanca e radhës u planifikua në datën 22.04.2022 (30 ditë).
12. **Seanca e datës 22.04.2022**, kjo seancë është zhvilluar në prani të përfaqësuesit të palës paditëse dhe ekspertit. Me qëllim caktimin e detyrave ekspertit, seanca është shtyrë për në datën 08.06.2022 (1 muaj e 17 ditë).
13. **Seanca e datës 08.06.2022**, kjo seancë është zhvilluar në prani të paditësit, përfaqësuesit të tij dhe ekspertit, nuk janë paraqitur palët e paditura. Pala paditëse ka paraqitur kërkesë për ndërrimin e ekspertit, kërkesë e cila nuk është pranuar nga gjykata. Pas administrimit të provave të paraqitura, gjykata planifikon seancën



e radhës në datën 14.07.2022 me qëllimin komunikimin e akteve palëve të paditura në mungesë (1 muaj e 6 ditë).

14. **Seanca e datës 14.07.2022**, kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të bojkotit të avokatëve. Seanca e radhës është caktuar në datën 20.10.2022 (3 muaj e 6 ditë).
15. **Seanca e datës 20.10.2022**, kjo seancë është zhvilluar në prani të palës paditëse dhe përfaqësuesit të tij dhe në mungesë të palëve të paditura dhe ekspertit. Me qëllim njoftimin e një prej palëve të paditura dhe ekspertit, seanca është shtyrë për në datë 23.11.2022 (1 muaj e 3 ditë).
16. **Seanca e datës 23.11.2022**, kjo seancë është zhvilluar në prani të përfaqësuesit të palës paditëse, dhe në mungesë pjesërisht të palëve të paditura. Për shkak të mungesës së akteve në dosje lidhur me një praktikë administrative është caktuar data 26.01.2023 për ti lënë kohë ekspertes të paraqesë aktin e ekspertimit (2 muaj e 3 ditë).
17. **Seanca e datës 26.01.2023**, kjo seancë është zhvilluar në prani të përfaqësuesit të palës paditëse, dhe palëve të paditura të cilat më herët kanë paraqitur kërkesë për pezullim e cila është rrëzuar nga gjykata. Për të njoftuar ekspertin është shtyrë seanca për në datën 02.03.2023 (1 muaj e 4 ditë).
18. **Seanca e datës 02.03.2023**, kjo seancë është zhvilluar në prani të paditësit dhe përfaqësuesit të tij, mungojnë pjesërisht palët e paditura. Është paraqitur ekspertja e cila ka bërë betimin dhe ka marrë detyrat mbi bazën e akteve të kërkuara dhe të depozituara. Për ti lënë kohë ekspertes të paraqesë aktin deri në datën 03.04.2023 gjykata vendos shtyrjen e seancës si dhe paraqitjen e palëve për të marrë aktin në datën 11.04.2023. Njoftimi i seancës së radhës do bëhet me fletëthirrje (8 muaj e 5 ditë).
19. **Seanca e datës 07.11.2023**, kjo seancë është zhvilluar në prani të përfaqësuesit të palës paditëse. Revokohet vendimi për mungesën e një prej palëve të paditura dhe vazhdon gjykimi në mungesë për palët e tjera të paditura. Kalohet në seancë gjyqësore e cila do të zhvillohet në datën 21.12.2023 (1 muaj e 14 ditë).
20. **Seanca gjyqësore e datës 21.12.2023**, kjo seancë është zhvilluar në prani të përfaqësuesit të palës paditëse dhe në mungesë të palëve të paditura. Gjykata ka relatuar se ekspertja ka paraqitur kërkesë për shtyrje e cila është pranuar nga gjykata. Seanca është shtyrë për në datën 27.02.2024 (2 muaj e 6 ditë).
21. **Seanca gjyqësore e datës 27.02.2024**, kjo seancë nuk është zhvilluar pasi gjyqtari ndodhet në KLGJ në cilësinë e zv/kryetarit të gjykatës. Seanca e radhës është caktuar në datën 16.04.2024 (1 muaj e 20 ditë).
22. **Seanca gjyqësore e datës 16.04.2024**, kjo seancë është zhvilluar në prani të paditësit dhe përfaqësuesit të tij, mungojnë pjesërisht palët e paditura. Kërkesa për shtyrje e depozituar nga ekspertja është pranuar nga gjykata. Seanca e radhës është caktuar në datën 07.05.2024 (21 ditë).
23. **Seanca gjyqësore e datës 07.05.2024**, seanca u zhvillua në prani të palës paditëse dhe palëve të paditura. Pasi është administruar akti i ekspertimit dhe janë administruar provat është mbyllur shqyrtimi gjyqësor dhe është shtyrë seanca për konkluzione përfundimtare për në datën 09.05.2024 (2 ditë).
24. **Seanca gjyqësore e datës 09.05.2024**, shpallja e vendimit

Për këtë çështje konstatohet se janë zhvilluar 24 seanca. Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë, 22.10.2020 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës, 09.05.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 3 vite e 6 muaj e 17 ditë. Në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave ndër të tjera konstatohen 8 seanca të shtyra për shkak të procedurave që kanë të bëjnë me procedura që lidhen me akt ekspertimin; 3 seanca të shtyra për shkak të mungesës së gjyqtarit, 2 seanca për arsye të tjera dhe seancë për arsye shëndetësore; 7 seanca të shtyra për shkak të mungesës së palëve të paditura; 3 seanca të shtyra për shkak të palës paditëse (një seancë për shkak të bojkotit të avokatëve).

Distanca kohore nga njëra seancë në tjetrën: Distanca më e shkurtër është 2 ditë; Distanca më e gjatë është 8 muaj e 5 ditë

16. Çështja nr. 21001-00137-23-2022 me objekt “zgjidhje martesë”

Kjo çështje është relatuar me detaje tek pika 5.4 e këtij raporti (shkaqet e zgjatjes së proceseve duke ju referuar llojit të objektit të padis) .

Në mënyrë të përmbledhur konstatohet se për këtë çështje gjykata ka zhvilluar gjithsej 14 seanca. Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë, dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 2 vite e 3 muaj e 11 ditë.

Nga përmbajtja e seancave rezulton shtyrje të seancave për shkaqe procedurale të passjella nga mosmarrja dijeni e palëve ndërgjyqëse (specifikisht palës së paditur); 4 seanca të pazhvilluara, për shkak të mungesës së gjyqtarit se ka qenë në trajnim 1 seancë; për shkak gjendjes shëndetësore 1 seancë; për shkak të delegimit në një gjykatë tjetër 1 seancë, për arsye familjare 1 seancë; 4 seanca rezultojnë të jenë shtyrë për shkak të kërkesës për shtyrje të paraqitur nga paditësi.

Distanca kohore ndërmjet seancave:

Për gjyqtarin e parë; Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 1 muaj e 5 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 3 muaj e 6 ditë. Për gjyqtarin e dytë; Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 1 muaj e 5 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 3 muaj e 18 ditë.

Për gjyqtarin e tretë; Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 29 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 1 muaj e 17 ditë.

17. Çështja nr. 21283-00125-23-2022 me objekt “përmbushje e detyrimit kontraktor”

Kërkesë padia është paraqitur në gjykatë në datë 01.02.2022, është regjistruar në këtë të fundit dhe është shortuar në datën 03.02.2022 (referuar tabelës së çështjeve dërguar elektronikisht, data e shortit rezulton 01.02.2022, ndërsa referuar formularit RIV data e shortit rezulton 03.02.2022).

Kjo çështje është shortuar dy herë përkatësisht: shorti i parë – 03.02.2022; shorti i dytë – 20.03.2023.

Seanca e parë është caktuar pas 2 muaj dhe 1 ditë nga data e hedhjes së shortit të parë.

Pas rishortimit seanca e parë është caktuar pas 3 muaj e 22 ditë nga data e hedhjes së shortit të dytë.

Nga ana e gjyqtarit të çështjes janë kryer këto veprime procedurale si më poshtë:

1. **Seanca e datës 04.04.2022.** Kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye shëndetësore. Seanca e radhës është caktuar për në datën 16.05.2022 (1 muaj e 12 ditë).
2. **Seanca e datës 16.05.2022.** Kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye të pjesëmarrjes në trajnim. Seanca e radhës është caktuar në datën 20.06.2022 (1 muaj 4 ditë).
3. **Seanca e datës 20.06.2022,** në këtë seancë pasi u verifikua prezenca e palëve u konstatua se janë paraqitur palët paditëse bashkë me përfaqësuesit e tyre të cilët janë legjitimuar në seancë, janë paraqitur palët e paditura të cilët kanë deklaruar se do të mbrohen nga përfaqësuesi i tyre i cili nuk ndodhet në seancë. Për t'ju lënë kohë palëve të paditura të mbrohen me avokatë, seanca është shtyrë për në datën 20.09.2022 (3 muaj).
4. **Seanca e datës 20.09.2022.** Kjo seancë është zhvilluar në prezencë të përfaqësuesit të palëve paditëse dhe në mungesë të palëve të paditura për të cilat është vendosur gjykimi në mungesë. Për ti lënë kohë palëve për të diskutuar mundësinë e pajtimit, gjykata ka shtyrë seancën për në datën 21.11.2022 (2 muaj e 1 ditë).
5. **Seanca e datës 21.11.2022.** Kjo seancë është zhvilluar në prezencë të njëjës prej palëve paditëse dhe përfaqësueses të ë gjithë palëve paditëse. Është paraqitur njëri prej të paditurve dhe përfaqësuesi i tij i cili është legjitimuar nga gjykata. Nuk është paraqitur i padituri tjetër për të cilin është marrë vendimi i gjyqimit në mungesë. Në vijim gjykata ka vlerësuar se duhet caktuar një ekspert. Për të thërritur ekspertin, gjykata ka shtyrë seancën për në datën 19.12.2022 (28 ditë).
6. **Seanca e datës 19.12.2022,** kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të pjesëmarrjes së gjyqtarit në një seminar trajnimi. Seanca e radhës është caktuar në datën 07.02.2023 (1 muaj e 19 ditë).
7. **Seanca e datës 07.02.2023,** në këtë seancë u relatua se gjyqtari do paraqitet me vonesë për shkak se ndodhej i deleguar në një gjykatë tjetër. Vazhdohet me seancën në të cilën konstatohet se është paraqitur për palën paditëse përfaqësuesi. Nuk janë paraqitur palët e paditura për të cilët ka vijuar gjykimi në mungesë. Në vijim pala paditëse ka kërkuar kohë për të saktësuar objektin e padisë. Për ti lënë kohë palës paditëse të kryejë saktësimin e objektit të padisë, seanca është shtyrë për në datën 04.04.2023 (në këtë seancë nuk evidentohet nëse është paraqitur eksperti) (5 muaj e 5 ditë).

- **Çështja u rishortua në datën 20.03.2023**

8. **Seanca e datës 12.07.2023,** kjo seancë është zhvilluar në prani të përfaqësuesit të palës paditëse, është paraqitur përfaqësuesi për vetëm njërën nga palët e paditura. Për të njoftuar palët paditëse dhe palët e paditura, seanca është shtyrë për në datën 25.10.2023 (3 muaj e 13 ditë).

9. **Seanca e datës 25.10.2023**, në këtë seancë gjykata pasi verifikon prezencën e palëve ka konstatuar se janë paraqitur përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse për të cilët verifikohen aktet e përfaqësimit. Në vijim për t'u paraqitur njëra nga paditëset dhe për tu njoftuar njëri nga të paditurit, është shtyrë seanca për në datën 14.12.2023 (1 muaj e 19 ditë).
10. **Seanca e datës 14.12.2023**, kjo seancë është zhvilluar në prezencë të përfaqësueses të palëve paditëse dhe njëres prej palëve paditëse. U konstatua se për njërin nga të paditurit nuk është konfirmuar marrja dijeni për seancën dhe për njoftimin e palës së paditur më shpallje publike, është shtyrë seanca për në datën 20.02.2024 (2 muaj e 6 ditë).
11. **Seanca e datës 20.02.2024**, kjo seancë është zhvilluar në prani të përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse, nuk është paraqitur vetëm njëri nga të paditurit, i cili ka dijeni nga shpallja publike dhe për të cilin është marrë vendimi i gjykimit në mungesë. Në vijim gjykata ka shtyrë seancën për në datën 25.03.2024 me qëllim komunikimin e pakësimit të objektit të padisë palës në mungesë (1 muaj e 5 ditë).
12. **Seanca e datës 25.03.2024**, kjo seancë është zhvilluar në prani të përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse të cilët janë legjitimuar të përfaqësojnë palët dhe në mungesë të tyre. Në vijim gjykata ka marrë vendim për të kaluar çështjen në seancë gjyqësore për në datën 30.04.2024 (1 muaj e 5 ditë).
13. **Seanca gjyqësore e datës 30.04.2024**, kjo seancë është zhvilluar në prani të përfaqësueses të palëve paditëse dhe të njëres prej palëve paditëse. I pranishëm është edhe përfaqësuesi i palës së paditur, nuk është paraqitur pala tjetër e paditur për të cilin është marrë vendimi i gjykimit në mungesë. Në vijim, gjykata pasi shpall trupin gjykues dhe sekretaren gjyqësore, ka ftuar palët të japin shpjegime rreth çështjes. Gjykata pasi lejon për shqyrtim provat shkresore të cilat citohen dhe administrohen, i jep fund hetimit shqyrtimit gjyqësor dhe ka ftuar palët për të dhënë konkluzionet përfundimtare. Seanca e radhës për shpallje vendimi është caktuar në datën 16.05.2024 (16 ditë).
14. **Seanca e datës 16.05.2024**, shpallja e vendimit.

Për këtë çështje konstatohet se janë zhvilluar 14 seanca. Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadiës, 01.02.2022 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës, 16.05.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 2 vite, 3 muaj dhe 15 ditë.

Në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave ndër të tjera konstatohen 3 seanca të shtyra për shkak të mungesës së gjyqtarit, 2 seanca të shtyra për shkak të pjesëmarrjes në trajnim të gjyqtarit dhe 1 seancë për shkak të gjendjes shëndetësore të tij; 1 seancë e shtyrë për shkak të lënies kohë palëve të zgjidhin çështjen me pajtim; 1 seancë e shtyrë për shkak të ekspertit; 4 seanca të shtyra për shkak të mungesës së palës së paditur; 4 seanca të shtyra për shkak të palës paditëse.

Distanca kohore nga seanca në seancë:

Për gjyqtarin e parë; Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 28 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 5 muaj e 5 ditë

Për gjyqtarin e dytë; Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 16 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 3 muaj e 13 ditë.

18. Çështja nr. 21256-00130-23-2021 me objekt "pushim cenimi, shpërblim dëmi, lirim dorëzim sendi"

Kërkesë padia është paraqitur në gjykatë në datë 09.02.2021, është regjistruar në këtë të fundit dhe është shortuar në datën 09.02.2021. Kjo çështje është shortuar dy herë përkatësisht: shorti i parë – 09.02.2021; shorti i dytë – 26.10.2023.

Seanca e parë është caktuar pas 3 muaj e 10 ditë nga data e hedhjes së shortit të parë.

Pas rishortimit seanca e parë është caktuar pas 6 muaj e 20 ditë nga data e hedhjes së shortit të dytë.

Nga ana e gjyqtarit të çështjes janë kryer këto veprime procedurale si më poshtë:

1. **Seanca e datës 19.05.2021**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur paditësi dhe përfaqësuesi i tij i cili është legjitimuar nga gjykata. Është paraqitur pala e paditur. Në vijim nga paditësi është kërkuar përjashtimi nga tarifat për shkak të gjendjes së invaliditetit të paditësit. Gjithashtu i padituri ka kërkuar përjashtimin nga tarifat. Në vijim gjykata ka lënë detyrë argumentimin e kërkesave për përjashtim dhe për këtë qëllim ka shtyrë seancën për në datën 07.07.2021 (1 muaj e 18 ditë).
2. **Seanca e datës 07.07.2021**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur paditësi dhe përfaqësuesi i tij, është paraqitur i padituri. Gjykata ka vlerësuar caktimin e një eksperti që disponon njohuri të posaçme. Ekspertes e cila është paraqitur në seancë i janë caktuar detyrat. Seanca e radhës është shtyrë për në datën 30.09.2021 (2 muaj e 23 ditë).
3. **Seanca e datës 30.09.2021**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse dhe përfaqësuesi, është paraqitur pala e paditur, është paraqitur ekspertja e cila ka deklaruar se nuk e ka depozituar aktin e ekspertimit. Për ti lënë kohë ekspertes për të hartuar aktin seanca është shtyrë për në datën 18.11.2021(1 muaj e 19 ditë).
4. **Seanca e datës 18.11.2021**, kjo seancë është zhvilluar në prezencë të palëve dhe në mungesë të ekspertes e cila ndodhet në një ceremoni mortore. Seanca e radhës është caktuar në datën 23.12.2021(1 muaj e 4 ditë).
5. **Seanca e datës 23.12.2021**, në këtë seancë, gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se janë paraqitur palët ndërgjyqëse, nuk është paraqitur eksperti. Seanca e radhës është caktuar në datën 02.02.2022 (1 muaj e 10 ditë).
6. **Seanca e datës 02.02.2022**, kjo seancë u zhvillua në prezencë të palëve ndërgjyqëse. Nuk është paraqitur ekspertja gjykata ka relatuar se akti i ekspertimit ka përfunduar, por nuk është kryer pagesa. Seanca është shtyrë për në datën 24.03.2022 (1 muaj e 22 ditë).
7. **Seanca e datës 24.03.2022**, kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit që ndodhet për trajnim. Seanca e radhës është caktuar në datën 05.05.2022 (1 muaj e 11 ditë)
8. **Seanca e datës 05.05.2022**, në këtë seancë gjykata pasi verifikon prezencën e palëve, ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse dhe ekspertja dhe përfaqësuesi i paditësit, nuk është paraqitur i padituri. Për të njoftuar palën e paditur, është shtyrë seanca për në datën 20.06.2022 (1 muaj e 15 ditë)

9. **Seanca e datës 20.06.2022**, në këtë seancë pasi u verifikua prezenca e palëve u konstatua se janë paraqitur palët ndërgjyqëse dhe ekspertja. Për shkak të mungesës së kushteve ekonomike të të paditurit është kërkuar të bëhet këqyrja në vend nga gjyqtari, kërkesë e cila nuk është vlerësuar e nevojshme pasi është caktuar eksperti topograf. Në vijim seanca e radhës është caktuar në datën 15.07.2022. (25 ditë)
10. **Seanca e datës 15.07.2022**, kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit i cili ndodhet në trajnim. Seanca e radhës është caktuar në datën 03.10.2022.(2 muaj e 18 ditë)
11. **Seanca e datës 03.10.2022**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur paditësi, nuk është paraqitur përfaqësuesi i tij, është paraqitur i padituri dhe përfaqësuesi i të paditurit. Janë paraqitur të 2 ekspertët. Për t'i dhënë mundësi palës paditëse dhe përfaqësuesit të tij të depozitojnë prova, parashtrime dhe pyetje për ekspertin, është shtyrë seanca për në datën 24.11.2022.(1 muaj e 21 ditë)
12. **Seanca e datës 24.11.2022**, kjo seancë është zhvilluar në prezencë të palëve ndërgjyqëse dhe të 2 ekspertëve të cilëve u janë relatuar pyetjet. Legjitimohet përfaqësuesja e re e paditësit. Në vijim seanca është caktuar në datën 31.01.2023 (2 muaj e 7 ditë).
13. **Seanca e datës 31.01.2023**, kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarës e cila ndodhet në trajnim. Seanca e radhës është caktuar në datën 13.03.2023 (1 muaj e 10 ditë)
14. **Seanca e datës 13.03.2023**, kjo seancë është zhvilluar në prezencë të palëve ndërgjyqëse, është paraqitur njëri nga ekspertët i cili ka deklaruar për ekspertin tjetër se nuk ka kryer aktin për shkak të moskryerjes së pagesës. Seanca është shtyrë për në datën 24.04.2023 (1 muaj e 11 ditë).
15. **Seanca e datës 24.04.2023**, kjo seancë është zhvilluar në prani të palëve ndërgjyqëse. Gjykata ka relatuar se njëra nga ekspertet ka bërë kërkesë për shtyrje, ndërsa është kryer pagesa e tarifës për ekspertin tjetër. Për të njoftuar ekspertët, seanca e radhës është caktuar në datën 12.06.2023 (1 muaj e 19 ditë).
16. **Seanca e datës 12.06.2023**, në këtë seancë pasi është verifikuar prezenca e palëve ndërgjyqëse, është konstatuar se janë paraqitur palët ndërgjyqëse, nuk janë paraqitur ekspertët për të cilët gjykata ka deklaruar se aktet e ekspertimit nuk janë përgatitur. Gjykata ka shtyrë seancën për në datën 11.09.2023 (2 muaj e 30 ditë).
17. **Seanca e datës 11.09.2023**, kjo seancë është shtyrë për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye shëndetësore. Seanca e radhës është caktuar në datën (8 muaj e 5 ditë)

- **Çështja është rishortuar në datën 26.10.2023**

18. **Seanca e datës 16.05.2024** (6 muaj e 20 ditë), gjykata ka konstatuar se nuk janë paraqitur pala paditëse dhe përfaqësuesi i saj edhe pse kanë marrë dijeni rregullisht. Në vijim gjykata ka vendosur pushimin e çështjes.

Për këtë çështje konstatohet se janë zhvilluar 18 seanca. Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë, 09.02.2021 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës, 16.05.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 3 vite, 3 muaj dhe 7 ditë. Në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave ndër të tjera konstatohen 4 seanca të shtyra për shkak të mungesës së gjyqtarit, 3 seanca të shtyra për shkak të pjesëmarrjes në trajnim të gjyqtarit dhe 1 për shkak të gjendjes shëndetësore; 2 seanca të shtyra për shkak të mungesës së palës së paditur; 10 seanca të shtyra për shkaqe që lidhen me ekspertin dhe aktin e ekspertimit; 3 seanca të shtyra për shkak të palës paditëse.

Distanca kohore nga seanca në seancë:

Për gjyqtarin e parë; Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 23 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 7 muaj e 4 ditë. Për gjyqtarin e dytë; Gjyqtari i dytë ka zhvilluar vetëm 1 seancë

19. Çështja nr. 21246-00175-23-2021 me objekt "Njohje pronar"

Kërkesë padia është paraqitur në gjykatë në datë 25.02.2021, është regjistruar në këtë të fundit dhe është shortuar në datën 25.02.2021. Kjo çështje është shortuar 1 herë-25.02.2021.

Seanca e parë është caktuar pas 3 muaj e 22 ditë nga data e hedhjes së shortit.

Nga ana e gjyqtarit të çështjes janë kryer këto veprime procedurale si më poshtë:

1. **Seanca e datës 16.06.2021**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur paditësi dhe përfaqësuesi i tij, nuk janë paraqitur palët e paditura dhe personi i tretë. Ka marrë vendim për gjykim në mungesë të palëve të paditura. Në vijim gjykata ka caktuar ekspert dhe me qëllim njoftimin e tij, seanca është shtyrë për në datën 15.07.2021(29 ditë).
2. **Seanca e datës 15.07.2021**, në këtë seancë u paraqit përfaqësuesi i palës paditëse, për palët e paditura ka vijuar gjykimin në mungesë. Është paraqitur eksperti i cili ka kërkuar kohë për hartimin e aktit. Seanca e radhës është caktuar në datën 07.10.2021 (2 muaj e 21 ditë)
3. **Seanca e datës 07.10.2021**, kjo seancë nuk është zhvilluar për arsye se mungon gjyqtari për shkaqe shëndetësore. Seanca e radhës është caktuar në datën 25.11.2021(1 muaj e 18 ditë).
4. **Seanca e datës 25.11.2021**, kjo seancë është zhvilluar në prezencë të përfaqësuesit të palës paditëse, në mungesë të disa palëve të paditura dhe personit të tretë. Është paraqitur eksperti i cili në funksion të përgatitjes së aktit të ekspertimit ka kërkuar akte të tjera, për depozitimin e të cilave ngarkon palën paditëse. Seanca është shtyrë për në datë 19.01.2022 (1 muaj e 25 ditë).
5. **Seanca e datës 19.01.2022**, kjo seancë është zhvilluar në prezencë të palës paditëse, një prej palëve të paditura dhe në prani të ekspertit. Përfaqësuesi i palës paditëse ka relatuar se aktet e kërkuara nga gjykata nuk i janë vënë në dispozicion nga institucionet. Në vijim seanca është caktuar në datën 10.03.2022 (1 muaj e 19 ditë).

6. **Seanca e datës 10.03.2022**, kjo seancë është zhvilluar në prani të palës paditëse, në prani të njëres prej palëve të paditura si dhe e pranishme është një nga palët e treta. Janë administruar pjesërisht aktet e kërkuara nga institucionet përkatëse dhe në vijim, për pjesën e akteve të munguara, gjykata i është drejtuar institucioneve. Seanca është caktuar për në datën 22.04.2022 (1 muaj e 12 ditë).
7. **Seanca e datës 22.04.2022**, kjo seancë është zhvilluar në prani të përfaqësuesit të palës paditëse dhe përfaqësuesit të një prej palëve të paditura. Gjukata ka relatuar se është kthyer përgjigje nga institucionet. Në vijim përfaqësuesi i palës paditëse ka paraqitur provë të re e cila është bërë shkak për marrje informacioni nga institucionet. Seanca është shtyrë për në datën 08.06.2022 (1 muaj e 17 ditë).
8. **Seanca e datës 08.06.2022**, kjo seancë është zhvilluar në prani të palës paditëse, në prani të njëres prej palëve të paditura, dhe për palët e tjera ka vazhduar gjykimin në mungesë. Në kushtet kur nuk është marrë informacioni i kërkuar në seancën e kaluar, gjykata ka vlerësuar ti drejtohet institucionit përkatës. Seanca është shtyrë për t'u zhvilluar në datën 05.10.2022 (3 muaj e 27 ditë).
9. **Seanca e datës 05.10.2022**, kjo seancë është zhvilluar në prezencë të përfaqësuesit të palës paditëse, në mungesë të njëres prej palëve të paditura, është revokuar vendimi i mungesës për njëren nga palët e paditura. Është siguruar informacioni i kërkuar nga institucioni. Seanca e radhës është caktuar në datën 25.04.2023 (6 muajsh e 20 ditësh).
10. **Seanca e datës 25.04.2023**, kjo seancë është zhvilluar në prezencë të përfaqësuesit të palës paditëse, një prej palëve të paditura, ndërsa për palët e tjera ka vijuar gjykimi në mungesë. Gjithashtu nuk është paraqitur eksperti i cili ka paraqitur kërkesë për shtyrje. Gjukata ka relatuar një kërkesë për ndërhyrje dytësore e cila pasi shqyrtohet, pranohet nga gjykata. Për të njoftuar ekspertin, seanca është shtyrë për në datën 08.06.2023 (1 muaj e 14 ditë)
11. **Seanca e datës 08.06.2023**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se nuk është paraqitur pala paditëse, por është paraqitur përfaqësuesi i tij, për palët e tjera ka vijuar gjykimi në mungesë. Është paraqitur ndërhyrësi dytësor dhe përfaqësuesi i tij i cili legjitimohet nga gjykata. Në vijim gjykata ka relatuar se është paraqitur akti i ekspertimit. Për tu njohur palët në mungesë më aktin e ekspertimit si dhe për të kërkuar informacion institucionit, gjykata ka shtyrë seancën për në datën 20.09.2023 (3 muaj e 12 ditë).
12. **Seanca e datës 20.09.2023**, në këtë seancë është prezent përfaqësuesi i paditësit, nuk është paraqitur ndërhyrësi dytësor dhe përfaqësuesi i tij, janë paraqitur palët e paditura dhe është revokuar vendimi i mungesës. Gjukata rrëzon kërkesën për shtyrje seance nga ndërhyrësi dytësor dhe vendos të kalojë çështjen në seancë gjyqësore. Seanca e radhës është caktuar në datën 08.11.2023 (1 muaj e 19 ditë).
13. **Seanca gjyqësore e datës 08.11.2023**, në këtë seancë, gjykata, pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur përfaqësuesi i palës paditëse, është vendosur gjykimi në mungesë për palët të cilët kanë marrë dijeni dhe nuk janë paraqitur. Gjukata nuk ka pranuar kërkesën për shtyrje të paraqitur nga ndërhyrësi dytësor. Rezulton të mos jetë paraqitur eksperti. Për të njoftuar ekspertin është shtyrë seanca për në datën 19.12.2023 (1 muaj e 11 ditë).

14. **Seanca gjyqësore e datës 19.12.2023**, kjo seancë është shtyrë për shkak të mungesës së ekspertit për shkaqe shëndetësore. Seanca është shtyrë për në datën 08.02.2024 (1 muaj e 20 ditë).
15. **Seanca gjyqësore e datës 08.02.2024**, kjo seancë është shtyrë për arsye të mungesës së gjyqtarit për shkaqe shëndetësore. Seanca është shtyrë për në datë 16.04.2023 (2 muaj e 8 ditë).
16. **Seanca gjyqësore e datës 16.04.2024**, në këtë seancë janë të pranishëm pala paditëse dhe përfaqësuesi i saj, është paraqitur përfaqësuesi i një prej palëve të paditura, nuk është paraqitur ndërhyrësi dytësor. Gjithashtu është paraqitur dhe eksperti i cili ka relatuar aktin e ekspertimit. Gjykata ka deklaruar mungesën e ndërhyrësit, i është dhënë fund shqyrtimit gjyqësor dhe ftohen palët të japin pretendimet përfundimtare. Seanca e radhës është caktuar në datën 23.04.2024 (7 ditë).
17. **Seanca gjyqësore e datës 23.04.2024**, seanca është zhvilluar në prezencë të përfaqësuesit të palës paditëse, është paraqitur një nga palët e paditura, ka vijuar gjykimi në mungesë për palët të cilët nuk janë paraqitur. Janë administruar pretendimet përfundimtare dhe është shtyrë seanca për shpallje të vendimit në datën 09.05.2024 (16 ditë).
18. **Seanca gjyqësore e datës 09.05.2024**, kjo seancë nuk është zhvilluar për arsye të mungesës së gjyqtarit për shkaqe shëndetësore dhe për shkak të ngarkesës në punë. Seanca është caktuar në datën 21.05.2024 (12 ditë).
19. **Seanca gjyqësore e datës 21.05.2024**, shpallja e vendimit.

Për këtë çështje konstatohet se janë zhvilluar 19 seanca. Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë, 25.02.2021 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës, 21.05.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 3 vite, 2 muaj e 26 ditë.

Në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave ndër të tjera konstatohen 6 seanca të shtyra për shkak të procedurave që kanë të bëjnë me ekspertin; 3 seanca të shtyra për shkak të mungesës së gjyqtarit; 3 seanca për arsye shëndetësore; 1 seancë e shtyrë për shkak të mungesës së palës së paditur.

Distancat kohore ndërmjet seancave: Distanca më e shkurtër nga seanca në seancë është 7 ditë; Distanca më e gjatë nga seanca në seancë është 6 muaj e 20 ditë.

20. Çështja nr. 11232-01388-23-2019 me objekt "përcaktimi i pjesëve takuese"

Kjo çështje është relatuar me detaje tek pika 5.4 e këtij raporti (shkaqet e zgjatjes së proceseve duke ju referuar llojit të objektit të padisë).

Në mënyrë të përmbledhur konstatohet se për këtë çështje gjykata ka zhvilluar 29 seanca. Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë 15.10.2019, dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës 21.05.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 4 vjet, 7 muaj e 6 ditë.

Në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave ndër të tjera konstatohen 9 seanca të shtyra për shkaqe që lidhen me mungesën e gjyqtarit për shkaqe shëndetësore, trajnimi, mosformim i trupit gjykues. (çështje me trup gjykues); 3 seanca të shtyra për shkak të

mungesës së palës së paditur; 9 seanca të shtyra për shkaqe që lidhen me ekspertin dhe aktin e ekspertimit; 1 seancë e shtyrë për shkak të bojkotit të avokatëve.

Diferencat kohore ndërmjet seancave:

Për gjyqtarin e parë: Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 4 muaj e 7 ditë; Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 21 ditë.

Për gjyqtarin e dytë: Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 7 muaj e 30 ditë; Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 5 ditë.

21. Çështja nr. 21239-00876-23-2020 me objekt “pavlefshmëri absolute e vendimit”

Kërkesë padia është paraqitur në gjykatë në datë 08.10.2020, është regjistruar në këtë të fundit dhe është shortuar në datën 08.10.2020. Kjo çështje është shortuar dy herë përkatësisht: shorti i parë – 08.10.2020; shorti i dytë – 20.03.2023.

Seanca e parë është caktuar pas 4 muaj dhe 2 ditë nga data e hedhjes së shortit të parë.

Pas rishortimit seanca e parë është caktuar pas 6 muaj e 19 ditë nga data e hedhjes së shortit të dytë.

Nga ana e gjyqtarit të çështjes janë kryer këto veprime procedurale si më poshtë:

- 1. Seanca e datës 10.02.2021**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur përfaqësuesja e A.SH, nuk janë paraqitur palët e paditura të cilat kanë dijeni rregullisht për seancën. Gjykata ka marr vendim për zhvillimin e gjykimit në mungesë për njërën nga palët e paditura. Rezulton të mos jetë njoftuar personi i tretë. Paditësi ka deklaruar se ka një kërkesë për saktësim të objektit të kërkesëpadisë. Për të njoftuar personin e tretë, është shtyrë seanca për në datën 19.03.2021 (1 muaj e 9 e ditë).
- 2. Seanca e datës 19.03.2021**, kjo seancë është zhvilluar në prezencë të palës paditëse, nuk janë paraqitur palët e paditura dhe personi i tretë. I pranishëm ka qenë ndërhyrësi dytësor dhe përfaqësuesi i tij i cili ka deklaruar se nuk është pranuar si person i tretë në gjykim. Gjykata vendos të përsërisë pjesërisht hetimin gjyqësor për sa i përket ndërgjyqësisë dhe të metave që konstatohen në kërkesë padi. (gjykata referon në një gjykim të mëparshëm, duke deklaruar se gjykimi do fillojë nga e para). Për ti lënë kohë palës paditëse të depozitojë provat e kërkuara me qëllim përcaktimin e saktë të ndërgjyqësisë, gjykata ka shtyrë seancën për në datën 05.05.2021 (1 muaj e 16 ditë).
- 3. Seanca e datës 05.05.2021**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse. Nuk është paraqitur njëra nga palë e paditura dhe as personi i tretë për të cilët është marrë vendimi i gjykimit në mungesë. Është paraqitur ndërhyrësi dytësor. Për ti lënë kohë palës paditëse të sigurojë provën tek të tretët, gjykata ka shtyrë seancën për në datën 30.06.2021 (1 muaj e 25 ditë).
- 4. Seanca e datës 30.06.2021**, kjo seancë nuk është zhvilluar pasi mungonte gjyqtari për arsye shëndetësore. Seanca e radhës është caktuar në datën 07.10.2021(3 muaj e 7 ditë).

5. **Seanca e datës 07.10.2021**, kjo seancë është zhvilluar në prani të prani të palës paditëse, për palët në mungesë është marrë vendimi i gjyqimit në mungesë. Është paraqitur ndërhyrësi dytësor dhe përfaqësuesi i tij. Gjykata për ti lënë përsëri kohë palës paditëse të paraqesë provën, ka shtyrë seancën për në datën 13.12.2021 (2 muaj e 6 ditë).
6. **Seanca e datës 13.12.2021**, kjo seancë nuk është zhvilluar pasi gjyqtari ndodhej në seminar trajnimi. Seanca e radhës është caktuar në datën 13.01.2022 (1 muaj).
7. **Seanca e datës 13.01.2022**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse, nuk janë paraqitur palët e tjera. Është paraqitur ndërhyrësi dytësor dhe përfaqësuesi i tij. Përsëri gjykata ka shtyrë seancën për në datën 09.03.2022 për ti lënë kohë palës paditëse të depozitojë provën e kërkuar (1 muaj e 24 ditë).
8. **Seanca e datës 09.03.2022**, kjo seancë është zhvilluar në prani të palës paditëse dhe të ndërhyrësit dytësor dhe përfaqësuesit të tij. Gjykata ka relatuar se është paraqitur prova e kërkuar nga pala paditëse por është e paplotë. Për ti lënë kohë palës paditëse të depozitojë një provë tjetër, gjykata ka shtyrë seancën për në datën 25.05.2022 (2 muaj e 16 ditë).
9. **Seanca e datës 25.05.2022**, kjo seancë është zhvilluar në prezencë të palës paditëse dhe të ndërhyrësit dytësor. Paditësi ka relatuar se kërkojnë një afat të ri për depozitim të një prove të re. Për ti lënë kohë paditësit të paraqesë këtë provë, gjykata ka shtyrë seancën për në datën 29.09.2022 (4 muaj e 4 ditë).
10. **Seanca e datës 29.09.2022**, kjo seancë u zhvillua në prani të palës paditëse, në mungesë të palëve të paditura si dhe në prani të ndërhyrësit dytësor dhe përfaqësuesit të tij. Gjykata i lë detyrë edhe palës së paditur edhe paditësit të paraqesin prova të tjera dhe ka shtyrë seancën për në datën 13.12.2022 (2 muaj e 14 ditë).
11. **Seanca e datës 13.12.2022**, kjo seancë është zhvilluar në prani të palës paditëse, ndërhyrësit dytësor dhe përfaqësuesit të tij. Për ti lënë kohë palës paditëse të depozitojë provën është shtyrë seanca për në datën 21.03.2023.

- **Çështja u rishortua në datën 20.03.2023**

12. **Seanca e datës 09.10.2023**, kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye trajnimi. Seanca është shtyrë për në datën 01.11.2023 (23 ditë).
13. **Seanca e datës 01.11.2023**, kjo seancë është zhvilluar në prani të palës paditëse, të ndërhyrësit dytësor dhe përfaqësuesit të tij. Në vijim palët japin qëndrimin e tyre rreth çështjes. Gjykata ka shtyrë seancën për të përsëritur njoftimin për njëherë nga palët e paditura për të cilën ishte marrë vendimi i mungesës nga gjyqtari i mëparshëm, gjykata ka shtyrë seancën për në datën 17.01.2024 (2 muaj e 16 ditë).
14. **Seanca e datës 17.01.2024**, kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye shëndetësore. Seanca e radhës është caktuar në datën 28.03.2024 (2 muaj e 11 ditë).
15. **Seanca e datës 28.03.2024**, kjo seancë është zhvilluar në prani të palës paditëse, gjykata ka marrë vendim për gjykim në mungesë të palës së paditur të thërritur nga

seanca e kaluar. Është paraqitur ndërhyrësi dytësor. Në vijim gjykata ka ftuar palët të japin qëndrimin e tyre. Në përfundim të seancës, gjykata i lë kohë palës paditëse të saktësojë ndërgjyqësinë dhe ka shtyrë seancën për në datën 22.05.2024 (1 muaj e 24 ditë).

- 16. Seanca e datës 22.05.2024**, kjo seancë është zhvilluar në prani të palës paditëse, ndërhyrësit dytësor dhe përfaqësuesit të tij. Në vijim të debatit gjyqësor, gjykata ka konstatuar se diskutimi është përqendruar te çështja e ndërgjyqësisë dhe legjitimitetit dhe për këtë qëllim tërhiqet për vendim dhe kur kthehet vendos pushimin e gjykimit.

Për këtë çështje konstatohet se janë zhvilluar 16 seanca. Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë, 08.10.2020 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës, 22.05.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 3 vite, 7 muaj e 14 ditë.

Në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave ndër të tjera konstatohen 4 seanca të shtyra për shkak të mungesës së gjyqtarit, 2 seanca të shtyra për shkak të pjesëmarrjes në trajnim të gjyqtarit dhe 2 seanca për shkak të gjendjes shëndetësore të tij; 1 seancë e shtyrë për shkak të personit të tretë; 2 seanca të shtyra për shkak të mungesës së palës së paditur; 9 seanca të shtyra për shkak të palës paditëse.

Distanca kohore nga seanca në seancë:

Për gjyqtarin e parë; Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 1 muaj; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 4 muaj e 4 ditë.

Për gjyqtarin e dytë; Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 23 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 2 muaj e 16 ditë.

22. Çështja nr. 21235-00233-23-2022 me objekt “përmbushje detyrimi që rrjedh nga kontrata”

Kërkesë padia është paraqitur në gjykatë në datë 24.02.2022, është regjistruar në këtë të fundit dhe në datën 24.02.2022 është shortuar. Kjo çështje është shortuar 1 herë përkatësisht – 24.02.2022;

Seanca e parë është caktuar pas 4 muaj e 5 ditë nga data e hedhjes së shortit.

Nga ana e gjyqtarit të çështjes janë kryer këto veprime procedurale si më poshtë:

- 1. Seanca e datës 29.06.2022**, gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se nuk janë paraqitur palët paditëse dhe palët e paditura, por është paraqitur vetëm përfaqësuesi i palës paditëse. Seanca është shtyrë për t'u zhvilluar në datën 26.07.2022 për shkak të një gjykimi tjetër penal. (27 ditë)
- 2. Seanca e datës 26.07.2022**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse, nuk janë paraqitur palët e paditura për të cilët nuk është mundur njoftimi i seancës (për njërin nga palët e paditura ka ardhur fletëthirrja me shënimin larguar). Gjykata ka legjitimuar përfaqësuesin e palës paditëse dhe për të njoftuar palët e paditura ka shtyrë seancën për në datën 22.09.2022 (1 muaj e 27 ditë)
- 3. Seanca e datës 22.09.2022**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur paditësi, ka munguar përfaqësuesi i tij. Për



- njërën nga palët e paditura është kthyer përsëri njoftimi me shënimin "larguar". Është paraqitur përfaqësuesi i shoqërisë e cila është thirrur në cilësinë e palës së paditur. Me qëllim plotësimit e të metave të kërkesëpadisë, gjykata i ka lënë 10 ditë kohë paditësit, duke i caktuar edhe detyrat përkatëse lidhur me adresën e palës së paditur (nuk është caktuar në procesverbal data e seancës së radhës). (27 ditë)
4. **Seanca e datës 19.10.2022**, kjo seancë është zhvilluar në mungesë të palës paditëse për arsye shëndetësore dhe avokatit të tij i cili ka vënë në dijeni sekretarinë se është larguar për një gjykim tjetër. Gjukata ka relatuar kërkesën për shtyrje, të avokatit të një prej palëve të paditura. Me qëllim marrjen e informacionit lidhur me adresën zyrtare të palës së paditur, gjykata ka shtyrë seancën për në datën 09.11.2022. (21 ditë)
 5. **Seanca e datës 09.11.2022**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse, nuk janë paraqitur palët e paditura. Me qëllimin njoftimin e një prej të paditurve me shpallje publike, është shtyrë seanca për në datën 14.12.2022.(1 muaj e 5 ditë)
 6. **Seanca gjyqësore e datës 14.12.2022**, kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit i cili ndodhet në trajnim. Seanca është shtyrë për në datën 26.01.2023 (1 muaj e 12 ditë)
 7. **Seanca gjyqësore e datës 26.01.2022**, kjo seancë rezulton të jetë zhvilluar në prezencë të palës paditëse dhe në mungesë të palëve të paditura ku njëra prej tyre ka dorëzuar kërkesë për shtyrje seancë ndërsa për palën tjetër, njoftimi i të cilës është bërë nëpërmjet shpalljes publike (konfirmuar nga Bashkia), ka vijuar gjykimi në mungesë. Me qëllim njoftimin e palës së paditur përmes telefonit dhe njoftimin e palëve të tjera mbi këtë kërkesë për shtyrje, seanca e radhës është caktuar për t'u zhvilluar në datën 31.01.2023. (5 ditë)
 8. **Seanca gjyqësore e datës 31.01.2023**, kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye familjare. Seanca e radhës është caktuar në datën 22.02.2023. (22 ditë)
 9. **Seanca e datës 22.02.2023**, kjo seancë është zhvilluar në prezencë të palës paditëse dhe në mungesë të palëve të paditura. Pas diskutimeve të zhvilluara, me qëllim lënien kohë për paraqitjen e deklaratës së mbrojtjes nga i padituri, seanca është shtyrë për në datën 30.03.2023 (1 muaj e 8 ditë)
 10. **Seanca e datës 30.03.2023**, kjo seancë është zhvilluar në prezencë të palës paditëse dhe në mungesë të palëve të paditura. Me qëllim caktimin e ekspertëve, gjykata ka shtyrë seancën për në datën 03.05.2023 (1 muaj e 3 ditë).
 11. **Seanca e datës 03.05.2023**, kjo seancë është zhvilluar në prezencë të palës paditëse dhe një prej palëve të paditura, ndërsa për palën tjetër të paditur vazhdon gjykimi në mungesë. Në vijim janë paraqitur ekspertët të cilët kanë bërë betimin. Me qëllim paraqitjen e akt ekspertimit, gjykata ka vendosur që seanca e radhës të zhvillohet në datën 20.06.2023. (48 ditë)
 12. **Seanca e datës 20.06.2023**, kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye familjare. Seanca e radhës është në datën 10.07.2023.(20 ditë)
 13. **Seanca e datës 10.07.2023**, gjykata pasi verifikon prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse, është paraqitur me vonesë përfaqësuesi i palës paditëse. Ka vijuar gjykimi në mungesë për një nga palët e paditura. Në

mungesë të dorëzimit të aktit të ekspertimit nga eksperti kontabël, gjykata ka vendosur të shtyjë seancën për t'u zhvilluar në datën 25.10.2023 me qëllim thërritjen e ekspertit.(3 muaj e 5 ditë)

14. **Seanca e datës 25.10.2023**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse dhe ka vijuar gjykimi me vetëm njërin prej palëve të paditura. Pas diskutimeve rreth çështjes, në vijim të konstatimit të mungesës së aktit të ekspertimit si rrjedhojë e pengesës të krijuar për shkak të objektit, gjykata ka ndërhyrë për të orientuar dhe caktuar detyrat përkatëse drejtuar ekspertit. Për dorëzimin e aktit të ekspertimit nga njëri ekspert si dhe për plotësimin e aktit nga eksperti tjetër, gjykata ka shtyrë seancën për në datën 13.12.2023.(1 muaj e 18 ditë)
15. **Seanca e datës 13.12.2023**, gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve, ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse, vazhdon gjykimi në mungesë për palët e paditura, gjykata ka relatuar se akti është dorëzuar dhe me qëllim njoftimin e aktit palëve në mungesë, gjykata ka vendosur të shtyjë seancën për në datën 12.02.2024.(1 muaj e 30 ditë)
16. **Seanca e datës 12.02.2024**, gjykata pasi verifikon prezencën e palëve ka konstatuar se ka një kërkesë për shtyrje nga përfaqësuesi i palës paditëse si dhe kërkesë për shtyrje nga një prej palëve të paditura. Në vijim gjykata ka relatuar kërkesën e palës së paditur për ti rikomunikuar aktin e ekspertimit, kërkesë e cila është pranuar nga gjykata. Në vijim seanca është shtyrë për në datën 05.03.2024.(22 ditë)
17. **Seanca e datës 05.03.2024**, kjo seancë është zhvilluar në prezencë të palës paditëse, palët e paditura vijnë në mungesë. Përfaqësuesi i paditësit ka paraqitur kërkesë për sigurim padie, e cila në vijim është rrëzuar nga gjykata. Gjkata ka marrë vendim për kalim të çështjes në seancë gjyqësore . Seanca është shtyrë për në datë 15.04.2024 (1 muaj e 10 ditë).
18. **Seanca gjyqësore e datës 15.04.2024**, kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye familjare. Seanca e radhës është caktuar në datën 08.05.2024. (23 ditë)
19. **Seanca gjyqësore e datës 08.05.2024**, kjo seancë është zhvilluar në mungesë të palëve të paditura dhe në prezencë të palës paditëse. Pas depozitimit të konkluzioneve përfundimtare, gjykata ka shtyrë seancën për shpalljen e vendimit për në datën 27.05.2024. (19 ditë)
20. **Seanca gjyqësore e datës 27.05.2024**, shpallja e vendimit.

Për këtë çështje konstatohet se janë zhvilluar 20 seanca. Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë, 24.02.2022 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës, 27.05.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 2 vite, 3 muaj e 3 ditë.

Në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave ndër të tjera konstatohen 4 seanca të shtyra për shkak të mungesës së gjyqtarit, 1 seancë për pjesëmarrje në trajnim dhe 3 seanca të shtyra për shkaqe të tjera; 7 seanca të shtyra për shkak të mungesës së palëve të paditura për shkaqe që kanë të bëjnë me procedurën e njoftimit të paditurit dhe kërkesa për shtyrje të depozituara nga të paditurit; 1 seancë është shtyrë për

shkak të mungesës së palës paditëse për arsye shëndetësore; 4 seanca të shtyra për shkaqe të cilat lidhen me aktin e ekspertimit.

Distanca kohore ndërmjet seancave: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 5 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 3 muaj e 5 ditë.


23. Çështja nr. 11114-00347-23-2022 me objekt “Servitut kalimi”

Kërkesë padia është paraqitur në gjykatë në datë 05.04.2022, është regjistruar në këtë të fundit dhe është shortuar në datën 05.04.2022. Kjo çështje është shortuar një herë përkatësisht -05.04.2022.

Seanca e parë është caktuar pas 3 muaj e 16 ditë nga data e hedhjes së shortit.

Nga ana e gjyqtarit të çështjes janë kryer këto veprime procedurale si më poshtë:

- 1. Seanca e datës 21.07.2022**, kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mosparaqitjes së palëve ndërgjyqëse. Seanca është shtyrë për në datën 25.10.2022 (3 muaj e 4 ditë).
- 2. Seanca e datës 25.10.2022**, kjo seancë është zhvilluar në prani të palës paditëse dhe përfaqësuesit të saj, në mungesë të njëres prej palëve të paditura, ndërsa për palën tjetër të paditur, do përsëritet njoftimi me shpallje. Seanca e radhës është caktuar në datën 05.12.2022.(1 muaj e 10 ditë)
- 3. Seanca e datës 05.12.2022**, kjo seancë është zhvilluar në prani të paditësit dhe përfaqësuesit të tij, prezent është një nga të paditurit, ndërsa për të paditurit e tjerë u zhvillua gjykimi në mungesë. I padituri ka kërkuar shtyrjen e seancës për arsye se ka kërkuar të përfaqësohet me avokat. Seanca e radhës është caktuar në datën 08.02.2023 (2 muaj e 3 ditë).
- 4. Seanca e datës 08.02.2023**, kjo seancë është zhvilluar në prani të palës paditëse dhe përfaqësuesit të saj, në prani të njëres prej palëve të paditura dhe përfaqësuesit të saj dhe në mungesë të palës tjetër të paditur. Për të caktuar ekspert, gjykata vendos të shtyjë seancën për në datën 08.03.2023 (1 muaj).
- 5. Seanca e datës 08.03.2023**, në këtë seancë pasi u verifikua prezenca e palëve gjykata ka konstatuar se janë paraqitur paditësi dhe një nga të paditurit me përfaqësuesit e tyre, gjithashtu është paraqitur edhe eksperti. Për ti lënë kohë ekspertit (i cili ka kërkuar 1 muaj kohë) të depozitojë aktin e ekspertimit, gjykata ka caktuar seancën në datën 14.04.2023 (1 muaj e 6 ditë)
- 6. Seanca e datës 14.04.2023**, në këtë seancë pasi është verifikuar prezenca e palëve gjykata ka konstatuar se janë paraqitur paditësi dhe një nga të paditurit me përfaqësuesit e tyre, është paraqitur edhe eksperti të cilit i janë caktuar detyra shtesë. Seanca është shtyrë për në datën 13.12.2023 (7 muaj e 29 ditë)
- 7. Seanca e datës 13.12.2023**, kjo seancë është shtyrë për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye shëndetësore. Seanca e radhës është caktuar për në datën 27.02.2024 (2 muaj e 14 ditë).



8. **Seanca e datës 27.02.2024.** kjo seancë është shtyrë për shkak të mungesës së gjyqtarit i cili ndodhej në KLGJ. Seanca e radhës në datën 09.04.2024. (1 muaj e 13 ditë)
9. **Seanca e datës 09.04.2024,** në këtë seancë pasi është verifikuar prezenca e palëve gjykata ka konstatuar se janë paraqitur paditësi dhe një nga të paditurit me përfaqësuesit e tyre, është paraqitur edhe eksperti i cili rezulton të mos ketë realizuar detyrat e caktuara nga gjykata. Seanca e radhës është caktuar në datën 08.05.2024 (29 ditë).
10. **Seanca e datës 08.05.2024,** në këtë seancë është paraqitur paditësi dhe përfaqësuesi i tij, përfaqësuesi i një prej palëve të paditura dhe eksperti. Është paraqitur akti i ekspertimit dhe është kaluar në diskutime përfundimtare. Seanca është shtyrë për në datën 28.05.2024 për shpallje vendimi (20 ditë).
11. **Seanca e datës 28.05.2024,** shpallja e vendimit.

Për këtë çështje konstatohet se janë zhvilluar 11 seanca. Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë, 05.04.2022 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës, 28.05.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 2 vite, 1 muaj e 23 ditë.

Në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave ndër të tjera konstatohen 2 seanca të shtyra për shkak të mungesës së gjyqtarit, 1 seancë e shtyrë për shkak të gjendjes shëndetësore, 1 seancë për shkak të pjesëmarrjes në KLGJ; 3 seanca të shtyra për shkak të mungesës së palës së paditur; 4 seanca të shtyra për shkaqe që lidhen me ekspertin dhe aktin e ekspertimit; 1 seancë e shtyrë për shkak të palës paditëse.

Distanca kohore nga seanca në seancë: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 20 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 7 muaj e 29 ditë.

24. Çështja nr. 21298-00317-23-2022 me objekt “Kallëzimi i një punimi të ri”

Kërkesë padia është paraqitur në gjykatë në datë 25.03.2022, është regjistruar në këtë të fundit dhe është shortuar në datën 25.03.2022. Kjo çështje është shortuar 1 herë përkatësisht në datën 25.03.2022.

Seanca e parë është caktuar pas 5 ditë nga data e hedhjes së shortit.

Nga ana e gjyqtarit të çështjes janë kryer këto veprime procedurale lidhur me shqyrtimin e kërkesës për sigurim padie dhe shqyrtimin e themelit të çështjes si më poshtë:

1. **Seanca e datës 30.03.2022,** në këtë seancë, gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur administratori i shoqërisë paditëse, është paraqitur gjithashtu edhe shoqëria e paditur, nuk është paraqitur i padituri tjetër pasi është kthyer fletëthirrja me shënimin “larguar”, nuk është paraqitur personi i tretë. Gjukata ka konstatuar se ka të meta akti i përfaqësimit të palës paditëse. Për të njoftuar të paditurin që s’ka marrë dijeni, gjykata ka caktuar seancën në datën 07.04.2022 (8 ditë).
2. **Seanca e datës 07.04.2022,** kjo seancë është zhvilluar në prezencë të paditësit dhe përfaqësuesit të tij si dhe në prezencë të palëve të paditura. Është paraqitur një nga

përfaqësuesit e personit të tretë, mungon personi tjetër i tretë. Përgjatë zhvillimit të procesit gjyqësor, pas administrimit të dokumentacionit të paraqitur nga personi i tretë, gjykata ka konstatuar mungesë aktesh në lidhje me zhvillimin e procesit. Me qëllim lënien kohë personit të tretë të sjellë aktet e kërkuara, gjykata ka shtyrë seancën për në datën 13.04.2022 (6 ditë)

3. **Seanca e datës 13.04.2022**, kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye shëndetësore. Seanca e radhës është caktuar në datën 22.04.2022 (9 ditë).
4. **Seanca e datës 22.04.2022**. Në këtë seancë nuk është paraqitur paditësi i cili ka paraqitur kërkesë për shtyrje seance. Për të paditurin nuk është paraqitur përfaqësuesi. Për personin e tretë është paraqitur përfaqësuesja. Në vijim gjykata nuk ka pranuar kërkesën për shtyrje të depozituar nga pala paditëse dhe për rrjedhojë ka pushuar gjykimin e çështjes³⁴ (sigurimin e padisë) (1 muaj e 30 ditë).
5. **Seanca e datës 21.06.2022**. Në këtë seancë nuk është paraqitur paditësi dhe as përfaqësuesi i tij për të cilin fletëthirrja ka ardhur me shënimin larguar. Nuk është paraqitur përfaqësuesi i palës së paditur i cili ka paraqitur kërkesë për shtyrje seance si dhe është paraqitur ortaku i shoqërisë. Për të njoftuar palën paditëse gjykata ka shtyrë seancën për në datën 28.09.2022 (3 muaj e 7 ditë).
6. **Seanca e datës 28.09.2022**, kjo seancë është zhvilluar në prezencë të palës paditëse dhe përfaqësuesit të saj. Për të gjitha palët e paditura rezulton se i pranishëm është ortaku i tyre. Nuk janë paraqitur përfaqësuesit ligjorë të cilët janë njoftuar më fletëthirrje. Për një prej palëve të paditura, gjykata ka relatuar se ortaku i shoqërisë nuk ka legjitimitet të përfaqësojë shoqërinë tjetër të paditur për të cilën është vendosur gjykimi në mungesë. Referuar diskutimeve rreth çështjes, gjykata ka vlerësuar caktimin e një eksperti. Seanca është shtyrë për në datën 03.11.2022 (1 muaj e 6 ditë).
7. **Seanca e datës 03.11.2022**, në këtë seancë pas verifikimit të prezencës së palëve është konstatuar se është paraqitur pala paditëse, por ka munguar përfaqësuesi, ka vijuar gjykimi në mungesë për palët të cilat kanë dijeni por nuk janë paraqitur. Gjukata ka relatuar se është paraqitur një kërkesë për ndërhyrje dytësore nga një shtetas. Në vijim revokohet vendimi për caktim eksperti. Paditësi ka kërkuar shtyrjen e seancës për shkak të mungesës së përfaqësuesit të tij. Gjukata pasi ka pranuar kërkesën e paditësit dhe ka vlerësuar të caktojë një ekspert tjetër. Për të njoftuar ekspertin si dhe për të njoftuar përfaqësuesin e paditësit, gjykata ka shtyrë seancën për në datën 24.01.2023 (2 muaj e 21 ditë).
8. **Seanca e datës 24.01.2023**, në këtë seancë është paraqitur paditësi dhe përfaqësuesi i tij, për palët e tjera ndërgjyqëse, për një nga shoqëritë e paditura është paraqitur ortaku, ndërsa për palët e tjera ka vijuar gjykimi në mungesë. Gjukata ka vlerësuar të pranojë kërkesën për ndërhyrës kryesor. Në vijim është paraqitur eksperti i cili ka marrë detyrat. Gjukata i ka lënë kohë ekspertit të përgatisë aktin e ekspertimit, duke caktuar si datë dorëzimi të aktit datën

³⁴ Referuar tabelës të dërguar elektronikisht rezulton se për këtë çështje janë zhvilluar 16 seancë, ndërkohë referuar procesverbaleve konstatohet se janë zhvilluar 4 seanca



- 06.03.2023 si dhe një afat 5 ditësh për paraqitjen e kundërshtimeve nga palët. (3 muaj e 9 ditë)
9. **Seanca e datës 03.05.2023**, kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për shkaqe shëndetësore. Seanca është caktuar për në datën 20.06.2023 (1 muaj e 17 ditë)
 10. **Seanca e datës 20.06.2023**, në këtë seancë është paraqitur paditësi, përfaqësuesi i tij, ndërhyrësi dytësor dhe eksperti. Për palët e tjera ka vijuar gjykimi në mungesë. Paditësi ka paraqitur kërkesë për saktësim të objektit të padisë e cila konsiston në zhvillimin e gjykimit me trup gjykues për shkak të vlerës së objektit të padisë. Për t'i lënë kohë palës paditëse të paguajë tarifën e objektit të kërkesëpadisë si dhe për t'i lënë kohë formimit të trupit gjykues, gjykata ka shtyrë seancën për në datën 11.10.2023 (3 muaj e 21 ditë).
 11. **Seanca e datës 11.10.2023**, në këtë seancë u paraqit paditësi dhe përfaqësuesi i tij, ndërsa për palët e tjera ndërgjyqëse ka vijuar prezenca si në seancën paraardhëse. Për shkak të mosformimit të trupit gjykues për shkak të gjendjes shëndetësore të një prej anëtarëve të trupës, seanca është shtyrë për në datën 14.12.2023 (2 muaj e 3 ditë).
 12. **Seanca e datës 14.12.2023**, kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së njërit prej anëtarëve të trupit gjykues për arsye shëndetësore. Seanca e radhës është caktuar në datën 27.02.2024 (2 muaj e 13 ditë).
 13. **Seanca e datës 27.02.2024**, kjo seancë nuk është zhvilluar pasi njëri nga anëtarët e trupit gjykues ndodhej në KLGJ. Seanca e radhës është caktuar në datën 16.04.2024.(1 muaj e 20 ditë).
 14. **Seanca e datës 16.04.2024**, seanca u zhvillua në prani të palës paditëse dhe përfaqësuesit të tij, ndërsa për një prej palëve të paditura është kthyer fletëthirrja me shënimin "adresë e panjohur". Është paraqitur ndërhyrësi kryesor dhe përfaqësuesi i tij. Për të njoftuar përmes shpalljes publike palën e paditur është shtyrë seanca për në datën 22.05.2024. (1 muaj e 6 ditë)
 15. **Seanca e datës 22.05.2024**, është paraqitur pala paditëse dhe përfaqësuesi i saj, ka vijuar të paraqitet administratori i njëres prej palëve të paditura, ndërsa për palën tjetër të paditur të cilit i është bërë njoftimi përmes shpalljes publike, është paraqitur përfaqësuesi i tij. Rezulton të jetë paraqitur ndërhyrësi dytësor dhe eksperti i cili ka relatuar aktin e ekspertimit. Në vijim gjykata, pasi ka administruar provat shkresore dhe ka deklaruar të mbyllur shqyrtimin gjyqësor, ka ftuar palët në konkluzione përfundimtare. Seanca është shtyrë për në datën 28.05.2024 (6 ditë).
 16. **Seanca e datës 28.05.2024**, shpallja e vendimit

Për këtë çështje konstatohet se janë zhvilluar 16 seanca. Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë, 25.03.2022 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës, 28.05.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 2 vite, 2 muaj e 3 ditë.

Në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave ndër të tjera konstatohen 5 seanca të shtyra për shkak të mungesës së gjyqtarit (3 seanca të shtyra për shkak të gjendjes shëndetësore të një prej anëtarëve të trupit gjykues, 1 seancë për shkak të pjesëmarrjes në KLGJ të njërit prej anëtarëve të trupit gjykues dhe 1 seancë për shkak të mosformimit të trupit gjykues); 3 seanca të shtyra për shkak të mungesës së

palës së paditur; 3 seanca të shtyra për shkaqe që lidhen me ekspertin dhe aktin e ekspertimit; 4 seanca të shtyra për shkak të palës paditëse.

Distanca kohore nga seanca në seancë: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 6 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 3 muaj e 21 ditë.

25. Çështja nr. 11112-01067-23-2021 me objekt “pjesëtim sendi”

Kërkesë padia është paraqitur në gjykatë në datë 02.11.2021, është regjistruar në këtë të fundit dhe është shortuar në datën 02.11.2021.

Kjo çështje është shortuar dy herë përkatësisht: shorti i parë – 02.11.2021; shorti i dytë – 26.10.2023. Seanca e parë është caktuar pas 3 muaj e 7 ditë nga data e hedhjes së shortit të parë. Pas rishortimit seanca e parë është caktuar pas 5 muaj e 28 ditë nga data e hedhjes së shortit të dytë.

Nga ana e gjyqtarit të çështjes janë kryer këto veprime procedurale si më poshtë:

1. **Seanca e datës 09.02.2022**, kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye shëndetësore. Seanca e radhës është caktuar në datën 28.03.2022 (1 muaj e 19 ditë)
2. **Seanca e datës 28.03.2022**, kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës të gjyqtarit për shkaqe shëndetësore. Seanca e radhës është caktuar në datën 05.05.2022 (1 muaj e 7 ditë).
3. **Seanca e datës 05.05.2022**, kjo seancë është zhvilluar në prezencë të palës paditëse dhe përfaqësuesit të saj i cili u legjitimua në seancë. Nuk është paraqitur njëri nga të paditur pasi nuk konfirmohet marrja dijeni. Për të njoftuar palën e paditur është shtyrë seanca për në datën 22.06.2022 (1 muaj e 17 ditë).
4. **Seanca e datës 22.06.2022**, në këtë seancë, gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se nuk janë paraqitur palët ndërgjyqëse për shkak të bojkotit të avokatëve. Seanca e radhës është caktuar në datën 28.09.2022 (3 muaj e 6 ditë).
5. **Seanca e datës 28.09.2022**, kjo seancë është zhvilluar në prani të palës paditëse dhe përfaqësuesit të saj. Është paraqitur një nga palët e paditura dhe përfaqësuesi i tij, i cili u legjitimua në seancë. Për t'i lënë kohë palës së paditur të paraqesë provën në formën e kërkuar nga ligji, si dhe për të njoftuar palën tjetër të paditur, seanca është shtyrë për në datën 23.11.2022 (1 muaj e 26 ditë).
6. **Seanca e datës 23.11.2022**, kjo seancë është zhvilluar në prani të palës paditëse dhe përfaqësuesit të saj, prezent ishte njëra nga palët e paditura dhe përfaqësuesi i saj. Për të paditurin tjetër nuk konfirmohet marrja dijeni. Për të njoftuar me shpallje publike të paditurin tjetër, seanca është shtyrë për në datën 25.01.2023 (2 muaj e 2 ditë).
7. **Seanca e datës 25.01.2023**, kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës të gjyqtarit për shkaqe shëndetësore. Seanca e radhës është caktuar në datën 15.03.2023 (2 muaj).
8. **Seanca e datës 15.03.2023**, kjo seancë është zhvilluar në prani të palës paditëse dhe përfaqësueses së saj. Për njërin nga të paditurit nuk është paraqitur përfaqësuesi

i tij i cili ka depozituar kërkesë për shtyrje pa dokumentacion bashkëlidhur. Për të paditurin tjetër deklarohet mungesa. Gjykata ka marrë vendim për të kaluar çështjen në seancë gjyqësore. Për të njoftuar palët e paditura, seanca është shtyrë për në datën 12.04.2023 (28 ditë).

9. **Seanca gjyqësore e datës 12.04.2023**, kjo seancë është zhvilluar në prani të palës paditëse dhe përfaqësuesit të tij. Rezulton të jetë paraqitur përfaqësuesi i njëres prej palëve të paditura, ndërsa për palën tjetër të paditur ka vijuar gjykimi në mungesë. Gjykata pasi ka deklaruar të hapur shqyrtimin gjyqësor, ka ftuar palët të japin qëndrimet e tyre rreth padisë. Në vijim gjykata ka marrë në administrim provat shkresore që janë lejuar për shqyrtim dhe ka deklaruar të mbyllur shqyrtimin. Pasi palët kanë paraqitur pretendimet e fundit, gjykata ka caktuar datën 27.04.2023 për të shpallur vendimin përfundimtar (15 ditë)
 10. **Seanca gjyqësore e datës 27.04.2023**, në këtë seancë, gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka relatuar se ka vendosur të riçel hetimin gjyqësor dhe ka kërkuar nga pala paditëse depozitim të dokumenteve. Për ti lënë kohë palës paditëse të depozitojë provën e kërkuar si dhe për të njoftuar palët në mungesë, gjykata ka shtyrë seancën për në datën 15.06.2023 (1 muaj e 19 ditë).
 11. **Seanca gjyqësore e datës 15.06.2023**, kjo seancë është zhvilluar në prani të palës paditëse dhe përfaqësuesit, si dhe në prani të përfaqësuesit të palës së paditur. Ka vijuar gjykimi në mungesë për të paditurin tjetër. Në vijim gjykata ka konstatuar se provat nuk janë në formën e kërkuar nga ligji dhe për këtë shkak i ka lënë kohë përsëri palës paditëse të depozitojë provat në formën e kërkuar. Seanca e radhës është caktuar në datë 20.07.2023 (1 muaj e 5 ditë).
 12. **Seanca gjyqësore e datës 20.07.2023**, kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës të gjyqtarit për shkaqe shëndetësore. Seanca e radhës është caktuar në datën 02.10.2023. (2 muaj e 12 ditë)
 13. **Seanca gjyqësore e datës 02.10.2023**, kjo seancë është zhvilluar në prani të përfaqësuesit të palës paditëse, janë paraqitur i padituri dhe përfaqësuesi i tij. Ka vijuar gjykimi në mungesë për të paditurin tjetër. Në kushtet kur përfaqësuesi i paditësit ka deklaruar se nuk mund të marrë provën nga të tretët, gjykata do i drejtohet me shkresë institucionit për marrjen e provës së kërkuar. Për të siguruar provën e kërkuar, seanca është shtyrë për në datën 23.11.2023.
- **Çështja rishortohet në datën 26.10.2023.**
14. **Seanca gjyqësore e datës 23.04.2024**, kjo seancë është zhvilluar në prani të përfaqësuesit të palës paditëse, dhe përfaqësuesit të palës së paditur. Gjykata pasi legjitimon përfaqësuesit e të paditurit dhe ka konstatuar se për të paditurin tjetër është kthyer fletëthirrja me shënimin adresë e pasaktë. Për të konfirmuar adresën e saktë të të paditurit si dhe për të njoftuar paditësin seanca është shtyrë për në datën 03.06.2024 (1 muaj e 11 ditë).
 15. **Seanca gjyqësore e datës 03.06.2024**, në këtë seancë pasi u verifikua prezenca e palëve u konstatua se nuk është paraqitur pala paditëse por është paraqitur përfaqësuesi i tij me deklaram. Në vijim përfaqësuesi i palës së paditur ka kërkuar

pushimin e gjykimit pasi nuk është paraqitur pala paditëse. Gjykata e këshilluar në vend ka vendosur pushimin e gjykimit.

Për këtë çështje konstatohet se janë zhvilluar 15 seanca. Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë 02.11.2021 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës, 03.06.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 2 vite, 7 muaj e 1 ditë

Në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave ndër të tjera konstatohen 4 seanca të shtyra për shkak të mungesës së gjyqtarit për shkaqe shëndetësore; 6 seanca të shtyra për shkak të mungesës së palës së paditur; 1 seancë e shtyrë për shkak të palës paditëse; 1 seancë e shtyrë për shkak të bojkotit të avokatëve.

Distanca kohore nga seanca në seancë: Për gjyqtarin e parë: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 15 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 3 muaj e 6 ditë.

Për gjyqtarin e dytë; Janë zhvilluar vetëm 2 seanca me një diferencë kohore midis 1 muaj e 11 ditë.

26. Çështja nr. 23008-00362-23-2021 me objekt "Vërtetim i atësisë"

Kërkesë padia është paraqitur në gjykatë në datë 06.05.2021, është regjistruar në këtë të fundit dhe është shortuar në datën 06.05.2021. Kjo çështje është shortuar 3 herë përkatësisht: shorti i parë – 06.05.2021; shorti i dytë – 20.03.2023; shorti i tretë - 26.10.2023.

Seanca e parë është caktuar pas 5 muaj e 22 ditë nga data e hedhjes së shortit të parë.

Pas rishortimit të parë seanca e parë është caktuar pas 2 muaj e 9 ditë nga data e hedhjes së shortit të dytë.

Pas rishortimit të dytë seanca e parë është caktuar pas 5 muaj e 8 ditë.

Nga ana e gjyqtarit të çështjes janë kryer këto veprime procedurale si më poshtë:

- 1. Seanca e datës 28.10.2021**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar se është paraqitur pala paditëse dhe përfaqësuesi i tij i cili legjitimohet nga gjykata. Nuk është paraqitur njëra nga palët e paditura e cila rezulton të mos ketë marrë dijeni. Për palën tjetër të paditur e cila nuk është paraqitur edhe pse ka dijeni për seancën, gjykata ka marrë vendim për gjykim në mungesë. Për të njoftuar me shpallje publike palën e paditur, gjykata ka shtyrë seancën për në datën 02.12.2021 (1 muaj e 4 ditë).
- 2. Seanca e datës 02.12.2021**, kjo seancë është zhvilluar në prezencë të palës paditëse, nuk janë paraqitur palët e paditura, për të cilat është vendosur gjykim në mungesë. Gjykata ka vendosur të pranojë kërkesën e paditësit për të thërritur personin e tretë. Seanca e radhës u caktua në datën 03.02.2022 (2 muaj e 1 ditë).
- 3. Seanca e datës 03.02.2022**, kjo seancë është zhvilluar në prani të përfaqësuesit të palës paditëse dhe në mungesë të palëve të paditura, në mungesë rezulton gjithashtu edhe personi i tretë. Pas kërkesës së palës paditëse për caktimin e një eksperti, gjykata ka vendosur të shtyjë seancën për në datën 09.03.2022, me qëllim njoftimin

e Institutit të Mjekësisë Ligjore për vënien në dispozicion të një eksperti mjekoligjor (1 muaj e 6 ditë).

4. **Seanca e datës 09.03.2022**, kjo seancë është zhvilluar në prezencë të palës paditëse, për palët e paditura është marrë vendimi për gjykim në mungesë. Institucioni i ML-së ka informuar gjykatën në lidhje me moskryerjen e këtij inspektimi dhe me kërkesë të palës paditëse është caktuar seanca e radhës për në datë 21.03.2022 me qëllim thirrjen e një eksperti privat (ka qenë eksperti XH.C) (12 ditë)
5. **Seanca e datës 21.03.2022**, kjo seancë është shtyrë për t'u zhvilluar në datën 28.03.2022, për shkak se data 21.03.2022 ka rezultuar festë zyrtare. (7 ditë).
6. **Seanca e datës 28.03.2022**, seanca është zhvilluar vetëm në prani të ekspertit (A.LL)³⁵. Gjykata ka relatuar kërkesën për shtyrje nga pala paditëse. Për të njoftuar palën paditëse, gjykata ka shtyrë seancën për në datën 30.03.2022 (2 ditë).
7. **Seanca e datës 30.03.2022**, në këtë seancë gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve ka konstatuar prezencën e përfaqësuesit të palës paditëse dhe ekspertit A.LL. Për ti lënë kohë ekspertit të hartojë aktin e ekspertimit është shtyrë seanca për në datë 11.05.2022 (1 muaj e 11 ditë).
8. **Seanca e datës 11.05.2022**. kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak se gjyqtari ndodhej në trajnim. Seanca e radhës është caktuar në datën 01.06.2022 (21 ditë).
9. **Seanca e datës 01.06.2022**, kjo seancë është zhvilluar në prani të paditësit, dhe në mungesë të palëve të paditura. Është paraqitur eksperti i cili ka kërkuar shtyrjen e seancës pasi nuk është përgatitur akti për shkak se pala ndodhej jashtë shtetit. Seanca është shtyrë për në datën 05.07.2022 (1 muaj e 4 ditë).
10. **Seanca e datës 05.07.2022**, kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të bojkotit të avokatëve. Seanca e radhës është caktuar në datën 11.10.2022 (3 muaj e 6 ditë).
11. **Seanca e datës 11.10.2022**, kjo seancë është shtyrë për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye shëndetësore. Seanca e radhës është në datën 07.11.2022 (27 ditë)
12. **Seanca e datës 07.11.2022**, seanca nuk është zhvilluar për shkak se gjyqtari ishte deleguar në një gjykatë tjetër. Seanca e radhës është caktuar në datën 18.01.2023 (2 muaj 11 ditë)
13. **Seanca e datës 18.01.2023**, në këtë seancë nuk është paraqitur asnjë prej palëve. Gjykata ka relatuar kërkesën e palës paditëse për shtyrje të seancës. Për të njoftuar palën paditëse është shtyrë seanca për në datën 05.04.2023.

- **Çështja u rishortua në datën 20.03.2023**

14. **Seanca e datës 29.05.2023**, kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të një kërkesë për shtyrje të ardhur nëpërmjet e-mailit nga pala paditëse. Për të njoftuar palën paditëse, seanca është shtyrë për në datën 11.07.2023 (1 muaj e 12 ditë).
15. **Seanca e datës 11.07.2023**, kjo seancë është zhvilluar në prezencë të përfaqësuesit të palës paditëse. Gjykata ka relatuar se ka vendosur të njoftohet

³⁵ Në seancën e datës 28.03.2022 gjykata relaton paraqitjen e një eksperti tjetër. Nuk identifikohen shkaqet e ndërrimit të ekspertit

personalisht njëra nga palët e paditura e cila më herët është njoftuar dhe për shkak të adresës nuk ka marrë dijeni. Për të njoftuar përsëri palën e paditur³⁶ me shpallje publike, gjykata ka shtyrë seancën 13.09.2023 (2 muaj e 2 ditë).

16. Seanca e datës 13.09.2023, kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye shëndetësore. Seanca e radhës është caktuar në datën 03.04.2024.

- **Çështja është rishortuar në datën 26.10.2023**

17. Seanca e datës 03.04.2024, në këtë seancë pasi është verifikuar prezenca e palëve, ka rezultuar se është njoftuar paditësi dhe nuk është paraqitur por është paraqitur përfaqësuesi i palës paditëse, është njoftuar e paditura me fletëthirrje, kthyer me shënimin larguar, është njoftuar pala tjetër e paditur si dhe personi tretë dhe nuk janë paraqitur. Për të përsëritur njoftimet pasi nuk është përcaktuar lidhja me palën paditëse, është shtyrë seanca për në datën 20.05.2024. (1 muaj e 17 ditë)

18. Seanca e datës 20.05.2024, në këtë seancë është paraqitur babai i paditësit dhe përfaqësuesi i palës paditëse të cilët kanë kërkuar shtyrjen e seancës për shkak se paditësi ndodhet jashtë shtetit. Në vijim gjykata ka pranuar kërkesën dhe ka shtyrë seancën për në datën 06.06.2024. (17 ditë)

19. Seanca e datës 06.06.2024, në këtë seancë rezulton se nuk janë paraqitur paditësi dhe përfaqësuesi i tij. Gjykata ka relatuar se 2 seancat e kaluara janë shtyrë me qëllimin e njoftimit të palës paditëse nëpërmjet të atit për të qene prezent dhe duke marrë të mirëqenë faktin se është ezauruar njoftimi, gjykata ka pushuar gjykimin.

Për këtë çështje konstatohet se janë zhvilluar 19 seanca. Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë, 06.05.2021 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës, 06.06.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 3 vjet dhe 1 muaj

Në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave ndër të tjera konstatohen 5 seanca të shtyra për shkak të mungesës së gjyqtarit (1 seancë për shkak të festës zyrtare, 1 seancë për shkak të delegimit të gjyqtarit në një gjykatë tjetër, 1 seancë e shtyrë për shkak të pjesëmarrjes në trajnim të gjyqtarit dhe 2 seanca të shtyra për shkak të gjendjes shëndetësore); 2 seanca të shtyra për shkak të mungesës së palës së paditur; 4 seanca të shtyra për shkaqe që lidhen me ekspertin dhe aktin e ekspertimit; 5 seanca të shtyra për shkak të palës paditëse; 1 seancë e shtyrë për shkak të bojkotit të avokatëve; 1 seancë e shtyrë për shkak të thërritjes së personit të tretë.

Distanca kohore nga seanca në seancë:

Për gjyqtarin e parë: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 2 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 6 muaj e 21 ditë.

Për gjyqtarin e dytë: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 1 muaj e 12 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 2 muaj e 2 ditë.

³⁶ Për palën e paditur ka rezultuar vendimi i gjykimit në mungesë pasi nuk është paraqitur në asnjë seancë të zhvilluar edhe pse është njoftuar me shpallje publike. Nuk identifikohet se kur është paraqitur e paditura dhe kur është revokuar vendimi i mungesës (seancat e datave në të cilat është marrë vendimi për mungesën e palëve të paditura janë: 09.03.2022, 30.03.2022 dhe 01.06.2022).

Për gjyqtarin e tretë: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 17 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 1 muaj e 17 ditë.

27. Çështja nr. 11112-00579-23-2022 me objekt “pjesëtim pasurie në bashkëpronësi”

Kërkesë padia është paraqitur në gjykatë në datë 07.06.2022, është regjistruar në këtë të fundit dhe është shortuar në datën 07.06.2022. Kjo çështje është shortuar dy herë përkatësisht: shorti i parë – 07.06.2022; shorti i dytë – 26.10.2023.

Seanca e parë është caktuar pas 4 muaj e 20 ditë nga data e hedhjes së shortit të parë.

Pas rishortimit seanca e parë është caktuar pas 3 muaj e 21 ditë nga data e hedhjes së shortit të dytë.

Nga ana e gjykatës janë kryer veprimet procedurale si më poshtë:

1. **Seanca e datës 27.10.2022**, kjo seancë është zhvilluar në prani të palës paditëse, në prani të njëjës prej palëve të paditura dhe përfaqësuesit të tij, nuk janë paraqitur 2 palët e tjera të paditura dhe personi i tretë edhe pse kanë dijeni rregullisht. Në vijim pasi deklarohet i hapur shqyrtimi gjyqësor, ftohen palët të japin shpjegime rreth padisë dhe akteve. Gjykata urdhëron kalimin në seancë gjyqësore. Seanca e radhës është caktuar në datën 12.12.2022 (1 muaj e 15 ditë).
2. **Seanca gjyqësore e datës 12.12.2022**, kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye trajnimi. Seanca e radhës është caktuar në datën 26.01.2023 (1 muaj e 14 ditë).
3. **Seanca gjyqësore e datës 26.01.2023**, kjo seancë është zhvilluar në prani të palës paditëse dhe në mungesë të palëve të paditura dhe personit të tretë. Me kërkesë të palës paditëse, gjykata ka caktuar një ekspert. Për të thërritur ekspertin është shtyrë seanca për në datën 07.02.2023 (11 ditë).
4. **Seanca gjyqësore e datës 07.02.2023**, kjo seancë është zhvilluar në prani të palës paditëse, ndërsa të paditurit janë në mungesë. Është paraqitur eksperti i cili pasi ka lexuar formulën e betimit, ka marrë detyrat. Seanca e radhës është përcaktuar në datën 26.04.2023 (2 muaj e 19 ditë).
5. **Seanca gjyqësore e datës 26.04.2023**, në këtë seancë nuk është paraqitur pala paditëse për arsye familjare, është paraqitur përfaqësuesi i palës së paditur për të cilën tashmë revokohet vendimi i mungesës. Nuk është paraqitur eksperti i cili ka depozituar kërkesë për shtyrje. Për të njoftuar paditësin dhe ekspertin, është shtyrë seanca për në datën 12.06.2023 (1 muaj e 17 ditë).
6. **Seanca gjyqësore e datës 12.06.2023**, kjo seancë është zhvilluar në prani të palës paditëse, nuk është paraqitur përfaqësuesi i palës së paditur për të cilin u deklarua mungesa, është paraqitur eksperti i cili ka kërkuar kohë për plotësimin e aktit. Seanca e radhës është caktuar në datën 13.09.2023 (3 muaj e 1 ditë).
7. **Seanca gjyqësore e datës 13.09.2023**, kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye shëndetësore.

- **Çështja u rishortua në datën 26.10.2023**

8. **Seanca gjyqësore e datës 16.02.2024**, në këtë seancë relatohet ndryshimi i trupit gjykues për shkak se gjyqtarja paraardhëse nuk ushtron aktualisht funksionin në këtë gjykatë. Gjykata pasi verifikon prezencën e palëve ka konstatuar se nuk është paraqitur pala paditëse (paraqitet me vonesë në seancë), është paraqitur një nga të paditurit i cili ka deklaruar se do të përfaqësohet me avokat, nuk është paraqitur i padituri tjetër edhe pse ka dijeni për seancën, nuk është paraqitur as personi i tretë. Për ti lënë kohë palës paditëse të paraqesë praktikën shkresore, gjykata ka shtyrë seancën për në datë 29.03.2024 (1 muaj e 13 ditë).
9. **Seanca gjyqësore e datës 29.03.2024**, kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye familjare. Seanca e radhës është caktuar në datën 30.04.2024. (1 muaj e 1 ditë)
10. **Seanca gjyqësore e datës 30.04.2024**, kjo seancë është zhvilluar në prani të palës paditëse, për një të paditur u paraqit përfaqësuesi, ndërsa për të paditurit e tjerë ka vijuar gjykimi në mungesë. Gjykata pasi është relativuar seanca e kaluar, i tërheq vëmendjen palës paditëse. Seanca është shtyrë për në datën 07.06.2024 (1 muaj e 8 ditë).
11. **Seanca gjyqësore e datës 07.06.2024**, në të cilën pasi u verifikua prezenca e palëve u konstatua mungesa e palës paditëse. Në vijim gjykata ka vlerësuar se paditësi nuk ka interes për çështjen dhe për këtë shkak vendos pushimin e gjykitimit.

Për këtë çështje konstatohet se janë zhvilluar 11 seanca. Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë 07.06.2022 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës, 07.06.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 2 vjet.

Në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave ndër të tjera konstatohen 3 seanca të shtyra për shkak të mungesës së gjyqtarit (1 seancë e shtyrë për shkak të pjesëmarrjes në trajnim të gjyqtarit dhe 1 seancë për shkak të gjendjes shëndetësore të tij dhe një seancë për shkaqe të tjera); 3 seanca të shtyra për shkak të palës paditëse; 1 seancë e shtyrë për shkak të kalimit të çështjes në seancë gjyqësore

Distanca kohore nga seanca në seancë:

Për gjyqtarin e parë: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 11 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 5 muaj e 3 ditë

Për gjyqtarin e dytë: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 1 muaj e 1 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 1 muaj e 13 ditë

28. Çështja me nr. 21235-01262-23-2021 me objekt “Detyrimin e palës së paditur të përmbush detyrimin kontraktor ndaj paditësve, detyrimin e palës së paditur ti dorëzojë paditësve ambientin dyqan, shpërblim dëmi etj.”

Kërkesë padia është paraqitur në gjykatë në datë 16.12.2021, është regjistruar në datë 16.12.2021 si dhe është shortuar brenda kësaj date.

Kjo çështje është shortuar 1 herë përkatësisht: shorti – 16.12.2021;

Seanca e parë është caktuar pas 2 muaj e 21 ditë nga data e hedhjes së shortit.

Nga ana e gjykatës janë kryer veprimet procedurale si më poshtë:

1. **Seanca e datës 09.03.2022**, (seancë përgatitore) në të cilën gjykata ka verifikuar prezencën e palëve, janë paraqitur paditësit, nuk është paraqitur pala e paditur e cila ka dijani dhe ka kërkuar shtyrjen e seancës. Gjykata pas legjitimitit të përfaqësuesve të palës paditëse ka pranuar kërkesën për shtyrje dhe ka caktuar seancën e radhës më datë 05.04.2022, (pas 26 ditë)
2. **Seanca gjyqësore datë 05.04.2022**. Gjykata pasi ka verifikuar prezencën e palëve, ku rezulton të jenë paraqitur avokatët përkatës dhe avokati i palës së paditur ka kërkuar kohë të njihet me çështjen. Gjykata ka pranuar kërkesën dhe ka shtyrë seancën për më datë 12.05.2022, (pas 36 ditë).
3. **Seanca gjyqësore datë 12.05.2022**, nuk është zhvilluar pasi gjyqtari nuk ka qenë prezent për shkak të trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës dhe seanca e radhës është caktuar 15.06.2022. (pas 1 muaj e 3 ditë).
4. **Seanca gjyqësore datë 15.06.2022**, ku rezulton të mos jenë paraqitur as pala paditëse dhe as e paditur dhe as avokatët përkatës për shkak të një bojkoti të të gjitha proceseve gjyqësore për shkak të hartës së re gjyqësore, nga ana a DHASH (Dhomës Kombëtare të Avokatisë) dhe seanca e radhës është caktuar më datë 27.09.2022, (3 muaj e 12 ditë)
5. **Seanca gjyqësore e datës 27.09.2022**, pas verifikimit të prezencës së palëve dhe prezencës së avokatëve përkatës është deklaruar i hapur shqyrtimi gjyqësor dhe është parashtruar padia dhe provat. Gjykata ka vlerësuar caktimin e një eksperti për të konstatuar gjendjen e pronës objekt gjykimi aktualisht. Seanca e radhës është planifikuar në datë 03.11.2022, (1 muaj e 7 ditë).
6. **Seanca e datës 03.11.2022**. Gjykata pas verifikimit të prezencës së palëve ka vijuar me betimin e 2 ekspertëve dhe caktimin e detyrave, të cilëve i është lënë kohë edhe për paraqitjen e akteve. (4 muaj e 25 ditë).
7. **Seanca e datës 28.03.2023**, rezulton që palët të jenë njohur me aktin e ekspertimit dhe përfaqësuesi i palës paditëse ka kërkuar shtrim të objektit nisur nga akti i ekspertimit dhe gjithashtu kanë kërkuar kohë për pagimin e 1% të shumës. Gjithashtu paditësit kanë kërkuar edhe thirrjen si person i tretë të personit që mund të ketë me qera ambientin. Gjykata ka vlerësuar të pranojë kërkesat dhe ka shtyrë seancën datë 20.04.2023. (23 ditë).
8. **Seanca e datës 20.04.2023**, pas verifikimit të prezencës së palëve ku ka rezultuar se nuk është paraqitur pala e tretë (letërthirrja me shënimin i panjohur), nga pala paditëse rezulton të jetë paguar 1 % dhe gjykata ka vlerësuar të njoftojë palën e tretë me shpallje publike dhe ka shtyrë seancën datë 06.06.2023. (1 muaj e 17 ditë)
9. **Seanca e datës 06.06.2023**, rezulton të jetë paraqitur pala e tretë, i cili ka pohuar se objektin e ka marrë me qera nga pronari i tokës. Gjykata i ka lënë detyrë palës së paditur të paraqes aktet se në emër të kujt është objekti në të kundërt do të gjobetet pala e paditur. Seanca e radhës është caktuar 19.07.2023. (1 muaj e 13 ditë)
10. **Seanca e datës 19.07.2023**, avokati i palës së paditur nuk ka sjellë aktet e kërkuara me arsyetimin se klienti i tij është sëmurë. Në këto kushte gjykata vendos të gjobis palën e paditur (firmën e ndërtimit) me 50 mijë lekë gjobë, pasi po bëhet shkak për zvarritjen e gjykimit dhe me dashje po fsheh rrethanat në lidhje me çështjen objekt gjykimi. Gjithashtu gjykata vendos ti drejtohet ASHK Sarandë me qëllim

verifikimin e pronësisë së sendit objekt gjykimi dhe të gjitha aktet që kanë të bëjnë me praktikën e regjistrimit. I lihet sërish detyrë palës së paditur të paraqes aktet dhe shtyn seancën për më datë 26.10.2023. (3 muaj e 7 ditë).

11. **Seanca e datës 26.10.2023**, pas verifikimit të prezencës së palëve rezulton të jetë paraqitur edhe administratori i shoqërisë dhe nuk është paraqitur pala e tretë. Gjithashtu rezulton të ketë kthyer përgjigje ASHK Sarandë. Administratori i shoqërisë deklaroi se nuk ka kontratë të lidhur me personin e tretë dhe gjithashtu paraqet kontratën e sipërmarrjes dhe vendimin e Gjykatës së Apelit Administrativ e cila ka lënë në fuqi këtë aktmarrëveshje. Gjykata pyet paditësit se kush ja cenon aktualisht pronësinë dhe i tërheq vëmendjen paditësit të përcaktoj në mënyrë të qartë shkakun ligjor të padisë, pasi kanë 2 vjet që zvarrisin procesin dhe është e pa tolerueshme që nuk i tregohet e vërteta gjykatës. Seanca e radhës shtyhet për më datë 12.12.2023 (1 muaj e 16 ditë).
12. **Seanca e datës 12.12.2023**, nuk është zhvilluar pasi magjistrati për arsye shëndetësore nuk është paraqitur në punë. Seanca e radhës caktuar më 31.01.2024 (1 muaj e 19 ditë).
13. **Seanca e datës 31.01.2024** nga seanca e kaluar ishte shtyrë për saktësimin e shkakut të padisë, nga ana tjetër avokati i palës së paditur shprehet se firma e ka të pamundur të ekzekutoj detyrimin për sa kohë dyqanin e ka zënë dikush tjetër dhe për këtë fakt janë në proces gjyqësor. Gjykata i lë detyrë palës së paditur të sjellë një vërtetim që janë në proces gjyqësor. Seanca e radhës shtyhet për më 07.03.2024 (1 muaj e 7 ditë).
14. **Seanca e datës 07.03.2024**, rezulton të jetë depozituar vërtetimi i kërkuar nga gjykata dhe në referim të nenit 213 të K.Pr.Civile gjykata vendos të lejoj për shqyrtim të gjitha provat dhe urdhërohet kalimi në seancë gjyqësore në referim të nenit 158 të K. Pr. Civile. Seanca e radhës 09.04.2024 (1 muaj e 2 ditë).
15. **Seanca e datës 09.04.2024**, pas verifikimit të prezencës së palëve është deklaruar e hapur seanca gjyqësore dhe gjykata ka marrë në administrim provat duke deklaruar të mbyllur shqyrtimin gjyqësor dhe ka kaluar në diskutime përfundimtare. Është kërkuar kohë për ti paraqitur me shkrim dhe gjykata ka caktuar seancën e radhës datë 16.04.2024 (7 dite)
16. **Seanca e datës 16.04.2024**, avokati i palës paditëse ka qenë në pamundësi për arsye familjare për përgatitjen e konkluzioneve dhe e ka lënë në vlerësim të gjykatës, e cila ka shtyrë seancën e radhës 23.04.2024 (7 ditë)
17. **Seanca e datës 23.04.2024**, rezulton që pas verifikimit të prezencës së palëve rezulton të jetë paraqitur pala e tretë e cila ka paraqitur kontratën e qerasë dhe një kërkesë për të dal jashtë gjykimit, e cila nuk i është pranuar nga gjykata. Janë depozituar e administruar konkluzionet. Shtyhet seanca për shpalljen e vendimit datë 14.05.2024. (21 ditë)
18. **Seanca e datës 14.05.2024**, rezulton të mos jetë zhvilluar për shkak se gjyqtari për arsye shëndetësore nuk mund të paraqitet në punë. Seanca e radhës datë 06.06.2024. (23 ditë)
19. **Seanca e datës 06.06.2024**, nuk është zhvilluar për shkak të mosparaqitjes së palëve për shkak të bojkotimit të seancave nga ana e avokatëve, sipas vendimit të DHKA. Seanca e radhës 11.06.2024. (5 ditë)

20. Seanca e datës 11.06.2024, rezulton të jetë shpallur vendimi, duke vendosur: “Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë, detyrimin e palëve të paditur të përmbush detyrimin kontraktor etj”.

Për këtë çështje konstatohet se janë zhvilluar 20 seanca. Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë 16.12.2021, dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës 11.06.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 2 vite e 5 muaj e 26 ditë. Në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave ndër të tjera konstatohen me palën e paditur 2 seanca; mosparaqitjen e personit të tretë 3 seanca; caktimin e ekspertëve dhe kryerjen e akt ekspertimeve 3 seanca; 3 seanca të pazhvilluara, për shkak të mungesës së gjyqtarit se ka qenë në trajnim 1 seancë; për shkak të gjendjes shëndetësore 2 seanca; për shkaqe të tjera bojkotit të organizuar nga DHKA 2 seanca; 1 seancë rezulton të jetë shtyrë për shkak të kërkesës për shtyrje të paraqitur nga përfaqësuesi i palës paditëse i cili për arsye familjare ka qenë në pamundësi të përgatitjes së konkluzioneve përfundimtare; gjithashtu arsye të tjera për plotësim të detyrave të lëna nga gjykata si depozitim kontratash, korespondenca me institucione ASHK Sarandë etj .

Distanca kohore ndërmjet seancave: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 5 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 4 muaj e 25 ditë.

29. Çështja me nr. 21262-00235-23-2021 “konstatim pavlefshmëri absolute të vendimeve”

Kjo çështje është relatuar me detaje tek pika 5.4. e këtij raporti (shkaqet e zgjatjes së proceseve duke ju referuar llojit të objektit të padis) .

Në mënyrë të përmbledhur konstatohet se për këtë çështje gjykata ka zhvilluar gjithsej 20 seanca. Referuar datës 18.03.2021 të depozitimit të kërkesëpadisë dhe datës 11.06.2024 të vendimmarrjes së gjykatës, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 3 vjet 2 muaj 24 ditë.

Referuar shkaqeve të shtyrjes së seancave ndër të tjera rezultojnë 2 seanca të shtyra për shkak të mungesës së gjyqtarit për shkak delegimi si dhe shkaqe të tjera, 3 seanca të shtyra për shkak të mosmarrjes dijeni të palëve ndërgjyqëse për seancën si dhe për shkak të njohjes së tyre me provat e reja.

Distanca kohore ndërmjet seancave: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra çështje në tjetrën është 6 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra çështje në tjetrën është 4 muaj e 27 ditë.

30. Çështja nr. 21234-00113-23-2021 me objekt “Shpërblim dëmi”

Kjo çështje është relatuar me detaje tek pika 5.4. e këtij raporti (shkaqet e zgjatjes së proceseve duke ju referuar llojit të objektit të padis) .

Në mënyrë të përmbledhur konstatohet se për këtë çështje gjykata ka zhvilluar 19 seanca.

Referuar datës 02.02.2021 të depozitimit të kërkesëpadisë dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës 13.06.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 3 vjet, 4 muaj e 11 ditë.

Shkaqet e shtyrjes së seancave ndër të tjera lidhen me shkaqe procedurale që vijnë nga sjellja e paditësit (4 seanca) si kërkesa për shtyrje seance, rregullim prokure, si dhe me mungesën e gjyqtarit, (3 seanca) për arsye delegimi; familjare; festë zyrtare). Gjithashtu konstatohen seanca të shtyra për shkaqe që janë të lidhura me ekspertin dhe aktin e ekspertimit.

Për sa i përket distancës kohore ndërmjet seancave konstatohet se:

Për gjyqtarin e parë : Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 24 ditë. Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 3 muaj e 6 ditë.

Për gjyqtarin e dytë: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 12 ditë. Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 2 muaj e 14 ditë.

31. Çështja me nr. 21256-00646-23-2020-R, datë 15.03.2022, me objekt “ Pushim cenimi në posedim”

Kërkesë padia është paraqitur në gjykatë në datë 15.03.2022, është regjistruar në datë 15.03.2022 si dhe është shortuar brenda kësaj date.

Kjo çështje është shortuar dy herë përkatësisht: shorti i parë – 15.03.2022; shorti i dytë – 26.10.2023.

Seanca e parë është caktuar pas 1 muaj e 24 ditë nga data e hedhjes së shortit të parë.

Seanca e parë pas shortit të dytë është caktuar pas 6 muaj e 19 ditë nga data e hedhjes së rishortimit.

Nga ana e gjykatës janë kryer veprimet procedurale si më poshtë:

- 1. Seanca e datës 09.05.2022**, nuk është zhvilluar për shkak se gjyqtarja për arsye familjare nuk është paraqitur, seanca e radhës është shtyrë për më 13.06.2022. (1 muaj e 4 ditë)
- 2. Seanca e datë 13.06.2022**, ka evidentuar faktin se gjyqtarja ndodhet në seminar trajnues dhe palët për seancën e radhës do njoftohen me fletëthirrje. Seanca e radhës 21.09.2022. (3 muaj e 8 ditë)
- 3. Seanca përgatitore e datës 21.09.2022**, në të cilën gjykata pas verifikimit të prezencës së palëve konstaton se nuk është paraqitur përfaqësuesi i paditësve dhe se ka bërë kërkesë për shtyrje por që nuk i është bashkëlidhur prokura. Rezulton të jetë paraqitur avokati i të paditurve. Gjykata vendos të njoftoj personalisht palët për seancën e radhës datë 10.11.2022. (1 muaj e 20 ditë).
- 4. Seanca përgatitore e datës 10.11.2022**, rezulton të jetë paraqitur avokati për palën paditëse dhe të mos jetë paraqitur avokati i të paditurve (i cili ka qenë prezent seancën e kaluar dhe ka pasur dijeni). Përfaqësuesi i paditësve ka bërë kërkesë për tu njohur me dosjen pasi nuk ka kopje të dokumentacionit. Seanca e radhës 31.01.2023. (2 muaj e 21 ditë).
- 5. Seanca e datës 31.01.2023** nuk është zhvilluar për shkak se gjyqtarja ka qenë në trajnim në Shkollën e Magjistraturës. Seanca e radhës është planifikuar në datë 20.03.2023(1 muaj e 20 ditë)

6. **Seanca e datës 20.03.2023**, nuk është zhvilluar për shkak se gjyqtarja ka qenë në trajnim në Shkollën e Magjistraturës. Seanca e radhës është planifikuar në datë 18.04.2023 (29 ditë)
7. **Seanca e datës 18.04.2023**, është shtyrë me kërkesë të palës paditëse. Seanca e radhës është planifikuar në datë 31.05.2023.(1 muaj e 13 ditë)
8. **Seanca e datës 31.05.2023**, është shtyrë me kërkesë të palës paditëse, e cila i ka bashkëlidhur kërkesës raport mjekësor. Seanca e radhës është planifikuar në datë 13.09.2023 (3 muaj e 13 ditë).
9. **Seanca e datës 13.09.2023** nuk është zhvilluar pasi gjyqtarja për arsye shëndetësore nuk mund të paraqitet. Seanca e radhës është planifikuar në datë 18.10.2023 (1 muaj e 5 ditë).

- **Çështja është rishortuar në datë 26.10.2023**

10. **Seanca përgatitore e datës 15.05.2024** gjykata verifikon prezencën e palëve, ku rezulton se nuk është paraqitur përfaqësuesja e palës paditëse, është paraqitur përfaqësuesi i të paditurit. Gjykata vendos të përsëris njoftimin për palët paditëse dhe shtyn seancën e radhës datë 13.06.2024. (29 ditë)
11. **Seanca e datës 13.06.2024**, rezulton të jetë verifikuar prezenca e palëve, ku përfaqësuesja e palëve paditëse nuk rezulton të jetë paraqitur për të dytën herë radhazi, pa shkak të arsyeshëm e në këto kushte gjykata është tërhequr në dhomë këshillimi, duke vendosur: “Pushimin e gjykimit të çështjes nr. 21256-00646-23-2020-R, datë 15.03.2022”.

Për këtë çështje konstatohet se janë zhvilluar 11 seanca. Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë 15.03.2022 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës 13.06.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 2 vjet, 2 muaj e 29 ditë.

Në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave ndër të tjera konstatohen 6 seanca të shtyra për mosparaqitjen e përfaqësuesit të palëve paditëse; gjithashtu për shkak të mungesës së gjyqtarit 5 seanca përkatësisht për arsye trajnimi 3 seanca, për shkak gjendjes shëndetësore 2 seanca.

Distanca kohore ndërmjet seancave:

Për gjyqtarin e parë: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 29 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 3 muaj e 13 ditë. Për gjyqtarin e dytë: Rezulton që gjyqtari i dytë të ketë planifikuar vetëm 1 seancë në distancë kohore 29 ditë dhe në tjetër të ketë vendosur pushimin e gjykimit pasi përfaqësuesi i paditëse nuk u paraqit 2 herë radhazi pa shkaqe të arsyeshme edhe pse rezultonte të kishte marrë dijani.

32. Çështja me nr. 21246-01241-23-2021, datë 09.12.2021, me objekt “Detyrimin e paditurve të njohin paditësit pronar të vetëm etj.”

Kërkesë padia është paraqitur në gjykatë në datë 09.12.2021, është regjistruar në datë 09.12.2021 si dhe është shortuar brenda kësaj date.

Kjo çështje është shortuar dy herë përkatësisht: shorti i parë – 09.12.2021; shorti i dytë – 20.03.2023.

Seanca e parë është caktuar pas 4 muaj e 12 ditë nga data e hedhjes së shortit të parë.

Seanca e parë është caktuar pas 6 muaj e 6 ditë nga data e hedhjes së shortit të dytë.

Nga ana e gjyqtarit të çështjes janë kryer këto veprime procedurale si më poshtë:

1. **Seanca e datës 21.04.2022**, pas verifikimit të prezencës së palëve rezulton të mos jenë paraqitur pala e paditur dhe të mos jetë paraqitur Agjencia e Kadastrës Sarandë. Gjykata shtyn seancën për të njoftuar me shpallje publike të paditurit për më datë 23.06.2022. (2 muaj e 2 ditë)
2. **Seanca e datë 23.06.2022**, rezulton të mos jetë paraqitur asnjë nga palët dhe gjithashtu avokatët kanë bërë bojkot të seancave. Seanca e radhës shtyhet për më 30.09.2022. (3 muaj e 7 ditë)
3. **Seanca përgatitore e datës 30.09.2022**, pas verifikimit të prezencës së palëve rezulton të mos jetë paraqitur një prej të paditurve i cili ka dijeni me shpallje dhe Agjencia e Kadastrës dhe gjykata ka marrë vendim të zhvillojë seancën në mungesë së tyre. Gjithashtu për ti lënë kohë avokatit të palës së paditur të sigurojë prokurën seanca e radhës shtyrë për më 19.10.2022 (19 ditë).
4. **Seanca gjyqësore e datës 19.10.2022**, rezulton që pas verifikimi të prezencës së palëve, i është dhënë fjala palës paditëse e cila ka paraqitur padinë dhe gjithashtu ka kërkuar kohë për pajtim. Për këtë arsye, me qëllim lënien kohë palëve për pajtim ka shtyrë seancën gjyqësore për më datë 19.12.2022. (2 muaj)
5. **Seanca gjyqësore e datës 19.12.2022**, nuk është zhvilluar për shkak se gjyqtari ndodhet në seminar trajnimi, seanca e radhës është caktuar datë 08.02.2023. (1 muaj e 20 ditë)
6. **Seanca gjyqësore e datës 08.02.2023**, pas verifikimit të prezencës së palëve rezulton të ketë paraqitur kërkesë me e-mail për shtyrje avokati i palës paditëse, gjykata në këto kushte pranon kërkesën dhe shtyn seancën për më datë 10.05.2023.

Çështja është rishortuar në datë 20.03.2023

7. **Seanca e datës 26.09.2023** pas verifikimit të prezencës së palëve rezulton të ketë paraqitur kërkesë për shtyrje avokati i palës paditëse, gjykata ka pranuar kërkesën dhe shtyn seancën për më datë 15.11.2023 (1 muaj e 20 ditë).
8. **Seanca e datës 15.11.2023**, pas verifikimit të prezencës së palëve rezulton se fletë thirrja për të paditurën A.N ka ardhur me shënimin: “*refuzuar ndodhet jashtë vendit*” dhe gjykata ka marr vendim për të shtyrë seancën për më datë 18.01.2024, për të njoftuar edhe njëherë të paditurën A.N. (2 muaj e 3 ditë)
9. **Seanca e datës 18.01.2024**, pas verifikimit të prezencës së palëve rezulton të ketë ardhur fletëthirrja me shënimin larguar për të paditurën A.N, ndërkohë që vazhdojnë në mungesë V.N dhe ASHK Sarandë. Gjykata merr vendim për të njoftuar me shpallje publike palën e paditur A.N. Seanca e radhës 06.03.2024 (1 muaj e 17 ditë)
10. **Seanca e datës 06.03.2024**, rezulton të jetë çelur shqyrtimi gjyqësor, avokati i palës paditëse i ka bërë me dije gjykatës se për objektin nuk mund të bëhet

pjesëtimi fizik, është përgatitur edhe akti i ekspertimit për këtë fakt dhe në Gjykatën e Sarandës kanë dalë edhe vendimet për fazën e parë. Gjykata i lë detyrë avokatit të palës paditëse të sjellë vendimet dhe gjithashtu administron aktin e ekspertimit. Seanca e radhës 15.04.2024 (1 muaj e 9 ditë).

11. **Seanca e datës 15.04.2024**, nuk është zhvilluar për shkak të mosparaqitjes në punë për arsye familjare të gjyqtarit. Seanca e radhës është caktuar datë 22.05.2024. (1 muaj e 7 ditë).
12. **Seanca e datës 22.05.2024**, është shtyrë me kërkesë të avokatit të palës paditëse i cili shprehet se i ka gati vendimet e kërkuara nga gjykata në seancën e kaluar, i kanë mbetur vetëm për vula. Gjykata shtyn seancën për më datë 13.06.2024. (22 ditë).
13. **Seanca e datës 13.06.2024**, rezulton të jetë depozituar vendimi i Apelit nga avokati i palës paditëse i cili i jep përgjigje pyetjeve të gjykatës dhe sqaron, gjykata tërhiqet për vendim dhe vendos: "Pushimin e gjykimit të çështjes nr.21246-01241-23-2021/1536/684/297 regjistri themeltar, datë regjistrimi 09.12.2021, pasi padia nuk mund të ngrihej dhe gjykimi nuk mund të vazhdojë.

Për këtë çështje konstatohet se janë zhvilluar 13 seanca. Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë 09.12.2021, dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës 13.06.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 2 vjet, 6 muaj e 4 ditë.

Në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave ndër të tjera konstatohen 4 seanca për mosparaqitjen e palëve të paditura; bojkotit të DHKA-së 1 seancë; kërkesa për shtyrje të palës paditëse 2 seanca; mungesës së gjyqtarit 2 seanca në total pasi ndodhej në trajnim 1 seancë, për arsye shëndetësore 1 seancë.

Distanca kohore ndërmjet seancave:

Për gjyqtarin e parë; Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 19 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 3 muaj e 7 ditë. Për gjyqtarin e dytë; Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 22 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 2 muaj e 3 ditë.

33. Çështja me nr. 21256-00456-23-2022 me objekt: "pushim cenimi në posedim"

Kjo çështje është relatuar me detaje tek pika 5.4 e këtij raporti (shkaqet e zgjatjes së proceseve duke ju referuar llojit të objektit të padis) .

Në mënyrë të përmbledhur konstatohet se për këtë çështje gjykata ka zhvilluar 13 seanca. **Referuar datës 05.05.2022 së depozitimit të kërkesëpadisë dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës 13.06.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 2 vjet, 1 muaj e 8 ditë.**

Në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave pjesë e konsiderueshme e shkaqeve të shtyrjes lidhen me ekspertin dhe aktin e ekspertimit. Gjithashtu 3 seanca janë shtyrë për shkak të palës paditëse. Për shkak të gjykatës është shtyrë 1 seancë (trajnim gjyqtari) ndërsa 1 seancë është shtyrë për shkak të bojkotit të avokatëve. Konstatohet gjithashtu se 1 seancë është shtyrë për shkak të shqyrtimit të kërkesës për përjashtim gjyqtari.



Distanca kohore nga seanca në seancë: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 8 ditë. Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 5 muaj e 8 ditë.

34. Çështja me nr. 11112-01027-23-2021 me objekt “ Pjesëtim i sendit në bashkëpronësi”

Kjo çështje është relatuar me detaje tek pika 5.4 e këtij raporti (shkaqet e zgjatjes së proceseve duke ju referuar llojit të objektit të padis) .

Në mënyrë të përmbledhur konstatohet se për këtë çështje gjykata ka zhvilluar 12 seanca. Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë 26.10.2021 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës 24.06.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 2 vjet 7 muaj 29 ditë.

Shtyrjet janë për shkak të veprimeve procedurale që kanë të bëjnë me aktin e ekspertimit, mosparaqitja e përsëritur e ekspertes si dhe për mosparaqitje të palëve të paditura. Evidentohet 1 shtyrje për shkak të mungesës së gjyqtarit.

Distanca ndërmjet seancave:

Për gjyqtarin e parë: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra çështje në tjetrën është 1 muaj e 17 ditë. Distanca më e gjatë kohore nga njëra çështje në tjetrën është 3 muaj e 17 ditë.

Për gjyqtarin e dytë: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra çështje në tjetrën është 15 ditë. Distanca më e gjatë kohore nga njëra çështje në tjetrën është 1 muaj e 24 ditë.

35. Çështja nr. 11232-01686-23-2014 me objekt “pjesëtim pasurie bashkëshortore”

Kërkesë padia është paraqitur në gjykatë në datë 01.12.2014, është regjistruar në këtë të fundit dhe është shortuar në datën 01.12.2014.

Kjo çështje është shortuar 6 herë përkatësisht:

- Shorti i I-rë në datë 01.12.2014. Seanca e parë është caktuar 15 ditë pas hedhjes së shortit.
- Shorti i 2-të në datë 09.04.2015. Seanca e parë është caktuar 15 ditë pas hedhjes së këtij shorti.
- Shorti i 3-të në datë 10.10.2015. Seanca e parë është caktuar 18 ditë pas hedhjes së këtij shorti.
- Shorti i 4-rt në datë 30.09.2020. Nuk ka planifikim seance pasi vendimi për fazën e parë të pjesëtimin të datës 04.12.2015 është rekursuar në Gjykatë të Lartë e cila me vendimin nr.00-2021-1225 datë 05.07.2021 ka vendosur “mospranimin e rekursit”
- Shorti i 5-të në datë 20.09.2021. Seanca e parë është caktuar 2 muaj e 12 ditë pas hedhjes së këtij shorti.
- Shorti i 6-të në datë 26.10.2023. Seanca e parë është caktuar 3 muaj e 14 ditë pas hedhjes së këtij shorti.

Nga ana e gjykatës janë kryer këto veprime procedurale si më poshtë:

1. **Seanca e datës 16.12.2014**, në këtë seancë pasi u verifikua prezenca e palëve u konstatua se nuk janë paraqitur palët ndërgjyqëse, janë njoftuar por nuk kanë dijeni. Për të njoftuar paditësen dhe plotësimin e të metave, gjykata ka shtyrë seancën për në datën 29.12.2014 (13 ditë).
2. **Seanca e datës 29.12.2014**, kjo seancë është zhvilluar në prani të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur. Janë plotësuar të metat e padisë dhe për shkak se nuk ka zgjidhje me pajtim, është kaluar në seancë gjyqësore. Seanca e radhës është caktuar në datën 12.01.2015 (14 ditë).
3. **Seanca gjyqësore e datës 12.01.2015**, kjo seancë është zhvilluar në prani të palëve ndërgjyqëse. Për ti lënë kohë të paditurit të njihet me aktet e paraqitura objekt gjykimi, seanca është shtyrë për në datën 20.01.2015 (8 ditë)
4. **Seanca gjyqësore e datës 20.01.2015**, kjo seancë është zhvilluar në prani të palëve ndërgjyqëse si dhe janë legjitimuar përfaqësuesit ligjorë të tyre. Për ti lënë palëve për të paraqitur prova të reja, gjykata ka shtyrë seancën për në datën 04.02.2015 (15 ditë).
5. **Seanca gjyqësore e datës 04.02.2015**, kjo seancë është zhvilluar në prani të palëve ndërgjyqëse. Rezulton një kërkesë e palës paditëse për shtim të ndërgjyqësisë me person të tretë, kërkesë e cila është pranuar nga gjykata. Për ti lënë palës paditëse kohë të paraqesë prova të reja, seanca e radhës është shtyrë për në datën 16.02.2015 (12 ditë).
6. **Seanca gjyqësore e datës 16.02.2015**, kjo seancë është zhvilluar në prezencë të palës paditëse, të personit të tretë dhe të palës së paditur, mungon përfaqësuesi i të paditurit. Për ti lënë kohë palës së paditur për të siguruar avokatin, gjykata ka shtyrë seancën për në datën 27.02.2015 (11 ditë).
7. **Seanca gjyqësore e datës 27.02.2015**, kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të anazhimit të gjyqtarit në një mbledhje pune. Seanca e radhës është caktuar në datën 12.03.2015 (13 ditë)
8. **Seanca gjyqësore e datës 12.03.2015**, e cila është shtyrë për shkak të mungesës së gjyqtarit për shkak të analizës vjetore të gjykatës. Seanca është shtyrë për në datën 01.04.2015 (20 ditë).
9. **Seanca gjyqësore e datës 01.04.2015**, kjo seancë është zhvilluar në prezencë të palës paditëse, të personit të tretë dhe të palës së paditur, mungon përfaqësuesi i të paditurit. Për ti lënë kohë palëve të depozitojnë më shkrim konkluzionet për fazën e parë, ka caktuar seancën për në datën 15.04.2015.

- **Çështja është rishortuar në datën 09.04.2015³⁷ (shorti 2-të)**

10. **Seanca gjyqësore e datës 24.04.2015**, për të mundësuar përsëritjen e njoftimit të seancës palës të paditur (më shpallje) që nuk ka marrë dijeni, gjykata ka shtyrë seancën për në datën 14.05.2015 (21 ditë).

³⁷ Është vlerësuar dorëheqja me vendim datë 08.04.2025.



11. Seanca gjyqësore e datës 14.05.2015, kjo seancë është zhvilluar në prani të palëve të paditur dhe paditëse. Pala paditëse dhe pala e paditur kanë paraqitur një kërkesë për t'u përfaqësuar në mungesë të tyre. Në vijim gjykata pranon kërkesat dhe ka shtyrë seancën për në datën 05.06.2015 (22 ditë).

12. Seanca gjyqësore e datës 05.06.2015, kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye shëndetësore. Seanca e radhës është caktuar për në datën 28.10.2015

- **Çështja u rishortua në datën 10.10.2015 (shorti 3-të)**

13. Seanca gjyqësore e datës 28.10.2015, kjo seancë është shtyrë për në datën 13.11.2015, pasi gjykata pranoi kërkesën e palës paditëse për shtyrje³⁸ (16 ditë)

14. Seanca gjyqësore e datës 04.12.2015, në këtë seancë konstatohet se gjykata ka relatuar se procesi gjyqsor është shtyrë për t'ju drejtuar me shkresë të tretëve (kjo lidhet me procesverbalin e datës 13.11.2015 i cili mungonte). Në vijim gjykata, pasi administron provën ka vendosur ti japë fund fazës së parë të pjestimit, gjykata ka shpallur vendimin për fazën e parë të pjesëtimit.

- **Çështja u rishortua në datën 30.09.2020 (Shorti i 4-rt- konstatohet që gjyqtari i ri nuk ka planifikuar seancë për shkak se vendimi është rekursuar në Gjykatë të Lartë)**

- **Çështja u rishortua në datën 20.09.2021 (shorti i 5-të)**

15. Seanca gjyqësore e datës 02.12.2021, kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye shëndetësore. Seanca e radhës është caktuar në datën 07.02.2022 (2 muaj e 5 ditë).

16. Seanca gjyqësore e datës 07.02.2022, kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye shëndetësore (Covid 19). Seanca e radhës është caktuar në datën 10.03.2022 (1 muaj e 3 ditë).

17. Seanca gjyqësore e datës 10.03.2022, kjo seancë është zhvilluar në prani të palës paditëse dhe përfaqësuesit dhe të paditurit. Gjukata ka relatuar se kërkesa për heqje dorë nga gjykimi nuk është pranuar. Në vijim gjykata ka vlerësuar të caktojë një ekspert. Seanca e radhës është caktuar në datën 27.04.2022 (1 muaj e 17 ditë).

18. Seanca gjyqësore e datës 27.04.2022, kjo seancë është zhvilluar në prani të palës paditëse dhe përfaqësuesve të saj, palës së paditur dhe përfaqësueses së tij. Ka vijuar debati gjyqsor rreth padisë dhe në vijim gjykata ka deklaruar emrin e ekspertes për thërritjen e së cilës, është shtyrë seanca për në datën 13.06.2022 (1 muaj e 17 ditë).

19. Seanca gjyqësore e datës 13.06.2022, kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye të pjesëmarrjes në trajnim. Data e seancës së radhës nuk është përcaktuar (3 muaj e 2 ditë).

³⁸. Kostatojmë se nuk është mbajtur procesverbal për seancën e datës 13.11.2015 dhe nuk ka anulim për këtë planifikim.



- 20. Seanca gjyqësore e datës 15.09.2022**, kjo seancë është zhvilluar në prezencë të palëve ndërgjyqëse dhe përfaqësuesve të tyre. Gjykata ka relatuar se është paraqitur ekspertja dhe se ndodhen në fazën e dytë të pjestimit. Padiçësja ka kërkuar të përfaqësohet me 2 avokatë të cilët legjitimohen nga gjykata. Në vijim palët diskutojnë rreth detyrave që do ti caktohen ekspertit. Për të siguruar provat të cilat do ti shërbejnë ekspertës për aktin si dhe për thërritjen e ekspertit veteriner, është shtyrë seanca për në datën 09.11.2022 (1 muaj e 25 ditë).
- 21. Seanca gjyqësore e datës 09.11.2022**, kjo seancë është zhvilluar në prani të përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse. Gjykata ka relatuar se ekspertja ka paraqitur nëpërmjet email se për arsye familjare nuk mund të paraqitet. Është caktuar edhe eksperti veteriner. Për të thërritur ekspertin, seanca është shtyrë për në datën 01.02.2023 (2 muaj e 23 ditë).
- 22. Seanca gjyqësore e datës 01.02.2023**, kjo seancë është zhvilluar në prani të paditëses dhe përfaqësueses së saj si dhe në prani të të paditurit. Rezulton të mos jenë paraqitur ekspertët. Për të njoftuar ekspertët është shtyrë seanca për në datën 22.03.2023 (1 muaj e 21 ditë).
- 23. Seanca gjyqësore e datës 20.04.2023**, kjo seancë është zhvilluar në prani të palës palës paditëse dhe përfaqësuesit, nuk është paraqitur përfaqësuesi i të paditurit për të cilin deklarohet mungesa. Pala paditëse është njohur me aktin e ekspertës së parë. Është paraqitur eksperti veteriner i cili ka marrë detyrat. Për të hartuar aktin e ekspertimit eksperti, është shtyrë seanca për në datën 30.05.2023 (1 muaj e 10 ditë).
- 24. Seanca gjyqësore e datës 30.05.2023**, kjo seancë është zhvilluar në prani të palës paditëse dhe përfaqësuesve si dhe në prani të përfaqësuesit të palës së paditur. Është paraqitur eksperti veteriner i cili ka përpiluar aktin e ekspertimit dhe e është relatuar atë. Për ti lënë kohë palës së paditur të njihet me aktin e ekspertimit, gjykata ka shtyrë seancën për në datën 20.07.2023 (1 muaj 20 ditë).
- 25. Seanca gjyqësore e datës 20.07.2023**, kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarës për shkak të angazhimit në një mbledhje në KLGJ. Seanca e radhës është caktuar në datën 28.09.2023 (2 muaj e 8 ditë).
- 26. Seanca gjyqësore e datës 28.09.2023**, kjo seancë është zhvilluar në prani të palëve ndërgjyqëse. Gjykata ka ftuar palët të diskutojnë rreth aktit të ekspertimit. Gjykata ka vlerësuar që duhet të paraqitet eksperti personalisht në kuadër të diskutimeve rreth aktit të ekspertimit. Me qëllim thërritjen e ekspertit, është shtyrë seanca për në datën 12.10.2023.

- **Çështja është rishortuar në datën 26.10.2023 (shorti i 6 -të)**

- 27. Seanca gjyqësore e datës 09.02.2024**, kjo seancë është zhvilluar në prani të palëve ndërgjyqëse. Është relatuar ndryshimi i trupi gjykues, duke cituar se gjyqtarja paraardhëse nuk ushtron detyrën pranë kësaj gjykate. Gjykata legjitimon përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse, dhe konstaton se nuk është paraqitur eksperti. Për të thërritur ekspertët të relatojnë aktet është shtyrë seanca për në datën 15.03.2024 (1 muaj e 6 ditë).

28. **Seanca gjyqësore e datës 15.03.2024**, kjo seancë është zhvilluar në prani të palëve ndërgjyqëse. Janë paraqitur ekspertët të cilët kanë diskutuar aktin e ekspertimit. Në lidhje me vazhdimin e gjykimit, gjykata ka vlerësuar t'i japë kohë ekspertës të plotësojë aktin dhe ka shtyrë seancën për në datën 24.05.2024 (1 muaj 9 ditë).
29. **Seanca gjyqësore e datës 24.05.2024**, gjykata pas administrimit të të gjitha provave shkresore, i jep fund shqyrtimit gjyqsor dhe kalon në fazën e konkluzioneve përfundimtare. Seanca e radhës është caktuar në datën 10.06.2024 (18 ditë).
30. **Seanca gjyqësore e datës 10.06.2024**, kjo seancë është zhvilluar në prezencë të palëve ndërgjyqëse si dhe janë dorëzuar pretendimet e fundit të cilat janë administruar nga gjykata. Për shkak të volumit të çështjes është shtyrë seanca për shpallje në datën 24.06.2024 (14 ditë).
31. **Seanca e datës 24.06.2024**, shpallja e vendimit.

Për këtë çështje konstatohet se janë zhvilluar 31 seanca. Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë 01.12.2014 dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës 24.06.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqsor i kësaj çështjeje ka zgjatur 9 vite, 6 muaj e 23 ditë. Konstatohet se në këtë kohëzgjatje ka ndikuar periudha gjatë të cilës vendimit për fazën e parë të pjesëtimit të datës 04.12.2015 është rekursuar në Gjykatën e Lartë e cila me vendimin nr.00-2021-1225 datë 05.07.2021 ka vendosur “mospranimin e rekursit”.

Në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave ndër të tjera konstatohen 7 seanca të shtyra për shkak të mungesës së gjyqtarit për shkaqe shëndetësore, trajnimi, KLGJ, takime pune; 9 seanca të shtyra për shkaqe që lidhen me ekspertin dhe aktin e ekspertimit; 4 seanca të shtyra për shkak të palës paditëse; 4 seanca të shtyra për shkak të palës së paditur

Distanca kohore ndërmjet seancave:

Për gjyqtarin e I-rë: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 8 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 20 ditë;

Për gjyqtarin e 2-të: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 21 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 22 ditë;

Për gjyqtarin e 3-të: Ka zhvilluar dy seanca me diference kohore prej 16 ditësh;

Për gjyqtarin e 4-rt: Nuk ka zhvilluar seancë;

Për gjyqtarin e 5-të: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 1 muaj e 3 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 3 muaj e 2 ditë;

Për gjyqtarin e 6-të: Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 14 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 1 muaj e 9 ditë.

36. Çështja me nr. 21240-01201-23-2014, datë 12.09.2014, me objekt "Shpërblim dëmi"

Kjo çështje është relatuar me detaje tek pika 5.4 e këtij raporti (shkaqet e zgjatjes së proceseve duke ju referuar llojit të objektit të padisë).

Në mënyrë të përmbledhur konstatohet se për këtë çështje gjykata ka zhvilluar 48 seanca.

Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë, dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 9 vjet, 9 muaj e 12 vite.

Në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave konstatohet ndër të tjera se: Rezultojnë 20 seanca të shtyra për shkak të mungesës së gjyqtarit, 1 seancë e shtyrë për shkak të mungesës së palës paditëse, 4 seanca të shtyra për shkak të mungesës të palës së paditur, 2 seanca të shtyra për shkak të mungesës e palëve ndërgjyqëse, 14 seanca të shtyra për shkak të ekspertit dhe veprimeve procedurale që lidhen me aktin e ekspertimit, 1 seancë e shtyrë për shkak të rregullimit të metave të padisë, 3 seanca të shtyra për shkak të marrjes dhe paraqitjes së provave, 1 seancë e shtyrë për shkak të kalimit nga një fazë procedurale në tjetrën, 1 seancë e shtyrë për administrim prove që lidhje me shkakun ligjor të pezullimit, 1 seancë e shtyrë për shkaqe të tjera.

Në lidhje me distancën kohore ndërmjet seancave konstatohet se:

Për gjyqtarin e parë: Distanca me e gjatë nga seanca në seancë është 1 muaj e 4 ditë

Distanca me e shkurtër nga seanca në seancë është 2 ditë

Për gjyqtarin e dytë: Distanca me e gjatë nga seanca në seancë është 2 muaj e 8 ditë;

Distanca me e shkurtër nga seanca në seancë është 13 ditë

Për gjyqtarin e tretë: Distanca me e gjatë nga seanca në seancë është 5 muaj e 10 ditë;

Distanca me e shkurtër nga seanca në seancë është 21 ditë

Për gjyqtarin e katërt: Ka caktuar dy seanca me distancë kohore 1 muaj e 15 ditë.

37. Çështja me nr. 21256-00382-23-2020, me objekt "Pushim cenimi në pronësi dhe mospërsëritjen në të ardhmen"

Kërkesë padia është paraqitur në gjykatë në datë 05.05.2020, është regjistruar në datë 05.05.2020 si dhe është shortuar brenda kësaj date.

Kjo çështje është shortuar dy herë përkatësisht: shorti i parë – 05.05.2020; shorti i dytë – 26.10.2023.



Seanca e parë është caktuar pas 5 muaj e 7 ditë nga data e hedhjes së shortit.

Seanca e parë pas rishortimit është caktuar pas 3 muaj e 26 ditë nga data e hedhjes së rishortimit.

Nga ana e gjykatës janë kryer këto veprimet procedurale si më poshtë:

1. **Seanca e datës 12.10.2020**, pas verifikimit të prezencës së palëve rezultojnë palë në proces që nuk kanë marrë dijeni për procesin dhe duhet të përsëriten njoftimet. Seanca e radhës është caktuar 19.11.2020. (1 muaj e 7 ditë)


2. **Seanca e datës 19.11.2020**, në procesverbalin e seancës nuk ka shënim lidhur me çfarë ka ndodhur dhe datën e shtyrjes. (2 muaj e 13 ditë)
3. **Seanca e datës 01.02.2021**, gjykata ka konstatuar se për palët G.V dhe L.S s'ka adresë dhe gjykata ka vlerëson se i duhet drejtuar Zyrës së Përgjithshme të Gjendjes Civile. Seanca e radhës është caktuar 02.04.2021. (2 muaj e 1 ditë)
4. **Seanca e datës 02.04.2021**, gjykata ka konstatuar se nuk ka ardhur përgjigje për shkresën e nisur nga seanca e kaluar lidhur me adresat, por është kthyer me shënimin "ardhur gabimisht në Ministrinë e Brendshme". Gjykata ka vlerësuar përsëritjen e shkresës dhe gjithashtu të bëhet shpallje publike dhe seancën e ardhshme të pushohet çështja për personat nëse vazhdojnë të mos paraqiten, pasi prona është në bashkëpronësi. Gjithashtu do i kërkohet Bashkisë Sarandë vënia në dispozicion e kontratave të qerasë. Seanca e radhës 26.05.2021. (1 muaj e 24 ditë)
5. **Seanca e datës 26.05.2021**, pas verifikimit të prezencës së palëve është konstatuar se përfaqësuesi i palës paditëse ka paraqitur kërkesë për shtyrje. Gjithashtu rezulton të ketë ardhur përgjigje nga Zyra e Gjendjes Civile lidhur me adresat e L.S dhe G.B dhe të jetë paraqitur Bashkia Konispol. Në këto kushte anulohet vendimi i mungesës së Bashkisë Konispol dhe shtyhet seanca për më datë 15.07.2021 për njoftimin e palëve L.S dhe G.B. (1 muaj e 19 ditë)
6. **Seanca e datës 15.07.2021**, pas verifikimit të prezencës së palëve rezulton, rezulton se njoftimi për shtetasin L.S ka ardhur sërish me shënimin adresë e pamjaftueshme, gjykata kërkon kontakte nëse palët i disponojnë dhe gjithashtu shtyn seancën për më datë 18.10.2021. (3 muaj e 3 ditë)
7. **Seanca e datës 18.10.2021**, pas verifikimit të prezencës së palëve rezulton se nuk është paraqitur avokati i palës paditëse i cili ka paraqitur kërkesë për shtyrje për shkak se ndodhet në një gjykim tjetër në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë. Gjithashtu rezulton të mos jetë paraqitur ATP dhe pala L.S, megjithëse rezultojnë të ketë marrë dijani. Gjykata pranon kërkesën për shtyrje, vendos ti njoftojë edhe njëherë palët dhe shtyn seancën e radhës për më datë 02.12.2021. (1 muaj e 14 ditë)
8. **Seanca e datës 02.12.2021**, rezulton të mos jetë zhvilluar për shkak se gjyqtarja për arsye shëndetësore nuk është paraqitur. Palët do njoftohen me fletëthirrje për seancën e radhës.
9. **Seanca e datës 07.02.2022**, nuk rezulton të jetë zhvilluar për shkak se gjyqtarja është infektuar me Covid 19. Seanca e radhës 16.03.2022. (1 muaj e 9 ditë)
10. **Seanca e datës 16.03.2022**, pas verifikimit të prezencës së palëve, të paditurit janë në mungesë. Gjykata deklaron të hapur shqyrtimin gjyqësor dhe fjalën e ka marrë pala paditëse dhe lidhur me pyetjen e gjykatës lidhur me vlerën e dëmit që ato kërkojnë, është kërkuar thirrja e një eksperti topograf dhe një eksperti zooteknik (nga Drejtoria e Bujqësisë Sarandë). Seanca e radhës 21.04.2022. (1 muaj e 5 ditë)
11. **Seanca e datës 21.04.2022**, rezulton të jetë paraqitur eksperti topograf dhe nuk rezulton të jetë kthyer përgjigje nga Bashkia Konispol lidhur me ekspertin zooteknik. Bëhet betimi i ekspertit, pala paditëse do të parapaguaj shpenzimet për ekspert dhe gjykata do i drejtohet sërish Drejtorisë së Bujqësisë për ekspert zooteknik. Seanca e radhës 09.06.2022. (1 muaj e 19 ditë)

12. **Seanca e datës 09.06.2022**, nuk rezulton të jetë zhvilluar pasi paditësit dhe avokati i tyre nuk janë paraqitur edhe pse kanë pasur dijeni të rregullt. Seanca e radhës shtyhet për më datë 21.09.2022. (3 muaj e 12 ditë)
13. **Seanca e datës 21.09.2022**, pas verifikimit të prezencës së palëve serish nuk është paraqitur avokati i paditësve, i cili ka bërë kërkesë për shtyrje por sipas gjykatës pa një shkak objektiv dhe të ligjshëm. Gjykata shtyn seancën për t'i dhënë edhe një mundësi dhe njëkohësisht për të njoftuar personalisht paditësit. Seanca e radhës 23.11.2022. (2 muaj e 2 ditë)
14. **Seanca e datës 23.11.2022**, rezulton të mos jetë paraqitur eksperti topograf për arsye familjare nuk ka mundur të jetë i pranishëm dhe gjithashtu Bashkia Konispol ka bërë me dije se nuk ka ekspert sipas fushës së kërkuar. Avokati i paditësve shprehet se do propozoj një emër në seancën e radhës e cila është caktuar nga gjykata më 02.02.2023. (2 muaj e 10 ditë)
15. **Seanca e datës 02.02.2023**, rezulton të jetë paraqitur eksperti topograf i cili nuk e ka paraqitur akoma aktin e ekspertimit dhe gjithashtu është paraqitur eksperti zooteknik i cili bën betimin. Avokati i paditësve shprehet se i ka kërkuar Bashkisë Konispol kontratat por ata ja japin fotokopje dhe ndërkohë vazhdojnë lidhin kontrata të tjera. Pritet akti i ekspertimit nga eksperti topograf e më pas do vijohet me pyetjen për ekspertin zooteknik. Seanca e radhës 23.03.2023.(1 muaj e 21 ditë)
16. **Seanca e datës 23.03.2023** rezulton të mos jetë zhvilluar për shkak se nuk është paraqitur avokati i paditësve i cili ka bërë kërkesë për shtyrje. Seanca e radhës 16.05.2023.(1 muaj e 23 ditë)
17. **Seanca e datës 16.05.2023**, eksperti topograf, pasi u njoh me dosjen shprehet se sipërfaqja që pretendohet nga paditësit është në disa male dhe ai për shkak të gjendjes së tij shëndetësore kërkon të heq dorë. Gjykata cakton ekspertin tjetër dhe seanca e radhës caktohet më 27.06.2023. (1 muaj e 11 ditë)
18. **Seanca e datës 27.06.2023**, nuk është zhvilluar për shkak se gjyqtarja për arsye familjare s'mund të paraqitet në punë. Seanca e radhës 13.09.2023. (2 muaj e 17 ditë)
19. **Seanca e datës 13.09.2023**, nuk është zhvilluar për shkak se gjyqtarja për arsye familjare s'mund të paraqitet në punë. Seanca e radhës 19.10.2023.

Çështja është rishortuar në datë 26.10.2023

20. **Seanca e datës 21.02.2024**, rezulton të jetë verifikuar prezenca e palëve, avokati i paditësve ka kërkuar bërjen e ndryshimeve lidhur me të paditurit dhe është shprehur se do depozitoj kërkesë në sekretari. Gjithashtu është verifikuar prezenca e të paditurve (20 të paditur). Gjykata ka kërkuar të saktësohet objekti në mënyrë që të bëhet i mundur njoftimi efektiv. Gjykata është shprehur se për shkak të ngarkesës tej normave të arsyeshme ka shtyrë seancën për në datë 08.05.2024. (2 muaj e 17 ditë)
21. **Seanca e datës 08.05.2024**, pas verifikimit të prezencës së palëve ka rezultuar se për disa prej tyre bashkia Konispol ka kthyer përgjigje e nuk ekziston shtetas me ato gjeneralitete, apo për të tjerë që kanë ndërruar jetë dhe gjykata i ka kërkuar paditësit të depozitoj në kryesekretari të dhëna e sakta, nr telefoni për shtetasit



A.K dhe P.A në mënyrë që të përsëritet shkresa. Seanca e radhës është caktuar 26.06.2024. (1 muaj e 18 ditë)

- 22. Seanca e datës 26.06.2024**, rezulton se paditësi G.K ka kërkuar të përfaqësohet vet dhe gjykata ka revokuar vendimin për përfaqësimin e tij nga avokati. Gjykata gjithashtu ka referuar faktin se ka pasur mangësi në adresat e palëve të paditura dhe janë bërë verifikimet. Gjykata është angazhuar në marrje informacioni zyrtar, zyra e gjendjes civile ka kthyer përgjigje lidhur me adresat e për disa të tjerë paditës që nuk figurojnë. Gjykata bazuar në nenin 1547/a/c të Kodit të Procedurës Civile ka vendosur: *“Të kthejë kërkesëpadinë dhe aktet e tjera bashkëlidhur fashikullit të gjykimit të çështjes civile me objekt “Pushimin e cenimit në pronësi...”*

Për këtë çështje konstatohet se janë zhvilluar 22 seanca. Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë 05.05.2020, dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës 26.06.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 4 vite e 1 muaj e 21 ditë. Në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave ndër të tjera konstatohen 5 seanca të shtyra për mosparaqitjen e përfaqësuesit të palëve paditëse; 4 seanca për shkak të mungesës së gjyqtarit (arsye shëndetësore apo familjare); 10 seanca të shtyra për shkaqe që lidhen me ekspertin dhe aktin e ekspertimit.

Distanca kohore ndërmjet seancave: Për gjyqtarin e parë; Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 1 muaj e 5 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 3 muaj e 12 ditë

Për gjyqtarin e dytë; Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 1 muaj e 7 ditë ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 3 muaj e 12 ditë.

38. Çështja me nr. 11112-01003-23-2020, datë 05.11.2020, me objekt “Pjesëtim sendi në bashkëpronësi”

Kërkesë padia është paraqitur në gjykatë në datë 05.11.2020, është regjistruar në datë 05.11.2020 si dhe është shortuar brenda kësaj date.

Kjo çështje është shortuar dy herë përkatësisht: shorti i parë – 05.11.2020; shorti i dytë – 26.10.2023.

Seanca e parë është caktuar pas 3 muaj e 6 ditë nga data e hedhjes së shortit.

Seanca e parë pas rishortimit 26.10.2023, është caktuar 22.05.2024 pas 6 muaj e 26 ditë nga data e hedhjes së rishortimit.

Nga ana e gjyqtarit të çështjes janë kryer këto veprime procedurale si më poshtë:

- 1. Seanca datë 11.02.2021**, pas verifikimit të prezencës së palëve rezulton të jetë paraqitur avokati për palët e paditëse, për të paditurit ka ardhur fletëthirrja me shënimin adresë e pamjaftueshme. Gjykata ka kërkuar vënien në dispozicion

- të adresave nga Zyra e Gjendjes Civile. Seanca e radhës shtyrë për më datë 15.04.2021. (2 muaj e 4 ditë)
2. **Seanca e datës 15.04.2021**, rezulton të jetë paraqitur avokati si përfaqësues i paditësve, palët e paditura nuk janë të pranishme, Gjykata shprehet se do i drejtohet Zyrës së Gjendjes Civile Tiranë si edhe zyrës së qendrës administrative nr.8. Seanca e radhës 06.05.2021. (21 ditë)
 3. **Seanca e datës 06.05.2021**, pas verifikimit të prezencës së palëve, është paraqitur avokati për palët paditëse, nuk janë paraqitur të paditurit. Fletëthirrja ka ardhur me shënimin “i panjohur”. Gjykata shtyn seancën për më datë 30.06.2021 me qëllimin për ti lënë kohë paditësve për të plotësuar të metat. (1 muaj e 24 ditë)
 4. **Seanca datë 30.06.2021**, rezulton të mos jetë zhvilluar për shkak se gjyqtarja është në një trajnim në KLGJ. Seanca e radhës është caktuar 30.09.2021. (3 muaj)
 5. **Seanca e datës 30.09.2021**, rezulton të jetë verifikuar prezenca e palëve rezulton të jetë paraqitur avokati si përfaqësues i paditësve, është bërë njoftimi për të paditurin I.Xh në adresën e ardhur nga Zyra e Gjendjes Civile dhe fletëthirrja ka ardhur me shënimin ka ndryshuar adresë. Paditësit shprehen se shtëpinë e ka në adresë por nuk kanë kontakte dhe gjykata vendos të dërgoj edhe njëherë fletëthirrje në të njëjtën adresë duke tentuar edhe kontaktimin me telefon sekretaria. Seanca e radhës 01.11.2021.(1 muaj e 2 ditë)
 6. **Seanca e datës 01.11.2021**, pas verifikimit e prezencës së palëve gjykata bazuar në nenin 179/2 të Kodit të Procedurës Civile ka deklaruar mungesën për të paditurin M.Xh dhe ka vendosur të procedohet njoftimi me shpallje publike në Bashkinë Tiranë për I.Xh. Seanca e radhës 09.12.2021. (1 muaj e 8 ditë)
 7. **Seanca e datës 09.12.2021**, rezulton të jetë paraqitur avokati si përfaqësues i paditësve dhe deklaruar mungesa për 2 të paditurit. Gjykata ka deklaruar të hapur shqyrtimin gjyqësor dhe i jepet fjala palës paditëse, e cila kërkon caktimin e një eksperti pasi sipërfaqja është e madhe dhe duhet një ekspert për përllogaritjen. Citohen provat që do merren në shqyrtim dhe vendoset të thirret ekspertja për bërjen e llogaritjeve. Seanca e radhës caktohet më 10.01.2022. (1 muaj e 1 ditë)
 8. **Seanca e datës 10.01.2022**, rezulton të jetë paraqitur ekspertja, të ketë bërë betimin dhe gjithashtu i është caktuar detyra për përllogaritjen sipas ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi të vlerës së sendit për të përcaktuar më pas trupin gjykues. Seanca e radhës 07.03.2021. (1 muaj e 25 ditë)
 9. **Seanca e datës 07.03.2022**, rezulton të jetë paraqitur avokati i paditësve dhe nuk janë paraqitur të paditurit. Është paraqitur akti i ekspertimit dhe çështja do gjykohet nga një gjyqtare dhe bazuar në nenin 158 të Kodit të Procedurës Civile urdhërohet kalimi në seancë gjyqësore dhe citohen provat shkresore që do lejohen të merren në shqyrtim. Urdhërohet njoftimi i palëve të paditura dhe seanca e radhës caktohet më 13.04.2022. (1 muaj e 6 ditë)
 10. **Seanca e datës 13.04.2022**, verifikohet prezenca e palëve, paraqitur avokati i paditësve, nuk është paraqitur M.Xh e cila ka dijeni për seancën pasi ka ardhur

fletëthirrja me shënimin refuzuar dhe gjykata deklaroi mungesën në referim të nenit 179.2 të K.Pr.Civile, ndërsa sa i takon të paditurit I.Xh fletëthirrja ka ardhur me shënimin ka ndryshuar adresë dhe gjykata ka vendosur njoftimin me shpallje publike në Bashkinë Tiranë. Seanca e radhës 06.06.2022. (1 muaj e 24 ditë)

11. **Seanca e datës 06.06.2022**, rezulton të jetë deklaruar mungesa edhe për të paditurin I.Xh për të cilin u procedua me shpallje publike, në referim të nenit 133/b dhe 179 të K.Pr.Civile. I është dhënë fjala paditësit i cili ka relatuar padinë dhe gjithashtu pyetjet e gjykatës. Gjykata për fazën e parë të pjesëtimit ka deklaruar të mbyllur shqyrtimin gjyqësor. Kalohet në diskutime përfundimtare dhe vendimi do shpallet i arsyetuar më datë 27.06.2022. (21 ditë)
12. **Seanca e datës 27.06.2022**, rezulton të jetë çelur seanca për shpalljen e vendimit, nuk rezulton të jetë i pranishëm as avokati i paditësve dhe as palët e paditura. Gjykata ka vendosur: *“Pranimin e pjesërisht të padisë për sa i përket fazës së parë të pjesëtimit. 2. Lejimin e pjesëtimit të pasurive të paluajtshme...”* (3 muaj e 28 ditë, referuar seancës pasardhëse (25.10.2022), megjithëse në procesverbalin e datës 27.06.2022 nuk rezulton të jetë shënuar data e seancës pasardhëse).
13. **Seanca e datës 25.10.2022**, pas verifikimit të prezencës së palëve, rezulton të jetë paraqitur kërkesë për shtyrje nga avokati i palëve paditëse pasi ndodhet jashtë shtetit për shkaqe familjare, gjithashtu gjykata ka deklaruar mungesën për një nga të paditurit dhe procedimin me shpallje publike për tjetrin pasi fletëthirrja ka ardhur me shënimin ka ndryshuar adresë. Edhe vendimi gjyqësor lidhur me fazën e parë të pjesëtimit është njoftuar me shpallje publike. Seanca e radhës është caktuar datë 01.12.2022. (1 muaj e 6 ditë)
14. **Seanca e datës 01.12.2022**, rezulton të jetë deklaruar mungesa edhe sa i takon të paditurit për të cilin ishte proceduar me njoftimin me shpallje publike. Gjykata deklaroi se ndodhen në fazën e dytë të pjesëtimit dhe nga avokati i paditësve është kërkuar kohë pak kohë për të vendosur nëse pala do ta vazhdojë këtë gjyq pasi kanë një mosmarrëveshje. Seanca e radhës 27.02.2023.
15. **Seanca datë 27.02.2023**, sërish avokati i paditësve ka paraqitur kërkesë për shtyrje dhe seanca e radhës është caktuar 27.04.2024. (2 muaj e 26 ditë)
16. **Seanca e datës 27.04.2023**, rezulton se nga avokati i paditësve është propozuar caktimi i një eksperteje lidhur me përcaktimin e faktit nëse sendi mund të ndahet në natyrë në aq pjesë sa janë bashkëpronarët dhe nëse kjo është e pamundur të përcaktohet se si mund të bëhet kompensimi në vlerë monetare. Seanca e radhës 27.06.2023. (2 muaj)
17. **Seanca e datës 27.06.2023**, nuk është zhvilluar për shkak se gjyqtarja për arsye familjare nuk mund të paraqitet në punë. Seanca e radhës 13.09.2023. (2 muaj e 17 ditë)
18. **Seanca datë 13.09.2023**, nuk është zhvilluar për shkak se gjyqtarja për arsye shëndetësore nuk mund të paraqitet. Seanca e radhës 19.10.2023.

- Çështja është rishortuar në datën 26.10.2023

19. **Seanca e radhës referuar procesverbaleve është datë 22.05.2024**, ku rezulton të jetë verifikuar prezenca e palëve, paraqitur avokati i paditësve, ndërsa për të paditurit fletëthirrjet kanë ardhur me shënimin larguar e në këto kushte është vendosur të njoftohen palët e paditura me shpallje publike. Seanca e radhës 27.06.2024. (1 muaj e 5 ditë)
20. **Seanca e datës 27.06.2024**, pas verifikimit të prezencës së palëve rezulton se nuk janë paraqitur paditësit dhe as avokati i zgjedhur prej tyre për përfaqësim, i cili ka dijeni për datën pasi ka qenë prezent seancën e kaluar, dhe nuk ka paraqitur asnjë shkak të arsyeshëm për mospraninë e tij. Gjykata tërhiqet për vendim në dhomë këshilli dhe vendos: “..Pushimin e gjykimit ”

Për këtë çështje janë zhvilluar gjithsej 20 seanca (12 seanca deri në dhënien e vendimit të datës 27.06.2022 për pranimin pjesërisht të padisë për sa i përket fazës së parë të pjesëtimit dhe lejimin e pjesëtimit të pasurisë së paluajtshme) dhe më pas edhe 8 seanca të tjera. Referuar datës së depozitimit të kërkesëpadisë 05.11.2020, dhe datës së vendimmarrjes së gjykatës 27.06.2024, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje ka zgjatur 3 vite e 7 muaj e 22 ditë.

Në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave ndër të tjera konstatohen 8 seanca të shtyra për shkaqe që lidhen me palët e paditura; 4 seanca për shkaqe që lidhen me paditësin; 3 seanca të shtyra për shkaqe që lidhen me gjyqtarin; 4 seanca të shtyra për shkaqe që lidhen me ekspertin dhe aktin e ekspertimit.

Distancat kohore ndërmjet seancave:

Për gjyqtarin e parë; Distanca më e shkurtër kohore nga njëra seancë në tjetrën është 21 ditë; Distanca më e gjatë kohore nga njëra seancë në tjetrën është 3 muaj e 28 ditë. Për gjyqtarin e dytë; Rezulton që gjyqtari i dytë të ketë planifikuar vetëm 1 seancë në distancë kohore 1 muaj e 5 ditë dhe në tjetrën të ketë vendosur pushimin e gjykimit.



GJETJE:

Totali i seancave të shtyra për 38 çështjet civile me palë kundërshtare është 604 seanca. Mesatarja e shtyrjeve për çështje është afërsisht 15.9 seanca për një çështje.

Shtyrjet për shkak të gjykatës si dhe shtyrjet që lidhen me aktin e ekspertimit përbëjnë afërsisht 42 % të të gjitha shtyrjeve.

Për shkak të gjykatës: (143 seanca): Referuar analizës së shkaqeve të shtyrjes së seancave për 38 çështjet të cilat kanë pasur një kohëzgjatje gjykimi më shumë se dy vjet, konstatohet se pjesa më e madhe e shtyrjeve përkatësisht 143 seanca janë për shkak të mungesës së gjyqtarit. Përkatësisht nga 38 çështje, 28 çështje janë shortuar për herë të dytë për shkak të caktimit të gjyqtarit në një gjykatë tjetër/transferimit/pezullimit/shkarkimit për shkak të vettingut, që do të thotë se të paktën 28 seanca janë shtyrë për këtë shkak; 5 çështje janë shortuar për herë të tretë. Konstatohet se ka çështje të cilat janë shortuar më shumë se tre herë për shkaqet e sipërcituara.

Shkaqet e tjera të shtyrjes së seancave për sa i përket mungesës së gjyqtarit lidhen me delegimin e gjyqtarit për të gjykuar në një gjykatë tjetër, me mungesën e gjyqtarit për shkak të trajnimeve, për shkaqe shëndetësore personale apo familjare.

Ekspertiza (109 seanca): Shtyrjet e seancave për shkaqe që lidhen me paraqitjen e ekspertit, kërkesat e palëve për përjashtimin e ekspertit, hartimin, administrimin e aktit të ekspertimit, renditen në vend të dytë për sa i përket numrit më të madh të shtyrjeve. Këtu nuk futen shtyrjet për herë të parë të seancës për njoftim eksperti të cilat janë kategorizuar më vete. Seancat për njoftim eksperti/dëshmitari zënë rreth 5 % ose 31 seanca.


Sjellja e palës paditëse: 58 seanca ose rreth 9.6 % e shtyrjeve të seancave lidhen me vetë palën paditëse sikurse janë kërkesat për shtyrje, për njohje me aktet. Këtu nuk përfshihen shtyrjet të cilat kanë ndodhur për nevojat e rregullimit të prokurës, rregullimit të të metave si dhe shtyrjet kur të dy palët ndërgjyqëse nuk janë paraqitur. Së bashku me këto të fundit konstatohet se sjellja e palës paditëse ka ndikuar në shtyrjen e 92 seancave ose 15 % të seancave të shtyra.

Mungesa e palës së paditur/kërkesa për shtyrje dhe njohje me aktet zënë një pjesë të konsiderueshme të shtyrjeve, përkatësisht 73 seanca ose 12% e seancave totale të shtyra. Konstatohen shtyrje seancash për shkak të mosmarrjes dijeni të kësaj pale në lidhje me njoftimin e gjykatës (nuk provohet marrja dijeni; mungesa adresash; adresa të pasakta), konstatohen raste të përsëritjes së shpalljes publike përveç kërkesave për shtyrje dhe njohje me aktet.

Ndonëse zënë vetëm 2 % të shtyrjeve, është evident se administrimi i akteve nga institucione të tjera dhe mosdorëzimi i tyre në afatin e përcaktuar nga gjykata (15 seanca të shtyra) si dhe bojkoti i avokatëve (15 seanca të shtyra) kanë qenë shkak për shtyrjen e 30 seancave.



Shkaqet e shtyrjes të seancave më të detajuara janë paraqitur në grafikun si më poshtë:



6.2. Fakte të konstatuara në lidhje me numrin e çështjeve për të cilat nëpërmjet vendimit gjyqësor është konstatuar shkelja e afatit të arsyeshëm.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar se në referim të nenit 46 të Konventës shteti duhet të vendosë një zgjidhje të brendshme, në lidhje me kohëzgjatjen e tepruar të procedurave. Në përmbushje të rekomandimeve të Gjykatës duke ju referuar edhe vendimit të kësaj gjykate në çështjen “Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë”, në Kodin e Procedurës Civile me ligjin nr.38/2017 u shtua “Kreu X” dhe përkatësisht nenet 399/1-399/12 të K.Pr.C.

Neni 399/2 i K.Pr.C parashikon se afati i arsyeshëm i kohëzgjatjes së një gjykimi civil në shkallë të parë është dy vjet.

Konkretisht neni 399/2 pika 1,2,3 parashikon ndër të tjera se:

“1. Afate të arsyeshme të përfundimit hetimit, gjykimit apo ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, për qëllimet e përcaktuara në nenin 399/1, do të konsiderohen:; b) në gjykimin civil në shkallë të parë përfundimi i procesit të gjyimit brenda dy viteve,.... .

2. Palët në proces mund të kërkojnë konstatimin e tej zgjatjes së procedurave, sipas nenit 399/6 pika 1, edhe pa kaluar afatet e mësipërme, duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjes, objektin e mosmarrëveshjes, sjelljen e organit që po kryen procedurat, si dhe të çdo personi tjetër të lidhur me çështjen, kur pretendojnë për zvarritje të hetimit, gjykimin ose ekzekutimit të vendimit.

3. Në kohëzgjatjen e gjykimin ose të procedimit, nuk llogaritet koha kur çështja është pezulluar për shkaqe ligjore, kur është shtyrë për shkak të kërkesave të palës kërkuuese, sipas këtij kreu, ose kur shfaqen rrethana të pamundësisë objektive për procedim”.

Neni 399/5 parashikon se: “Kërkesa depozitohet në sekretarinë e gjykatës që është në vonesë, ose gjykatës kompetente për ekzekutimin. ...”

Neni 399/7 parashikon ndër të tjera se :”Gjykimi i kërkesëpadisë sipas nenit 399/6 pika 1³⁹, bëhet në dhomë këshillimi dhe gjykata që shqyrton çështjen merr vendim brenda 45 ditëve, nga paraqitja e kërkesës. Brenda 15 ditëve nga paraqitja e kësaj kërkesë, organi që pretendohet se ka kryer shkeljen, i dërgon kopje të dosjes dhe mendimin me shkrim, gjykatës që shqyrton shkeljen.

Neni 399/8, pika 2: “Vendimi i gjykatës është përfundimtar dhe i formës së prerë”.

Neni 399/12 parashikon gjithashtu se “Vendimi i formës së prerë i gjykatës kompetente, sipas nenit 399/6 i përcillet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të vlerësuar nëse vonesat e shkaktuara nga gjyqtarët, sipas këtij kreu, përbëjnë shkelje disiplinore”.

Për sa më sipër, me ndryshimet që i janë bërë Kodit të Procedurës Civile me ligjin nr. 38/2017 (të cilat kanë hyrë në fuqi në datën 05.11.2017), tashmë çdo individ i janë ofruar mjete të reja ligjore për t’u mbrojtur efektivisht nga cenimi i së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm. Konkretisht, K.Pr.Civile përcakton se çfarë do të konsiderohen afate të arsyeshme (neni 399/2); me çfarë mjetesh mbrohesh nga cenimi; kërkesa për përshpejtim të gjykimin (neni 399/4) dhe kërkesa për dëmshpërblim; çfarë do të konsiderohet shpërblim i drejtë (neni 399/3); cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës (nenet 399/4 dhe 399/6); rregullat për gjykimin e kërkesës (neni 399/7); marrja e vendimit (neni 399/8), etj. Për rrjedhojë, ligji procedural ka parashikuar mjete ligjore nëpërmjet të cilave individëve u garantohet mbrojtja efektive në lidhje me pretendimet për cenimin e së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm, si dhe për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm (shih vendimin nr.3 datë 11.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese).

Një vëmendje e veçantë gjatë inspektimit i është kushtuar çështjeve në të cilat kohëzgjatja ka qenë e tillë që mund të çojë në konstatimin e shkeljes së të drejtës së individit për një proces gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme. Në kuadër të identifikimit të çështjeve për

³⁹ Neni 399/6 pika 1, shkronja a) : Kërkesa për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave i drejtohet gjykatës kompetente, sipas llojit të mosmarrëveshjes penale, civile, administrative si më poshtë: a) në rastet kur çështja, në të cilën pretendohet të ketë shkelje, është duke u gjykuar në gjykatën e shkallës së parë, kërkesa shqyrtohet nga Gjykata e Apelit, në juridiksionin e të cilës ndodhet gjykata e shkallës së parë;

të cilat është depozituar kërkesë me objekt "Konstatim shkeljesh dhe përshpejtim procedurash" kemi kërkuar informacion pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë si dhe pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë na ka informuar se nuk ka kërkesa me objekt "Konstatim shkelje dhe përshpejtim procedurash" (në referim të nenit 399/6 pika 1 i K.Pr.C) të përfunduara gjatë periudhës kohore 01.04.2024 – 30.06.2024.

Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm në lidhje me kërkesën e ILD-së se sa çështje kanë përfunduar gjatë periudhës 01.01.2018-30.06.2024 me objekt "Konstatim shkeljesh dhe përshpejtim procedurash nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë" ka informuar se nga verifikimet në arkivin e zyrës së shërbimit Gjirokastër si dhe referuar sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore (ICMIS) është dhënë një vendim për një çështje përfundimi i të cilës është jashtë periudhës (tre mujore) objekt inspektimi. Ky rast është relatuar si më poshtë:

- Çështja civile 21238-00394-30-2023 datë 17.02.2023 regj. Nr.5668 akti me objekt "Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes civile me nr. 21248-01708-23-2019, nr. akti 1447/347 regjistruar në datë 31.12.2019 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë".

Rrethanat e çështjes:

Kërkesa me objekt "Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimi i procedurave" ka të bëjë me çështjen për të cilën ishte depozituar kërkesë padia përkatëse pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë në datë 31.12.2019, regjistruar në gjykatë në datën 31.12.2019 me objekt "Marrjen e masës së përkohshme të sigurimit të padisë.... Konstatimin absolutisht të pavlefshëm të vendimit nr.20 datë 27.12.2019 të Asamblesë së Përgjithshme...."

Seanca e parë u mbajt në datën 03.01.2020 të cilën, gjykata verifikon prezencën e palëve, deklaron të hapur shqyrtimin gjyqësor, po në këtë seancë gjykata vendos rrëzimin e kërkesës për sigurim padie të depozituar nga pala paditëse.

Çështja është rishortuar në datë 27.04.2020 për shkak të ndërprerjes së funksionit të magjistratit nga procesi i vetingut.

Në datën 08.09.2020 zhvillohet seanca e parë me trupin e ri ku gjyqtarja e çështjes relatton faktin se ndryshimi i trupës ka ardhur si rezultat i mbarimit të statusit të magjistratit të mëparshëm. Pas verifikimit të prezencës së palëve konstaton mungesën e ekspertëve dhe për këtë shkak shtyn seancën për në datën 07.10.2020.

Seanca e datës 07.10.2020 nuk u zhvillua për shkak të mungesës së gjyqtares për arsye shëndetësore.

Në datën 04.11.2020 u zhvillua seanca e radhës në të cilën pasi verifikohet prezenca e palëve konstatohet se është paraqitur vetëm një nga ekspertët i cili bëri betimin dhe mori detyrat. Për arsye të njoftimit të ekspertit tjetër u shty seanca për në datën 23.12.2020.

Në seancën e datës 23.12.2020 gjykata pasi verifikoi prezencën e palëve, mori në shqyrtim kërkesën e paditësit për t'u përjashtuar nga tarifat gjyqësore, kërkesë e cila u rrëzua. Seanca e radhës u shty për në datën 08.02.2021, për shkak të caktimit të një eksperti tjetër dhe kërkesës për shtyrje të depozituar nga pala e paditur.

Në datën 12.02.2021 u mbajt seanca në të cilën pasi u verifikua prezenca e palëve u zhvillua debati gjyqësor, ndërsa në lidhje me aktin e ekspertimit, diskutimi rreth tij do të bëhet në seancë gjyqësore.

Në datën 25.02.2021 u zhvillua seanca e radhës në të cilën pasi u verifikua prezenca e palëve dhe çelet seanca, vijohet me diskutime rreth çështjes të cilat konsistojnë rreth aktit të ekspertit dhe nevojës për caktim të një eksperti tjetër, i cili pasi ti merret identiteti dhe ti lexohet formula e betimit, do të vijojë me marrjen e detyrave. Seanca e radhës planifikohet në datën 19.03.2021.

Në datën 19.03.2021 është çelur seanca në të cilën është bërë prezenca e palëve nga ku ka rezultuar se është dorëzuar akti i ekspertimit të ekspertit i cili nuk mund të paraqitet në seancë për shkak të vendndodhjes në një gjykatë tjetër. Gjykata ndodhet në pritje të caktimit të ekspertit tjetër. Seanca shtyhet për në datë 28.04.2021.

Në seancën e datës 28.04.2021 pasi është verifikuar prezenca e palëve është relatuar nga gjykata se i është vënë në dispozicion lista e ekspertëve për të përzgjedhur.

Në datën 09.06.2021 u zhvillua seanca e radhës e cila u shty për shkak të moskthimit të konfirmimit të dijenisë nga ekspertja, lidhur me datën e seancës.

Në datën 02.07.2021 u zhvillua seanca e radhës në të cilën pasi është verifikuar prezenca e palëve është konstatuar se edhe pse është njoftuar, ekspertja nuk është paraqitur. Me qëllim që të njoftohet përsëri është shtyrë seanca në datën 29.09.2021.

Në seancën e datës 29.09.2021 gjykata pasi verifikoi prezencën e palëve relatoi se ekspertja është kontaktuar dhe do paraqitet në datën 09.11.2021 për të bërë betimin.

Në datën 09.11.2021 është zhvilluar seanca e radhës në të cilën pasi është verifikuar prezenca e palëve është relatuar prania e ekspertes e cila pasi ka lexuar formulën e betimit, ka marrë detyrat për të vijuar me përgatitjen e aktit.

Në datën 15.12.2021 është caktuar seanca e radhës në të cilën pasi është verifikuar prezenca e palëve ndërgjyqëse, është konstatuar se akti i ekspertimit nuk është komunikuar ende dhe për këtë qëllim seanca u shty për në datën 20.01.2022.

Në datën 20.01.2022 u zhvillua seanca e radhës në të cilën u relatua se është komunikuar akti i ekspertimit i cili do t'ju vihet në dispozicion palëve. Gjykata urdhëron kalimin e çështjes në seancë gjyqësore e cila do të zhvillohet në datën 10.03.2022.

Në datën 10.03.2022 u zhvillua seanca gjyqësore në të cilën pasi u verifikua prezenca e palëve dhe u deklarua i hapur shqyrtimi gjyqësor, u ftuan palët të zhvillojnë debatin gjyqësor rreth padisë, aktit të ekspertimit dhe provave. Diskutimet rreth çështjes do të vijnë në seancën e ardhshme gjyqësore e cila do të zhvillohet në datën 21.04.2022.

Në seancën e datës 21.04.2022 pasi u verifikua prezenca e palëve ndërgjyqëse u konstatua se nuk paraqitet në mënyrë të përsëritur eksperti për të cilin nëse do të vijojë mungesa, do të urdhërohet shoqërimi i detyrueshëm i tij. Seanca e radhës u caktua në datën 14.06.2022, Në seancën e datës 14.06.2022 gjyqtarja e çështjes ndodhej në një seminar trajnues.

Në datën 06.07.2022 është zhvilluar seanca gjyqësore në të cilën pasi është verifikuar prezenca e palëve kanë vijuar diskutimet rreth aktit të ekspertimit.

Në datën 14.07.2022 u zhvillua seanca gjyqësore e radhës në të cilën pasi u verifikua prezenca e palëve u konstatua mungesa e palës së paditur dhe u relatua akti i ekspertimit mbi të cilin u vijuan diskutime dhe kundërshtime. Gjykata i jep fund shqyrtimit gjyqësor, merr në administrim provat shkresore dhe fton palët të japin konkluzionet përfundimtare. Në seancën e datën 18.07.2022 u depozitua nga paditësi një kërkesë për riçelje të hetimit gjyqësor, kërkesë e cila nuk u pranua nga gjykata. Gjykata pasi administroi pretendimet e fundit shpalli vendimin duke rrëzuar kërkesë padinë.

Referuar informacionit të përcjellë nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm⁴⁰ konstatohet se:

Pala paditëse ka dorëzuar kërkesën me objekt “Konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes civile me nr. 21248-01708-23-2019”, kërkesë e cila është regjistruar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në datë **17.02.2023**. Në kërkesën civile të paraqitur pala kërkuese ka parashtruar ndër të tjera se:

- Se pari, në themel të objektit të padisë qëndron dëmshpërblimi nga mosmarrëveshjet në marrëdhëniet e punës dhe shpërblimi dëmi pasuror dhe jo pasuror.
- Së dyti kjo çështje është regjistruar në datë 31.12.2019. Çështja është ri shortuar për shkak të ndërprerjes së funksionit nga gjyqtari i parë i caktuar për gjykimin e saj.
- Së treti, procesi ka vijuar me 21 seanca dhe në datë **18.07.2022** është shpallur vendimi.
- Së katërti nga data e regjistrimit të çështjes 31.12.2019 e deri në datën e paraqitjes së kësaj kërkesë kanë kaluar më shumë se 2 vjet e 9 muaj dhe në kundërshtim me nenin 399/1 pika 6 nuk është komunikuar vendimi, nuk është dorëzuar dosja në sekretari, nuk është arsyetuar, dorëzuar dhe njoftuar vendimi i arsyetuar.
- Së pesti që nga koha e shpalljes së dispozitivit të vendimit datë 18.07.2022 e deri në datën e paraqitjes së kësaj kërkesë na është mohuar e drejta e ankimit.

Nga ana e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është marrë informacion dhe mendim nga gjyqtarja e cila ka shqyrtuar çështjen në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë. Në shkresën e titulluar “Prapësime” protokolluar pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, gjyqtarja e çështjes ka parashtruar ecurinë e gjykimit duke parashtruar ndër të tjera se:

-Ajo është caktuar për gjykimin e çështjes me rishortimin e datës 27.04.2020. Veprimtaria gjyqësore është pezulluar për tre muaj si rezultat i Covid-2019. Në vijim gjyqtarja relatton ecurinë e gjykimit duke filluar nga “Vendimi datë 10.06.2020 për kalim në seancë përgatitore” duke planifikuar seancën përgatitore për t’u zhvilluar në datë 08.09.2020 e deri në seancën e datës 18.07.2022 në të cilën është shpallur vendimi përfundimtar.

⁴⁰Shkresa nr. 23529/1 prot., datë 07.11.2025, protokolluar në ILD me nr. 1209/8 prot., datë 10.11.2025

Vlerësimi i gjykatës së Apelit:

Gjykata në vlerësimin e bazueshmërisë së kërkesës për “Konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, për çështjen civile me nr. 21248-01708-23-2019” analizoi ndër të tjera se:

Neni 399/2 i K.Proc.Civile lidhur me afatin e arsyeshem të përfundimit të procesit të gjykimit referon në afatin maksimal të kohëzgjatjes prej 2 vitesh për gjykimin civil në shkallë të parë.

GJEDNJ ka theksuar se “Arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procesit duhet vlerësuar në bazë të rrethanave të çështjes dhe duke u kushtuar vëmendje kritereve të vendosur nga Jurisprudenca e Gjykatës, sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e paditësi si dhe sjelljen e autoriteteve përkatëse”. Në kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca e GJEDNJ për vlerësimin e afatit kohor të arsyeshem në çështjen “König” datë 28 qershor 1978 është shtuar edhe një tjetër kriter ai se çfarë interesi rrezikon paditësi. Sipas jurisprudencës së GJEDNJ mund të përdoren edhe pika të tjera të fillimit të llogaritjes së afatit, në varësi të procedurave ose rrethanave specifike.

Lidhur me gjykimin e çështjes civile nr. 21248-01708-23-2019 nr. akti 1447/347 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë për të vlerësuar nëse jemi përpara tejkalimit të afatit të arsyeshem sipas nenit 399/2 të K.Pr.Civile, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka analizuar rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese dhe GJEDNJ që lidhen me: (i) sjelljen e kërkuetit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkueti.


Gjykata pasi ka vlerësuar në tërësi të gjithë këto elementë nuk ka konstatuar se ka shkelje të afatit të arsyeshem për gjykimin e konfliktit civil të iniciuar nga paditësi .

Rezulton se nga ana e gjykatës së shkallës së parë janë marrë masat për zhvillimin e një hetimi të plotë e të gjithanshëm, duke realizuar aktet e ekspertimit të nevojshme për zgjidhjen e konfliktit mes palëve ndërgjyqëse. Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ka arsyetuar se ka qenë kompleksiteti i çështjes që ka ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit. Shumica e seancave gjyqësore janë shtyrë për të realizuar aktet e ekspertimit (mosparaqitje të ekspertëve për shkaqe të arsyeshme apo realizimin e prezantimit e akteve të ekspertimit). Gjyqtarja e çështjes, është bërë shkak për shtyrjen e dy seancave gjyqësore, por në të dy rastet mungesa ka qenë e justifikuar (arsye shëndetësore të vërtetuara me raport mjekësor dhe pjesëmarrje në trajnim të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, detyrim ligjor ky për magjistratët në detyrë). Gjykata, ka vlerësuar se nuk ndodhemi para shkeljes së afatit të arsyeshem të gjykimit të çështjes.

Gjithashtu, kërkueti (pala paditëse) i ka kërkuar gjykatës së apelit edhe urdhërimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, të kryejë arsyetimin e vendimit dhe njoftimin e vendimit sipas urdhërimeve të parashikuara në dispozitat e neneve 308 e 316 të K.Pr.Civile.

Një kërkim i tillë ka mbetur pa objekt pasi vendimi gjyqësor është arsyetuar, i është komunikuar palëve dhe fashikulli i gjykimit i është përcjellë për shqyrtim gjykatës së shkallës së dytë mbi ankimin e paditësit.

Për rrjedhojë, gjykata ka vlerësuar dhe arritur në përfundimin se nuk është tejkaluar afati i arsyeshem i gjykimit, i interpretuar edhe në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ dhe për rrjedhim kërkesa për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshem, për çështjen civile nr. 21248-01708-23-2019 nr. akti 1447/347 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, është vlerësuar si e pabazuar në ligj dhe në prova dhe është rrëzuar për këtë arsye.



Vendimi i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, datë 03.04.2024:

Gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Ky vendim është përfundimtar edhe i formës së prerë.

7. KONKLUZIONE

7.1. Inspektimi u zhvillua në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë dhe arriti qëllimin e tij për tu njohur me veprimtarinë administrative dhe gjyqësore të kësaj gjykate në lidhje me kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore civile me palë kundërshtarë të përfunduara gjatë periudhës kohore 01.04.2024-30.06.2024.

7.2. Duke pasur si burim të dhënat e pasqyruara në regjistrat manual, në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore si dhe të dhënat statistikore, inspektimi fillimisht u orientua drejt verifikimit të llojit të të dhënave dhe saktësisë së tyre. Saktësia e të dhënave statistikore në rastin konkret paraqet një rëndësi të veçantë, jo vetëm për matjen e performancës dhe efikasitetit të gjykatës por gjithashtu edhe për sigurimin e transparencës, forcimin e llogaridhënies, evidentimin e problematikave si dhe identifikimin e nevojave për përmirësim të vazhdueshëm të veprimtarisë administrative dhe gjyqësore.

Nga analiza e të dhënave që përmban regjistri fizik i shënuar “Numërori i vendimeve civile” (duke iu referuar vetëm të dhënave që pasqyrojnë kohëzgjatjen e proceseve nga momenti i paraqitjes së kërkesë padive në gjykatë deri në shpalljen e vendimeve për periudhën 01.04.2024-30.06.2024); të dhënat e pasqyruara jo gjithmonë përputhen me të dhënat statistikore.

Nga analiza e të dhënave statistikore të cilat janë përdorur si burim për kryerjen e inspektimit, konstatohet se në këto të dhëna nuk pasqyrohen rrethana të rëndësishme të cilat mund të karakterizojnë një çështje. Konkretisht nuk evidentohet koha kur gjyqtari ka vënë në lëvizje çështjen; nuk identifikohen 2 anëtarët e tjerë të trupit gjykues si dhe mungon informacioni mbi faktin nëse çështja ka qenë ose jo e pezulluar.

7.3. Referuar “shënimeve” të procesverbaleve të seancave të printuara nga sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore konstatohet se ka raste kur nuk identifikohet lloji i seancës nëse është përgatitore apo gjyqësore. Gjithashtu ka raste kur referuar shënimeve të procesverbalit nuk kuptohet shkaku i shtyrjes së seancës si dhe identifikohen raste kur procesverbali nuk përmban asnjë shënim.

7.4. Periudha objekt inspektimi 01.04.2024-30.06.2024 përkon me kohën pas implementimit të hartës së re gjyqësore. Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 140, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë”⁴¹ ka vendosur ndër të tjera që Gjykata e Rrethit

⁴¹ Ky vendim, i cili hyn në fuqi me botimin në fletoren zyrtare, është publikuar në fletoren zyrtare në datën 29.03.2023.

Gjyqësor Sarandë të emërtohet Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë. Kjo gjykatë ka filluar funksionimin (me këtë emërtim) në datë 01.05.2023.

7.5. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë është gjykatë e kategorisë së tretë (e ulët) e përcaktuar si e tillë me vendimin e KLGJ-së me nr. 147 datë 29.03.2023 dhe nr.149 datë 29.03.2023.

“Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 149, datë 29.03.2023 *“Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e dytë dhe e tretë pa zyrë shërbimi”*, në nenin 15 parashikon ndër të tjera se *“Këshilli i gjykatës pritëse, brenda 2 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, miraton strukturën, organikën, si dhe përshkrimet e hollësishme të punës, duke i përshtatur me nevojat e gjykatës dhe kriteret e vendit të punës”*.

Në referim të vendimit të sipërcituar, Këshilli i Gjykatës ka miratuar vendimin nr. 5, datë 03.04.2023 *“Për miratimin e organigramës, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë”*.

7.6. Referuar analizës vjetore të gjykatës subjekt inspektimi për vitin 2024 konstatohet se gjatë vitit 2024 në gjykatë kanë ushtruar detyrën 6 sekretarë gjyqësorë (aq sa është numri i gjyqtarëve efektivë) dhe 1 kryesekretare e cila përmbush edhe detyrat e sekretarit regjistruar, dhe shërbimit ndaj publikut. Në këtë analizë parashtrohet ndër të tjera se mungesa e sekretarëve gjyqësorë gjatë vitit 2024 ka sjellë vështirësi në veprimtarinë e përditshme të gjykatës dhe se ka qenë i vështirë organizimi i këtij sektori në raste jo të zakonshme si sëmundje apo ndonjë problem tjetër që sekretaret gjyqësore mund të kenë duke u bërë shkak edhe për dështimin e seancave gjyqësore.

Për sa më sipër gjykata, duke iu referuar dhe numrit të nëpunësve civilë gjyqësorë të kësaj gjykate i cili është sa gjysma e nëpunësve civilë gjyqësorë të gjykatave të tjera të të njëjtit nivel (po të shikohen statistikat kjo gjykatë ka më tepër ngarkesë), ka kërkuar në mënyrë të përsëritur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor shtesë të strukturës organike në pozicione të cilat janë imediate dhe ndikojnë drejtpërdrejtë në veprimtarinë e kësaj gjykate.

Këshilli i Lartë Gjyqësor për vitin 2025 (kohë e cila është jashtë periudhës së inspektimit) ka miratuar shtesën e organikës me 6 (gjashtë) punonjës të rinj përkatësisht 1 (një) shef sektori te burimet njerëzore; 1 (një) specialist buxheti; 1 (një) specialist prokurimesh; 1 (një) specialist protokolli; 1 (një) sekretare gjyqësore.

7.7. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve nuk është ndarë në seksione. Duke iu referuar numrit të gjyqtarëve efektivë që është 6 gjyqtarë, në gjykatë janë krijuar 2 trupa gjykues ndërsa është krijuar dhe vazhdon funksionimin vetëm seksioni për gjykimin e çështjeve të drejtësisë për të mitur.

7.8. Gjatë vitit 2023-2024 dhe gjatë periudhës objekt inspektimi 01.04.2024-30.06.2024 ka pasur lëvizje në trupën gjyqësore. Gjyqtari Sh. L., dhe gjyqtarja S. Xh., me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor janë caktuar në skemë delegimi të gjykojnë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një vit duke filluar nga data 13.03.2023 për z. Liçaj dhe nga data 16.10.2023 për znj. Xhani. Gjyqtarit Sh. L., i është shtyrë edhe për 1 vit afati si gjyqtar i përfshirë në skemën e delegimit.

Gjithashtu në datën 20.06.2024 gjyqtarja D. Ç., ka përfituar raport paralindje ndërsa gjyqtari A. V. me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor datë 31.07.2024 është transferuar për 1 (një) vit për të gjykuar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Këto lëvizje kanë sjellë si pasojë rindarjen e çështjeve duke sjellë një ngarkesë të shtuar për trupën gjyqësore.

Për periudhën objekt inspektimi 01.04.2024-30.06.2024 organika e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë ka qenë 7 gjyqtarë, ndërkohë që për muajin prill - maj 2024 kjo gjykatë ka funksionuar me 6 gjyqtarë efektivë ndërsa për muajin qershor ka funksionuar me 5 - 6 gjyqtarë efektivë. Gjithashtu mbajmë në konsideratë faktin se 3 gjyqtarë të kësaj trupe gjykuese janë gjyqtarë të emëruar në tetor të vitit 2023, me një eksperiencë pune rreth 5-6 muaj kur është iniciuar periodha objekt inspektimi.

7.9. Gjatë periudhës objekt inspektimi kanë qenë të disponueshme 4 salla, në të cilat seancat gjyqësore zhvillohen nga gjyqtarët në bazë të një kalendari të miratuar me urdhër të Zëvendës/Kryetarit të Gjykatës. Është për t'u theksuar se në muajin tetor të vitit 2024 kanë qenë funksionale vetëm 3 salla. Referuar analizës vjetore të gjykatës për vitin 2024 konstatohet se ndër të tjera parashtrohet se vetëm njëra nga sallat ofron kushtet minimale të solemnitetit, dhe se infrastruktura e gjykatës përbën shkak për zhvillimin jo në orar të proceseve gjyqësore, për shkak të përplasjes së orareve ndërmjet gjyqtarëve.

7.10. Referuar raportimit të vet gjykatës për përdorimin e sistemit të regjistrimit audio, gjatë periudhës 01.04.2024-30.04.2024 konstatohet se 97.9 % e seancave janë regjistruar audio.

7.11. Referuar të dhënave statistikore, gjatë periudhës 3 mujore objekt inspektimi, përkatësisht nga data 01.04.2024 - 30.06.2024, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, e përbërë nga 6 gjyqtarë, ka shpallur 170 vendime.

7.12. Referuar analizës së të dhënave në lidhje me periudhën kohore brenda së cilës çështjet kanë përfunduar, konstatohet se nga 170 çështje civile me palë kundërshtare të përfunduara, 23 çështje janë përfunduar brenda 30 ditëve, ndërsa 132 çështje janë përfunduar brenda një periudhe dyvjeçare. Numri më i lartë i vendimeve të shpallura lidhet me çështjet me objekt "zgjdhje martesë" të cilat zënë 41 % (70 çështje) të totalit të çështjeve të përfunduara gjatë tremujorit objekt inspektimi.

7.13. Koha mesatare e kohëzgjatjes se gjykimit për 170 çështjet civile me palë kundërshtare të përfunduara për periudhën 01.04.2024-30.06.2024 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, është 423 ditë. Kemi parasysh këtu faktin se koha mesatare i referohet kohëzgjatjes së çështjes që nga momenti i regjistrimit të kërkesëpadisë deri në shpalljen e vendimit që do të thotë se për çështjet e rindara (47 çështje) në përcaktimin e kohës mesatare është e përfshirë edhe koha që është mbajtur në gjykim nga gjyqtarët e caktuar më parë.

7.14. Referuar raportit vjetor të Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2024, koha mesatare për likuidimin e një çështjeje civile gjatë vitit 2024 për gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm është 256 ditë, ndërsa koha mesatare për gjykimin e një çështjeje civile gjatë vitit 2024 për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë është 214 ditë.

7.15. Totali i çështjeve të rindara, të përfunduara gjatë periudhës tre mujore objekt inspektimi, për të cilat ka pasur më shumë se një short është 47 çështje. Ndër këto çështje, evidentohen çështje të cilat janë shortuar dy herë, tre herë si dhe katër herë. Përkatësisht dy çështjet të cilat kanë kohëzgjatjen më të gjatë janë shortuar katër herë për kryesuesin e trupës gjyqësore ndërsa trupa gjyqësore referuar anëtarëve ka ndryshuar më shumë se katër herë⁴².

7.16. Nga analiza e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore sipas llojit të objektit të padisë konstatohet se koha mesatare më e shkurtër i referohet gjykimit të çështjeve me objekt “Sigurim padie”, “Lëshim urdhër mbrojtje” si dhe me objekt “Kundërshtimin e veprimeve përmbarrimore”.

7.17. Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore civile me palë kundërshtare të përfunduara gjatë periudhës kohore 01.04.2024-30.06.2024, në varësi të llojit të objektit të padisë paraqitet si më poshtë:

- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt “shpërblim dëmi” është 574 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt “kundërshtim veprime përmbarrimore” është 88 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt “lëshim urdhër mbrojtje/ urdhër i menjëhershëm i mbrojtjes” është 16 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt “pavlefshmëri dokumenti/ akti / titulli ekzekutiv” është 918 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt “pushim cenimi,” është 1164 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt “përmbushje detyrimi që rrjedh nga kontrata” është 642 ditë.

⁴² Shiko çështjen nr. 11232-01686-23-2014 si dhe çështjen nr. 21240-01201-23-2014 e cila është shortuar katër herë për kryesuesin ndërsa trupa gjyqësore referuar anëtarëve ka ndryshuar shtatë herë.

- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt “kthim shume” është 1389 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt “lirim dorëzim sendi” është 628 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt “njohje pronar” është 602 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt “deklarim falsifikimi” është 457 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt “zgjidhje martesë” është 192 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt “pjesëtim sendi” është 796 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt “vërtetim atësie” është 668 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt “sigurim padie” është 4 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt “të tjera” është 633 ditë.

Për sa më sipër, koha mesatare më e gjatë e gjykimit përkatësisht 1389 ditë ka të bëjë me gjykimin e llojit të çështjes “kthim lekësh” me objekt “detyrim kthim shume/shpërblim dëmi”.

7.18. Një vëmendje e veçantë gjatë inspektimit i është kushtuar çështjeve, kohëzgjatja e të cilave mund të çojë në konstatimin e shkeljes së të drejtës së individit për një proces gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme. Sikurse kemi konstatuar edhe më lart, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, për periudhën 01.04.2024-30.06.2024 ka shpallur 170 vendime. **Nga këto 170 çështje të përfunduara, numri i çështjeve të cilat kanë zgjatur më shumë se dy vjet është 38 çështje.**

7.19. Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ka shqyrtuar një kërkesë me objekt “Konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë”. Në lidhje me këtë kërkesë kjo gjykatë ka disponuar me vendim për “Rrëzim kërkesë”.

7.20. Nga studimi i shkaqeve të shtyrjes së seancave konstatohet se arsyet më të zakonshme lidhen me disa kategori:

- **Shkaqe që lidhen me vetë gjykatën.** Këtu përfshihen rastet e shtyrjeve të seancave për shkak të miratimit të dorëheqjes së gjyqtarit, për shkak të kalimit të çështjes në seancë me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë; për t’i dhënë mundësi anëtarit të ri të trupit gjykues të njihet me çështjen; mungesë të trupit gjykues për shkaqe shëndetësore apo shkaqe të tjera familjare; mbivendosje planifikimesh mes anëtarëve të trupit gjykues; planifikime seancash në datat kur: gjyqtari është në trajnim / kur është i deleguar në gjykata të tjera / në ditë festash.

Konstatohet se në shumicën e rasteve, gjykata shtyn seancën pasi merr vendim për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, si dhe gjykata shtyn seancën për shpallje vendimi.

Evidentohen të paktën 47 çështje të cilat janë të rishortuara dhe në këto raste shkak për shtyrjen e seancave është largimi i trupës gjyqësore për shkak të pezullimit/shkarkimit të gjyqtarëve si rrjedhojë e procesit të vettingut ose për shkak të caktimit (transferimit) të gjyqtarëve në gjykata të tjera.

- **Shkaqe që lidhen me mos marrjen dijeni të të paditurit për seancën e parë** - Gjukata shtyn seancën me qëllim njoftimin e të paditurve duke përsëritur njoftimin. Konstatohen raste kur gjykata ka përsëritur shpalljen publike më shumë se një herë dhe më pas ka marrë vendim për gjykimin në mungesë të të paditurit.
- **Shkaqe që lidhen me kërkesa të përsëritura për shtyrje nga ana e palës paditëse edhe e palës së paditur si dhe me mungesën e tagrave të përfaqësimit ose konstatimin e të metave të aktit të përfaqësimit** - Gjukata në përgjithësi ka pranuar kërkesat për shtyrje të paraqitura nga palët për arsye shëndetësore, të justifikuara me raport mjekësor si dhe ka shtyrë seancën për t'i dhënë mundësi përfaqësuesit të palës të paraqesë prokurën e rregullt.
- **Shkaqe që lidhen me njoftimin e personit të tretë** - Gjukata pranon kërkesën e palës paditëse dhe shtyn seancën me qëllim njoftimin e personave të tretë si dhe shtyn seancën për t'i dhënë mundësi personave të tretë të paraqesin provat e pretenduara prej tyre.
- **Shkaqe që kanë lidhje me caktimin e ekspertit/njoftimin e tij/kërkesat për ekspertim shtesë si dhe me dorëzimin e aktit të ekspertimit.** Konstatohet se në kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore një ndikim të konsiderueshëm ka edhe mënyra se si gjyqtari procedon në lidhje me caktimin, afatet, njohjen me aktin si dhe procedurën në tërësi të ekspertimit. Gjithashtu është konstatuar se në mënyrë të përsëritur ekspertët nuk dorëzojnë aktin në afatin e dakordësuar më parë. Gjithashtu është konstatuar se gjykata i'a njofton palëve aktin në seancë gjyqësore dhe si pasojë seanca shtyhet me qëllim që ata të njihen me aktin dhe të paraqesin parashtrimet e tyre.
- **Shkaqe që kanë lidhje me pezullimin e veprimtarisë gjyqësore** – për shkak të marrjes së masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19.
- **Shkaqe që lidhen me mosdorëzimin e provave nga institucionet** – në mënyrë të përsëritur shtyhen seancat për shkak se dokumentet e kërkuara tek këto të fundit, për nevoja të kryerjes së ekspertimit, nuk paraqiten në afatin e përcaktuar nga gjykata.
- **Shkaqe që kanë lidhje me kalimin procedural** – janë shtyrë seanca në mënyrë të përsëritur për shkak se nuk administrohet në afatin e përcaktuar nga gjykata certifikata e vdekjes dhe dëshmia e trashëgimisë.
- **Shkaku i shtyrjes lidhet me kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit.**

7.21. Konstatohet se palët kanë paraqitur kërkesë për përjashtim gjyqtari, edhe në vijim të procesit për shkak të mospajtit me qëndrimin e gjykatës në lidhje me një vendimmarrje të caktuar.

Gjithashtu konstatohen kërkesa për dorëheqje të paraqitura nga gjyqtarët si dhe miratime të këtyre kërkesave, jo vetëm pasi është shortuar çështja por edhe në vijim të procesit gjyqësor.

Duke iu referuar këtyre kërkesave, vlerësojmë të theksojmë se çdo magjistrat dhe aq më tepër kur magjistrati është duke ushtruar detyrën e gjyqtarit në seancë gjyqësore, gjatë gjykimit me dyer të hapura, në prezencë të palëve, duhet të manifestojë një sjellje të kujdesshme, me objektivitet, vetëpërbajtje dhe maturi. Gjyqtari duhet të marrë masat për të ruajtur standardin e gjyqtarit të përgjegjshëm dhe profesionist. Paanësia duhet të jetë e dukshme gjatë ushtrimit të funksioneve gjyqësore të gjyqtarit. Gjyqtari duhet të marrë masa për të shmangur çdo lloj situatë në të cilën individët mund të ndiejnë se po ndërmerret një qasje e njëanshme dhe t'i adresojë këto situata në momentin e duhur, në një mënyrë që të rrisë besimin dhe respektimin e palëve dhe publikut në tërësi për gjykatën.

7.22. Në kohëzgjatjen e gjykimit ndër të tjera ka ndikuar edhe administrimi me vonesë i akteve të cilat ndikojnë në vendimmarrjen e gjykatës për sa i përket kërkesës së palës për pezullimin e gjykimit. Konstatohen në mënyrë të përsëritur shtyrje të seancave për shkak se pala nuk ka vënë në dispozicion “dokumentin e kërkuar nga gjykata” që provon se në lidhje me çështjen objekt gjykimi ka një mosmarrëveshje në shqyrtim.

7.23. Nga analiza e shkaqeve të shtyrjeve të seancave konstatohet se një pjesë e shtyrjeve të tyre kanë ndodhur për shkak se gjyqtarët janë përfshirë në angazhime të tjera. Vlerësojmë se gjyqtarët duhet të mbajnë parasysh se ushtrimi i funksionit si gjyqtar ka përparësi mbi të gjitha aktivitetet e tjera dhe se gjyqtari duhet të kujdeset që angazhimi i tij në veprimtari jashtëgjyqësore të mos cenojë kryerjen me përkushtim të detyrave gjyqësore.

7.24. Në lidhje me distancën kohore nga seanca në seancë, konstatohet se distancat më të gjata kohore përkojnë me ato seanca kur periudha midis seancave është muaji gusht si dhe muaji dhjetor-janar. Kur gjykata e ka shtyrë seancën përtej muajit gusht apo përtej muajit dhjetor, konstatohet se ka relatuar edhe faktin e caktimit të një afati më të gjatë kohor sikurse ka qenë periudha e lejes vjetore të gjyqtarëve ose periudha e mbartjes së dosjeve në vitin pasardhës. Konstatohen raste se gjykata kur ka caktuar seancën në një distancë jo të afërt, ka relatuar se data e ardhme caktohet duke pasur parasysh ngarkesën e punës.

7.25. Kodi i Procedurës Civile me ndryshimet që ka pësuar me ligjin nr. 38/2017 e në vijim, ka parashikuar rregullime procedurale që kanë të bëjnë me shmangien e shkaqeve që sjellin zvarritje të proceseve gjyqësore civile, me qëllime për të nxitur eficiencën dhe efektshmërinë e sistemit të drejtësisë⁴³. Në këtë kontekst, janë parashikuar në Kod rregulla procedurale që kanë të bëjnë me zgjidhjen e çështjes jo vetëm me pajtim por edhe me ndërmjetësim (nenet 25, 158/ç të K.Pr.Civile); me abuzimin me të drejtat në proces (neni 34 i K.Pr.Civile); bashkimi i padive (neni 57); rregulla më të detajuara në lidhje me

⁴³ Shiko “Raport për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.81/16, datë 29.03.1996 “Kodi i procedurës civile i R.SH”, i ndryshuar.

“thirrjen në gjykatë”; “njoftimin shkresor të akteve”; “pasojat juridike të mosparaqitjes së palëve” në lidhje me përcaktimin e personit të autorizuar për marrjen e njoftimeve (nenet 129,130,131,179,133); janë shtuar rregulla në lidhje me mënyrën e njoftimit me shpallje publike (neni 133/a), etj.

7.26. Gjithashtu janë parashikuar në formën e një liste veprimet e nevojshme për t’u kryer nga gjyqtari pa caktuar seancë përgatitore ndër të cilat përmenden këto veprime: gjyqtari përjashton paditësin nga tarifa gjyqësore sipas rastit; cakton provat që do të merren në shqyrtim në seancë gjyqësore; cakton ekspertin të cilin ua njofton palëve; vendos për marrjen e provave dhe informacioneve tek të tretët sipas rastit; vendos për marrjen e masave për sigurimin e padisë, sigurimin e provës, pezullimin e gjykimit, sipas rastit në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile.

7.27. Nga analiza e çështjeve objekt inspektimi konstatohet se ka vend për përmirësim të veprimtarisë së gjyqtarëve në drejtim të përdorimit më të mirë të dispozitave ligjore të sipërcituara si dhe të burimeve të tjera të gjykatës me qëllim që proceset gjyqësore të përfundojnë brenda një afati të arsyeshëm.

7.28. Kodi i Procedurës Civile në ndryshim nga Kodi i Procedurës Penale nuk përcakton afat për distancën kohore midis seancave⁴⁴. Pavarësisht kësaj, gjykata gjatë shqyrtimit të çështjeve civile duhet të organizojë punën dhe të përcaktojë afatet e nevojshme në kuadër të zhvillimit sa më të mirë të procesit gjyqësor brenda një kohëzgjatje të arsyeshme. Në këtë kontekst gjyqtarët duhet të mbajnë në konsideratë jo vetëm shmangien e mungesës së planifikimeve por edhe menaxhimin e ngarkesës nëpërmjet një planifikimi efektiv të seancave, të shoqëruar me marrjen e masave të nevojshme që këto seanca të jenë realisht produktive.

7.29. Gjyqtari me marrjen dijeni se është caktuar si gjyqtar për çështjen konkrete duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet dhe vendimet në kuadër të miradministrimit të procesit gjyqësor për respektimin e afateve ligjore si dhe të afateve orientuese⁴⁵. Në vijim të këtij arsyetimi vlerësojmë se efektshmëria e procesit gjyqësor varet nga veprimtaria e gjyqtarit që në fazën fillestare të procesit⁴⁶ e cila konsiston në vlerësimin pa vonesë të kushteve të kërkesëpadisë dhe studimit paraprak të akteve bashkëngjitur si dhe në ndërmarrjen e veprimeve paraprake të përcaktuara në nenin 158/a të K.Pr.Civile (sipas rastit), të cilat ndikojnë në mbarëvajtjen e procesit gjyqësor. Kjo veprimtari paraqet rëndësi duke pasur parasysh edhe parashikimet ligjore se disa veprime të caktuara procedurale mund të kryhen vetëm derisa nuk është nxjerr urdhri për caktimin e seancës gjyqësore.

7.30. Gjithashtu konstatohet se ka vend për përmirësimin e veprimtarisë së gjykatës për sa i përket qëndrimit që duhet të mbajë ndaj veprimeve apo mosveprimeve, të palës ose

⁴⁴ Neni 171/a i K.Pr.Civile

⁴⁵ Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr.433 datë 22.07.2025 ka miratuar afatet standarde minimale kohore dhe sasiore për gjykimin e çështjeve gjyqësore.

⁴⁶ Neni 153 i K.Pr.Civile “Gjykimi i një çështjeje në gjykatë fillon me paraqitjen e kërkesëpadisë me shkrim”.

përfaqësuesit të saj/ të dëshmitarit / të ekspertit/ të një personi të tretë që nuk është palë, që shkaktojnë zvarritjen e procesit.

7.31. Për sa më sipër, gjykata gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor duhet të jetë në gjendje të identifikojë sjelljen e palës apo përfaqësuesit të saj në rast se abuzojnë me të drejtat procedurale për të shmangur seancat joproductive. Në këtë kontekst gjykata duhet të jetë aktive me qëllim marrjen e të gjitha masave të nevojshme për parandalimin e kësaj sjelljeje si dhe ndëshkimin e palës përgjegjëse duke urdhëruar gjëbajtjen e saj në referim të nenit 34 të K.Pr.Civile.

7.33. Jo vetëm palët por edhe personat e tjerë që marrin pjesë apo asistojnë në gjykimin e një çështjeje janë të detyruar në bazë të ligjit të japin ndihmesën e tyre për zhvillimin normal të hetimit gjyqësor dhe në rast se ata nuk u binden urdhrave të gjykatës, gjykata është e detyruar të marrë masat e nevojshme në respektim të neneve 165-168 të K.Pr.Civile.

7.34. Gjykata duhet të bëjë përpjekje për të pajtuar palët në mosmarrëveshje dhe/ose t'i njoftojë e t'i udhëzojë për mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim.

7.35. Në përfundim vlerësojmë se gjykata ka për detyrë të zhvillojë një proces të rregullt ligjor nëpërmjet garantimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm në përputhje me ligjin. Ajo duhet të ushtrojë të gjitha të drejtat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile të nevojshme për zhvillimin sa më të mirë të procesit gjyqësor dhe duhet të përdorë gjithë autoritetin e saj me qëllim rritjen e eficiencës dhe efektshmërisë së procesit gjyqësor.

7.36. Gjyqtarët duhet të mbajnë në vëmendje se gjykimi brenda një afati të arsyeshëm është e drejtë kushtetuese e individit dhe në këtë kontekst duhet të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme që gjykimet të përfundojnë brenda një afati të arsyeshëm.

8. REKOMANDIME

1. Rekomandime për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

- Raporti i inspektimit t'i njoftohet të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, në zbatim të parimit të transparencës së veprimtarisë inspektuese si dhe me qëllim që gjyqtarët, me marrjen në dorëzim të çështjeve për shqyrtim e në vijim, të mbajnë në konsideratë e t'i kushtojnë kujdesin e duhur:
- Veprimtarisë gjyqësore të zhvilluar para nxjerrjes së "Urdhrit për caktimin e seancës gjyqësore" në drejtim të përcaktimit të masave dhe vendimmarrjeve të nevojshme për mbarëvajtjen e procesit gjyqësor sipas një rendi kronologjik në respektim të rregullave procedurale të përcaktuara në nenet 153-158/b të K.Pr.Civile, që lidhen me vlerësimin

e kushteve të kërkesëpadisë dhe akteve bashkëngjitur, me veprimet paraprake dhe vendimet e gjyqtarit gjatë kësaj faze si dhe me seancën përgatitore (sipas rastit).

- Veprimtarisë gjyqësore që lidhet me drejtimin/zhvillimin e seancave, për sa i përket parandalimit dhe marrjes së masave të nevojshme ndaj abuzimit të palëve me të drejtat procedurale por edhe ndaj sjelljes së personave pjesëmarrës në proces apo që asistojnë procesin kur kjo sjellje mund të bëhet shkak për zvarritjen e procesit në referim të neneve 34, 101/2, 165-168 të K.Pr.Civile.
- Evitimit të shtyrjes së seancave të shkaktuara nga vetë gjykata për shkak të mosnjoftimit të rregullt të palëve⁴⁷; mungesës së koordinimit midis anëtarëve të trupit gjykues; përfshirjes së gjyqtarëve në angazhime të tjera; moskryerjes së veprimeve procedurale paraprake të nevojshme; mos vlerësimit të duhur të kërkesave për shtyrje si dhe në mënyrë të veçantë keqadministrimit të procesit të marrjes së provës me ekspert.
- Veprimtarisë gjyqësore që ka të bëjë me detyrën e gjykatës për të bërë përpjekje për të pajtuar palët në mosmarrëveshje dhe/ose të njoftojë e të udhëzojë palët për mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes përmes ndërmjetësimit në referim të neneve 25 dhe 158/ç të K.Pr.Civile.
- Veprimtarisë gjyqësore që ka të bëjë me shqyrtimin pa vonesë të kërkesës për përjashtim të gjyqtarit si dhe me zbatimin e sanksioneve të parashikuara nga neni 76 i K.Pr.Civile ndaj palës abuzuese, duke qenë se vonesa në shqyrtimin e këtyre kërkesave ndikon drejtpërsëdrejti në ecurinë e procesit gjyqësor.
- Respektimit të afatit të paraqitjes së kërkesave për leje vjetore veçanërisht në rastet kur kërkohet leje më shumë se tre ditë. Kërkesat drejtuar Kryetarit të Gjykatës për përfitim të lejes vjetore (më tepër se tre ditë), duhet të paraqiten të paktën një muaj para përfitimit të lejes.
- Të sigurohet koordinimi me kalendarin e planifikimit të seancave, në mënyrë që të shmanget planifikimi i seancave në periudhën e lejes, në ditët e festave zyrtare, apo në ditët kur gjyqtari është i angazhuar në veprimtari të tjera.
- Të tregohet kujdes i shtuar në drejtim të organizimit të punës në mënyrë që gjykimi i çështjes të përfundojë nga i njëjti trup gjykues.
- Të tregohet kujdes i shtuar në drejtim të shmangies së mungesës së planifikimeve por edhe menaxhimit të ngarkesës nëpërmjet një planifikimi efektiv të seancave, të

⁴⁷ Neni 128 i K.Pr.Civile "Njoftimi i akteve bëhet sipas mënyrave të parashikuara në këtë kre. Gjyqtari ose kryetari i trupit gjykues të çështjes kujdeset dhe kontrollon procesin e njoftimit, që kryhet nga punonjësit e gjykatës të caktuar për realizimin e tij".

shoqëruar me marrjen e masave të nevojshme që këto seanca të jenë realisht produktive.

- Të tregohet kujdes i shtuar në drejtim të planifikimit të balancuar të seancave, duke mbajtur në konsideratë përcaktimin e një tavani ditor dhe mujor planifikimesh me qëllim respektimin njëkohësisht të afateve ligjore, të afateve standarde minimale kohore e sasiore⁴⁸, si dhe garantimin e cilësisë së gjyqimit.

Ky rekomandim të zbatohet menjëherë.

- Këshilli i Gjykatës, të vlerësojë nevojën që në përshkrimet e punës të parashikuara në rregulloren e miratuar, të përcaktojë rregulla të hollësishme në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësve të gjykatës të ngarkuar me hedhjen e të dhënave në regjistrat fizikë, në sistemin e menaxhimit të çështjeve si dhe në procesverbalet e seancave, me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë dhe identifikimin e qartë të përgjegjësisë në lidhje me këtë proces.
- Kryetari i gjykatës të vlerësojë marrjen e masave për mundësinë e shfrytëzimit të ambienteve të gjykatës në mënyrë që gjykimi i të gjitha çështjeve me palë kundërshtarë të zhvillohen në salla gjykimi të pajisura me regjistrim audio.
- Kryetari i gjykatës të marrë masa që në regjistrat fizikë civilë dhe në të dhënat statistikore, të pasqyrohen minimalisht tregues lidhur me: rishortimet (duke shënuar datën e të gjitha rishortimeve dhe trupën gjyqësore të ricaktuar) si dhe pezullimin e çështjes (nëse çështja ka qenë e pezulluar).
- Kryetari i gjykatës, në konsultim me Këshillin e Lartë Gjyqësor të vlerësojë mundësinë e lidhjes së marrëveshjes me shërbimin postar me qëllim rritjen e aftësisë së punonjësve të këtij shërbimi për të realizuar në mënyrë të rregullt dhe me eficiencë procedurën e njoftimeve gjyqësore.
- Kryetari i gjykatës, në konsultim me Këshillin e Lartë Gjyqësor, të vlerësojë mundësinë e lidhjes së marrëveshjeve me Dhomën Kombëtare të Avokatisë për krijimin e mekanizmave të përshtatshëm që mundësojnë njoftimin e përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik në referim të nenit 129 dhe 141 të K.Pr.Civile.
- Kryetari i gjykatës, për sa i përket transparencës së veprimtarisë së gjykatës, të marrë masa që në vijim publikimi i tabelave standarde të kryhet në mënyrë të rregullt brenda dy javëve, pas përfundimit të çdo periudhe raportuese, në zbatim të nenit 37, shkronja "gj" të ligjit nr. 98/2016, si dhe vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 47, datë 11.02.2021.

Këto rekomandime të zbatohen brenda muajit dhjetor 2026.

- Kancelari i gjykatës të marrë masa për mbikëqyrjen, mbledhjen dhe përpunimin e saktë të të dhënave statistikore në referim të nenit 39, pika 2, shkronja "a" të ligjit nr.

⁴⁸ Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 433, datë 22.07.2025 "Për përcaktimin e afateve standarde minimale kohore dhe standardeve minimale sasiore për gjykimin e çështjeve.

98/2016 si dhe vendimit nr. 47, datë 11.02.2021 “Për miratimin e udhëzuesit për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe eficiencës së gjykatave”.

Ky rekomandim të zbatohet brenda muajit shtator të vitit 2026.

2. Rekomandime për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Rekomandime në lidhje me organikën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

- Këshilli i Lartë Gjyqësor, si institucioni përgjegjës për ndjekjen e çështjeve të burimeve njerëzore në gjykata⁴⁹, duhet të marrë masa efektive dhe të menjëhershme për plotësimin e organikës së gjykatës.

Ky rekomandim të zbatohet brenda muajit dhjetor 2026.

Rekomandime në lidhje me administrimin e infrastrukturës

- Këshilli i Lartë Gjyqësor në bashkëpunim me Kryetarin e Gjykatës dhe Këshillin e Gjykatës të vlerësojë marrjen e masave për mundësinë e shfrytëzimit të ambienteve të gjykatës në mënyrë që gjykimi i të gjitha çështjeve civile me palë kundërshtare të zhvillohet në salla gjykimi të pajisura me regjistrim audio.

Ky rekomandim të zbatohet brenda muajit dhjetor 2026.

Propozime

Bazuar në nenin 147/d, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 194, pika 4, dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, në cilësinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë,

PROPOZOJMË:

1. Përfundimin e inspektimit tematik me objekt “Mbi kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve gjyqësore civile, me palë kundërshtare, të përfunduara gjatë periudhës kohore 01.04.2024 – 30.06.2024, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë”, miratuar me vendimin nr. 19, datë 15.04.2025.
2. Ndjekjen e rekomandimeve sipas afateve të përcaktuara në raportin e inspektimit.
3. Njoftimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, për përfundimin e inspektimit tematik, duke i dërguar edhe një kopje të raportit të inspektimit.
4. Njoftimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, me raportin e inspektimit, duke i'u dërguar një kopje të këtij raporti.

INSPEKTORËT

Znj. Daniela Sulaj

Znj. Joana Sorraj

⁴⁹ Neni 90, pika 1 i ligjit nr. 115/2016.